



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për Auditimin financiar dhe të përputhshmërisë i
ushtruar në Ministrinë e Brendshme

RAPORT PËRFUNDIMTAR
MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË NË
“MINISTRINË E BRENDSHME”

TIRANË, Korrik 2024

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit	3
I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	8
II. HYRJA	12
a. Objektivat dhe qëllimi	12
b. Identifikimi i çështjes	13
c. Përgjegjësitë e Strukturave Drejtuese	13
d. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:	13
e. Kriteret e vlerësimit:	13
f. Standardet e Auditimit	14
g) Metodot e auditimit	15
h) Dokumentimi i auditimit	16
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	16
1. Informacion i Përgjithshëm	16
2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	17
2.1 Hartimi dhe zbatimin i buxhetit të shtetit.	17
2.2. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave	33
2.3 Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.	55
2.4 Auditimi i llogarive vjetore	62
2.5 Prokurimet me fonde publike	82
2.6 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm.	109
2.7 Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit	123
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	136

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.

a. Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 169/1, datë 31.01.2024, i ndryshuar, Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi Ministrinë e Brendshme (MB), për periudhën 01.01.2021-31.12.2023, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme, ndër të tjera, çështjeve që lidhen me:

1. Njohjen me aktivitetin ekonomiko-financiar të saj dhe organizimin e funksionimit sipas rregulloreve të miratuara,
2. Vlerësimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe auditimin e pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2021 dhe 2022 si dhe transaksionet financiare për gjithë periudhën objekt auditimi, detyrimeve të prapambetura etj.

Ministria e Brendshme ka për mision hartimin, zbatimin dhe zbërthimin e strategjive dhe politikave të punëve të brendshme, në përputhje me programin politik të Qeverisë. Ministria është aparati organizativ dhe profesional, që i shërben interesit publik me paanësi, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, duke kryer shërbimet publike dhe duke hartuar e zbatuar politikat e përgjithshme shtetërore në fushën e punëve të brendshme.

Kontrolli i Lartë i Shtetit si organi Kushtetues i kontrollit të fondeve buxhetore ka për qëllim që, nga studimi i vlerësimit të riskut në lidhje me menaxhimin e fondeve buxhetore vjetorë të MB, për sigurimin e kushteve të duhura për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues, të auditojë nëse këto fonde janë përdorur me ekonomicitet, efektivitet dhe eficiencë.

b. Rëndësia e auditimit.

Nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka një rëndësi të veçantë, për shkak të ndikimit në publik mbi transparencën dhe efektivitetin në përdorimin e fondeve të Buxhetit të shtetit, në drejtim të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, parandalimit të krimit të organizuar, sigurisë rrugore, luftën kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave etj.

c. Qëllimi i auditimit.

Qëllimi i këtij auditimi ishte dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën e auditimit nga data 01.01.2021 deri ne 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë gjetje e rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga MB. Në përmbushje të qëllimit të auditimit janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- *Hartimi dhe zbatimi i buxhetit.*

- *Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.*

- *Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.*

- *Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik.*

- *Zbatimi i dispozitave ligjore në funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm, etj.*

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes së të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat ku vlera

e blerjeve është e konsiderueshme. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të Audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme:

Verifikim i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se MB për periudhën në auditim, paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 28 gjetje/masa organizative, 3/Gjetje/masa për eliminimin e efekteve negative financiare dhe ka dhënë 39 rekomandime.

f. Gjetjet kryesore sipas drejtimeve.

I. Sipas drejtimit 1: Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit u konstatuan:

1. Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të investimeve u konstatua se Ministria e Brendshme ka realizuar projekte investime të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në PBA-të respektive, PBA 2022-2024 dhe PBA 2023-2025, konkretisht për 23 projekte në vitin 2022 dhe 15 projekte të realizuara gjatë vitit 2023.

2. Nga auditimi i situatës së detyrimeve të prapambetura për vitin 2022, rezulton se përgjatë periudhës ushtrimore ka pasur një rritje të tyre në shumën **246,608,212 lekë**, krahasuar me gjendjen e detyrimeve të prapambetura të raportuara në vitin 2021. Shtesa e detyrimeve për vitin 2022 ka ardhur kryesisht nga Institucioni i IKMT-së në shumën **120,700,596 lekë**. Nga auditimi i situatës së detyrimeve të prapambetura për vitin 2023, rezulton se përgjatë periudhës ushtrimore ka pakësim në shumën 324,344,696 lekë. Gjithashtu nga auditimi i raportimeve periodike mbi ecurinë e detyrimeve të prapambetura për të cilat MB ka dërguar në MFE, rezulton se vlera e raportuar mbi gjendjen e detyrimeve të prapambetura për vitin 2022 në MFE është në shumën **833,5 milionë lekë**, shumë e cila nuk rakordon dhe nuk pasqyrohet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të Konsoliduar të Institucionit ku është regjistruar gjendja e detyrimeve të prapambetura për vitin 2022, në shumën 819,641,150 lekë, për rrjedhojë me një diferencë të pa regjistruar dhe të pa kontabilizuar në krahasim me të dhënat e raportuara në MFE, në shumën **13,9 milionë lekë**. E njëjta situatë është edhe për vitin 2023 ku ka një diferencë të pa regjistruar dhe të pa kontabilizuar në krahasim me të dhënat e raportuara në MFE, në shumën **7,3 milionë lekë**.

Sa më sipër, nga ana e Institucionit të MB, nuk është hartuar dhe përcaktuar një strategji konkrete në lidhje me njohjen e saktë dhe reale të detyrimeve si edhe shlyerjen e tyre.

II. Sipas drejtimit 2: Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave, u konstatuan:

1. Në strukturat e Ministrisë së Brendshme të miratuara në periudhën objekt auditimi është konstatuar se, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar nuk ka varësi direkt nga Nëpunësi Autorizues, (NA) por është nën Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse duke cenuar varësisë direkt të marrëdhënies ndërmjet Nëpunësit Zbatues (NZ) dhe Nëpunësit Autorizues të njësisë publike çka nuk mundëson linjën direkt të raportimit të Nëpunësit Zbatues tek Nëpunësi i Autorizuar.

2. Menaxhim pa efektivitet dhe eficiencë i fondeve të buxhetit të shtetit përsa i përket dëmshpërblimit të gjyqe fituesve të larguar nga puna në vlerën **84,238 mijë lekë** e përbërë nga:

- 64,577 mijë lekë, paga (përfshirë këtu edhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore +TAP);

- 2,261, mijë lekë -shpenzime përmbarimore

- 17,399 mijë lekë - gjoba + kamatëvonesa në sigurime shoqërore dhe TAP

III. Sipas drejtimit 3: Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, u konstatuan:

1. Mosrespektimi i afatit ligjor lidhur me pagesat e faturave të konsumit të energjisë elektrike, ka sjellë që Ministria e Brendshme të penalizohet me kamatëvonesa në vlerën **68,626,842.82 lekë, menaxhim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve publike.**

2. Nga auditimi i urdhër shpenzimeve për pagesat e shpenzimeve gjyqësore, u konstatua se nga ana e MB janë kryer pagesat për vendimet gjyqësore ku përfshihen edhe tarifat përmbartimore me TVSH në vlerën 2,952,523 lekë. Për këto vlera nuk ka fatura tatimore dhe rrjedhimisht nuk është **mbajtur tatimi në burim në vlerën 442,878 lekë.**

IV. Sipas drejtimit 4: Auditimi i pasqyrave financiare, periudha 2021-2023, u konstatuan:

1. Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore, rezultoi se shuma e shlyer për to në vlerën 33,928,467 lekë, nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t'u shlyer.

- Si pasojë, llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nuk pasqyron vlerën e saktë në pasqyrat financiare të viteve 2021 dhe 2022. Në këtë zë nuk janë reflektuar detyrimet sa i takon shpenzimeve të periudhave të ardhshme për vendimet gjyqësore, të cilat kanë marrë formën e prerë përpara mbylljes së pasqyrave financiare të vitit ushtrimor sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos u njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë të Vendimit të Gjykatës, por janë njohur në momentin e likuidimit.

2. Nga auditimi i procedurës së inventarizimit dhe analitikut të llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” ka rezultuar se Sistemi i adresave, dhoma ICT në DPGJC, ndërtimi i ndërfaqes së komunikimit RKGJC dhe RKA dhe Portali ri sistemit regjistrir kombëtar të Gjendjes Civile nuk janë marrë në dorëzim nga AKSHI, të cilat aktualisht janë të regjistruara në llogarinë 218 “*Inventar ekonomik*” me vlerën 373,205,543 lekë edhe pse kanë kaluar 5 vite nga afati i përcaktuar në VKM. nr. 673, datë 22.11.2017 “*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*”, i ndryshuar, pika 18. Nga auditimi është konstatuar se këto aktive vazhdojnë të jenë pjesë e pasqyrave financiare të MB.

3. Nga kryqëzimi i të dhënave midis pasqyrave financiare fizike të MB-së me pasqyrat e dorëzuara nëpërmjet Sistemit Financiar Qeveritar (SIFQ), u konstatua se: Në pasqyrat e dorëzuara në Degën e Thesarit llogaria 17 “*Hua Afatgjatë*” paraqitet në shumën zero lekë, ndërsa në pasqyrat financiare në sistemin SIFQ, përkatësisht në pasqyrën e pozicionit financiar, kjo llogari paraqitet në shumën **34,977,500 lekë.** Kjo shumë përfaqëson një kredi të marrë për projektin e Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës (LAMP) nga IBRD, në vitin 2013 dhe është mbartur në pasqyra financiare që nga viti 2013, por nga Sektori i Financës nuk ka informacion për shlyerjen e saj.

4. Nga auditimi mbi regjistrimin e ndërtesave në ASHK, rezultoi se 2 (dy) ndërtesa me vlerë fillestare 502,927,990 lekë (Godina qendrore dhe Oborri i Ministrisë së Brendshme) janë të regjistruara dhe 9 (nëntë) ndërtesa me vlerë fillestare 80,344,402 lekë nuk janë të regjistruara. Objektet e paregjistruara, janë kryesisht tunele që i kanë shërbyer MB, të ndërtuara në vitet 1932 – 1935 (objekti “Shtylla” dhe 4 qendrat e ndërlidhjes, vendkomanda Linzë në vitin 1921 dhe 3 tunelet “Tomorri”, të ndërtuara nga viti 1970 – 1974.

Nga komisioni i inventarizimit, për llogarinë 212 “*Ndërtesa dhe Konstrukione*”, gjatë procedurës së inventarizimit, është mbajtur një tabelë me të dhënat përkatëse për të gjitha ndërtesat që MB ka në pronësi, për të cilat është konstatuar se 5 (pesë) ndërtesa, përkatësisht Qendrat e Ndërlidhjes Mullet me nr. 1, 2, 3, 4 dhe 5 janë objekte të amortizuara dhe shkatërruara plotësisht. Sa më sipër, nga ana e komisionit të inventarizimit të vitit 2021 dhe 2022, në fund të

procesit nuk është mbajtur asnjë procesverbal në terren, si dhe nuk është përgatitur një raport mbi inventarizimin e llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” veprime jo në përputhje me paragrafin 85/c të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar. Përpos konstatimeve të Komisionit të inventarizimit mbi dëmtimin apo mungesën e aktiveve, Ministria e Brendshme nuk ka marrë masa për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve.

V. Sipas drejtimit 5: Auditimi i procedurave të prokurimeve publike si dhe zbatimi i kontratave, për periudhën 2021-2023, u konstatuan:

1. Nga auditimi me përzgjedhje mbi bazë risku i procedurave të prokurimit “sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar” (gjithsej 35 procedura) për periudhën në auditim 2021-2023, si gjetje e përbashkët u konstatua:

-Në të gjitha rastet e audituara, procedurat e prokurimit realizohen kryesisht 1-2 ditë para datës së udhëtimit. Praktika e miratimit për pjesëmarrje në evente bëhet me vonesë nga Drejtoria e Kabinetit, jo menjëherë nga momenti i njoftimit nga organizatorët. Vonesa në fillimin e procedurave të prokurimit, sjell si pasojë blerjen e biletave të transportit ajror me kosto të lartë. Në disa nga urdhër shpenzimet e përzgjedhura për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar, si dhe në disa urdhër-pagesa të shërbimeve-dieta jashtë vendit të punonjësve, të likuiduara nëpërmjet arkës, u konstatua mungesa e ftesës së vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve.

2. Nga auditimi i 4 (katër) procedurave të prokurimit “Blerje e vogël” me objekt “Punë dhe shërbime”, në Ministrinë e Brendshme dhe konkretisht për procedurat:

-Procedura e hapur me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtjen e sistemit të kondicionimit në Ministrinë e Brendshme”, korrik 2021,

- Procedura e hapur me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtjen e gjeneratorit në Ministrinë e Brendshme”, nëntor 2021.

- Procedura e hapur me objekt: Shpenzime për mirëmbajtjen e sistemit të kondicionimit në Ministrinë e Brendshme”, maj 2022

- Procedura e hapur me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtjen e sistemit të kondicionimit në Ministrinë e Brendshme”, gusht 2023

U konstatua se KVO për blerjet e vogla nuk ka kryer verifikimin me korrektësi të plotësisimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, të vendosura nga vetë ky komision të cilat janë për të garantuar se OE që do të paraqiten pranë AK, janë të specializuara për ofrimin e shërbimit të kërkuar dhe për rëndësinë e punimeve që do të kryejnë në përputhje me standardet teknologjike, veprime në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020. Konkretisht kriteri bazë i vendosur për procedurat e sipërcituara ka qenë *punësimi nga OE, i të paktën 1(një) inxhinieri elektrik dhe një specialisti elektrik të licencuar, të certifikuar nga një institucion i formimit profesional* për të cilin në dosjen fizike nuk ka pasur dokumente që vërtetojnë praninë në skemën e sigurimeve shoqërore për të paktën një muaj. Grupi i auditimit ka verifikuar dhe ka konstatuar se OE lidhin kontrata punësimi dhe nuk bëjnë deklarin e këtyre punonjësve në liste pagesën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore në shkelje të detyrimeve kontraktuale si dhe në kundërshtim me Ligjin 9920 dt 19.05.2008, i ndryshuar “Për procedurat tatimore në RSH”. Në lidhje me mangësitë në plotësimin e kriterëve nga OE pjesëmarrës në garë dhe shpallur fitues, nga KVO-ja nuk rezulton të jetë kërkuar asnjë sqarim nga ofertuesi për të motivuar apo argumentuar vendimin e tyre në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

VI. Sipas drejtimit 6: Të tjera çështje të dala gjatë auditimit si dhe në zbatim të rekomandimeve të auditimit të mëparshëm kryer në MB, u konstatua se:

1.1 Nga auditimi u konstatua se prona me sipërfaqe 28,452 m2 ku ushtronte aktivitetin ish-

QSHAMT, institucion në varësi të MB, në harkun kohor prej 24 orësh, pa u kryer paraprakisht një studim dhe vlerësim i ankesës së ardhur nga qytetarët¹, në raport me interesat e Ministrisë së Brendshme dhe për funksionin e rëndësishëm që QSHAMT ka në administrimin dhe riparimin e mjeteve të MB dhe DPPSH, nëpërmjet vendimeve nr. 528, datë 25.07.2019 dhe nr. 529, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave, propozuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, kaluan përkatësisht në pronësi të MFE-së dhe pasuritë me nr. 3/771, 3/772, 3/773, 3/774, zona kadastrale 8240, me sipërfaqe totale 4,122 m² (7 herë më e vogël se sipërfaqja në të cilën ushtronte aktivitetin QSHAMT) me vendndodhje në Rrugën Hamdi Pepa, në përgjegjësi administrimi të MB-së, me qëllim që në këtë pronë të zhvendosej QSHAMT, veprime në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar. Konstatohet që veprimet e mësipërme janë të pastuduara dhe të nxituara, duke sjellë pasoja për Ministrinë e Brendshme, pasi asetet në pronësi të QSHAMT nuk mund të përshtaten në një sipërfaqe sa 1/7 e sipërfaqes që MB dispononte dhe aktualisht Drejtoria e Menaxhimit të Mjeteve të Transportit -DMMT (ish-QSHAMT), sot ende nuk ushtron aktivitetin e saj as në pronën e dhënë² me nr. 3/771, 3/772, 3/773, 3/774, me sipërfaqe totale 4,122 m². Procedura e tjetërsimit të pronës është kryer jashtë çdo afati kohor të parashikuar në dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndonëse nuk ka pasur asnjë emergjencë për inicimin e këtij projekt akti, ku për miratimin e VKM-ve do të duheshin minimalisht 10 ditë kalendarike nga propozimi tek miratimi i projekt-aktit, veprime që nuk janë në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", përgjegjësi kjo e MFE dhe MB.

1.2 Procesi i pastudiuar i tjetërsimit të pronave ka sjellë implikime financiare për buxhetin e shtetit, përdorim të fondeve buxhetore sipas VKM nr. 980, datë 02.12.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e projektimit, zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të Qendrës së Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit”, në vlerën 259,699 mijë lekë, *jashtë destinacionit të miratuar* nga ligjvënësi dhe për pasojë është shoqëruar me vonesa të procesit të rindërtimit dhe korigjimin në kohë të efekteve të fatkeqësisë natyrore për qytetarët e dëmtuar, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 97/2019 ‘Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore.

Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

1.1 Titullari i Institucionit në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit Strategjik, të marrin masat e nevojshme në mënyrë që në periudhat në vijim të eliminohen praktikatat e çeljes së projekteve të reja pa kaluar në procedurat e ciklit të menaxhimit të investimeve publike, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore.

1.2 Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për evidentimin dhe pasqyrimin real të detyrimeve të prapambetura në Pasqyrat Financiare, duke rakorduar me të dhënat e detyrimeve të paraqitura në MFE.

2.1 Titullari i MB në lidhje me pozicionin e Nëpunësit Zbatues të vlerësojë dhe të rishikojë modelin e organizimit të institucionit dhe të marrë masa për ndryshimin e varësisë funksionale të DBMF duke riorganizuar strukturën organike aktuale, miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.116, datë 28.07.2022, në mënyrë të tillë që të respektohen kriteret ligjore për eliminimin e mospërputhjes që cenon përmbushjen e objektivave të njësisë publike.

¹ Procedura e zhvendosjes së vendndodhjes së QSHAMT është iniciuar nga një letër-ankesë e datës **04.07.2019** dërguar nga shoqata “PSEDA-ILIRIA” për mbrojtjen dhe zhvillimin mjedisor, e cila kërkonte adresimin e çështjes së zhurmës që vinte nga parku i automjeteve të Ministrisë së Brendshme, çka sillte shqetësim për banorët.

² Vendimi nr. 529, datë 25.07.2019, i MFE.

2.2 Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave (Drejtoria e përgjithshme e tatimeve) të bashkëpunojnë dhe të marrin masa të menjëhershme në vlerësimin e detyrimit prej **17,399,158 lekë**, të cilat janë gjoba dhe kamatëvonesa në kontribute të sigurimeve shoqërore dhe Tatim mbi të ardhurat personale të gjeneruara prej vitit 2008 e në vijim, të pa pasqyruara në pasqyrat financiare të Ministrisë së Brendshme si detyrim i prapambetur e për rrjedhim i padeklaruar as në pasqyrat financiare të konsoliduara të MB në MFE.

- Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave të marrin masa për shlyerjen/sistemimin e këtij detyrimi i cili është evident në sistemin C@TS dhe “njihet” si i tillë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

3.1 Titullari i Institucionit në bashkëpunim me Strukturat Drejtuese, të marrin masat e nevojshme për shlyerjen e detyrimit pa vonesa të institucionit të MB-së kundrejt OSHEE, me qëllim shmangien e përdorimit të fondeve publike pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet si pasojë e llogaritjes së kamatëvonesave në shumën 68,626,842.82 lekë.

4.1 Titullari i Institucionit të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim verifikimin e shumës së huas prej 34,977,500 lekë, si dhe nga ana e Sektorit të Financës të bëhen sistemimet përkatëse në pasqyrat financiare me qëllim paraqitjen reale të detyrimeve që ka Ministria e Brendshme.

4.2 Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat, për verifikimin e gjendjes reale dhe statusin e pronave si dhe të kryhet vlerësimi i këtyre aktiveve, regjistrimi i tyre në ASHK, duke përgatitur të gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor.

5.1 AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një s' kualifikim apo kualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

1.2. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit.

1. Opinioni për auditimin financiar³: i kualifikuar⁴:

Ne kemi audituar hartimin dhe konsolidimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Brendshme, për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i zbatimit të parimeve kontabël si dhe i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinioni:

3 - Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

4 -Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit financiar “ të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3,5 (faqe 54 dhe 60-61), “Një “Opinion i Kualifikuar”, jepet në rastet kur: *audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.*”

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të institucionit më 31 dhjetor 2022, referuar kuadrit rregullator në fuqi:

Ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi kornizën e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, etj.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti dhe në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, kemi përmbushur përgjegjësitë etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale por jo të përhapura

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 7,485 mijë lekë, dhe bazuar në parregullsitë e mangësitë e konstatuara, sipas gjykimit profesional të audituesve justifikohet dhënia e opinionit të kualifikuar të auditimit.

Nga auditimi i kryer nga ana e KLSH-së, mbi vlerësimin integral të sistemit të mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar në institucionin e qeverisjes qendrore Ministria e Brendshme dhe subjektet e varësisë së saj, sipas kërkesave të legjislacionit mbi buxhetin dhe kontabilitetin, kanë rezultuar disa mangësi dhe parregullsi, të identifikuara si më poshtë vijon:

-Nga auditimi i Llogarive të Arkëtueshme, rezulton se llogaria 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba”, në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 32,989,574 lekë, shumë e cila përfaqëson të drejta që Institucioni ka ndaj palëve të treta (ku nga informacioni i vënë në dispozicion janë gjoba ndaj punonjësve që prej vitit 2005). Nga ana e strukturave përgjegjëse të MB nuk janë ndjekur gjithë procedurat dhe rrugët ligjore për arkëtimin në afat të këtyre të drejtave të regjistruara në kontabilitet, duke sjellë që këto shuma të jenë të paarkëtueshme dhe të rrezikohet parashkrimi i tyre, pasi ka humbur fuqia ligjore;

- Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura të regjistruara në kontabilitet, rezulton se llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2022, paraqitet në shumën 5,770,886 lekë, (e cila përbëhet nga detyrime ndaj OE “I****” për fatura të muajit mars të vitit 2022, në vlerën 1,997,574 lekë, nga detyrime të prapambetura për sigurime shoqërore në vlerën 2,803,534 lekë si dhe nga detyrime për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi në vlerën 945,528 lekë). Nga kryerja e testeve të auditimit nga KLSH, rezulton se:

1. Detyrimet e deklaruara për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si edhe ato për tatimin mbi të ardhurat personale, sipas regjistrimeve në sistemin C@ts, në fund të vitit 2022 janë në shumën 17,113,821 lekë, shumë kjo e cila nuk është kontabilizuar për vlerë të plotë në llogarinë nr.486 “shpenzime të periudhave të ardhshme” ku këto detyrime janë regjistruar vetëm për vlerën 3,749,062 lekë, me një diferencë të pa regjistruar dhe të pa kontabilizuar në shumën 13,364,759 lekë.

2. Detyrime të prapambetura për shpenzimet e energjisë elektrike të cilat MB ka kundrejt OSHEE, për periudhën prej vitit 2015 deri në muajin qershor 2022, si edhe kamatëvonesat respektive për 3 matësa, ku shuma në total është prej 136,142,855 lekë dhe përbëhet nga detyrimi në shumën 67,516,013 lekë e kamatëvonesat në shumën 68,626,842 lekë. Ky detyrim nuk është regjistruar si edhe të jetë njohur në kontabilitet në llogarinë nr. 486 “shpenzime të periudhave të

ardhshme”, duke sjellë për pasojë paraqitjen e një situate jo reale të detyrimeve të prapambetura të cilat Institucioni ka ndaj të tretëve në periudha të ndryshme.

3. Nga auditimi i vendimeve gjyqësore rezulton se për vitin 2022 janë likuiduar vendime të formës së prerë në shumën 17,407,291 lekë, që nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos i njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë nga Vendimet e Gjykatave, por janë njohur në momentin e likuidimit. Për sa më sipër, situata e paraqitur për detyrimet e prapambetura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të Institucioni të MB, nuk paraqet gjendjen reale të tyre dhe të detajuar, duke mos regjistruar dhe njohur në kontabilitet shumë detyrime të cilat kanë lindur edhe nga periudhat e mëparshme si edhe diferenca të verifikuara në sistemin tatimor, ku për rrjedhojë shuma totale prej 166,914,905 lekë, janë detyrime të prapambetura të pa regjistruara në kontabilitet për periudhën ushtrimore 2022.

- Nga auditimi i Llogarive të Pagueshme, rezulton se llogaria 17 “Huatë Afatgjata”, paraqiten në shumën prej 34,977,500 lekë, e cila përfaqëson një kredi të marrë për projektin e Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës (LAMP) nga IBRD nga viti 2013. Kjo kredi është e mbartur në Pasqyrat Financiare të konsoliduara që nga viti 2013 si dhe nuk ka një informacion mbi shlyerjen dhe planin e amortizimit të saj.

-Nga auditimi i procedurave të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve u konstatua se procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të finalizuara pasi nuk janë ndjekur nga proceset e daljes jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit të atyre aktiveve që nuk kanë destinacion tjetër, dhe pse nga komisioni i vlerësimit janë vlerësuar për dalje jashtë përdorimit në shumën 4,830,358 lekë.

-Nga grupi i auditimit u konstatua se për vitin 2021 dhe 2022, Kryetari i komisionit të inventarizimit është përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe anëtarë janë specialistët e Sektorit të Financës, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.11.2011, i ndryshuar, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 82.

Përgjegjësia e strukturave drejtuese të Subjektit

Strukturat menaxheriale të Ministrisë së Brendshme janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafit drejtues është përgjegjës për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Opinion për auditimin e përputhshmërisë (i Kualifikuar⁵).

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit Ministria e Brendshme me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e MB, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë”.

⁵ **Opinion i modifikuar/ kualifikuar:** Referuar Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH, miratur me Vendimin nr.245 date 29.12. 2022 të kryetarit të KLSH: “Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura”.

Baza për opinionin e përputhshmërisë.

Në kemi audituar veprimtarinë e subjektit Ministria e Brendshme (MB) në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42. Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet INTOSAI-PI, “Deklarata e Limës”; INTOSAI P-10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe INTOSAI P-12, INTOSAI P-20 dhe INTOSAI P-50, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 56, datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga MB dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa.

Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e *opinionit të kualifikuar*.

Raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara janë si më poshtë:

1. Vendimmarrja për tjetërsimin e pronës shtetërore ku zhvillonte veprimtarinë e saj, ish-QSHAMT-së, që ka implikuar kosto financiare në buxhetin e shtetit, si dhe prekur direkt aktivitetin e njësisë është kryer në mungesë të analizës së detajuar të shkaqeve dhe relacioneve kosto-përfitim, nga grupe te posaçëm vlerësimi, duke mbartur risqe për një proces vendimmarrjeje të paargumentuar dhe të pastudiuar.

Gjithashtu, ndryshimi i destinacionit të fondeve të rindërtimit në vlerën prej 259,699 mijë lekë dhe përdorimi i tyre për qëllime të tjera nga sa parashikuar në Aktin Normativ sipas ligjit nr. 97/2019 *Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”,* pra të destinuara për korrigjimin e pasojave të tërmetit, është konsideruar menaxhim pa efektivitet, duke i përdorur në rastin konkret për ndërtimin e një godine të re për QSHAMT-së e konstatuar më herët si e amortizuar.

2. Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të investimeve u konstatua se Ministria e Brendshme ka realizuar projekte investime të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në PBA-të respektive, PBA 2022-2024 dhe PBA 2023-2025, konkretisht për 23 projekte në vitin 2022 dhe 15 projekte të realizuara gjatë vitit 2023, në kundërshtim me VKM nr. 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, pika 7.

3. Nga auditimi i situatës së detyrimeve të prapambetura për vitin 2022, rezulton se përgjatë periudhës ushtrimore ka pasur një rritje të tyre në shumën 246,608,212 lekë, krahasuar me gjendjen e detyrimeve të prapambetura të raportuara në vitin 2021. Shtesa e detyrimeve për vitin 2022 ka ardhur kryesisht nga Institucioni i IKMT-së në shumën 120,700,596 lekë. Nga auditimi i situatës së detyrimeve të prapambetura për vitin 2023, rezulton se përgjatë periudhës ushtrimore ka pakësim në shumën 324,344,696 lekë. Gjithashtu nga auditimi i raportimeve periodike mbi ecurinë e detyrimeve të prapambetura për të cilat MB ka dërguar në MFE, rezulton se vlera e raportuar mbi gjendjen e detyrimeve të prapambetura për vitin 2022 në MFE është në shumën 833,5 milionë lekë, *shumë e cila nuk rakordon* dhe nuk pasqyrohet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të Konsoliduar të Institucionit ku është regjistruar gjendja e detyrimeve të prapambetura për vitin 2022, në shumën 819,641,150 lekë, për rrjedhojë *me një diferencë të pa*

regjistruar dhe të pa kontabilizuar në krahasim me të dhënat e raportuara në MFE, në shumën 13,9 milionë lekë. E njëjta situatë është edhe për vitin 2023 ku ka një diferencë të pa regjistruar dhe të pa kontabilizuar në krahasim me të dhënat e raportuara në MFE, në shumën 7,3 milionë lekë.

4. Mosrespektimi i afatit ligjor lidhur me pagesat e faturave të konsumit të energjisë elektrike, ka sjellë që Ministria e Brendshme të penalizohet me kamatëvonesa në vlerën 68,626,842.82 lekë, e konsideruar si menaxhim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve publike.

5. Nga auditimi i urdhër shpenzimeve për pagesat e shpenzimeve gjyqësore, u konstatua se nga ana e MB janë kryer pagesat për vendimet gjyqësore ku përfshihen edhe tarifat përmbartimore me TVSH në vlerën 2,952,523 lekë. Për këto vlera nuk ka fatura tatimore dhe rrjedhimisht nuk është mbajtur tatimi në burim në vlerën 442,878 lekë.

6. Menaxhim pa efektivitet dhe eficiencë i fondeve të buxhetit të shtetit përsa i përket dëmshpërblimit të gjyqe fituesve të larguar nga puna në vlerën 84,238 mijë lekë e përbërë nga:

- 64,577 mijë lekë, paga (përfshirë këtu edhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore +TAP);

- 2,261 mijë lekë -shpenzime përmbartimore

- 17,399 mijë lekë - gjoba + kamatëvonesa në sigurime shoqërore dhe TAP, të paregjistruara në kontabilitet duke dhënë një pozicion jo të drejtë të pasqyrave financiare për periudhën në auditim.

II. HYRJA

a. Objektivat dhe qëllimi.

Objektivat specifike të auditimit financiar ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:

-Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.

-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.

-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare. Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar. Audituesit shtetërorë do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.

Gjithashtu ky auditim ka për qëllim edhe kryerjen e auditimit të përputhshmërisë (pajtuueshmërisë) me qëllim përcaktimin nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si p.sh. me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; si dhe nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

b. Identifikimi i çështjes

Nga auditimi rezultoi se për periudhën 2021-2023, mbajtja e kontabilitetit dhe mbyllja e llogarive vjetore në Ministrinë e Brendshme (MB), është bërë në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Ministria është aparati organizativ dhe profesional, që i shërben interesit publik me paanësi, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, duke kryer shërbimet publike dhe duke hartuar e zbatuar politikat e përgjithshme shtetërore në fushën e punëve të brendshme. Ministria ushtron veprimtarinë e saj sipas VKM nr.604, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”. Ministria e Brendshme ushtron veprimtarinë e saj, në përputhje me legjislacionin përkatës, kryesisht, por jo vetëm, në fushat e përgjegjësisë shtetërore të poshtëshënuara, si dhe në çdo fushë tjetër përgjegjësie që i ngarkohet me ligj ose akte të Këshillit të Ministrave: të: a) rendit dhe sigurisë publike; b) luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikut të qenieve njerëzore; c) menaxhimit të integruar të kufirit dhe migracionit; ç) azilit dhe shtetësisë; d) antiterrorit dhe ekstremizmit të dhunshëm; dh) administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga krimi; e) veprimtarisë së prefektit të qarkut; ë) bashkërendimit me njësitë e qeverisjes vendore dhe shoqatat e të zgjedhurve vendorë; f) shërbimeve të gjendjes civile; g) hartimit të politikave, koordinimit dhe mbikëqyrjes së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri; gj) veprimtarisë së organit qendror blerës, me autorizim të Këshillit të Ministrave; h) parandalimit, mbrojtjes, mbikëqyrjes dhe kontrollit/inspektimit të zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tokës/territorit, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotje, dëmtime apo ndërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji.

c. Përgjegjësitë e Strukturave Drejtuese

Drejtimi i MB^{së} është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare dhe njerëzore në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

d. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të MB^{së}, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale. Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

e. Kriteret e vlerësimit:

Auditimi u krye duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”
- VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit” i ndryshuar;
- Udhëzimi MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”; i ndryshuar me Udhëzimin MF nr. 5, datë 21.02.2022.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";
- Urdhër i MFE nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”,
- Udhëzimi MFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”;
- Udhëzimet standard të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 7, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH^{së};
- Akte të tjera ligjore/nënligjore në zbatim të ligjeve të sipërcituar.

f. Standardet e Auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranura të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, nr .07, dt 17.01.2024, mbështetur në:

- Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- INTOSAI – P - 1 “Deklarata e Limës”;
- INTOSAI – P – 10 - 99 “Parimet themelore të INTOSAI”;
- INTOSAI – P - 10 “Deklarata e Meksikës mbi pavarësinë e SAP”;
- INTOSAI – P - 12 “Vlerat dhe përfitimet e SAI – sjellja e ndryshimit në jetën e qytetarëve”;
- INTOSAI – P - 20 “Parimet e Transparencës dhe Llogaridhënies”;
- INTOSAI – P - 50 “Parimet e juridiksionit të SAP”;
- ISSAI 100 - 129 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;
- ISSAI 2000 - 2899 “Standardet e Auditimit Financiar”;
- ISSAI 400 “Parimet e Auditimit të Përputhshmërisë”;
- ISSAI 4000 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”;
- ISSAI 2705 “Modifikimet e opinionit në Raportin e Audituesit të Pavarur”;
- Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 246, datë 29.12.2022;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 245, datë 29.12.2022.

g) Metodatat e auditimit

Mbështetur në **ISSAI 1315**, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 0,7-2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet. Nga përlogaritjet që grupi i auditimit kreu, për institucionin Ministrisë së Brendshme, niveli i materialitetit për vitin 2022 rezultoi në vlerën 7, 435 mijë lekë.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) *hartimit*; (b) *implementimit*; dhe (c) *funksionimit* të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontroleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të ulët deri në të moderuar.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara, metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Verifikimi i transaksioneve* - duke marrë informacion për një rrethanë ose transaksion nga një burim i caktuar, dhe krahasimin me një informacion të marrë për të njëjtat transaksione, por me origjinë nga një burim tjetër;

b. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;

c. *Raportet dhe informacionet* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht drejtimeve të auditimit;

d. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* - duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;

g. *Modelimet e thjeshta statistikore* – në lidhje me përzgjedhjen sa më përfaqësuese të shembullit për shqyrtim në çështje të caktuara të auditimit;

h. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

g. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të Audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit.

Auditimi ynë ka përfshirë përputhshmërinë e aktivitetit të MB, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi lidhur me zbatimin e kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e

informacioneve dokumenteve , procedurat për qarkullim e dokumentacionit, prokurimet duke filluar nga buxhetimi i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet e vlerësimit, kontraktuesi, zbatuesi i kontratës, procedurat për pagesat, etj.

h) Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet shënimeve, pyetësorëve, intervistave, verifikimeve të finalizuara në Akt Konstatimet, Projekt Raporti i auditimit, si dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Përfundimtar.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i Përgjithshëm

Ministria e Brendshme ka për mision, hartimin, zbatimin e strategjive dhe politikave të punës së brendshme , në përputhje me programin politik të Qeverisë. MB është aparati organizativ dhe profesional që i shërben interesit publik me paanësi, duke zbatuar legjisllacionin në fuqi, duke kryer shërbimet publike si dhe duke hartuar e zbatuar politikat e përgjithshme shtetërore në fushën e punëve të brendshme. Prioritetet kryesore strategjike të MB-së janë:

Ngritja e institucioneve të qëndrueshme, me profesionistë me integritet;

Institucione në shërbim të qytetarit;

Parandalimi, synim në luftën kundër korrupsionit;

Lufta kundër krimit të organizuar, sfidë madhore”: Siguria publike dhe shërbime efikase ndaj qytetarëve;

Kufij të sigurtë dhe menaxhim i integruar i tyre;

Lufta kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit;

Lufta kundër korrupsionit dhe pastrimit te parave;

Siguria rrugore;

Bashkëpunimi ndërinstytucional dhe ndërkombëtar, etj.

Ministria e Brendshme, aktualisht funksionon sipas strukturës organizative të miratuar me urdhër të Kryeministrit nr. 116, datë 28.07.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MB-së”. Për periudhën objekt auditimi ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore sipas pesë programeve buxhetore dhe konkretisht:

1. Programi “Planifikim Menaxhim Administrim”

2. Programi “Policia e shtetit”

3. Programi “Garda e Republikës”

4. Programi “Prefekturat dhe Funksionet e deleguara”

5. Programi “Gjendja Civile”

Objekt i këtij auditimi është rregullshmëria dhe përputhshmëria e operacioneve financiare të Aparatit të MB-së përgjatë vitit 2021,2022 dhe 2023.

Qëllimi i auditimit: Garantimi i sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Aparatit të MB-së, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit.

Vlerësimi i aktivitetit të MB-së, me qëllim dhënien e opinionit, është shtrirë sipas drejtimeve të programit të auditimit. Subjekt auditimi direkt nga grupi i auditimit, është Aparati i MB-së (për programet që ky i fundit administron). Për programet e tjera, i jemi referuar komunikimeve shkresore që lidhen me përgatitjet e PBA-ve, raportet e monitorimit si dhe është bërë një analizë më së shumti statistikore, mbi trendin e realizimit të tyre dhe krahasimet plan-fakt.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

2.1 Hartimi dhe zbatimin i buxhetit të shtetit.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

- 1) Programet Buxhetore Afatmesëm 2022-2024 dhe PBA-në 2023-2025;
- 2) Projektbuxheti për vitin 2021, vitin 2022 dhe 2023, si dhe shkresat e ndryshimit të buxhetit gjatë vitit ushtrimor;
- 3) Raportet e monitorimit të 4, 8 dhe 12-mujore të realizimit të buxhetit.

a. Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

Financimi i Ministrisë së Brendshme kryhet si më poshtë:

- Për shpenzimet për paga, sigurime, mallra dhe shërbime (llog. 600, llog. 601, llog. 602, 606 dhe 230-231) me financim të brendshëm nga fondet buxhetore;
- Për shpenzimet për investime (llog. 230 & llog. 231), të cilat financohen nga fondet buxhetore dhe financim i huaj.

Ministria e Brendshme është përgjegjëse për zbatimin e politikës së punëve të brendshme në Republikën e Shqipërisë, është aparati organizativ dhe profesional, që i shërben interesit publik me paanësi, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, duke kryer shërbimet publike dhe duke hartuar e zbatuar politikat e përgjithshme shtetërore në çështjet e punëve të brendshme.

Struktura buxhetore e Ministrisë së Brendshme për hartimin e PBA-së paraqitet në 5 programe buxhetore, si më poshtë:

- 1) Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrimi”;
- 2) Programi “Policia e Shtetit”;
- 3) Programi “Garda e Republikës”;
- 4) Programi “Prefekturat dhe Funkcionet e Deleguara”;
- 5) Programi “Shërbimi i Gjendjes Civile.”

Nën administrimin e Ministrisë së Brendshme përfshihen:

1. Policia e Shtetit;
2. Agjencia për Mbikëqyrjen Policore (AMP);
3. Garda e Republikës;
4. Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT);
5. Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV);
6. Qendra e Pushimit të MB-së, Durrës;
7. Qendra e Pritjes për Azil;
8. Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin (DPMZSH);
9. Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara;
10. Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm;
11. Agjencia e Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë;
12. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

▪ Programimi Buxhetor Afatmesëm në Ministrinë e Brendshme

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent i Sistemit të Planifikimit të Integruar. Ky dokument përdoret për të informuar Kuvendin e Shqipërisë dhe publikun e gjerë lidhur me planet e shpenzimeve të qeverisë për tre vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të qeverisë. Ai përcakton kontekstin afatmesëm të buxhetit vjetor. Kërkesat buxhetore të institucionit hartohen në bazë të programit buxhetor afatmesëm, në mënyrë që shpërndarjet e fondeve buxhetore të reflektojnë qëllimet e politikës dhe iniciativat e përcaktuara në programin e qeverisë gjatë një periudhe 3-vjeçare, në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit të MFE nr.7 datë 28.02.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm” dhe udhëzimit plotësues nr. 19, datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”. Planifikimi i zërave të shpenzimeve për “Fondin e pagave & sigurimeve shoqërore” (llog 600 dhe 601), është bazuar në nivelin aktual të punonjësve dhe strukturës së miratuar për secilin program buxhetor të pagave sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Llogaritja për shpenzime të tjera korrente (llog 602-606) është bazuar në kërkesat e institucioneve të varësisë së këtij institucioni, limiteve të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, limiteve të shpenzimeve të periudhave paraardhëse dhe realizimi i pritshëm të vitit.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II^e të PBA 2022-2024

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 janë miratuar me VKM nr. 440 datë 22.07.2021 “Për miratimin e taveve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”.

Me shkresën nr. 4239/19 prot., datë 31.08.2021 të SP në MB, janë përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MFE, kërkesat buxhetore, pasqyrat plotësuese të projektbuxhetit të vitit 2022 dhe relacioni shoqëruar (në përputhje me pikën 8.6, kapitulli 1 i udhëzimit standard për përgatitjen e PBA-së) për institucionet e varësisë dhe aparatit e MB-së në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, pra brenda afatit dhe sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin plotësues nr.19, datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e PBA 2022-2024”.

Tabela nr.1.1 - Planifikimi i fondeve sipas programeve në PBA 2022-2024 të hartuar nga Ministria e Brendshme, krahasuar me realizimin faktik të buxhetit të vitit paraardhës (viti 2021), paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Në mijë lekë

Programi	Emërtimi i programit	Fakti 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
01110	Planifikim Menaxhimi	1,450,289	1,364,689	1,449,329	1,452,624
03140	Policia e Shtetit	16,380,278	17,393,019	17,405,019	17,801,019
03150	Garda e Republikës	1,869,526	1,732,800	1,653,200	1,708,500
01160	Prefekturat dhe funksionet e deleguara	491,880	542,000	530,200	547,875
01170	Shërbimi i Gjendjes Civile	452,887	595,760	597,840	621,325
Totali		20,644,860	21,628,268	21,635,588	22,131,343

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MB

Nga të dhënat e paraqitura më sipër rezulton se shuma e planifikuar prej 21,628,268 mijë lekë për vitin 2022 në PBA është më e lartë krahasuar me buxhetin faktik të vitit 2021 në shumën 20,644,860 mijë lekë, ose me një rritje në masën prej 5%.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së I^e të PBA 2023-2025

Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Udhëzimin e MFE nr.8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e PBA 2023-2025”, Ministria e Brendshme ka hartuar dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025. Bazuar në VKM nr. 130 datë 02.03.2022 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, u miratuan tavanet përgatitore për ministrinë dhe institucionet buxhetore.

Për secilin program buxhetor janë ngritur e Ekipet e Menaxhimit të Programeve në Sistemin e MB nga struktura përkatëse me anë të shkresave nr. 2270/1 prot., datë 04.04.2022, nr.537/2 prot., datë 05.04.2022, nr. 2402/4 datë 01.04.2022, nr.2404/8 prot., 08.04.2022 dhe nr.1111/1 prot., datë 14.04.2022 veprime këto në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm.”

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II^ë të PBA 2023-2025

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 janë miratuar me VKM nr. 535 datë 29.07.2022 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”.

Me shkresën nr. 7664 prot., datë 31.08.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm në MB, janë përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MFE, kërkesat buxhetore, pasqyrat plotësuese të projektbuxhetit të vitit 2023 dhe relacioni shoqërues (në përputhje me pikën 8.6, kapitulli 1 i udhëzimit standard për përgatitjen e PBA-së) për institucionet e varësisë dhe aparatit e MB-së në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, pra brenda afatit dhe sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin plotësues nr.22, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e PBA 2023-2025.”

Tabela nr.1.2– Planifikimi i fondeve sipas programeve në PBA 2023-2025 të hartuar nga Ministria e Brendshme, krahasuar me realizimin faktik të buxhetit të vitit paraardhës (viti 2022), paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Në mijë lekë

Programi	Emërtimi i programit	Fakti 2022	Plan 2023	Plan 2024	Plan 2025
01110	Planifikim Menaxhimi	1,208,061	1,472,249	1,476,849	1,476,849
03140	Policia e Shtetit	18,277,498	19,523,528	19,168,773	18,232,151
03150	Garda e Republikës	1,794,060	1,960,300	1,930,000	1,930,000
01160	Prefekturat dhe funksionet e deleguara	539,308	525,370	510,000	510,000
01170	Shërbimi i Gjendjes Civile	426,812	647,700	646,000	701,000
Totali		22,245,739	24,129,147	23,731,622	22,850,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MB

Nga të dhënat e paraqitura më sipër rezultojnë se shuma e planifikuar prej 24,129,147 mijë lekë për vitin 2023 në PBA është më e lartë krahasuar me buxhetin faktik të vitit 2022 në shumën 22,245,739 mijë lekë, ose me një rritje në masën prej 8%.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së I^ë të PBA 2024-2026

Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Udhëzimin e MFE nr.5, datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e PBA 2024-2026”, Ministria e Brendshme ka hartuar dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026, i cili është dërguar me shkresën nr. 2760/21 prot., datë 28.04.2023.

Bazuar në VKM nr. 195 datë 05.04.2023 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”, u miratuan tavanet përgatitore për ministrinë dhe institucionet buxhetore.

Për secilin program buxhetor janë ngritur e Ekipet e Menaxhimit të Programeve në Sistemin e MB nga struktura përkatëse me anë të shkresave nr. 2894/1 prot., datë 28.03.2023, nr. 743/1 prot., datë 30.03.2023, nr.2760/10 prot., datë 11.04.2023, nr. 2760/6 prot., datë 03.04.2024 dhe 03.04.2024 veprime këto në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm.” Sa me më sipër, Ministria e Brendshme i ka implementuar fazat e PBA-së përmes sistemit AFMIS.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II^e të PBA 2024-2026

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 janë miratuar me VKM nr. 436 datë 19.07.2023 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”.

Me shkresën nr. 7647/12 prot., datë 31.08.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm në MB, janë përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MFE, kërkesat buxhetore, pasqyrat plotësuese të projektbuxhetit të vitit 2024 dhe relacioni shoqërues (në përputhje me pikën 8.6, kapitulli 1 i udhëzimit standard për përgatitjen e PBA-së) për institucionet e varësisë dhe aparatit e MB-së në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026, pra brenda afatit dhe sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin plotësues nr.22, datë 07.07.2023 “Për përgatitjen e PBA 2024-2026”.

▪ Grupi i Menaxhimit Strategjik

Me anë të Urdhrit të Ministrit nr.224 datë 11.04.2018 “Për krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik në Ministrinë e Brendshme”, u ngrit GMS i cili kryesohet nga ministri dhe anëtarët janë caktuar sipas funksioneve. Ky urdher nuk është rishikuar për çdo vit për të përcaktuar personat përgjegjës, si dhe nuk ka takime të dokumentuara të veprimtarisë së GMS, i cili duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, pika nr. 1, e nenit 27 “Takimet periodike ndërmjet menaxherëve të njësisë publike”, si dhe me Udhëzimin nr. 16 të MFE, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” pika nr. 3, paragrafi 2.2.4 “Roli i GMS në sistemin e MFK”, së, e cila përcakton se: “GMS duhet të mbledhet të paktën katër herë në vit. Vendimet duhet të jenë objektive dhe të merren si grup, (...).Vendimet e GMS duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike.”

▪ Ndryshimet midis PBA 2022-2024 dhe PBA 2023-2025

Nga auditimi i projekteve të investimit të planifikuara për vitin 2023 duke krahasuar PBA 2022-2024 dhe PBA 2023-2025, u konstatuan diferenca, të paraqitura në tabelën 1.1, në seksionin “Anekse”, sipas drejtimit 1.

Nga auditimi i ndryshimeve midis PBA 2022-2024 me PBA 2023-2025, u konstatuan se 14 projekte investimi, ku sipas PBA 2022-2024 janë parashikuar si projekte të reja në vlerë më të ulët, duke ruajtur tavanet buxhetore të miratuara, e më pas në PBA 2023-2025 rriten me një vlerë të konsiderueshme. Konkretisht, në PBA 2022-2024 janë parashikuar me një vlerë totale prej 458,408 mijë lekë, ndërsa në PBA 2023-2025 janë parashikuar në vlerën totale prej 981,369 mijë lekë, me një diferencë prej 522,961 mijë lekë.

Nga auditimi i planifikimit për vitin 2023, u konstatua se për 21 projekte investimi reflektohen me vlera të konsiderueshme më të ulëta në PBA 2023-2025, me qëllim ruajtjen e tavaneve të miratuara dhe alokimin e fondeve për projekte të reja. Konkretisht, për vitin 2023 në 21 projekte investimi, në PBA 2022-2024 parashikohen në shumën 578,719 mijë lekë, ndërsa në PBA 2023-2025 parashikohen në shumën 284,222 mijë lekë, me një diferencë prej 294,497 mijë lekë, të paraqitura në tabelën 1.2, në seksionin “Anekse”, sipas drejtimit 1.

Sa më sipër, nga ana MB-së evidentohet një parashikim i dobët sa i takon planifikimit të investimeve.

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit mbi përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe kryqëzimit dhe krahasimit të të dhënave midis PBA 2022-2024 dhe PBA 2023-2025, u konstatuan se 14 projekte investimi, sipas PBA 2022-2024 janë parashikuar si projekte të reja në vlerë më të ulët, duke ruajtur tavanet buxhetore të miratuara, e më pas në PBA 2023-2025 rriten me një vlerë të konsiderueshme. Konkretisht, në PBA 2022-2024 janë parashikuar me një vlerë totale prej 458,408 mijë lekë, ndërsa në PBA 2023-2025 janë parashikuar në vlerën totale prej 981,369 mijë lekë, me një diferencë prej 522,961 mijë lekë.

Nga auditimi i planifikimit për vitin 2023, u konstatua se për 21 projekte investimi nuk reflektohen në PBA 2023-2025, ose reflektohen me vlera të konsiderueshme më të ulëta, me qëllim ruajtjen e tavaneve të miratuara dhe alokimin e fondeve për projekte të reja. Konkretisht, për vitin 2023 në 21 projekte investimi, në PBA 2022-2024 parashikohen në shumën 578,719 mijë lekë, ndërsa në PBA 2023-2025 parashikohen në shumën 284,222 mijë lekë, me një diferencë prej 294,497 mijë lekë. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, pika 7 dhe Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” paragrafi 7.1, ku përcakton se “Të gjitha projektet e investimeve të reja duhet të përgatiten përmes formatit të propozimit të politikave të reja dhe të ndjekin procedurat e përgjithshme të shqyrtimit dhe miratimit të tyre.”

b. Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Investimet viti 2022

Referuar planit të investimeve të miratuar në projekt buxhet për vitin 2022, grupi i auditimit krahasoi këto projekte me projektet e çelura në vijim të miratimit të ligjit vjetor. Më hollësisht, në tabelën e mëposhtme paraqiten ndryshimet mes fondit të çelur me ligjin e buxhetit për vitin 2022 dhe planit sipas projekt buxhetit për projektet me financim të brendshëm, të paraqitura në tabelën 1.3, në seksionin “Anekse”, sipas drejtimit 1.

Nga ana e grupit të auditimit është kryer analiza dhe kryqëzimi i të dhënave përsa i përket projekteve të investimeve të realizuara gjatë vitit 2022 në raport me projektet e planifikuara në PBA 2022-2024, nga ku u konstatua se për 23 projekte (të listuara në tabelën 1.3) në shumën 343,148 mijë lekë, janë realizuar gjatë vitit 2022, por nuk ka qenë të planifikuara në PBA 2022-2024,

Investimet viti 2023

Referuar planit të investimeve të miratuar në projekt buxhet për vitin 2023, grupi i auditimit krahasoi këto projekte me projektet e çelura në vijim të miratimit të ligjit vjetor. Më hollësisht, në tabelën 1.4, në seksionin “Anekse”, sipas drejtimit 1, paraqiten ndryshimet mes fondit të çelur me ligjin e buxhetit për vitin 2023 dhe planit sipas projekt buxhetit për projektet me

financim të brendshëm.

Nga ana e grupit të auditimit është kryer analiza dhe kryqëzimi i të dhënave përsa i përket projekteve të investimeve të realizuara gjatë vitit 2023 në raport me projektet e planifikuara në PBA 2023-2025, nga ku u konstatua se për 15 projekte (të listuar në tabelën më sipër) në shumën 204,347 mijë lekë, janë realizuar gjatë vitit 2023 por nuk ka qenë të planifikuara në PBA 2023-2025.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nr.40, Udhëzimin nr.9, datë 20.03.2018, i MFE-së “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika nr.64; VKM 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, Aneksi 1, Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” paragrafi 7.1, ku përcakton se “Të gjitha projektet e investimeve të reja duhet të përgatiten përmes formatit të propozimit të politikave të reja dhe të ndjekin procedurat e përgjithshme të shqyrtimit dhe miratimit të tyre.”

Konkluzion: Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të investimeve u konstatua se Ministria e Brendshme ka realizuar projekte investime të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në PBA-të respektive, konkretisht:

- Për vitin 2022, nga analiza dhe kryqëzimi i të dhënave të projekteve të investimit të realizuara gjatë vitit 2022 në raport me projektet e planifikuara në PBA 2022-2024, u konstatua se për 23 projekte me vlerë 343,148 mijë lekë, janë realizuar gjatë vitit 2022, por nuk ka qenë të planifikuara në PBA 2022-2024;

- Për vitin 2023, nga analiza dhe kryqëzimi i të dhënave të projekteve të investimit të realizuara gjatë vitit 2023 në raport me projektet e planifikuara në PBA 2023-2025, u konstatua se për 15 projekte investimi me vlerë 204,347 mijë lekë, janë realizuar gjatë vitit 2023 por nuk ka qenë të planifikuara në PBA 2023-2025. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nr.40, Udhëzimin nr.9, datë 20.03.2018, i MFE-së “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika nr.64; VKM 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, Aneksi 1, Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” paragrafi 7.1, ku përcakton se “Të gjitha projektet e investimeve të reja duhet të përgatiten përmes formatit të propozimit të politikave të reja dhe të ndjekin procedurat e përgjithshme të shqyrtimit dhe miratimit të tyre.”

▪ Rishpërndarja e fondeve

Nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua se për periudhën objekt auditimi nga Ministria e Brendshme është kryer një numër i konsiderueshëm rishikimesh, duke kërkuar lëvizje fondesh në projektet ekzistuese, si dhe duke shtuar projekte te reja gjatë vitit, të cilat nuk janë çelur pa kaluar në procesin ligjor të miratimit të Planit Buxhetor Afatmesëm. Nga ana e MB, në vitin 2021 janë kryer 48 rishikime buxhetore, për vitin 2022 janë kryer 41 rishikime buxhetore dhe për vitin 2023, janë kryer 42 rishikime buxhetore, ndryshime të cilat kanë ardhur jo vetëm si rezultat i akteve normative të miratuara gjatë vitit, por edhe si pasojë e vendimmarrjes për kryerjen e rishpërndarjes së fondeve me impakt në buxhetin MB, e cila konsiderohet me impakt negativ në treguesit e monitorimit të buxhetit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 75 ku citohet “Numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore mund të

përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit”.

▪ Raportet e monitorimit

Nga ana institucioneve të varësisë si dhe nga vetë aparati i Ministrisë së Brendshme, si njësi shpenzuese, nuk janë hartuar raporte monitorimi 4 mujore për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit të secilës njësi shpenzuese më vete, për të garantuar përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, ndjekjen dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara, sipas deklaratës së politikës së programit, si dhe krahasimin e treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik. Raportet e monitorimit janë hartuar në bazë të programeve buxhetore nga Ekipi i Menaxhimit të Programeve, ku monitorimi është kryer për të gjithë programet e MB-së pa hartuar raporte 4 mujore monitorimi për Aparatin e MB-së si njësi shpenzuese më vete. Duke qenë në kushtet ku programet sipas së cilave aparati i MB realizon pagesat, janë programe ku realizohen pagesa edhe të institucioneve të tjera të varësisë, rrjedhimisht nuk mundësohet identifikimi i buxhetit që administrohet vetëm nga aparati i MB-së. Kjo situatë, ku nuk kryhet krahasimi i treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik për shpenzimet e realizuara vetëm nga aparati, mund të bëhet shkak për të ndjekur arritjen e qëllimit me objektivat e synuar sipas deklaratës së politikës së programit për të garantuar përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, duke kryer në kohë propozime/rekomandime për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese nëpërmjet alokimit të burimeve. Paraqitja e informacionit si dhe të dhënat e raportuara në raportet e monitorimit rezultojnë në përputhje me përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016 dhe Udhëzimin nr. 14 datë 30.05.2023 *“Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”*.

Nga ana e Ministrisë së Brendshme nuk janë publikuar në faqen zyrtare të internetit raportet e monitorimit të institucionit.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin nr.22 të MFE, datë 17.11.2016 dhe Udhëzimin nr. 14 datë 30.05.2023 *“Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”*, kapitulli 4, pika 49 dhe Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 *“Për procedurat standarde të Zbatimit të Buxhetit”*, kapitulli VI, pika 271.

▪ Realizimi i planit të buxhetit

Viti 2021

Realizimi i fondeve buxhetore sipas artikujve për 12-mujorin e vitit 2021 rezulton si vijon:

Në lekë

Llogaria ekonomike	Plani fillestar	Plani me ndryshime	Realizimi faktik 12 mujor	% realizimit
600.Paga	14,022,418	13,912,371	13,861,847	100%
601. Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	2,456,362	2,238,672	2,211,596	99%
602. Mallra dhe shërbime	2,590,120	3,222,767	3,156,252	98%
603.Subvencion	-	-	-	-
604. Transferta të brendshme	-	-	-	-
605. Transferta të jashtme	13,500	13,500	10,993	81%
606. Transferta për familjet dhe individët	278,600	397,683	392,357	99%
231.Investim me financim të brendshëm	881,000	878,508	777,354	88%
231.Investim me financim të huaj	618,868	348,268	234,461	67%
TOTALI	20,860,868	21,011,769	20,644,860	98%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MB

Buxheti i planifikuar për vitin 2021 në Ministrinë e Brendshme është realizuar në masën 98% ndaj buxhetit me ndryshime. Plani fillestar paraqitet në shumën 20,861 milionë lekë, ndërsa buxheti me ndryshime paraqitet në shumën 21,011 milionë lekë, i cili është realizuar në shumën prej 20,645 milionë lekë dhe detajuar sipas programeve buxhetore si vijon:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi i Programit	Buxheti Vjetor Viti 2021	Buxheti rishikuar	Realizimi 2021	Realizimi në %
1	Planifikim Menaxhimi	1,294,849	1,478,073	1,450,289	98%
2	Policia e Shtetit	16,763,019	16,632,727	16,380,278	98%
3	Garda e Republikës	1,645,000	1,888,000	1,869,526	99%
4	Prefekturat dhe funksionet e deleguara	517,000	539,069	491,880	91%
5	Shërbimi i Gjendjes Civile	641,000	473,900	452,887	96%
Totali		20,860,868	21,011,769	20,644,860	98%
Shpenzime nga te ardhurat jashtë limitit				166,030	0

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MB

Sa më sipër, rezulton se në Ministrinë e Brendshme janë realizuar shpenzimet buxhetore në nivelin 98% dhe referuar programeve buxhetore paraqitet si vijon:

Referuar programeve buxhetore rezulton se fondet e akorduara për programin buxhetor “Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi” përbëjnë 7 % të buxhetit me ndryshime të miratuara për MB-në, për vitin 2021, të cilat janë përdorur për financimin e 20 projekteve të investimit me vlerë 1,461,537 mijë lekë.

Fondet e akorduara për programin buxhetor “Policia e Shtetit” përbëjnë 79,2 % të buxhetit me ndryshime të miratuara për MB-në, për vitin 2021, të cilat janë përdorur për financimin e 40 projekteve të investimit me vlerë 16,535,060 mijë lekë. Qëllimi i këtij programi është lufta pa kompromis dhe ndëshkimi i ashpër penal ndaj grupeve dhe /ose organizatave kriminale të ndryshme, si dhe i grupeve me axhenda ekstremiste të dhunshme dhe terroriste duke shënjestruar dhe goditur veprimtarinë e krimit të organizuar e rrjetet kriminale, sekuestruar dhe konfiskuar çdo aset ekonomik të paligjshëm, përforcimi i zbatimit të ligjit për rritjen e nivelit të sigurisë publike dhe asaj rrugore. Menaxhimi efektiv, eficient dhe i integruar i kufijve nëpërmjet mirëfunksionimit të 27 pikave të kalimit kufitar në Republikën e Shqipërisë, forcimi i kapaciteteve institucionale, garantimi i pavarësisë operationale të policisë së shtetit dhe konsolidimi i arsimit, kualifikimit dhe veçanërisht trajnimit të vazhdueshëm e të profilizuar të strukturave të Policisë së Shtetit.

Fondet e akorduara për programin buxhetor “Garda e Republikës” përbëjnë 9% të buxhetit me ndryshime të miratuara për MB-në, për vitin 2021, të cilat janë përdorur për financimin e 5 projekteve të investimit me vlerë 1,869,526 mijë lekë.

Qëllimi i këtij programi është: të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të Sigurisë së Personaliteteve Vendas dhe të Huaj, të Objekteve të Rëndësisë së Veçantë nëpërmjet rritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe përputhjes me standardet evropiane në fushën e sigurisë, duke synuar arritjen e nivelit 100% të sigurisë.

Fondet e akorduara për Programin “Prefekturat dhe funksionet e deleguara” përbëjnë rreth 2.6 % të buxhetit me ndryshime të miratuar për MB-në për vitin 2021, të cilat janë përdorur për financimin e 21 projekteve të investimit me vlerë 491,880 mijë lekë. Qëllimi i këtij programi është ndjekja e zbatimit të programit të Qeverisë në nivel vendor, si përfaqësues i qeverisë.

Fondet e akorduara për Programin “Gjendja Civile” përbëjnë rreth 2.3 % të buxhetit me

ndryshime të miratuar për MB-në për 12-mujorin e vitit 2021, të cilat janë përdorur për financimin e 2 projekteve të investimit me vlerë 452,887 mijë lekë. Qëllimi i këtij programi është konsolidimi i mëtejshëm i një sistemi të digjitalizuar të regjistrit kombëtar të gjendjes civile (RKGJC), të sistemit të regjistrit kombëtar të adresave (RKA) dhe regjistrimi/përditësimi i të dhënave të shtetasve në Republikën e Shqipërisë me vërtetësi dhe në kohë reale.

Në total shpenzimet e realizuara nga të ardhurat jashtë planit limit për vitin 2021 paraqiten në shumën 166,030 mijë lekë, përkatësisht Programi “Policia e Shtetit”, në shumën 154,782 mijë lekë dhe Programi “Planifikim menaxhimi dhe administrimi”, në shumën 11,248 mijë lekë.

Viti 2022

Realizimi i fondeve buxhetore sipas artikujve për 12-mujorin e vitit 2022 rezulton si vijon:

Në lekë

Llogaria ekonomike	Plani fillestar	Plani ndryshime me	Realizimi faktik 12 mujor	% e realizimit
600.Paga	14,388,513	14,101,840	14,064,932	99.74%
601. Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	2,408,210	2,298,544	2,282,502	99.3%
602. Mallra dhe shërbime	2,745,887	3,671,644	3,595,388	97.9%
603.Subvencion	0	0	0	0.0%
604. Transferta të brendshme	0	0	0	0.0%
605. Transferta të jashtme	13,500	16,700	15,544	93.1%
606. Transferta për familjet dhe individët	285,000	638,077	626,873	98.2%
231.Investim me financim të brendshëm	1,000,000	1,039,598	853,382	82.1%
231.Investim me financim të huaj	350,290	683,290	807,118	118.1%
TOTALI	21,191,400	22,449,693	22,245,739	99.1%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MB

Buxheti i planifikuar për vitin 2022 në Ministrinë e Brendshme është realizuar në masën 99% ndaj buxhetit me ndryshime. Plani fillestar paraqitet në shumën 21,191 milionë lekë, ndërsa buxheti me ndryshime paraqitet në shumën 22,449 milionë lekë, i cili është realizuar në shumën prej 22,246 milionë lekë dhe detajuar sipas programeve buxhetore si vijon:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi i Programit	Buxheti Vjetor Viti 2022	Buxheti i rishikuar	Realizimi 2022	Realizimi në %
1	Planifikim Menaxhimi	1,339,230	1,234,262	1,208,061	98%
2	Policia e Shtetit	16,897,610	18,355,249	18,277,498	100%
3	Garda e Republikës	1,811,800	1,804,215	1,794,060	99%
4	Prefekturat dhe funksionet e deleguara	587,000	590,958	539,308	91%
5	Shërbimi i Gjendjes Civile	555,760	465,009	426,812	92%
Totali		21,191,400	22,449,693	22,245,739	99%
Shpenzime nga te ardhurat jashtë limitit				196,947	0

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MB

Sa më sipër, rezulton se në Ministrinë e Brendshme janë realizuar shpenzimet buxhetore në nivelin 99% dhe referuar programeve buxhetore paraqitet si vijon:

Referuar programeve buxhetore rezulton se fondet e akorduara për programin buxhetor “Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi” përbëjnë 5.5 % të buxhetit me ndryshime të miratuara për MB-në, për vitin 2022, të cilat janë përdorur për financimin e 16 projekteve të investimit me vlerë 1,216,530 mijë lekë.

Fondet e akorduara për programin buxhetor “Policia e Shtetit” përbëjnë 81.8 % të buxhetit me ndryshime të miratuara për MB-në, për vitin 2022, të cilat janë përdorur për financimin e 49 projekteve të investimit me vlerë 18,465,976 mijë lekë.

Fondet e akorduara për programin buxhetor “Garda e Republikës” përbëjnë 8% të buxhetit me ndryshime të miratuara për MB-në, për vitin 2022, të cilat janë përdorur për financimin e 3 projekteve të investimit me vlerë 1,794,060 mijë lekë.

Fondet e akorduara për Programin “Prefekturat dhe funksionet e deleguara” përbëjnë rreth 2.6 % të buxhetit me ndryshime të miratuar për MB-në për vitin 2022, të cilat janë përdorur për financimin e 19 projekteve të investimit me vlerë 539,308 mijë lekë.

Fondet e akorduara për Programin “Gjendja Civile” përbëjnë rreth 1.9 % të buxhetit me ndryshime të miratuar për MB-në për 12-mujorin e vitit 2022, të cilat janë përdorur për financimin e 2 projekteve të investimit me vlerë 426,812 mijë lekë.

Në total shpenzimet e realizuara *nga të ardhurat jashtë planit limit* për vitin 2022 paraqiten në shumën 196,947 mijë lekë, përkatësisht Programi “Policia e Shtetit”, në shumën 188,478 mijë lekë dhe Programi “Planifikim menaxhimi dhe administrimi”, në shumën 8,469 mijë lekë.

Viti 2023

Realizimi i fondeve buxhetore sipas artikujve për 12-mujorin e vitit 2023 rezulton si vijon:

Në lekë

Llogaria ekonomike	Plani fillestar	Plani me ndryshime	Realizimi faktik 12 mujor	% e realizimit
600.Paga	15,565,159	16,233,113	16,146,049	99.46%
601. Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	2,607,736	2,643,774	2,611,755	98.79%
602. Mallra dhe shërbime	3,497,187	5,173,836	5,108,674	98.74%
603.Subvencion	-	-	-	-
604. Transferta të brendshme	-	20,000	20,000	100.00%
605. Transferta të jashtme	13,500	14,600	11,723	80.29%
606. Transferta për familjet dhe individët	555,488	763,083	754,051	98.82%
231.Investim me financim të brendshëm	1,430,000	1,310,872	1,303,375	99.43%
231.Investim me financim të huaj	460,077	460,077	356,146	77.41%
TOTALI	24,129,147	26,619,355	26,311,773	98.84%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MB

Buxheti i planifikuar për vitin 2023 në Ministrinë e Brendshme është realizuar në masën 99% ndaj buxhetit me ndryshime. Plani fillestar paraqitet në shumën 24,129 milionë lekë, ndërsa buxheti me ndryshime paraqitet në shumën 26,619 milionë lekë, i cili është realizuar në shumën prej 26,311 milionë lekë dhe detajuar sipas programeve buxhetore si vijon:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi i Programit	Buxheti Vjetor Viti 2023	Buxheti i rishikuar	Realizimi 2023	Realizimi në %
1	Planifikim Menaxhimi	1,472,249	1,620,980	1,582,785	97.6%
2	Policia e Shtetit	19,523,528	21,529,476	21,369,547	99.3%
3	Garda e Republikës	1,960,300	2,085,800	2,082,187	99.8%
4	Prefekturat dhe funksionet e	525,370	632,601	580,676	91.8%

	deleguara				
5	Shërbimi i Gjendjes Civile	647,700	750,497	696,580	92.8%
<i>Totali</i>		<i>24,129,147</i>	<i>26,619,354</i>	<i>26,311,775</i>	<i>98.8%</i>
Shpenzime nga te ardhurat jashtë limitit				271,324	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MB

Sa më sipër, rezulton se në Ministrinë e Brendshme janë realizuar shpenzimet buxhetore në nivelin 99% dhe referuar programeve buxhetore paraqitet si vijon:

Referuar programeve buxhetore rezulton se fondet e akorduara për programin buxhetor “Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi” përbëjnë 6 % të buxhetit me ndryshime të miratuara për MB-në, për vitin 2023, të cilat janë përdorur për financimin e 15 projekteve të investimit me vlerë 1,610,306 mijë lekë.

Fondet e akorduara për programin buxhetor “Policia e Shtetit” përbëjnë 81 % të buxhetit me ndryshime të miratuara për MB-në, për vitin 2023, të cilat janë përdorur për financimin e 50 projekteve të investimit me vlerë 21,613,350 mijë lekë.

Fondet e akorduara për programin buxhetor “Garda e Republikës” përbëjnë 8% të buxhetit me ndryshime të miratuara për MB-në, për vitin 2023, të cilat janë përdorur për financimin e 3 projekteve të investimit me vlerë 2,082,187 mijë lekë.

Fondet e akorduara për Programin “Prefekturat dhe funksionet e deleguara” përbëjnë rreth 2 % të buxhetit me ndryshime të miratuar për MB-në për vitin 2023, të cilat janë përdorur për financimin e 20 projekteve të investimit me vlerë 580,677 mijë lekë.

Fondet e akorduara për Programin “Gjendja Civile” përbëjnë rreth 3 % të buxhetit me ndryshime të miratuar për MB-në për 12-mujorin e vitit 2023, të cilat janë përdorur për financimin e 3 projekteve të investimit me vlerë 696,580 mijë lekë.

Në total shpenzimet e realizuara nga të ardhurat jashtë planit limit për vitin 2023 paraqiten në shumën 271,324 mijë lekë, përkatësisht Programi “Policia e Shtetit”, në shumën 243,803 mijë lekë dhe Programi “Planifikim menaxhimi dhe administrimi”, në shumën 27,521 mijë lekë.

Konkluzion i Përgjithshëm:

- Nga auditimi i dokumentacionit mbi përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe kryqëzimit dhe krahasimit të të dhënave midis PBA 2022-2024 dhe PBA 2023-2025, u konstatuan se 14 projekte investimi, sipas PBA 2022-2024 janë parashikuar si projekte të reja në vlerë më të ulët, duke ruajtur tavanet buxhetore të miratuara, e më pas në PBA 2023-2025 rriten me një vlerë të konsiderueshme. Konkretisht, në PBA 2022-2024 janë parashikuar me një vlerë totale prej 458,408 mijë lekë, ndërsa në PBA 2023-2025 janë parashikuar në vlerën totale prej 981,369 mijë lekë, me një diferencë prej 522,961 mijë lekë. Nga auditimi i planifikimit për vitin 2023, u konstatua se për 21 projekte investimi nuk reflektohen në PBA 2023-2025, ose reflektohen me vlera të konsiderueshme më të ulëta, me qëllim ruajtjen e taveve të miratuara dhe alokimin e fondeve për projekte të reja. Konkretisht, për vitin 2023 në 21 projekte investimi, në PBA 2022-2024 parashikohen në shumën 578,719 mijë lekë, ndërsa në PBA 2023-2025 parashikohen në shumën 284,222 mijë lekë, me një diferencë prej 294,497 mijë lekë.

- Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të investimeve u konstatua se Ministria e Brendshme ka realizuar projekte investime të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në PBA-të respektive, konkretisht:

- Për vitin 2022, nga analiza dhe kryqëzimi i të dhënave për projekteve të investimit të realizuara gjatë vitit 2022 në raport me projektet e planifikuara në PBA 2022-2024, u konstatua se për 23 projekte me vlerë 343,148 mijë lekë, janë realizuar gjatë vitit 2022, por nuk ka qenë të

planifikuara në PBA 2022-2024.

- Për vitin 2023, nga analiza dhe kryqëzimi i të dhënave për projekteve të investimit të realizuara gjatë vitit 2023 në raport me projektet e planifikuara në PBA 2023-2025, u konstatua se për 15 projekte investimi me vlerë 204,347 mijë lekë, janë realizuar gjatë vitit 2023 por nuk ka qenë të planifikuara në PBA 2023-2025.

- Për periudhën objekt auditimi është kryer një numër i konsiderueshëm rishikimesh, duke kërkuar lëvizje fondesh në projektet ekzistuese, si dhe duke shtuar projekte te reja gjatë vitit, të cilat nuk janë çelur pa kaluar në procesin ligjor të miratimit të Planit Buxhetor Afatmesëm. Nga ana e MB, në vitin 2021 janë kryer 48 rishikime buxhetore, për vitin 2022 janë kryer 41 rishikime buxhetore dhe për vitin 2023, janë kryer 42 rishikime buxhetore, ndryshime të cilat kanë ardhur jo vetëm si rezultat i akteve normative të miratuara gjatë vitit, por edhe si pasojë e vendimmarrjes për kryerjen e rishpërndarjes së fondeve me impakt në buxhetin MB, e cila konsiderohet me impakt negativ në treguesit e monitorimit të buxhetit.

- Urdhri për ngritjen e GMS nuk është rishikuar për çdo vit për të përcaktuar personat përgjegjës, si dhe nuk ka takime të dokumentuara të veprimtarisë së GMS, i cili duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit.

- Nga ana institucioneve të varësisë si dhe nga vetë aparati i Ministrisë së Brendshme, si njësi shpenzuese, nuk janë hartuar raporte monitorimi 4 mujore për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit të secilës njësi shpenzuese më vete.

- Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nr.40, Udhëzimin nr.9, datë 20.03.2018, i MFE-së “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika nr.64; VKM 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, Aneksi 1, Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” paragrafi 7.1, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, pika nr. 1, neni 27 “Takimet periodike ndërmjet menaxherëve të njësisë publike”, Udhëzimin nr. 16 të MFE, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” pika nr. 3, paragrafi 2.2.4.

Detyrimet e prapambetura në sistemin e Ministrisë së Brendshme

Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MB është hartuar dhe administruar një regjistër përmbledhës, për detyrimet e prapambetura për secilin nga programet buxhetore.

Me anë të shkresës nr.2039 prot., datë 20.02.2023, MB i është drejtuar gjithë njësisive shpenzuese të varësisë për raportimin në kohë të llogarive vjetore në Ministrinë e Brendshme.

Me shkresën nr.3030/1, datë 28.04.2023 të MB janë dërguar në MFE Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të MB, së bashku me relacionin shpjegues.

Sa i takon planit të shlyerjes së detyrimeve te prapambetura, secila njësi shpenzuese në varësi të MB ka bazën e të dhënave dhe në çdo projektbuxhet vjetor llogarit me prioritet fondet për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Në vijim të zbatimit të buxhetit monitorohet ndjekja e kronologjisë së krijimit të detyrimeve dhe radhën e shlyerjes së tyre kjo sipas sqarimeve të nëpunësve që hartojnë llogaritë vjetore të institucionit të tyre.

Referuar regjistrimeve dhe kontabilizimeve të detyrimeve njësitë shpenzuese në varësi të MB, në sistemin financiar SIFQ është bërë konsolidimi i tyre, ku duke krahasuar të dhënat të llogarisë 486 “shpenzime të periudhave të ardhshme”, sipas përmbledhësës së bilanceve analitike me të dhënat e llogarisë 486 “shpenzime të periudhave të ardhshme” që gjeneron sistemi SIFQ, me

qëllim verifikimin e detyrimeve dhe përpjekjet e bëra nga institucionet e varësisë për shlyerjen e tyre.

Institucioni i Ministrisë së Brendshme përbëhet nga 23 njësi shpenzuese, për të cilat harton pasqyrat financiare. Institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit ka në varësi 40 njësi shpenzuese, për të cilat harton pasqyrat e konsoliduara vjetore, e më pas përfshihen tek pasqyrat e konsoliduara të Ministrisë së Brendshme.

Për vitin 2022, në llogarinë 486 janë konstatuar detyrime të prapambetura në shumën totale prej 819,641,150 lekë, të përbërë nga njësitë shpenzuese si vijon:

- Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në shumën 686,573,265 lekë, detyrime të lindura nga vendimet gjyqësore të formës së prerë të mbartura nga vitet e mëparshme dhe të lindura gjatë vitit 2022;
- Prefektura Qarku Tiranë në shumën 971,233 lekë;
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në shumën 126,325,766 lekë;
- Aparati i Ministrisë së Brendshme në shumën 5,770,886 lekë.

‘në lekë

Nr	Emërtimi i institucionit buxhetor	Llogaria 486 “Shpenzime te periudhave ardhshme” (det te prapambetura me 31.12.2022	Likuiduar gjatë 2023	Pa likuiduar
1.	DPPSH(40 Njësi shpenzuese)	126,325,766	125,171,809	1,153,917
2.	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit	686,573,263	188,846,853	507,329,631
3.	Aparati i MB	5,770,886	0	5,770,886
4.	Prefekti i Qarkut Tirane	971,233	971,223	0
	Totali i llogarisë 486 dt.31.12.2022	819,641,150	314,989,885	504,651,265

Burimi: Ministria e Brendshme

- Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të vitit 2022 u konstatua një rritje të detyrimeve të prapambetura në krahasim me vitin 2021 në vlerën 246,608,212 lekë (819,641,150-573,032,938), si rezultat i rritjes detyrimeve në Institucionin e IKMT-së në vlerën 120,700,596 lekë (686,573,263-565,872,667).

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit

Detyrimet e prapambetura të IKMT, llog.486 për vitin 2022 si më poshtë:

‘në lekë

Emri i Institucionit	Kodi i institucionit	Detyrimet e 2021	Revokim detyrimi me Vendim gjykate	Likuidimi i detyrimeve për 2022	Detyrimet e reja 2022	Vlera mbetur
IKMT	1016130	565,872,667	2,534,996	43,009,361	166,244,955	686,573,265

Burimi: Ministria e Brendshme

Sa më sipër, në mënyre analitike kjo llogari përbëhet nga dëmshpërblim nga prishjet në vlerën 675,018,315 lekë, prej te cilave vlera 51,058,813 lekë është pezulluar ekzekutimi nga Gjykata e Lartë; detyrime ndaj punonjësve në vlerën 1,991,270 lekë dhe detyrim telefonie celulare në vlerën 9,563,680 lekë.

Në institucionin IKMT-së, plani për shlyerjen e detyrimeve kreditore është data bazë e vendimeve të gjykatës së formës së prerë regjistruar në SIFQ dhe likuidimi i tyre bëhet sipas

metodës FIFO por duke pasur parasysh se vlerat e detyrimeve janë specifike (vlera të konsiderueshme), është përdorur edhe pagesa me këste, pasi ka dhe vendime që gjenerojnë kamata dhe interesa ditore.

Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit

Detyrimet e prapambetura të DPPSH, paraqiten si vijon:

'në lekë

<i>Institucioni</i>	<i>Gjendje 31.12.2021</i>	<i>Maturuar viti 2022</i>	<i>Paguar viti 2022</i>	<i>Gjendje me 31.12.2022</i>
QMMT ose QSHAMT	353,616	-	-	353,616
DVP Gjirokastrër	4,248,833	14,624,104	9,594,505	9,278,432
DVKM Korçë	671,796	-	671,796	-
Kom.Pol.Qark.Rr. Tirane	665,901	-	-	665,901
Komisariati Kufi Dibër	-	1,496,601	-	1,496,601
Drejtoria e Forcës Operacionale	-	114,531,216	-	114,531,216
<i>Totali</i>	<i>5,940,146</i>	<i>130,651,921</i>	<i>10,266,301</i>	<i>126,325,766</i>

Burimi: Ministria e Brendshme

QMMT: Detyrimet e prapambetura në vlerën prej 353,616 lekë përfaqësojnë detyrim ndaj operatorit ekonomik B*** E. për investime të pa likuiduara që nga viti 2018, për të cilin sipas shkresës nr.4737 datë 13.10.2022 të Gjykatës Administrative Tiranë, është në proces gjykimi;

DVP Gjirokastrër: Vlera prej 9,278,432 leke përfaqëson detyrime nga vendime gjyqësore të formës së prere, të cilat janë likuiduar gjatë vitit 2023 dhe mbetur detyrim për vitin 2024 vlera 86,400 leke.

KRPRR Tiranë: Vlera prej 585,901 lekë për tatim mbi paga dhe 80,000 lekë sigurime shëndetësore, të cilat në proces verifikimi dhe planifikimi për likuidim pasi nuk është i qarte ky detyrim;

KPK Dibër: Vlera prej 1,496,601 lekë përfaqëson detyrime nga vendime gjyqësore të formës së prerë, të cilat janë likuiduar gjatë vitit 2023;

Drejtoria e Forcës Operacionale: Vlera prej 114,531,216 lekë përfaqëson detyrime, të cilat janë për situacionin nr.4, për punime të realizuara, regjistruar në thesar me Urdhër regjistrimin nr.1 datë 30.12.2022 për 2,025,121 lekë si dhe Urdhër regjistrimin nr.2, datë 30.12.2022 për 112,506,095 lekë; Likuiduar gjatë vitit 2023 dhe mbetur detyrim për vitin 2024 vlera rreth 48,000 leke për mungese fondi.

Gjatë vitit 2022, janë krijuar detyrime gjithsej 123,101,398 lekë, nga të cilat likuiduar po gjatë vitit 2022 shuma 2,715,778 lekë. Mbeten pa u likuiduar nga viti 2022 shuma 120,385,620 lekë që përfaqëson situacionin e punimeve të DFPO për 114,531,216 lekë dhe diferenca 5,854,404 lekë vendime gjyqësore (likuiduar gjatë vitit 2023). Ndërsa nga detyrimet e prapambetura të trashëguara nga viti 2021 mbeten pa u likuiduar shuma 5,940,146 lekë, që përfaqësojnë vendime gjyqësore. (edhe këto janë likuiduar gjatë vitit 2023).

Aparati i Ministrisë së Brendshme

Nga auditimi mbi detyrimet e prapambetura të paraqitura në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 5,770,886 lekë e cila përbëhet nga detyrime të krijuara të cilat mbarten në pasqyrat financiare, për të cilët nuk ka asnjë informacion se çfarë masash janë marrë nga ana e Institucionit. Në mënyrë analitike sipas detyrimeve paraqiten si vijon:

- Diferenca e papaguar të Faturave ndaj operatorit ekonomik I*** për Muajin Mars 2020

për shërbimin e kryer, por të pa likuiduar shumen 1,997,574 lekë;

- Detyrime të prapambetura për sigurime shoqërore ne shumen 2,803,534 lekë;
- Detyrime te prapambetura për tatimin nga te ardhurat nga punësimi ne shumen 945,528 leke;
- Detyrime për pritje e përcjellje nga Albcontrol sha në shumën 24,250 lekë.

- Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura të njohura në pasqyrat financiare të vitit 2022 u konstatua se MB i ka lindur detyrimi për shpenzime energji elektrike për llogari të OSHEE, për konsumin e energjisë elektrike, si dhe të kamat vonesave të aplikuara për periudhën që nga viti 2015 deri në Qershor 2022, shpenzime të cilët në vlerë totale janë, 136,142,855 lekë. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e sektorit te ankesave, detajohet vlera e këtij detyrimi sipas numrit të tre kontratave respektive, respektivisht për tre matësa. Sipas këtij dokumentacioni vlera e faturave të pa likuiduara është 67,516,013 lekë ndërsa 68,626,842 janë kamat vonesat e detajuara sipas periudhës, (të detajuara për çdo vit dhe për çdo muaj) dhe sipas tre kontratave që u referohen në këto dokumente.

-Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura të njohura në pasqyrat financiare të vitit 2022 me detyrimet e deklaruara sistemin tatimor C@TS për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe detyrime për tatimin nga të ardhurat personale u konstatua se në Pasqyrën e Pozicionit Financiar këto detyrime paraqiten në shumën prej 3,749,062 lekë, ndërsa në sistemin tatimor C@TS paraqiten në shumën prej 17,113,821 lekë, pra me një diferencë prej 13,364,759 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtime me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 61, Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.

Për vitin 2023, në llogarinë 486 janë konstatuar detyrime të prapambetura në shumën totale prej 565,389,912 lekë, të përbërë nga njësitë shpenzuese si vijon:

- Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në shumën 551,534,391 lekë, detyrime të lindura nga vendimet gjyqësore të formës së prerë të mbartura nga vitet e mëparshme dhe të lindura gjate vitit 2023;
- Prefektura Qarku Tiranë në shumën 613,465 lekë;
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në shumën 8,742,324 lekë;
- Aparati i Ministrisë së Brendshme ne shumen 8,694,086 lekë.

Pra e thënë ndryshe në detyrimet totale prej 565 mln lekë të MB, IKMT përbën 97,55 % të totalit çka është një risk i madh në mundësinë e likuidimit të tyre dhe arsyeve që kanë sjellë këto vlera.

‘në lekë

Nr.	Emërtimi	Llog.486 Bilanc viti 2022	Shtesa viti 2023	Likuiduar viti 2023	Gjendje në fund të vitit 2023
1	DPPSH	252,297,916	18,470,412	262,026,004	8,742,324
2	IKMT	686,573,265	57,935,052	192,973,926	551,534,391
3	Aparati i MB	5,770,886	2,923,200	-	8,694,086
4	Prefekti i Qarkut Tirane	971,233	-	357,768	613,465
Totali i detyrimeve viti 2023		819,641,150	70,093,458	324,344,696	565,389,912

Burimi: Ministria e Brendshme

- Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura të vitit 2023 u konstatua një ulje e detyrimeve në krahasim me vitin 2022 si rezultat i shlyerjes së detyrimeve në vlerë totale prej 324,344,696 lekë. Nga ana tjetër, vërehet shtim gjatë vitit 2023 nga detyrimet e krijuara rishtazi vlera prej 70,093,458 lekë nga institucionet DPPSH, IKMT dhe Aparati i Ministrisë së Brendshme.

- Raportimet mbi detyrimet e prapambetura

Ministria e Brendshme ka *dërguar raportimin periodik për detyrimet e prapambetura dhe të krijuar rishtazi* në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë deri në fund të vitit 2022 dhe 2023. Udhëzimi nr. 37, datë 06.10.2020 *“Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”*, pika III/6 përcakton se Njësia Përgjegjëse për monitorimin e risqeve buxhetore (MFE) koordinon në vijimësi dhe periodikisht procesin duke mbledhur të dhënat e dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe përgatit një informacion të konsoliduar tabelor sipas formateve të përcaktuara, e cila më pas publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave. Nga auditimi dhe kryqëzimi i të dhënave mbi detyrimet e prapambetura u konstatua se: Vlera e raportimit të detyrimeve të prapambetura të konsoliduara për vitin 2022, referuar përmbledhëses vjetore të publikuar nga ana e MFE në faqen zyrtare, për institucionin e MB-së paraqitet në shumën 833.5 milionë lekë, e cila *nuk rakordon me vlerat e detyrimeve të prapambetura* në datën 31.12.2022 të evidentuara në Formatin nr.1 *“Pasqyra e pozicionit financiar të konsoliduar”*, (sipas pasqyrave financiare të konsoliduara për sistemin e MB-së), ku në llogarinë 486 *“Shpenzime të periudhave të ardhshme”* më datën 31.12.2022 ato janë regjistruar për 819.6 milionë lekë, ose me një diferencë prej 13.9 milionë lekë. Gjithashtu, nga të dhënat e vëna në dispozicion nga MB, rezulton se për vitin 2023 detyrimet e prapambetura janë në shumën 565.4 milionë lekë, dhe nga ana tjetër nga kryqëzimi i të dhënave me ato të publikuara në faqen zyrtare të MFE, rezulton se shuma e mbetur e detyrimeve të prapambetura për MB-në është 572.7 milionë lekë, me një diferencë prej 7.3 milionë lekë.

Sa më sipër, nga Grupi i auditimit konstatohet se këto të dhëna nuk paraqesin gjendjen reale të detyrimeve të prapambetura që Ministria e Brendshme ka mbartur deri në fund të vitit 2022. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin nr. 37, datë 06.10.2020 *“Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”*, pika III/6.

Konkluzion i Përgjithshëm

- Nga auditimi i situatës së detyrimeve të prapambetura për vitin 2022, rezulton se përgjatë periudhës ushtrimore ka pasur *një rritje në shumën 246,608,212 lekë*, krahasuar me gjendjen e detyrimeve të prapambetura të raportuara në vitin 2021. Shtesa e detyrimeve për vitin 2022 ka ardhur kryesisht si pasojë e mos likuidimit në afat të kontratave me palë të treta si dhe nga Institucioni i IKMT-së në shumën 120,700,596 lekë, për shkak të mos ndjekjes së procedurave ligjore nga ana e IKMT-së në lidhje me shembjen e objekteve duke krijuar detyrime me impakt në riskun e likuidimit të kamatëvonesave dhe krijimin e vështirësive financiare. Nga auditimi i situatës së detyrimeve të prapambetura për vitin 2023, rezulton se përgjatë periudhës ushtrimore ka pasur pakësim në shumën 324,344,696 lekë.

- Gjithashtu nga auditimi i raportimeve periodike mbi ecurinë e detyrimeve të prapambetura për të cilat MB ka dërguar në MFE, rezulton se vlera e raportuar mbi gjendjen e detyrimeve të prapambetura për vitin 2022 në MFE është në shumën 833,5 milionë lekë, *shumë e*

cila nuk rakordon dhe nuk pasqyrohet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të Konsoliduar të Institucionit ku është regjistruar gjendja e detyrimeve të prapambetura për vitin 2022, konkretisht në llogarinë nr.486 “shpenzime të periudhave të ardhshme” në shumën 819,641,150 lekë, për rrjedhojë me një diferencë të pa regjistruar dhe të pa kontabilizuar në krahasim me të dhënat e raportuara në MFE, në shumën 13,9 milionë lekë.

▪ Nga auditimi i raportimeve periodike mbi ecurinë e detyrimeve të prapambetura për të cilat MB ka dërguar në MFE, rezulton se vlera e raportuar mbi gjendjen e detyrimeve të prapambetura për vitin 2023 në MFE është në shumën 572.7 milion lekë, *shumë e cila nuk rakordon dhe nuk pasqyrohet gjendjen e detyrimeve të prapambetura të Institucionit ku konkretisht janë në shumën 565,389,912 lekë, për rrjedhojë me një diferencë të pa regjistruar dhe të pa kontabilizuar në krahasuar me të dhënat e raportuara në MFE, në shumën 7.3 milionë lekë.*

▪ Në lidhje me mos njohjen dhe mos regjistrimin në kontabilitet të detyrimeve të prapambetura në pasqyrën e pozicionit financiar të Aparatit të MB, rezulton se *nuk janë paraqitur detyrimet e krijuara nga viti 2015 deri në muajin Qershor të vitit 2022*, të cilat janë shpenzime për energji elektrike për llogari të OSHEE, mbi konsumin e energjisë elektrike si edhe kamatëvonesave të aplikuara për periudhën e mos shlyerjes së detyrimit. Për rrjedhojë shpenzimet për këto vite kanë qenë në shumën *136,142,855 lekë*, e cila përbëhet nga vlera e faturave të pa likuiduara në shumën *67,516,013 lekë* dhe kamatëvonesave në shumën *68,626,842 lekë*. Gjithashtu në pasqyrën e pozicionit financiar të Aparatit të MB, detyrimet e prapambetura të regjistruara mbi sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si edhe tatimit nga të ardhurat personale paraqiten në shumën *3,749,062 lekë*, ku nga krahasimi i kryer me të dhënat e raportuara nga sistemi C@ts rezulton se Aparati i MB, ka gjendjen e detyrimeve në shumën *17,113,821 lekë*, pra me një diferencë në shumën *13,364,759 lekë*.

Sa më sipër, të dhënat e paraqitura dhe të raportuara nga ana e Institucionit MB, nuk paraqesin gjendjen reale si dhe detyrimet nuk janë të regjistruara në kontabilitet me vlerë të plotë. Gjithashtu nga ana e Institucionit të MB, nuk është hartuar dhe përcaktuar një strategji konkrete në lidhje me njohjen e saktë dhe reale të detyrimeve si edhe shlyerjen e tyre.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 61, Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42, Udhëzimi nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pikat nga 60 – 68.

2.2. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.

Në zbatim të drejtimit 2 të programit të Auditimit nr.169/1, datë 31.01.2024, i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni fizik dhe elektronik mbi pagat, strukturën, organikën e miratuar dhe atë fakt sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 16, datë 13.01.2021 “Mbi miratimin e strukturës dhe organikës së MB” dhe Urdhrit të Kryeministrit nr.116, datë 28.07.2022 “Mbi miratimin e strukturës dhe organikës së MB “.

Për sa më sipër u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Struktura organizative e MB dhe krahasimi me faktin baza e të dhënave;
- Plani i nevojave për rekrutimin e personelit;
- Dosjet personale të punonjësve me zgjedhje;
- Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve;
- Realizimi i fondit të pagave.

Baza ligjore mbi të cilin u bazua auditimi:

- Ligji Nr.152/2013“Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar;
- Ligji Nr. 7961, dt. 12.07.1995 “Mbi Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- VKM Nr.108, datë 26.2.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”;
- VKM Nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar;
- VKM 929, datë 27.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar;
- Urdhri Nr. 3658 prot., datë 30.04.2019, me Nr. 384, dt. 30.04.2019 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Brendshme;
- Urdhri Nr. 3778/1 prot., datë 05.04.2023, me Nr. 42, dt. 05.04.2023 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Brendshme;
- Udhëzimit nr.1, datë 01.03.2016 “Për krijimin, funksionimin, dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo Ristrukturimit të Institucionit”

Auditimi u fokusua në respektimin e strukturës organike të miratuar në Ministrinë e Brendshme dhe krahasimi me faktin, procesin e ristrukturimit në MB, procedurat e ndjekura për ristrukturimin 2021/2022, planifikimin e rekrutimeve të punonjësve në shërbimin civil.

I. Respektimi i strukturës organike të miratuar në Ministrinë e Brendshme dhe krahasimi me faktin.

Ministria e Brendshme ("në vijim MB") ka për mision hartimin, zbatimin e strategjive dhe të politikave të punës së brendshme, në përputhje me programin politik të Qeverisë. Ministria është aparati organizativ dhe profesional që i shërben interesit publik me paanësi, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, duke kryer shërbimet publike dhe duke hartuar dhe zbatuar politikat e përgjithshme shtetërore në fushën e punëve të brendshme.

Nga auditimi i strukturës organizative në funksion të objektivave të institucionit për periudhën në auditim u konstatua se deri në datë 13.01.2021, MB ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 45, datë 9.3.2018, i ndryshuar me anë të urdhrin nr. 171 datë 06.11.2018 me 170 punonjës. Struktura organike e Ministrisë së Brendshme (MB) për periudhën objekt auditimi (13.01.2021 deri me datë 28.07.2022) ka funksionuar në zbatim të Urdhrin të Kryeministrit nr. 16, datë 13.01.2021 “Mbi miratimin e strukturës dhe organikës së MB”.

Me Urdhrin e Kryeministrit nr. 16, datë 13.01.2021, u miratua struktura e re me 171 punonjës. Struktura aktuale është miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 116, datë 28.07.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Brendshme”, pjesë përbërëse e kësaj strukture janë 172 punonjës.

Pra për periudhën 2021-2023 Ministria e Brendshme është ristrukturuar 2 herë. Me këto ristrukturime numri i përgjithshëm i punonjësve është shtuar vetëm me 1(një) por përveç ristrukturimeve në nivel Drejtorish së përgjithshme, specialistësh dhe përgjegjës sektorësh struktura aktuale ka ndryshime dhe në emërtimin e disa drejtorive të përgjithshme apo sektorëve në krahasim me strukturën e vitit 2021. Ndryshim tjetër i rëndësishëm është krijimi i një drejtorie të re:

1 Drejtori e Përgjithshme, (Drejtoria e Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve) e përbërë nga 2 sektorë, 1 Drejtori, Qendra e ekselencës dhe një sërë pozicionesh pune të reja të shtuara sipas saj. Përgjatë gjithë kësaj periudhe nuk është miratuar rregullorja e re por institucioni ka vazhduar me rregulloren e vjetër.

Si në strukturën e miratuar në vitin 2021 ashtu dhe në strukturën e re të miratuar në vitin 2022 konstatohen mospërputhje ligjore varësie konstatim ky i lënë dhe nga auditimi i mëparshëm i

KLSH- së. Referuar strukturës së miratuar me Urdhrit të Kryeministrit nr. 16, datë 13.01.2021, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse është e përbërë nga 4 drejtori, konkretisht: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Mirë administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Drejtoria e Arkivit të Sistemit dhe Drejtoria e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun.

Pozicionimi i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar me përbërje sektorin e Financës, është në varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse pra jo si një strukturë administrative më vete që i raporton direkt Nëpunësit të Autorizuar kjo vendosje varësie nuk mundëson linjën direkte të raportimit të Nëpunësit Zbatues tek Nëpunësi i Autorizuar referuar nenit 12, pika 1 në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe nenit 3, pika 44 në ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenit 16, pika 2 e ligjit nr. 90/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore.

Në organikën e miratuar në vitin 2021 Sektori i Shërbimeve dhe Menaxhimit të Aseteve është në përbërje të drejtorisë së Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve ndërkohë që ky sektor kryen një funksion financiar, jo shërbim mbështetës dhe vendosja e tij në këtë drejtori është në kundërshtim me nenin 16 pika 1, 2 e ligjit Nr. 90/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore”.

Sipas Strukturës së miratuar me Urdhrit nr. 16, datë 13.01.2021 në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar është shtuar sektori i Kontabilitetit dhe Menaxhimit të Aktiveve duke e adresuar problematiken e mësipërme, por kjo drejtori në vetvete ka mbetur në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse ***duke mos e zgjidhur çështjen e varësisë NZ dhe NA.***

Në strukturën e vitit 2021 Drejtoria e Përgjithshme e Politikave për Rendin dhe Sigurinë Publike përbëhej nga 3 Drejtori, 5 sektorë përkatësisht si vijon:

1. Drejtoria e Politikave dhe Strategjive (3 sektorë);
2. Drejtoria e Monitorimit;
3. Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve (2 sektorë).

Drejtorja e Përgjithshme e Politikave për Çështjet Vendore dhe Prefekturat përbëhej nga dy drejtori:

1. Drejtoria e Politikave dhe Strategjive për Çështjet Vendore;
2. Drejtoria e Koordinimit dhe Monitorimit të Prefekturave.

Ndryshimi më kryesor sipas strukturës së re është ndarja në strukturën e vitit 2022 e këtyre dy drejtorive të përgjithshme të cilat kanë ndryshuar emërtim përkatësisht në:

- Drejtoria e Përgjithshme e Politikave për Rendin, Sigurinë Publike dhe Çështjet Vendore e cila përbëhet nga dy drejtori:

1. Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Rendit dhe Sigurisë Publike (3 sektorë);
2. Drejtoria e Politikave për Çështjet Vendore (2 sektorë).

- Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Projekteve kjo drejtori e përgjithshme e përbërë nga 3 drejtori:

1. Drejtoria e Projekteve;
2. Drejtoria e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve Dhe Asistencës;
3. Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator.

- Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në strukturën e vitin 2021 ishte e përbërë nga

3 Drejtori ndërsa në strukturën e vitit 2022-2023 i është shtuar një drejtori; Drejtoria e Hartimit të Procedurave dhe Kontrollit.

E dhënë në mënyre tabelore struktura paraqitet në tabelën 2.1:

Tabela nr. 2.1: Paraqitja tabelore e strukturës për periudhën 2021-2023

Viti 2022-2023	Drejtori	Sektor	Nr. Punonjësish	
Ministri	0	0	1	
Kabineti	0	0	10	
Zëvendësministra	0	0	4	
Sekretar Zëvendësministra	0	0	4	
Sekretar i Përgjithshëm	0	0	1	
Sekretar i Sekretar i Përgjithshëm	0	0	1	
Drejtorja e Përgjithshme e Politikave për Rendin, Sigurinë Publike dhe Çështjet Vendore	Drejtorja e Politikave dhe Strategjive të Rendit dhe Sigurisë Publike	1	3	12
	Drejtorja e Politikave për Çështjet Vendore	1	2	7
Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore dhe Projekteve	Drejtorja e Projekteve	1	2	7
	Drejtorja e Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve Dhe Asistencës	1	2	8
	Drejtorja e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator	1	2	11
Drejtorja e Përgjithshme e Politikave të Migracionit dhe Azilit	Drejtorja e Azilit, të Huajve dhe Shtetësisë	1	2	8
	Drejtorja e Antitrafikut dhe Migracionit	1	2	7
Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile	Drejtorja e Hartimit të Procedurave dhe Kontrollit	1	2	7
	Drejtorja e Administrimit Të Regjistrave	1	2	5
	Drejtorja e Dokumenteve Biometrik Dhe Shërbimeve	1	2	6
	Koordinatori i Rrjetit Antikorrupsion	0	0	1
Drejtorja e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse	Drejtorja e Arkivit Të Sistemit	1	2	6
	Drejtorja e Burimeve Njerëzore	1	2	6
	Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse	1	3	24
	Drejtorja e Buxhetit Dhe Menaxhimit Financiar	1	3	11
Drejtorja e Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve	1	2	9	
Drejtorja e Auditit	1	1	8	
Qendra e Ekselencës	0	0	3	
Total	16	34	167 + 5 DP = 172	

Burimi i të dhënave MB, përpunuar nga grupi i auditimit.

Konkluzion:

Pra kjo ministri për periudhën 2021 deri në 05.04.2023 ka funksionuar sipas rregullores së brendshme të miratuar nga Ministri i MB me *Urdhrin Nr. 3658 prot., datë 30.04.2019, me Nr. 384, dt. 30.04.2019 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Brendshme”*, megjithëse në këtë hark kohor ka pasur 2 ristrukturime të pa shoqëruara me akte normative për t’iu përshtatur ndryshimeve strukturore të kryera. Ministri i MB-së miraton Rregulloren e Brendshme të organizimit dhe funksionimit të ministrisë

me gjithë ndryshimet dhe ristrukturimin e kësaj Ministrie. Nisur nga sa më sipër nga auditimi i përputhshmërisë së Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funkcionimin e MB-së”, me strukturën organizative të saj, u konstatua se kjo rregullore nuk është përditësuar sipas dy strukturave të miratuara. Rregullorja e miratuar me *Urdhri Nr. 3778/1 prot., datë 05.04.2023, me Nr. 42, dt. 05.04.2023 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Brendshme”*, e cila është në funksion edhe sot, është nxjerrë dhe miratuar 9 muaj me vonesë nga miratimi i strukturës së fundit më **28.07.2022**.

Nuk ka një ndryshim, përditësim në rregulloren me të cilën Ministria e Brendshme ka operuar për 3 vjet, ka munguar përshkrimi i punës për sektorët si pjesë e Drejtorive të MB-me, në kundërshtim me VKM nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 9/ pika 4, Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues, ku citohet se: *Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore: a) propozimin te nëpunësi autorizues i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi; b) hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike dhe vjetore, në përputhje me objektivat e miratuar nga titullari i njësisë publike; Pika 4a) propozimin te nëpunësi autorizues i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, si dhe Pika 4/f) Ndarjen e përgjegjësive që lidhen me vendimmarrjen, kontrollin, zbatimin dhe vendosjen e linjave të raportimit, në përputhje me përgjegjësitë e deleguara.*

2. Planifikimi i rekrutimeve dhe procedurat e ndjekura për rekrutimin e punonjësve në shërbimin civil.

Tabela 2.2 Pozicionet sipas strukturës së miratuar në 2021 dhe asaj të miratuar në 2022

Sipas Strukturës së miratuar në 2021			Sipas Strukturës së miratuar në 2022		
Emërtimi	Kategoria	Nr	Emërtimi	Kategoria	Nr
Ministër		1	Ministër		1
Kabineti	II-a,II-b	10	Kabineti	I-3,I-4, P/fikse	10
Zëvendësministër		4	Zëvendësministër		4
Sekretar		4	sekretar		4
Sekretar i Përgjithshëm	I-b	1	Sekretar i Përgjithshëm	I-2, P/fikse	1
Sekretar		1	sekretar		1
Drejtor i Përgjithshëm	II-a	5	Drejtor i Përgjithshëm	I-4, II-a, I-5	5
Drejtor Drejtorie	II-b	16	Drejtor Drejtorie	II-1, II-2,	16
Përgjegjës Sektori	III-a	21	Përgjegjës Sektori	III-1	25
Specialist/të tjerë	III-b,IV-b, IV-a	108	Specialist/të tjerë	II-1,III-1,IV-1, IV-2, IV-3, IV,VII, Kod Pune	105
Totali		171	Totali		172

Burimi: Ministria e Brendshme

Në strukturën e miratuar në vitin 2022 krahasuar me strukturën e re të miratuar në vitin 2021 kemi rritje të numrit të punonjësve vetëm me 1 (një) nëpunës, ndërsa Përgjegjës sektori në vitin 2021 kemi 21 ndërkohë shikohet një rritje në strukturën e vitit 2022 në 25 përgjegjës sektori pra 4 sektorë më shumë. Gjithashtu pas miratimit të strukturës aktuale me Urdhriin e Kryeministrit

nr.116, datë 28.07.2022 “Mbi miratimin e strukturës dhe organikës së MB “, përditësimi i rregullores referuar kësaj strukture është bërë 9 muaj me vonesë në të cilën janë shtuar Drejtoria e Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve me 2 Sektorë dhe Qendra e Ekselencës me 3 (tre) punonjës (vakante të 3 pozicionet). Nga verifikimi i numrit të punonjësve rezultoi se, institucioni për periudhën objekt auditimi, ka respektuar strukturën dhe të gjithë punonjësit janë pjesë e kësaj strukture por numri i punonjësve sipas organikës nuk është përmbushur. Në rregulloren në fuqi janë listuar detyrat e strukturave përgjegjëse për secilën drejtori të përgjithshme, drejtori e sektorë, si dhe ka përshkrime të linjave të raportimit midis sektorëve dhe drejtorive. Struktura dhe organika e institucionit ka të përcaktuar emërtimin e pozicioneve të punës, kategorinë dhe numrin e punonjësve gjithsej. Numri i punonjësve të rekrutuar sipas strukturës organike për vitin 2021, 2022 dhe 2023 krahasuar me faktin, për Aparatin e MB, paraqitet si më poshtë:

Tabela 2.3 Planifikimet dhe rekrutimet faktike të kryera në MB për vitet 2021,2022,2023

Nr	Emertimi	Viti 2021			Viti 2022			Viti 2023		
		Plan	Fakt	Jashtë planifikimit fillestare	Plan	Fakt	Jashtë planifikimit fillestare	Plan	Fakt	Jashtë planifikimit fillestare
I.	Punonjes gjithsej	12			14			17		
1	Sekretar i Përgjithshëm	TND			TND			TND		
2	Drejtor i Përgjithshëm	TND			TND			TND		
3	Drejtor Drejtorie	3	2	2	2	2	2	2	1	0
4	Përgjegjës Sektori	0	0	5	0	0	0	7	5	0
5	Specialist	9	5	3	12	8	4	8	5	2

Burimi: Ministria e Brendshme

Në zbatim të nenit 18, të Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe VKM Nr. 108, datë 26.2.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, përgatitet plani vjetor i pranimit në shërbimin civil për pozicionet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, si dhe për pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues. Nga auditimi në lidhje me rekrutimet për periudhën objekt auditimi rezultoi se Ministria e Brendshme ka hartuar shkresat për planifikimin e nevojave për rekrutim. Plani është dërguar në rrugë zyrtare me shkresë nga Sektori i burimeve njerëzore brenda afatit të parashikuar në shkresën nr.6336/10 prot., datë 27.11.2020 të DAP-it, në përputhje me VKM Nr.108, datë 26.2.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, pika 4, ku citohet: “Çdo institucion i administratës shtetërore përgatit planin e nevojave të tij për rekrutim në shërbimin civil për vitin e ardhshëm. ...”

Referuar këtij plani për vitin 2021, nevojat për rekrutim në shërbimin civil për MB janë për 15 (pesëmbëdhjetë) pozicione, por me ndryshimin e strukturës dhe plani i nevojave për rekrutim ka pësuar ndryshime. Ndryshimet në planin e nevojave për rekrutim nuk janë dërguar në DAP, pasi VKM Nr.108, datë 26.2.2014, pika 4, parashikon vetëm detyrimin për dërgimin e planit në fund të vitit për vitin e ardhshëm, si dhe pika 7, parashikon detyrimin e Sekretarit të Përgjithshëm të ministrive, që brenda muajit nëntor, të dërgojë në Departamentin e Administratës Publike planin e konsoliduar të nevojave për pranimit për të gjithë sistemin përkatës.

1. Për vitin 2021 me shkresën nr. 8644/1, dt. 23.12.2020 “Mbi planifikimin e nevojave për rekrutim, për vitin 2021” për Aparatin e Ministrisë së Brendshme, si dhe për institucionet e

varësisë së saj ka planifikuar për rekrutim 15 pozicione vakante të shërbimit civil, konkretisht: 3 Drejtorë, Sekretarë i Përgjithshëm 1 dhe 11 specialistë.

2. Për vitin 2022 me shkresën nr. 7613/51, dt. 23.12.2020 “Mbi planifikimin e nevojave për rekrutim, për vitin 2022” për Aparatin e Ministrisë së Brendshme, si dhe për institucionet e varësisë së saj ka planifikuar për rekrutim 14 pozicione vakante të shërbimit civil, konkretisht: 2 Drejtorë, dhe 12 specialistë.

3. Për vitin 2023 me shkresën nr. 8644/1, dt. 23.12.2020 “Mbi planifikimin e nevojave për rekrutim, për vitin 2021” për Aparatin e Ministrisë së Brendshme, si dhe për institucionet e varësisë së saj ka planifikuar për rekrutim 17 pozicione vakante të shërbimit civil, konkretisht: 2 Drejtorë, 7 Përgjegjës dhe 8 specialistë.

Bazuar në nenin 66/1 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, të ndryshuar, Urdhrit nr. 5151, dt. 28.10.2015, “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, janë emëruar për vitet 2021 dhe 2023 nga Drejtoria e Integritit Mbikëqyrjes dhe Ankesave Administrative e Gjyqësore me shkresën nr. 2139/2, dt. 01.04.2021 1(një) nëpunës, me shkresën nr. 5926/5, dt. 18.11.2021 1(një) nëpunës, me shkresën nr. 5646/5, dt. 17.11.2023 1 (një) nëpunës, me shkresën nr. 1637/2, dt. 24.03.2023 1 (një) nëpunës, me shkresën nr. 5464/2, dt. 02.11.2023 1 (një) nëpunës, me shkresën nr. 5757/2, dt. 30.11.2023 1(një) nëpunës. Me vendim gjyqësor të formës së prerë janë gjithsej për vitet 2021 dhe 2023 gjashtë nëpunës të kthyer në pozicionet e tyre të punës.

Emërimet

- Ministria e Brendshme ka rekrutuar gjatë vitit 2021 gjithsej 37 punonjës.
- Gjatë vitit 2022 gjithsej 29 punonjës.
- Gjatë vitit 2023 gjithsej 28 punonjës.

Largimet

- Në këtë institucion në vitin 2021 janë larguar 22 punonjës.
- Në vitin 2022 janë larguar nga institucioni 25 punonjës.
- Në vitin 2023 janë larguar nga institucioni 20 punonjës.

Gjithsej janë emëruar me kod pune 8 punonjës të paraqitur në *tabelën 2.1.1* në aneksin sipas drejtimit 2

Nga auditimi u konstatua se, referuar të dhënave mbi strukturat organike aktuale të MB për vitin 2023, rezulton një numër i konsiderueshëm vendesh vakante ose 25 të tillë, nga të cilët 2 funksione politike, 19 nëpunës civil, 4 me Kod pune: 1 Drejtorë Drejtorie, 3 ekspertë, 5 Përgjegjës Sektori dhe 12 specialistë, si dhe qarkullime të stafit, fenomen ky i cili konstatohet për të gjithë vitet objekt auditimi. Arsyet kryesore për vendet vakante aktuale janë si vijon;

- 2 punonjës të emëruar në institucion tjetër, me ngritje në detyrë;
- 1 punonjës me Pezullim me kërkesë;
- 3 punonjës me Pezullim nga shërbimi civil me kërkesë;
- 7 punonjës me Dorëheqje dhe
- 4 punonjës me Lirim.

Konkluzion: Pra gjatë auditimit konstatohen vende vakante 25 të tilla, si dhe lëvizjeve të shumta të punonjësve për pasojë, Performanca e disa drejtorive me mungesë të vazhdueshme stafi, drejtues dhe specialistë, si dhe një numër i konsiderueshëm i vendeve vakante, dhe qarkullime të

shpeshhta të stafit, rrishton mos kryerjen me eficiencë të funksioneve të këtyre sektorëve në vetvete dhe dobëson performancën e institucionit. Edhe pse nga auditimi me përzgjedhje i procedurave të pranimit rezultoi se, në çdo rast është zhvilluar procedura dhe konform rregullave të pranimit në shërbimin civil është marrë miratimi i DAP, po kështu dhe kalimi në një detyrë tjetër, ndryshimet kaq të shumta në numër të punonjësve mbartin me vetë riskun e plotësimit të detyrave në sektorët përkatës, por dhe të performancës së vetë institucionit.

3/1. Procesi i ristrukturimit në MB procedurat e ndjekura për ristrukturimin -2021

Në Ministrinë e Brendshme *deri në fillim të Janarit 2021* në fuqi ka qenë struktura e miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 45, datë 9.3.2018, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Brendshme", i ndryshuar. Në zbatim të VKM nr. 125, datë 17.2.2016 "Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë", Udhëzimi nr.1, datë 01.03.2016 "Për krijimin, funksionimin, dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo Ristrukturimit të Institucionit", rishikimi i strukturës për vitin 2021 të aparatit të Ministrisë së Brendshme është bërë pas marrjes së përgjegjësive të reja, si rezultat i kalimit në këtë ministri të disa funksioneve të inspektorateve dhe me qëllim mbështetjen e këtyre përgjegjësive me strukturat përkatëse në këto fusha. Riorganizimi i funksioneve të politikë bërjes dhe menaxhimit të çështjeve të vendore në një strukturë të vetme, në nivel drejtorie të përgjithshme, pjesë e aparatit të Ministrisë së Brendshme. Ndryshime diktohen edhe në zbatim të detyrimit për kalimin e funksioneve të sistemeve informatike të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, të cilat do të qendëzohen pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, duke funksionuar si pjesë përbërëse e kësaj Agjencie.

Me miratimin e strukturës dhe të organikës së MB-së, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 125 datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë" dhe Udhëzimit nr.1, datë 01.03.2016 "Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit, për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit", i ndryshuar, njësia e burimeve njerëzore, ka njoftuar nëpunësit civil të aparatit mbi fillimin e procesit të ristrukturimit.

Për ndryshimet e mësipërme strukturore pas miratimit të tyre, është dërguar nga MB me shkresën nr.2007/12, datë 15.01.2021, kërkesa për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit dërguar Departamentit të Administratës Publike (DAP).

Në vijim, është ngritur Komisioni i Ristrukturimit me Urdhrin e Departamentit të Administratës Publike nr. 10, datë 18.01.2021 "Për Krijimin e Komisionit të Ristrukturimit, në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme".

Sipas Udhëzimit nr.1, datë 01.03.2016 "Për krijimin, funksionimin, dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo Ristrukturimit të Institucionit", Kreu II Krijimi dhe Funksionimi i Komisionit të Ristrukturimit", Komisioni i Ristrukturimit përbëhet nga:

- Nëpunësi më i lartë civil i institucionit;
- Drejtuesi i njësisë ku bën pjesë menaxhimi i burimeve njerëzore.
- Një përfaqësues nga njësia përgjegjëse (DAP).

Përbërja e Komisionit të Ristrukturimit:

1. Një përfaqësues i DAP, znj. M. B., Përgjegjës i Sektorit të Procedurave të Rekrutimit, në Drejtorinë e Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil, në DAP, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit,
2. Znj. E. P., Sekretar i Përgjithshëm,

3. Z. V. H., Drejtor i DBMF, i autorizuar, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit.

Referuar kërkesave të përcaktuara në Udhëzimin e DAP me nr. 1, datë 01.03.2016, i ndryshuar, Kreu II, Pika 17, ku citohet: “Komisioni i Ristrukturimit, duhet ta shoqërojë vendimin e propozimit për transferimin e nëpunësit/ve në një nga pozicionet e lira dhe vendimin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, me praktikën mbi bazën e së cilës është marrë vendimi”, për marrjen e vendimit të propozimit për transferim e përhershëm të punonjësve, Komisioni i Ristrukturimit ka shqyrtuar dokumentacionin e administruar lidhur me procesin:

- Strukturën ekzistuese të Ministrisë;
- Strukturën dhe organikën e re të Ministrisë;
- Dosjet e nëpunësve civilë;
- Kriteret specifike të vendeve të lira apo të krijuara të prekura si pasojë e ristrukturimit.

Komisioni i Ristrukturimit me Vendimin nr. 2007/17, datë 15.02.2021, ka propozuar DAP transferimin e përhershëm të nëpunësve civilë të aparatit në kuadër të ristrukturimit të MB-së. Në shkresën nr. 1320/1, datë 19.02.2021 “Mbi transferimin e përhershëm të nëpunësve në kuadër të ristrukturimit në MB”, DAP-i ka dërguar në MB, Vendimin mbi transferimin e përhershëm të nëpunësve në kuadër të ristrukturimit të aparatit të MB, bazuar në propozimin e Komisionit të Ristrukturimit. Sipas Vendimit të Komisionit të Ristrukturimit të 89 nëpunësit e transferuar kanë ruajtur të njëjtën kategori page që kanë pasur. Nuk ka asnjë rast të nëpunësve civilë të cilën kanë ulje në kategori të pagës.

Në përfundim të procesit të shprehjes së dakordësisë mbi transferimin e përhershëm, referuar pikës 20, kreu II, i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 17.02.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, është vijuar me nxjerrjen e shkresës me nr. 2007/112, datë 24.02.2021 prot. “Mbi fillimin e efekteve financiare për nëpunësit civilë të transferuar në kuadër të ristrukturimit”. Mbas përfundimit të procesit të ristrukturimit është vijuar me procesin e dërgimit të pozicioneve për shpallje, si dhe e ndjekjes së procedurave për vendet e shpallura nga DAP-i.

3/2. Procesi i ristrukturimit në MB procedurat e ndjekura për ristrukturimin -2022

Në zbatim të VKM nr. 125, datë 17.2.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, Udhëzimi nr.1, datë 01.03.2016 “Për krijimin, funksionimin, dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo Ristrukturimit të Institucionit”, është bërë rishikimi i strukturës së aparatit të Ministrisë së Brendshme. Gjithashtu, riorganizimi i aparatit ka ardhur si rezultat i zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 586, datë 30.8.2019 “Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, të ndryshuar, me qëllim përthithjen e ekspertëve në fushat përkatëse të përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme.

Struktura e aparatit të Ministrisë së Brendshme është miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 116, datë 28.07.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Brendshme”. Urdhri për miratimin e strukturës hyn në fuqi menjëherë, por fillon të prodhojë efektet financiare në momentin e konfirmimit nga Departamenti i Administratës Publike të propozimit për ri pozicionimin e të gjithë punonjësve në strukturën e re.

Me miratimin e strukturës dhe të organikës së MB-së, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të

nëpunësve civilë” dhe Udhëzimit nr.1, datë 01.03.2016 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit, për shkak të mbylljes apo rristrukturimit të institucionit”, i ndryshuar, njësia e burimeve njerëzore, ka njoftuar nëpunësit civil të aparatit mbi fillimin e procesit të rristrukturimit. Për ndryshimet e mësipërme strukturore pas miratimit të tyre, është dërguar nga MB kërkesa për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit dërguar Departamentit të Administratës Publike (DAP) me shkresën nr.5084/8, datë 04.08.2022.

Nga krahasimi i numrit të punonjësve midis strukturës së re dhe strukturës së vjetër rezulton se kemi një shtesë me 1 (një) punonjës. Në vijim, është ngritur Komisioni i Ristrukturimit me Urdhrin e Departamentit të Administratës Publike nr. 380, datë 05.08.2022 “Për Krijimin e Komisionit të Ristrukturimit, në kuadër të rristrukturimit të Ministrisë së Brendshme”.

Sipas Udhëzimit nr.1, datë 01.03.2016 “Për krijimin, funksionimin, dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo Ristrukturimit të Institucionit”, Kreu II “Krijimi dhe Funksionimi i Komisionit të Ristrukturimit”, Komisioni i Ristrukturimit përbëhet nga:

- Nëpunësi më i lartë civil i institucionit;
- Drejtuesi i njësisë ku bën pjesë menaxhimi i burimeve njerëzore.
- Një përfaqësues nga njësia përgjegjëse (DAP).

Komisioni Ristrukturimit përbëhet nga: Një përfaqësues i DAP, znj. M. H., Specialiste në Sektorin e Procedurave të Rekrutimit, në Drejtorinë e Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil, në DAP, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit, znj. E. P., Sekretar i Përgjithshëm, anëtar, z. A. M, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit.

Me lirimin nga detyra të znj. E. P., Sekretare e Përgjithshme më datë 15.09.2022, DAP-i me urdhrin nr. 380/1, datë 26.09.2022 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 380, datë 05.08.2022, “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të rristrukturimit të Ministrisë së Brendshme”, ka bërë ndryshim të Komisionit. Komisioni Ristrukturimit përbëhet nga: Një përfaqësues i DAP, znj. M. H., Specialiste në Sektorin e Procedurave të Rekrutimit, në Drejtorinë e Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil, në DAP, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit, z. E. H., Sekretar i Përgjithshëm, z. A.M., Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit.

Referuar kërkesave të përcaktuara në Udhëzimin e DAP me nr. 1, datë 01.03.2016, i ndryshuar, Kreu II, Pika 17, ku citohet: “*Komisioni i Ristrukturimit, duhet ta shoqërojë vendimin e propozimit për transferimin e nëpunësit/ve në një nga pozicionet e lira dhe vendimin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, me praktikën mbi bazën e së cilës është marrë vendimi*”, për marrjen e vendimit të propozimit për transferim e përhershëm të punonjësve, Komisioni i Ristrukturimit ka shqyrtuar dokumentacionin e administruar lidhur me procesin:

- Strukturën ekzistuese të Ministrisë;
- Strukturën dhe organikën e re të Ministrisë;
- Dosjet e nëpunësve civilë;
- Kriteret specifike të vendeve të lira apo të krijuara të prekura si pasojë e rristrukturimit.

Komisioni i Ristrukturimit me Vendimin nr. 5084/20, datë 10.10.2022, ka propozuar DAP transferimin e përhershëm të nëpunësve civilë të aparatit në kuadër të rristrukturimit të MB-së.

Në shkresën nr. 5918/2, datë 20.10.2022 “Mbi transferimin e përhershëm të nëpunësve në kuadër të rristrukturimit në MB”, DAP-i ka dërguar në MB, Vendimin mbi transferimin e përhershëm të nëpunësve në kuadër të rristrukturimit të aparatit të MB, bazuar në propozimin e Komisionit të Ristrukturimit. Sipas Vendimit të Komisionit të Ristrukturimit të 89 nëpunësit e transferuar kanë

ruajtur të njëjtën kategori page që kanë pasur. Nuk ka asnjë rast të nëpunësve civilë të cilën kanë ulje në kategori të pagës.

Në përfundim të procesit të shprehjes së dakordësisë mbi transferimin e përhershëm, referuar pikës 20, kreu II, i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 17.02.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, është vijuar me nxjerrjen e shkresës me nr. 5084/201, datë 31.10.2022 prot. “Mbi fillimin e efekteve financiare më datë 01.11.2022, për nëpunësit civilë të transferuar në kuadër të ristrukturimit”. Mbas përfundimit të procesit të ristrukturimit është vijuar me hartimin e planit të nevojave për rekrutim për vitin 2023, dhe ka vijuar procesi i shpalljes dhe ndjekjes së procedurave për vendet e shpallura nga DAP-i.

Vendet e punës të plotësuara gjatë viteve 2021; 2022; 2023; në Ministrinë e Brendshme përmes procedurave të emërimit me ngritje në detyrë, lëvizjeve paralele, pranimit në shërbimin civil, nëpunës të kthyer përmes procedurave të rikthimit nga lista e gjyq fituesve, të rikthyer nga pezullimi, transferim, TND, emërim i studenteve të ekselencës, me kod pune etj, paraqiten në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 2.4

	<i>Vendet e punës të plotësuara</i>	2021	2022	2023
1	Emëruar përmes procedurës së ngritjes në detyrë	1	2	2
2	Emëruar përmes procedurës së lëvizjes paralele	8	5	4
3	Emëruar përmes procedurës së pranimit në shërbimin civil	5	6	3
4	Emëruar përmes procedurës së rikthimit nga lista e gjyq fituesve	3	-	4
5	Emëruar si TND	1	3	2
6	Rikthim nga Pezullimi	3	3	2
7	Transferim	1	-	-
8	Emërim i studentëve të ekselencës	4	2	-
9	Emërim i punonjësve me kod pune	3	4	2
10	Emërim të tjera (politik/administrativ), kabinet	8	3	8
11	Emëruar përmes procedurës së 20%	-	1	1
	Shuma	37	29	28

Për vitet objekt auditimi 2021/2022/2023 nëpunës civilë të larguar për arsye se janë emëruar në një institucion tjetër, pezulluar me kërkesë të tyre, kanë mbushur moshën e pensionit apo kanë dhënë dorëheqjen paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 2.5

	<i>Nëpunës civil të larguar</i>	2021	2022	2023
1	Emërim në një institucion tjetër	2	3	-
2	Emërohet në një institucion tjetër, me ngritje në detyrë	-	2	2
3	Emërohet në një institucion tjetër, me lëvizje paralele	-	2	-
4	Pezullim me kërkesë	10	6	7
5	Mbush moshën për pension	1	3	-
6	Dorëheqje	8	7	7
7	Lirim me kod pune	1	1	3
8	Lirim TND		1	1
	Shuma	22	25	20

Referuar të dhënave të marra nga MB (*Spektori i burimeve njerëzore*) për periudhën 2021-2023, numri mesatar i vendeve të lira/vakante është 24 nëpunës. Megjithëse MB ka marrë masat për plotësimet e pozicioneve të punës duke dërguar shkresat përkatëse në DAP për shpalljen vakant të këtyre pozicioneve për vitet objekt auditimi numri i vendeve vakant paraqiten në një numër të konsiderueshëm si vijon në tabelën nr.2.7.

Tabela nr. 2.6

		Vende vakante		
Nr	Institucioni	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
1	Ministria e Brendshme	23	24	25

Gjithashtu përkatësisht sipas Vendimit nr. 586, datë 30.08.2019, i ndryshuar "Për punësimin e studentëve të ekselencës në Institucionet e Administratës Shtetërore", përsa i përket punësimit të studentëve të ekselencës DAP ka kërkuar pozicionet vakante të kategorisë ekzekutive (specialist dhe të barasvlershëm) për tu përfshirë në program. Nga Ministria e Brendshme për vitin 2022 janë dërguar 3 pozicione, procedura e përzgjedhjes është zhvilluar nga DAP. Ministria e Brendshme në bazë të njoftimit të DAP ka lidhur kontratat me ekselentët për një vit. Për vitin 2023, janë punësuar pranë MB-së, edhe 3 punonjës me kontratë të përkohshme 1-vjeçare, të cilët janë pjesë e organikës së këtij Institucioni.

5. Sistemi Informatik i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS)

Sistemi Informatik i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) është një sistem i ndërtuar për të ndihmuar institucionet shtetërore në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore. Ky sistem përmban të dhëna dhe informacion të zgjeruar për burimet njerëzore aktive në të gjitha institucionet. Në dosjet personale të të punësuarve reflektohen të dhëna për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, trajnimet, pagat dhe sigurimet. HRMIS përmban informacion për strukturën dhe organikën e institucioneve. Strukturat e hedhura në sistem plotësohen nga personi përgjegjës në secilin institucion. Këta të fundit kanë akses si përdorues të nivelit të parë për të gjitha të dhënat që i përkasin institucionit, funksion që ushtrohet zakonisht nga titullari apo sekretari i përgjithshëm. Çdo institucion i përfshirë në HRMIS mund të krijojë edhe përdorues të nivelit të dytë, të cilët zgjidhen zakonisht nga njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore. VKM nr. 117, datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit" dhe VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit" parashikojnë se sistemi HRMIS duhet të ndër veprojë me bazat e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Sistemit të Thesarit në Ministrinë e Financave etj. HRMIS shërben si burim planifikimi dhe informacioni për pagat dhe pagesat e nëpunësve publikë, nëpërmjet ndërveprimit me Sistemin e Thesarit. Sa i përket Ministrisë së Brendshme, (MB) ky sistem është implementuar në përputhje me VKM nr. 117, datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit" dhe VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit" dhe është bërë hedhja e të dhënave të punonjësve në HRMIS. Implementimi i HRMIS lehtëson menaxhimin e burimeve njerëzore.

6. Mbi procedurën e Krijimit dhe Administrimin e Dosjeve të Personelit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjeve fizike, u konstatuan disa parregullsi, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, konkretisht si vijon:

Gjatë auditimit u konstatua se për nëpunësit e MB zbatohen procedurat e legjislativës për nëpunësin civil dhe Kodi i punës parashikuar për institucionet e administratës shtetërore. Nga auditimi me përzgjedhje rastësore të dosjeve të personelit rezultoi se në përgjithësi ato administrohen të inventarizuara në zbatim VKM nr. 117, datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit". Në dosjen teknike të nëpunësit janë përfshirë : Lidhja Nr. 1. "Fletë inventari me listën e gjithë

dokumentacionit që ndodhet në dosje dhe Lidhja Nr. 2. “Të dhënat që duhet të përmbajë fleta prezantuese e dosjes teknike të nëpunësit 1. Numri i identifikimit të nëpunësit civil; 2. Emri, atësia, mbiemri; 3. Numri kombëtar i identifikimit; 4. Shtetësia; 5. Gjinia; 6. Datëlindja; 7. Gjendja civile; 8. Përbërja familjare; 9. Adresa e vendbanimit të përhershëm; 10. Adresa e vendbanimit të përkohshëm; 11. Arsimimi; 12. Diploma; 13. Kualifikimi (llojet); 14. Gradë shkencore (titulli); 15. Njohuri gjuhe të huaj; 16. Data e fillimit të punës në pozicionin përkatës;” 17. Trajnimet e ndryshme pranë DAP, nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA).

Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit 30 të tilla konstatohet se, në të gjitha rastet dosjet e personelit janë të inventarizuar por në disa raste diplomat ose diplomën e nivelit të dytë nuk janë të noterizuara, në 4 raste mungon certifikata e aftësisë shëndetësore, në 5 raste mungon dëshmia e penaltetit, në 7 raste mungon lista e notave. Si konkluzion, mangësitë si dhe keqadministrimi i dosjeve të personelit, duke mos kryer përmirësimin dhe përditësimin e të gjitha elementeve përbërëse të tyre, ndikon negativisht në raportimin, zhvillimin dhe menaxhimin e proceseve të burimeve njerëzore.

Gjithashtu në dosjet e audituara asnjë nga dosjet nuk e ka të inventarizuar raportin mjeko- ligjor të azhurnuar në zbatim të VKM nr. 124, datë 17.02.2016 (i ndryshuar me VKM nr. 747, datë 19.12.2018) “Për pezullimin dhe lirim nga Shërbimi Civil” kreu III, pika 23, paragrafi 2 “Nëpunësi civil paraqet pranë njësisë së burimeve njerëzore të institucionit dokumentacionin e shëndetit në punë, sipas legjislacionit në fuqi për sigurinë dhe shëndetit në punë, brenda datës 10 janar të çdo viti”.

Në lidhje me mënyrën e vlerësimit periodik të performancës së punonjësve, Vendimi Nr. 109, datë 26.2.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë” i ndryshuar, ndër të tjera, në kreun II, parashikon sistemin e vlerësimit të rezultateve në punë, si procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive apo i dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, që realizohet çdo 6 muaj të vitit kalendarik. Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese kryhet bashkërisht nga zyrtari raportues, zyrtari kundër firmues dhe zyrtari autorizues.

Nga verifikimi i dokumentacionit pjesë e dosjeve të personelit, për nëpunësit civil, konstatohet se vlerësimet e performancës, në 5 dosje nuk janë pjesë e tyre. Këto të fundit nuk administrohen në dosje në mospërputhje me VKM-në nr. 833, datë 28.10.2020, pika II/1 sipas të cilës: “Dosja e personelit është individuale dhe përmban të dhëna të karakterit të përgjithshëm, profesional, akademik, masa disiplinore, të dhëna për vlerësimin e rezultateve në punë, si dhe të dhëna të tjera...”. Përsa më sipër nga dokumentacioni pjesë e dosjeve të personelit, konstatohet se disa nga dosjet e personelit janë të paplota, në kundërshtim me VKM-në nr. 833, datë 28.10.2020, e cila në lidhjen 1 të saj cilëson dokumentacionin që duhet të përmbajë dosja e personelit me qëllim vërtetimin e pohimit të bërë në fletën prezantuese.

Nga verifikimi i dokumentacionit pjesë e dosjeve të personelit, për punonjësit me kontratë pune, konstatohet se nuk ka vlerësime të performancës.

Si konkluzion, mungesa e formularëve të vlerësimit të performancës si dhe mungesa e njoftimit të tyre, ndikon negativisht në menaxhimin e marrëdhënies së punës midis palëve si dhe përbën një risk eventual të shtuar për institucionin.

7. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve. Realizimi i fondit të pagave.

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe fondit të veçantë, për vitin 2021, 2022

dhe 2023, paraqitet në tabelën 2.1 në aneksin sipas drejtimit 2.

Për të tre vitet objekt auditimi, fondi i pagave është realizuar pothuajse sa është planifikuar, ku më larg realizimit është viti 2023 ku fondi i pagave është realizuar në masën 99.7%. Fondi për sigurimet shoqërore përveç se në vitin 2021 që është realizuar në masën 96.2% në vitet 2022 dhe 2023 është realizuar në masën 96.2% dhe 99.7%.

Nga auditimi i përdorimit të fondit të veçantë për vitet 2021, 2022 dhe 2023 janë përdorur nga fondi i veçantë për ndihmë ekonomike për sëmundje dhe ndihme financiare në rastet daljes së punonjësve në pension pleqërie 489,000 lekë; 708,200 lekë dhe 430,000 lekë gjithsej për çdo vit respektivisht 2021;2022;2023, komfort VKM 929, datë 27.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”. Fondi i veçantë është akorduar sipas ligjit të buxheteve në vite. Përdorimi i fondit të veçantë për çdo rast është bërë me miratim të ministrisë së Financave dhe konform kërkesave të dispozitave nënligjore.

Auditimi i pagave të punonjësve për periudhën objekt auditimi rezultoi si më poshtë:

Me përzgjedhjen rastësore të Listë pagesave për vitet 2021, 2022 dhe 2023, u konstatua se llogaritjet për pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, siguracioni suplementar, si dhe tatimi mbi të ardhurat personale janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e tyre. U verifikuan fizikisht listë pagesat e Aparatit të MB

- për vitin 2021: listë pagesat muajt Janar, Mars, Shtator, Tetor e Nëntor,
- për vitin 2022: Listë pagesat për muajt Maj, Prill, Qershor, Nëntor e Dhjetor,
- për vitin 2023 listë pagesat muajt Shkurt, Maj, Qershor, Gusht e Nëntor.

Llogaritjet janë bërë për çdo punonjës dhe kontributi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat personale është ndalur e derdhur rregullisht çdo muaj.

listë pagesat janë plotësuar nga specialisti i financës, i caktuar për hartimin e pagave. Ato janë nënshkruar nga Përgjegjësi i Financës, Nëpunësi Zbatues ose nëpunësi Zbatues i deleguar (Drejtori i Drejtorisë së Financës apo përgjegjësi i financës) dhe Nëpunësi Autorizues (Sekretari i Përgjithshëm, apo i autorizuari) dhe janë nënshkruar nga punonjësi i caktuar për menaxhimin e burimeve njerëzore, duke respektuar plotësisht kërkesat e përcaktuara në pikën 69, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Përmbledhja e listë pagesave që shoqëron Urdhër Shpenzimin e pagave është nënshkruar nga Nëpunësi Zbatues (Drejtori i Drejtorisë së Financës), Nëpunësi Autorizues (Sekretari i Përgjithshëm) dhe Specialisti i Financës, punonjësi i caktuar për pagat). Listë pagesat mujore janë të shoqëruara me listë prezencën mujore të punonjësve të nënshkruar nga drejtuesit e drejtorive përkatëse, dhe specialisti ose përgjegjësi i burimeve njerëzore.

8. Krahasimi përmbledhës i listë pagesave me shumat e urdhër shpenzimeve të kryera.

U krahasuan përmbledhëset e listë pagesave me likuidimet, nuk u konstatuan pasaktësi në shpenzimet për paga e sigurime. Pagesat janë shoqëruar me dokumentacionin mbështetës listë-prezencat, urdhër shpenzimet për paga dhe urdhra të veçantë të titullarit të nënshkruara nga nëpunësi urdhërues, zbatues (Punonjësi i financës) të nënshkruara edhe nga Dega e Thesarit.

-Respektimi i dispozitave ligjore për përcaktimin e nivelit të pagave, hapja dhe azhurnimi periodik i regjistrit të punëmarrësve (libri i pagave). Niveli i pagave është përcaktuar në zbatim të VKM nr. 187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendës ministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura ,

institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit , lidhja 1 *“Struktura e pagave për nëpunësit civilë/nëpunësit në të gjitha institucionet pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi”*

Nga auditimi rastësor me përzgjedhje i listë pagesave për periudhat raportuese (3/mujori I-të dhe të II-të 2020; 3/mujori I-të dhe I IV-të 2021) u verifikua niveli pagave për çdo punonjës, arsimimi sipas diplomës, vjetërsia në punë me librezën e secilit, nuk u konstatuan mospërputhje të nivelit të diplomës me kategorinë e vendit të punës dhe funksionit sipas emërimit. Për rrjedhojë rezultoi se ato janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM nr. 545, datë 11.08.2011 i ndryshuar. Përlllogaritjet e kontributit sigurime shoqërore e shëndetësore përballuar nga punëmarrësi dhe ato nga punëdhënësi, deklarimet, ndalesat si dhe derdhjet e tyre janë bërë në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 *“Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, ligjin nr. 7770, datë 13.10.1994 *“Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar dhe ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 *“Për tatimin mbi të ardhurat”* i ndryshuar. Listë pagesat janë përpiluar me gjithë elementet përbërës, sipas listë prezencave dhe shumat e tyre janë të rakorduara. Vendosja e pagave e shtesave mbi pagë janë bërë me klasën përkatëse për çdo kategori dhe ndalesat janë përlllogaritur në përputhje me dispozitat ligjore për kontributet e sigurimeve dhe tatimi mbi të ardhurat, sipas pasqyrës së realizimit të buxhetit.

Për përdorimin e fondit të pagave, sigurime shoqërore e shëndetësore është respektuar legjislacionin përkatës ligji nr. 9136, datë 11.09.2013 *“Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, UMF nr. 26, datë 16.04.2009 *“Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”* i ndryshuar dhe ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 *“Për tatimin mbi të ardhurat”* i ndryshuar janë bërë llogaritjet dhe ndalesat për tatimin mbi të ardhurat si dhe derdhjet e tyre në tati me.

Është mbajtur libër për pagat e punonjësve, dhe janë hedhur pagesat e kryera për secilin punonjës për periudhën të përcaktuara nga emërimi, fillimi marrëdhënieve të punës dhe të rakorduar me listë pagesat.

2.2.2. Zbatimi i vendimeve gjyqësore mbi punonjësit e larguar nga puna dhe likuidimi i tyre.

Baza ligjore dhe dokumentacioni i nevojshëm për auditim:

- Regjistri i gjyqë fituesve dhe vendimet e gjykatave.
- Baza e të dhënave/Data baza e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar.
- Ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar,
- Urdhri nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike *“Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”*

Në zbatim të nenit 66/1 të Ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar dhe Urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike *“Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”*, MB ka krijuar bazën e të dhënave si dhe me vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm nr. 890, datë 08.02.2021 *“Për ngritjen e komisionit të posaçëm për zbatimin e vendimeve të formës së prerë në MB”*, të ndryshuar ka ngritur Komisionin e Posaçëm *“Për shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë, i ndryshuar me vendimin nr. 2913, datë*

18.03.2022, si dhe Urdhri nr. 2913/1, datë 14.11.2022 si pasojë e ndryshimeve në strukturën e MB për periudhën 2021-2023.

Komisioni i Posaçëm në zbatim të Kreu IV, pika 3, kryen këto detyra;

a-shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në favor të kreditorit gjyqë fitues,

b- shqyrtimin e rasteve kur Urdhërimet e gjykatës përcaktojnë zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, nëpërmjet zgjidhjeve alternative për njësitë debitorë.

c- shqyrtimin e mundësisë së sistemimit të gjyqë fituesit në një pozicion të rregullt në shërbimin civil.

Ky komision me cilësinë e organit kolegjal për periudhën në auditim ka marrë në shqyrtim të gjitha faktet dhe rrethanat e lindura për ekzekutimin e vendimeve për punonjësit e larguar padrejtësisht nga puna si dhe i është drejtuar DAP për të regjistruar gjyqë fituesit në listë pritje deri në mundësinë e sistemimit të tyre. (pasqyruar në tabelën 2.1, në aneksin bashkëngjitur këtij akt-konstatimi)

Për periudhën para vitit 2021, numri i punonjësve të rikthyer në punë si gjyqë fitues ka qenë 6.

Për periudhën në auditim 2021-2023 numri i të rikthyerve në punë është 8 punonjës ndërsa është pushuar ekzekutimi i titullit ekzekutiv për 3 persona të cilët nuk janë rikthyer në punë edhe pas gjetjes dhe ofrimit të pozicionit përkatës. Janë të **pa sistemuar për rikthimin në punë, ende 8 persona** me vendim gjyqë të formës së prerë, të cilët vazhdojnë të paguhen nga buxheti i shtetit si dhe t'u mbahen kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore çdo muaj.

Për periudhën objekt auditimi (01.01.2021 deri me 31.12.2023) shpenzimet për likuidimin që kanë rrjedhur nga vendimet gjyqësore të formës së prerë për gjyqë fituesit e larguar nga puna përfshirë dhe tarifën përmbartimore në rastet kur është aplikuar një e tillë, paraqitet në Tabelën nr. 2.2.2.1

Tabela nr. 2.2.2.1 Shpenzimet që rrjedhin nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore

(Në lekë)

Viti	Përshkrimi	Vlera e likuiduar bazuar në vendimet gjyqësore	Vlera e likuiduar për shërbimin përmbartimor	Kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore	TAP	TOTALI
2021	Pagesë për vendime gjyqësore.(10 punonjës)	10,368,829	799,708	2,839,992	821,828	14,830,357
2022	Pagesë për vendime gjyqësore. (9 persona)	16,240,091	311,813	2,803,708	795,826	20,151,438
2023	Pagesë për vendime gjyqësore. (10 punonjës)	16,469,739	1,149,558	11,128,605	3,108,659	31,856,561
	Totali	43,078,659	2,261,079	16,772,305	4,726,313	66,838,356

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Buxhetit dhe menaxhimit financiar/Sektori Financës, përpunuar nga grupi i auditimit

Pra konstatohet se efekti financiar për 3 vite i pagesës së gjyqë fituesve për t'u rikthyer në punë, është **66,838,356 lekë**, kur ndërkohë vende bosh në strukturë janë mesatarisht 24 pozicione.

Shpenzimet përbarimore janë në vlerën e **2,261,079 lekë** duke sjellë kosto shtesë në buxhetin e shtetit.

Referuar Kodit të Procedurës Civile, neni 510, germa “a” dhe 511, germa “a” shprehet në mënyrë eksplicite se:

*“Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv. Janë tituj ekzekutivë: a) **vendimet civile të formës së prerë të gjykatës**, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm”...*

*“Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim nëpërmjet **lëshimit të urdhrit të ekzekutimit**, i cili:*

a) për rastet e parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b” të nenit 510 të këtij Kodi, lëshohet nga gjykata që ka dhënë vendimin”.

Konstatohet një rritje e vlerës së shpenzimeve të kryera për shërbimin përbarimor (2023), rreth 4 herë më shumë krahasuar me vitin 2022, çka tregon për një risk të vazhdueshëm edhe në rritje për MB në lidhje me largimin e padrejtë të punonjësve nga puna.

Gjithashtu nga auditimi rezultoi se: Sektori i financës nuk ruan të dhënat të ndara sipas shpenzimeve gjyqësore, përbarimore dhe detyrimet ndaj gjyq fituesve, por i regjistron ato në total, çka sjellë riskun e mos evidentimit të detyrimeve që janë për gjyq fituesit dhe ato që janë për shpenzime përbarimore.

Bazuar në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë, nr. 1, datë 04.06.2014 *“Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisë të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”* pika 5 ku citon se:

*“Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, bëhet sipas radhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe **grafiku i shlyerjes bëhet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-line të njësisë shpenzuese**, apo në forma të tjera të publikimit, që ju bëhen të ditura publikut. Përbaruesi i përmbahet grafikut të shlyerjes së detyrimit të publikuar”.*

Në respekt të këtij detyrimi ligjor MB rezultoi se nuk ka publikuar on line në faqen zyrtare të saj, grafikun e shlyerjes së detyrimeve sipas përcaktimit të bërë në këtë udhëzim, e cila fillon me likuidimin e detyrimeve duke njoftuar menjëherë gjyq fituesin, ku sipas përcaktimit të pikës 2:

*“Njësitë e qeverisjes së përgjithshme **janë përgjegjëse për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin prej tyre”.***

Në respekt të këtij detyrimi ligjor MB me publikimin on line në faqen zyrtare të saj, të grafikut të shlyerjes së detyrimeve sipas përcaktimit të bërë në këtë udhëzim, fillon likuidimin e detyrimeve duke njoftuar menjëherë gjyq fituesin, pasi në zbatim të pikës 2:

*“Njësitë e qeverisjes së përgjithshme **janë përgjegjëse për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin prej tyre”.***

Përveç Sektorit të Financës dhe Buxhetit, Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, bazuar në Rregulloren e Brendshme të MB me nr. 3778/1 prot., datë 05.04.2023, pas evidentimit dhe monitorimit të proceseve gjyqësore, duhet të njoftojë shkresërisht në kohë reale DBMF për të shmangur shpenzimet përbarimore të cilat rëndojnë buxhetin e shtetit në këtë proces të tej zgjatur në lidhje me kthimin në punë të gjyqëfituesve.

Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore duhet t'i dërgojë Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ecurinë e proceseve gjyqësore duke bashkëpunuar mbi bazën e të dhënave të qarta dhe të sakta, në mënyrë që data basë për këtë proces të jetë një dhe jo të dhëna të ndryshme si dhe të informojë në vazhdimësi Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar për të gjitha vendimet gjyqësore, të cilat kanë kaluar shkallën e dytë të gjyqësorit, me qëllim që të merren masa për krijimin e provizioneve për shpenzime, të cilat janë ngjarje të ndodhura, që

mund të sjellin probabilitet për lindjen e një detyrimi. Për këtë qëllim është i domosdoshëm ky bashkëpunim me qëllim njohjen e tyre në kontabilitet dhe pasqyrimin në pasqyrat financiare vjetore të njësisë, duke bërë të mundur dhe planifikim në kohë të burimeve të financimit, si dhe shmangien e detyrimeve të akumuluar dhe të pagesave të tarifave përbarimore si pasojë e mosekzekutimit vullnetar të vendimeve, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 61, Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësinë e qeverisjes së përgjithshme” kapitull III pika 34, si dhe VKM nr.50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”.

Për periudhën në auditim ka bashkëpunim në rrugë zyrtare (shkresore) mes Sektorit të Ankesave Administrative dhe Gjyqësore dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar mbi vendimet e formës së prerë por edhe pse këto dërgohen në kohë, likuidimi i tyre kryhet në fund të vitit nga sektori i financës, veprime të cilat sjellin gjenerimin dhe rritjen në vlerë të gjobave dhe kamatëvonesave në kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për MB.

Efekt i negativ financiar ardhur si pasojë e shlyerjes së pagave kundrejt gjyqe fituesve dhe deklarimit në listë pagesa jashtë afateve të përcaktuara në ligj.

Në lidhje me detyrimet në të gjithë llojet e tatimeve si dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të deklaruara nga MB për aparatit, nga verifikimi në sistemin tatimor C@TS, u konstatuan detyrime në vlera të konsiderueshme të cilat deri në datë 06.03.2024, janë të detajuara në tabelën në vijim:

Tabela 2.2.2.2: Përmbledhje e detyrimeve në sistemin tatimor për MB.

nr	Lloji i tatimit	Detyrimi kryesor	Gjoba të regjistruara	Interes i regjistruar	gjoba të paregjistruara	Interes I paregjistruar	totali
1	Tatimi mbi vlerën e shtuar	0	43,808	4,307			48,115
2	Tatimi mbi Fitimin		575,000				575,000
3	Kontributet e Sigurimeve shoqërore e shëndetësore	120,371	5,914,043	4,914,267	26,361	12,505	10,987,547
4	Kontribute shoqërore	1,802,796	281,235	430,287	391,769	1,594,785	4,500,872
5	Tatim mbi të ardhurat personale	930,691	20,509	15,082	201,091	743,366	1,910,739
		2,853,858	6,834,595	5,363,943	619,221	2,350,656	18,022,273

Burimi i të dhënave: Sistemi C@TS, përpunuar nga grupi i auditimit.

Sikurse konstatohet, detyrimet në total janë 18,022,273 lekë (deri më datë 06.03.2024), ku të ndarë sipas llojeve të tatimit vërehet se peshën më të madhe e kanë Kontributet e Sigurimeve shoqërore e shëndetësore në vlerën 15,488,419 lekë dhe Tatim mbi të ardhurat personale në vlerën 1,910,739 lekë ose e thënë ndryshe 96,5 % e detyrimeve totale të pashlyera dhe të mbartura relativisht në një kohë të gjatë.

Nisur nga sa më sipër, grupi i auditimit verifikoi “moshën” e borxhit në një nga tatimet kryesore që janë Kontributet e Sigurimeve shoqërore e shëndetësore si dhe arsyen e këtyre vlerave shumë të larta ku vetëm **gjobat dhe interesat janë 10,828,310 lekë**. Drejtoria e buxhetit dhe menaxhimit financiar në MB ishte në dijeni të këtyre detyrimeve por nuk kishte ndjekur ecurinë

e tyre periodikisht si dhe nuk i kanë pasqyruar në detyrimet e prapambetura në pasqyrat financiare të MB duke mos i “njohur” ato si të tilla. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 61, Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42. (trajtuar kjo edhe në drejtimin 4 të programit të auditimit 169/1, datë 31.01.2024, i ndryshuar). Nga verifikimet e kryera rezultoi që për periudhën në auditim 2021-2023, MB ka detyrime në kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në vlerën totale 1,585,626 lekë, të detajuara në vijim:

Tabela 2.2.2.3: Detyrimet në Kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për periudhën në auditim.

Periudha	Detyrime	Gjoha	Interesa	Totali
viti 2021		361,116	239,312	600,428
viti 2022	120,371	303,972	159,432	583,775
viti 2023		286,128	115,295	401,423
Totali	120,371	951,216	514,039	1,585,626

Punoi grupi i auditimit

Ndërsa pjesa tjetër e detyrimeve të mbartura të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore si dhe tatimit mbi të ardhurat personale, në vlerën totale 15,929,618 lekë i përket periudhës 200801-202012.

Tabela 2.2.2.4: Detyrimet në Kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore para vitit 2021.

Periudha 200801-202012	detyrime	gjoha	interesa	Totali
	1,802,793	7,632,166	6,494,659	15,929,618

Punoi grupi i auditimit

“Moshë e vjetër” e këtij borxhi tregon mungesë përgjegjësie nga DBMF në Ministrinë e Brendshme ashtu edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe MFE në mos mbledhjen e borxhit tatimor duke shkaktuar në buxhetin e shtetit një dëm prej 15,929 mln lekë të cilat nuk janë arkëtuar dhe nuk është marrë asnjë masë ligjore për shlyerjen e tyre, me pretendimin që duhet të sistemohen nga DRT Tiranë dhe MFE. Në analizën e kryer u konstatua se këto gjoha dhe interesa vijnë si rezultat i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për të larguarit nga puna, fakt ky i njohur tashmë në të gjitha institucionet për tej zgjatjen e proceseve gjyqësore dhe mos kthimin në vendin e punës të gjyqëfituesve ku përveç pagave që paguhën nga buxheti i shtetit për këta ish punonjës, duhet të krijohet edhe një tjetër dëm dhe kjo për ndërhyrje në kohë relativisht të gjata në listë pagesat e viteve të mëparshme. Kjo ndërhyrje në sistemin tatimor C@TS ka gjeneruar këto gjoha dhe interesa në vlera të konsiderueshme dhe ajo që përbën risk potencial është se përveç mungesës së koordinimit midis vetë institucioneve qendrore **MB dhe MFE (DPT)** nuk ka asnjë nismë për ecurinë e mëtejshme dhe zgjidhjen e këtij problemi me një kosto në dëm të buxhetit të shtetit në vlerën 17,399,158 lekë, për të cilat mban përgjegjësi MB dhe MFE.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar “Për procedurat tatimore në RSH”, neni 88, neni 89, ku citohet se:

Neni 88 Autoriteti dhe kompetencat për mbledhjen e detyrimit tatimor të papaguar 1. Administrata tatimore ka autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas këtij kreu për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara, për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit apo kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor.

5. Mbledhja e detyrimeve të papaguara kryhet nga drejtoritë përgjegjëse të mbledhjes me forcë të detyrimeve të papaguara, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Neni 89/Njoftimi dhe kërkesa për të paguar

1. Kur administrata tatimore konstaton se një tatimpagues nuk ka paguar plotësisht dhe në datën e caktuar detyrimet tatimore, ajo i dërgon atij, me postë rekomande ose në rrugë elektronike, një njoftim me shkrim, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimit tatimor. Për njoftimin dhe kërkesën për të paguar detyrimet tatimore zbatohen afatet dhe procedurat e parashikuara në nenin 69 të këtij ligji.

*2. Nëse **tatimpaguesi nuk përdor të drejtën e ankimit dhe nuk paguan detyrimin tatimor**, administrata tatimore duhet ta mbledhë tatimin, duke përdorur njërën ose disa prej mënyrave, të parashikuara në këtë kre.*

MB nuk ka ushtruar asnjëherë të drejtën e ankimit, çka ka çuar në rritjen progresive të gjobave dhe interesave dhe nga ana tjetër as DPT nuk ka kryer mbledhjen e këtij detyrimi në zbatim të nenit 89. Pra mungesa e përgjegjësisë dhe moskryerja e detyrave funksionale është dypalëshe, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm prej 17,399,158 lekë.

Ka korrespondencë shkresore në lidhje me detyrimet e cila nga auditimi rezultoi se është një shkresë për secilin vit (periudhë auditimi) e bërë nga MB drejtuar DPT dhe DRT Tiranë, përkatësisht:

-Shkresa me nr. 1170/1, datë 12.04.2021, shkresa me nr 12987, datë 16.12.2022, shkresa me nr. 8470/1, datë 24.08.2023, ku DPESHM bën një kërkesë me të njëjtën përmbajtje në lidhje me detyrimet tatimore në kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të ardhura si pasojë e rivlerësimit të listë pagesave dhe kërkon sistemimin e gjobave dhe interesave pa asnjë argumentim ligjor. Nga ana tjetër nuk ka asnjë përgjigje nga MFE dhe DRT për kundrejt këtyre kërkesave çka tregon që DRT Tiranë nuk ka bazë ligjore për ti sistemuar e si rrjedhim MB duhet t'i njohë si detyrime të prapambetura dhe ti pasqyrojë ato në pasqyrat financiare për të deklaruar borxhin real.

Në vitin 2023, ka dalë udhëzimi nr. 15, datë 12.06.2023, për një shtesë në Udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, ku trajton këtë problematikë dhe konkretisht:

Në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas pikës 114.4 të udhëzimit, shtohet pika 114.5 me këtë përmbajtje:

“114.5 Gjobat për deklarata të pasaktë dhe pagesë të vonuar të detyrimeve për shkak të ndryshimit të listë pagesave dhe gjobat për deklarim të vonuar të formularëve të të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe të larguarve nga puna, nuk aplikohen për organet e qeverisjes qendrore apo vendore, institucionet kushtetuese dhe institucionet e tjera që financohen nga buxheti i shtetit, në rastet e

a) zbatimit të një akti ligjor apo nënligjor me efekte prapavepruese;

b) zbatimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë;

c) zbatimit të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese apo Gjykatës së Lartë;

d) vonesave në nxjerrjen apo dërgimin e vendimeve të emërimit të punonjësve nga organet që kanë këtë të drejtë. Në këto raste, gjobat ndaj organeve të përcaktuara në paragrafin e parë

nuk zbatohen pasi deklarimet apo ndryshimet e listë pagesave me vonesë nuk kanë ardhur për shkak të veprimit apo mosveprimit të këtyre institucioneve.”

Ky udhëzim i cili ka fuqi për të gjitha veprimet që do të kryhen nga institucionet qendrore apo vendore pas datës 12.06.2023, për faljen e gjobave dhe interesave që gjenerohen si rezultat i zbatimit të një vendimi gjykate të formës së prerë, edhe pse kanë kaluar 9 muaj nga hyrja e tij në fuqi nuk është kryer asnjë veprim i MFE me Akshin për përshtatjen edhe funksionimin në sistem në mënyre që sistemi tatimor të mos gjenerojë më gjoba dhe interesa për rastet e sipërcituara, veprime në kundërshtim me VKM nr. 1147, datë 09.12.2020, pika 5, neni 7 “Për përditësimin e shërbimeve elektronike” ku ***Institucionet ofruese të shërbimeve në PVK*** janë të detyruara që, sa herë të ketë ndryshime ligjore dhe procedurale, mbi bazën e të cilave ofrohet shërbimi publik i kërkuar, të dërgojnë ndryshimet e përditësimet përkatëse në AKSHI sipas formularit elektronik të publikuar.

Për përditësimin e shërbimeve elektronike, institucioni ofrues (MFE në rastin konkret) i shërbimit i përcjell AKSHI-t kërkesën për ndryshimet përkatëse brenda 3 (tri) ditëve pune nga hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore apo procedurale bazuar në VKM nr. 1147, datë 09.12.2020, pika 5, neni 7 “Për përditësimin e shërbimeve elektronike”. Mos respektimi i afateve ligjore nga MFE në përditësimin e formularëve elektronikë në përputhje me ndryshimet ligjore në udhëzimin nr nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, ka sjellë rritje të vazhdueshme të gjobave dhe interesave që sistemi tatimor gjeneron si rezultat i *zbatimeve të vendimeve të gjykatës të formës së prerë; për punonjësit e larguar nga puna.*

Gjithashtu, rrjedhojë e këtyre detyrimeve është edhe plotësimi jo i rregullt i listë pagesave nga sektori i financës në DBMF, pasi edhe për gjyqe fitues të cilët kanë vendimin e formës së prerë nga gjykata për kthimin e pagave si dhe duke qenë që MB për të gjithë gjyqëfituesit ka mbajtur kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore përveç, TAP-it, duhet të kryente deklarin periodik mujor sipas afateve të përcaktuara (1-20 të muajit pasardhës) në Ligjin 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar “Për procedurat tatimore në RSH”, veprime të cilat kanë sjellë gjenerimin e gjobave dhe kamatëvonesave e që janë detyrim i MB për t’u shlyer, si dhe një risk i vazhdueshëm për të rënduar buxhetin e shtetit me pagat e gjyqe fituesve.

Pra në total efekti negativ financiar i zbatimit të vendimeve të gjykatës për të larguarit nga puna është 84,237,514 lekë, i detajuar:

-64,577,277 lekë, paga (përfshirë këtu edhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore +TAP);

-2,261,079 lekë, -shpenzime për përmbarimin

-17,399,158 lekë, gjoba +kamatëvonesa në sigurime shoqërore dhe TAP, të pa pasqyruara në pasqyrat financiare e rrjedhimit në MFE nga Ministria e Brendshme.

Konkluzion: Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore dhe njohjen e tyre ne kontabilitet rezultoi se shuma e vendimeve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t’u shlyer sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, por janë njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42. Kjo ka sjellë mos pasqyrim të drejtë të llogarive në pasqyrën e “Pozicionit financiar”. Për periudhën në auditim 2021-2023 numri i të rikthyerve në punë është 8 punonjës ndërsa është pushuar ekzekutimi i titullit ekzekutiv për 3 persona të cilët nuk janë rikthyer në punë edhe pas gjetjes

dhe ofrimit të pozicionit përkatës. Janë të **pa sistemuar për rikthimin në punë, ende 8 persona** me vendim gjyqate të formës së prerë, të cilët vazhdojnë të paguhen nga buxheti i shtetit si dhe t'u mbahen kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore çdo muaj.

Konstatohet se efekti negativ financiar në buxhetin e shtetit nga MB, për 2021-2023, për pagesën ndaj gjyqe fituesve, është **66,838,356 lekë**, kur ndërkohë vende bosh në strukturë janë 25. Shpenzimet përmbartimore janë në vlerën e **2,261,079 lekë** duke sjellë kosto shtesë në buxhetin e shtetit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë, Nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesari” pika 5. Në respekt të këtij detyrimi ligjor MB rezultoi se nuk ka publikuar on line në faqen zyrtare të saj, grafikun e shlyerjes së detyrimeve sipas përcaktimit të bërë në këtë udhëzim, e cila fillon me likuidimin e detyrimeve duke njoftuar menjëherë gjyqe fituesin.

Kjo ka sjellë rritje të shpenzimeve të kryera për shërbimin përmbartimor për vitin 2023, rreth 4 herë më shumë krahasuar me vitin 2022, çka tregon për një risk të vazhdueshëm në ndikimin financiar negativ që kanë të larguarit nga puna pa të drejtë në Ministrinë e Brendshme.

-Nga auditimi u konstatua se përveç efektit negativ financiar që mbartin shlyerja e vendimeve gjyqësore për të larguarit pa të drejtë nga puna dhe mos sistemimit të tyre në organikën aktuale të MB një pasojë tjetër me kosto në buxhetin e shtetit është detyrimi që ka gjeneruar dhe rivlerësimi i listë pagesave mujore me këta gjyqë fitues në vite si rezultat i tej zgjatjes së proceseve gjyqësore. Nga verifikimi i detyrimeve të prapambetura **të deklaruara në pasqyrat financiare me ato në sistemin tatimor C@TS** konstatohet se Ministria e Brendshme ka detyrime në Kontributet e Sigurimeve shoqërore e shëndetësore detyrimet (deri më datë 06.03.2024), në vlerën 17,399,158 lekë ku të ndarë sipas llojeve të tatimit vërehet se peshën më të madhe e kanë Kontributet e Sigurimeve shoqërore e shëndetësore në vlerën 15,488,419 lekë dhe Tatim mbi të ardhurat personale në vlerën 1,910,739 lekë ose e thënë ndryshe 96,5 % e detyrimeve totale të pashlyera dhe të mbartura relativisht në një kohë të gjatë, janë gjoba dhe kamatëvonesa në Kontributet e Sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Nisur nga sa më sipër, grupi i auditimit verifikoi “moshën” e borxhit në këtë lloj tatimi si dhe arsyen e këtyre vlerave të larta ku vetëm **gjodat dhe interesat janë 10,828,310 lekë**. Në analizën e kryer u konstatua se këto gjodat dhe interesa vijnë si rezultat i likuidimit të vendimeve gjyqësore për të larguarit nga puna, për një kohë relativisht të gjatë, si nga tej zgjatja e proceseve gjyqësore ashtu edhe në mos kthimin në vendin e punës të gjyqe fituesve, ku përveç pagave që paguhen nga buxheti i shtetit për këta ish punonjës, duhet të krijohet edhe një tjetër dëm dhe kjo për ndërhyrje në kohë në listë pagesat e viteve të mëparshme. Për periudhën në auditim 2021-2023, MB ka gjeneruar detyrime në kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në vlerën 1,585,626 lekë, të përfshira këto në vlerën totale të cituar më sipër. (17,399,158 lekë).

Kjo ndërhyrje në sistemin tatimor C@TS ka gjeneruar këto gjodat dhe interesa në vlera të konsiderueshme dhe ajo që përbën risk potencial është se përveç mungesës së koordinimit midis vetë institucioneve qendrore **MB dhe MFE (DPT)** nuk ka asnjë nismë për ecurinë e mëtejshme dhe zgjidhjen e këtij problemi me një kosto në dëm të buxhetit të shtetit në vlerën 17,399,158 lekë, për të cilat mban përgjegjësi MB, MF dhe DPT. Drejtoria e buxhetit dhe menaxhimit financiar në MB nuk kishte ndjekur ecurinë e tyre periodikisht si dhe nuk i kanë pasqyruar në detyrimet e prapambetura në pasqyrat financiare të MB duke mos i “njohur” ato si të tilla, çka ka sjellë mos pasqyrim të drejtë të llogarive në pasqyrën e “Pozicionit financiar”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 61, Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për

procedurat në përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42. (trajtuar kjo edhe në drejtimin 4 të programit të auditimit 169/1, datë 31.01.2024, i ndryshuar).

Sa më sipër, vlera prej **84,238** mijë lekë e përbërë nga:

- 64,577 mijë lekë, paga (përfshirë këtu edhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore +TAP);
- 2,261, mijë lekë -shpenzime përmbarimore
- 17,399 mijë lekë - gjoba + kamatëvonesa në sigurime shoqërore dhe TAP, konsiderohet si shpenzim pa efektivitet për buxhetin e shtetit.

2.3 Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

Në zbatim të drejtimin nr. 3 të programit të Auditimit nr.169/1, datë 31.01.2024, i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni fizik dhe elektronik “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore mbi administrimin ruajtjen dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, u mbajt më dt. 26.04.2024 ky akt-konstatim për periudhën e auditimit vitet 2021/2022/2023.

Baza ligjore mbi të cilin u bazua auditimi:

- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar;
- Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”;
- Udhëzimi i Ministrisë Financave dhe Ekonomisë nr.30, date 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”;
- Udhëzim nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”;
- Ligji nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”;
- VKM-së nr. 50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”;
- UMFE nr. 37, datë 06.10.2020 ‘Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme;

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandat arkëtim, mandat-pagesë, urdhër-shpenzim;
- Transaksionet e llogarive bankare.

Nga auditimi me zgjedhje i transaksioneve të kryera përgjatë viteve objekt auditimi mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër shpenzim, etj.) të realizuara në Ministrinë Brendshme rezultoi se, veprimet janë kryer konform kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar sipas rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces

verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve) sipas pikës 35, të Udhëzimit të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë nr.30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" dhe në çdo rast kanë nënshkrimin e personit të autorizuar në Degën e Thesarit.

- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 janë në vlerën totale 379,217,459 lekë;
- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 janë në vlerën totale 385,496,159 mijë lekë;
- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 janë në vlerën totale 519,933,165 lekë.

Urdhër-shpenzimet e përzgjedhura u audituan në zbatim të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik", veçanërisht sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si dokumente autorizues, dokumente vërtetues, dokumente të kontabilitetit, etj.

2.3.1 Auditimi me zgjedhje i urdhër shpenzimeve

Nga auditimi me zgjedhje i urdhër-shpenzimeve, duke i analizuar dhe me regjistrimin në sistemin SIFQ, për vitet 2021;2022;2023, nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua mosrespektim i afateve, sa i takon likuidimit të faturave, duke tejkaluar afatin ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 184 "Nëpunësit zbatues të njësisve shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik", si dhe në ligjin nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", në nenin 7 lidhur me afatin e pagesave për autoritetet publike, përcaktohet se "Në veprimet juridike tregtare, në të cilat debitori është autoritet publik, pas mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit nga debitori. Sipas nenit 463 të Kodit Civil: a) kur kreditori i ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij, sipas ligjit dhe kontratës; b) kur kreditori nuk është paguar, me përjashtim të rastit kur vonesa nuk ka ardhur për faj të debitorit; c) kur nga kontrata apo nga ndonjë dispozitë tjetër ligjore nuk mund të përcaktohet ndonjë afat a datë për kryerjen e pagesës, afati i pagesës nuk duhet të jetë më i gjatë se: i) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes nga ana e debitorit të faturës ose të një kërkesë pagesë të njëvlershme; ii) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes së mallrave ose shërbimeve, kur nuk është e qartë data e marrjes së faturës ose kërkesë pagesës së njëvlershme". Gjithashtu, në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në nenin 52 përcaktohet se "Nëpunësit zbatues të njësisve shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik". Mos pagesa në kohë e faturave, shkakton premisë që operatorët ekonomikë të kërkojnë kamatëvonesa në favor të tyre, sikurse përcaktohet në nenin 11 të ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", ku specifikohet se "Kreditore ka të drejtë të kërkojë nga debitori jo vetëm pagimin në favor të tij të kamatëvonesës për moskryerjen e pagesës në afat, por edhe pagimin e të gjitha shpenzimeve të kryera prej tij për rikthimin e kredisë, shpenzime këto të kryera për shkak të pagesës me vonesë, përveç rasteve kur debitori nuk është në faj për vonesën".

Tejkalimi i këtij afati ka krijuar detyrime të prapambetura për institucionin, ku sipas VKM-së nr. 50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” dhe UMFE nr. 37, datë 06.10.2020 ‘Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, detyrime të prapambetura konsiderohen detyrimet e përcaktuara në një ligj/ marrëveshje/ vendim gjykatë të formës së prerë, që mbeten të papaguara 60 ditë, pas datës së lëshimit të faturës nga operatori ekonomik.

Në tabelat e paraqitura në aneksin sipas drejtimit 2.3, të ndara sipas viteve periudhë auditimi janë paraqitur urdhër shpenzimet e kryera jashtë afatit 30 ditor.

Rezultoi se për secilin vit, janë:

- ∞ Për vitin 2021-19 urdhër shpenzime jashtë afatit ligjor në vlerën 33,226,179 lekë
- ∞ Për vitin 2022-33 urdhër shpenzime jashtë afatit ligjor në vlerën 21,019,306 lekë
- ∞ Për vitin 2023-8 urdhër shpenzime jashtë afatit ligjor në vlerën 46,171,760 lekë

Gjithsej 60 urdhër shpenzime në vlerën 100,417 mijë lekë të paguara jashtë afateve ligjore duke rriskuar kërkimin e kamatëvonesave nga OE.

Nga verifikimi i memove të brendshme shkresore konstatohet se jo për të gjitha urdhër shpenzimet e likuiduara me vonesë, mban përgjegjësi sektori i Financës dhe Nëpunësi zbatues pasi referuar disa shkresave që DBMF i ka drejtuar Drejtorive përkatëse në MB që kanë marrë shërbimet për respektim të afateve ligjore, janë pikërisht këto drejtori të cilat kanë dorëzuar me vonesë praktikatat e duhura, ku përmendim:

-Shkresa nr. 2063/1. date 25.06.2021 "Mbi kërkesat për pagesë" drejtuar DPGJC.

-Për pagesat e energjisë elektrike të muajit dhjetor 2020, (4 urdhër shpenzime), kërkesa për pagesë është paraqitur me vonesë nga struktura përgjegjëse, (shkresë nr. 444 dt. 26.01.2021) 2 urdhër shpenzime janë brenda afatit 30 ditor (ujësjellës kanalizime dhe shpenzime telefoni). etj.

-Për pagesat e energjisë elektrike të muajit dhjetor 2021, (3 urdhër shpenzime), kërkesa për pagesë është paraqitur me vonesë nga struktura përgjegjëse që mbulon shërbimet, (shkresa nr. 1063 dt. 01.02.2022).

Lidhur me urdhër shpenzimet e paguara me vonesë për vitin 2023, janë konstatuar 8 copë, konkretisht: Për 5 urdhër shpenzime janë paraqitur me vonesë kërkesat për pagesë nga struktura përgjegjëse e shërbimeve, konkretisht:

Për pagesën e energjisë elektrike të muajit dhjetor 2022, kërkesa është paraqitur me shkresën nr. 916 dt. 26.01.2023,

Për blerje pajisje për sistemin e RKA-së të Gjendjes Civile, kërkesa është paraqitur me shkresën nr. 5368/6 dt. 15.12.2023,

Për urdhër shpenzimet e pagesave për shpenzime udhëtimi për shërbim jashtë vendit, ka pasur një korrespondencë me strukturën përkatëse (Sektori i shërbimeve të përgjithshme) lidhur me praktikatat e dërguara për likuidim, të sjella me vonesë nga ana e tyre.

2.3.2 Nga auditimi me përzgjedhje i urdhër shpenzimeve u konstatua se në 3(tre) raste urdhër-shpenzimi janë kryer pagesat për vendimet gjyqësore ku përfshihen edhe tarifatat përbarimore me TVSH-në vlerën 782,346 lekë. Për këto vlera nuk ka fatura tatimore si rrjedhim nuk është mbajtur tatimi në burim 15%.

Tabela nr. 3.1.

Urdhër shpenzime (V.G.J.) vitet 2021/2022/2023			Përfituesi
Nr.	Datë	vlera e përfituar	
488	30.12.2021	923,909.00	Zyra përbarimore Tiranë

462	30.12.2022	923,903.00	Zyra përbarimore Tiranë
445	29.12.2023	1,104,711.00	Zyra përbarimore Tiranë

Burimi i të dhënave, MB, përpunuar nga GA.

a. Nëpërmjet urdhër shpenzimit nr. 488 datë 30.12.2021, objekti i shpenzimit “Shpenzime për vendim gjyqësor” është paguar tarifë përbarimi, dhe është derdhur totali 923,909.00 lekë.

Kjo tarifë është paguar në zbatim të ekzekutimit të vendimit nr. 8205, dt. 29.09.2008 të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor, Shkallës së Parë Tiranë, me palë në procesin përbarimor kreditor Bajram Bistri dhe debitor Ministria e Brendshme. Padiësi, B. B. ka paditur Ministrinë e Brendshme në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë me objekt “Detyrimin e palës së paditur Ministrinë e Brendshme të punësojë padiësin B. B. në pozicionin e Përgjegjësit të Auditit, në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm”, sipas vendimit dt. 19.01.2007 të KSHC. Kundër këtij vendimi është bërë ankim dhe Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e Shkallës së Parë Tiranë. Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe në çastin kur merr formë të prerë ekzekutohet nga zyra e përbarimit. Veprimet e mësipërme përsa i përket urdhër shpenzimit nr. 488 datë 30.12.2021, nuk janë në përputhje me *Ligjin nr. 8438, dt. 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, nenit 33*, pra kemi mos llogaritje të saktë të tatimeve, nuk është mbajtur 15% tatimi në burim dhe derdhja e tyre në buxhet, mos plotësimi i dokumentacionit shoqërues sipas përcaktimeve ligjore (s’ka faturë tatimore).

b. Nëpërmjet urdhër shpenzimit nr. 462 datë 30.12.2022, objekti i shpenzimit “Shpenzime për vendim gjyqësor” është paguar tarifë përbarimi, dhe është derdhur totali 923,903.00 lekë.

Kjo tarifë është paguar në zbatim të ekzekutimit të vendimit nr. 8205, dt. 29.09.2008 të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor, Shkallës së Parë Tiranë, me palë në procesin përbarimor kreditor B. B. dhe debitor Ministria e Brendshme.

Veprimet e mësipërme përsa i përket urdhër shpenzimit nr. 488 datë 30.12.2021, nuk janë në përputhje me përcaktimet ligjore në *Ligjin nr. 8438, dt. 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, nenit 33*, pra kemi mos llogaritje të saktë të tatimeve, nuk është mbajtur 15% tatimi në burim dhe derdhja e tyre në buxhet, mos plotësimi i dokumentacionit shoqërues sipas përcaktimeve ligjore (s’ka faturë tatimore).

c. Nëpërmjet urdhër shpenzimit nr. 445 datë 29.12.2023, objekti i shpenzimit “Shpenzime për vendim gjyqësor” është paguar tarifë përbarimi, dhe është derdhur totali 1,104,711.00 lekë.

Kjo tarifë është paguar në zbatim të ekzekutimit të vendimit nr. 8205, dt. 29.09.2008 të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor, Shkallës së Parë Tiranë, me palë në procesin përbarimor kreditor Bajram Bistri dhe debitor Ministria e Brendshme.

Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me përcaktimet ligjore në *Ligjin nr. 8438, dt. 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, nenit 33*, pra kemi mos llogaritje të saktë të tatimeve nuk është mbajtur 15% tatimi në burim dhe derdhja e tyre në buxhet, mos plotësimi i dokumentacionit shoqërues sipas përcaktimeve ligjore (s’ka faturë tatimore).

Nga ana e Ministrisë duhet të llogaritet dhe mbahet tatimi në burim për pagesat e tarifave të subjekteve përbarimore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të cilat nuk dorëzojnë faturën TVSH-së. Duhet të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës së tatimit në burim nga subjektet përbarimore përfituar padrejtësisht si rezultat i mos mbajtjes të tatimit në burim mbi të ardhurat nga shërbimi përbarimor.

2.3.3 Gjithashtu nga grupi i auditimit u konstatua se MB ka likuiduar 3 (tre) fatura për konsumin e energjisë elektrike të paraqitura nga OSHEE, të cilat përfaqësojnë përkatësisht 3 kontrata për furnizimin me energji elektrike. Kontrata me nr.TR2A110078107840, nr.TR2A110031107841 dhe kontrata me nr.TR2A110031107843, këto kontrata janë lidhur më dt.15.03.1998.

Nga ana e grupit të auditimit iu kërkua sektorit të shërbimeve vënia në dispozicion e kontratave të lidhura me OSHEE për furnizimin me energji elektrike të institucionit, dhe kontrata e furnizimit me ujë, ku nga përgjigja e këtij sektori **rezultoi se kontratat nuk i dispononin dhe nuk gjenden as në arkivin e institucionit, pra nuk ekzistojnë.**

Pagesat e kryera për shpenzimin e energjisë elektrike dhe konsumit të ujit kryheshin mbi bazën e faturave të paraqitur nga OE që ofrojnë këto shërbime, u konstatua se faturat e likuiduara nuk pasqyronin të dhënat sasiore të konsumit të nxjerra nga aparatet matës, por pasqyronin një shumë, në vlerë për likuidim të pa argumentuar me të dhënat sasiore të aparatit matës.

Nga grupi i auditimit u konstatua se lidhur me pagesat për shpenzimet e energjisë elektrike, MB i është bllokuar llogaria 602, “Shpenzime operative” në thesar të kërkuar nga OSHEE, me argumentimin e mos shlyerjes së detyrimeve nga ana e institucionit të MB, për konsumin e energjisë elektrike, si dhe të kamatë vonesave të aplikuara për periudhën nga viti 2015 deri në Qershor 2022, shpenzime të cilët në vlerë totale janë, **136,142,855.86 lekë**, nga këto vetëm kamatë vonesat janë 68,626,842.82 lekë ose e thënë ndryshe sa 50 % e detyrimit total.

Pra sipas këtij dokumentacioni përveç vlerës së faturave që u referohen dhe që nuk dihet arsyeja e mos likuidimit, konstatohet analitikisht se po thuaj se për të gjithë muajt dhe për të tre kontratat e referuara evidentohen kamatëvonesa të përlllogaritura për tu paguar, madje edhe për periudhën kur faturat janë likuiduar dhe ato në vijim janë evidentuar dhe kërkohen nga OSHEE kamatëvonesa. Vlera e kamatëvonesave për çdo likuidim me vonesë të detyrimeve sipas faturave përbën një efekt negativ në buxhetin e institucionit të MB.

Lidhur me këto detyrime të pretenduara nga ana e OSHEE, nga MB është ngritur një grup pune dhe po punohet për rakordimin dhe zgjidhjen e problemit. Sa i takon këtij detyrimi, nga përfaqësuesit e OSHEE janë mundësuar disa skema lehtësuese për pagesën e këtij detyrimi, në format si vijon:

a) MB mund të paguajë shumën totale njëherazi dhe automatikisht përfitojnë një zbritje prej 50% të kamatës, pra 34,313,421.41 lekë;

b) MB mund të lidhë një aktmarrëveshje për shumën totale duke pasur mundësinë të propozojë se në sa këste mund ta ndajë (maksimumi në 60 këste). Çdo muaj do paguhet fatura e muajit përkatës dhe një këst. Për lidhjen e aktmarrëveshjes, detyrimisht duhet të likuidohen plotësisht detyrimet për vitin 2022. Më pas, kjo aktmarrëveshje mund të priset nga palët pa penalitete shtesë. Për çdo pretendim në lidhje me faturat, mund të bëhet ankesë vetëm pas lidhjes së marrëveshjes. Në rast të verifikimit të pretendimeve të MB, kjo aktmarrëveshje mund të priset pa penalitete dhe të lidhet aktmarrëveshja sipas kushteve të reja.

Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar është konfirmuar se nuk ka fonde për përballimin e totalit të detyrimit. Ministria së Brendshme ka vijuar me lidhjen e aktmarrëveshjes, e cila është nënshkruar nga personi i autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

Menjëherë pas lidhjes së aktmarrëveshjes, janë bërë ankesat pranë OSHEE në lidhje me:

a) Verifikimin nëse këto matësa furnizojnë me energji elektrike ndonjë subjekt tjetër dhe nëse ka ndonjë lidhje të jashtëligjshme, pasi faturat që vijnë çdo muaj janë shumë të larta;

b) Për kontratën TR2A110078107840 janë kërkuar shpjegime në lidhje me dy fatura të tetorit 2016, të cilat janë në vlera shumë të larta dhe i përkasin periudhës që Ministria ka qenë në proces rikonstruksioni;

c) Në lidhje me kontratën TR2A110031107843, është evidentuar se nuk përputheshin leximet e matësit me vlerën e faturës dhe na kanë sqaruar se për këtë kontratë, në matësin kryesor që është i Ministrisë së Brendshme, është i lidhur një nën matës, i cili i përket një subjekti tjetër. Më pas, nga matësi kryesor zbritet sasia e shënuar nga nën matësi duke nxjerrë përfundimisht konsumin e Ministrisë së Brendshme. Nga ana jonë është kërkuar që të identifikohet mbajtësi i këtij nën matësi dhe të shihet mundësia që për ministrinë të ketë një lidhje direkt pa përfshirjen e asnjë subjekti tjetër.

Konkretisht, pranë zyrave të OSHEE janë bërë ankesë/kërkesat me Nr. Çështjeje CSC2171022352, datë 17.10.2022, Nr. Çështjeje CSC217102282, datë 17.10.2022 dhe Nr. Çështjeje CSC2171022414 datë 17.10.2022, për të cilat nuk kemi marrë asnjëherë përgjigje. Gjithashtu, Ministria e Brendshme i është drejtuar në mënyrë të përsëritur OSHEE nëpërmjet shkresave Nr. 10820 Prot., datë 19.10.2022, me lëndë “*Kërkesë për verifikimin e matëseve të energjisë elektrike dhe ankesë në lidhje me mënyrën e faturimit*”, shkresës Nr. 10820/1, datë 24.01.2023, “*Ri kujtesë për kthimin e përgjigjes për shkresën Nr. 10820 Prot., datë 19.10.2022 dhe kërkesë për spostim matësi*”. Me shkresën Nr. 833/1 Prot., datë 13.02.2023 të OSHEE, është konfirmuar se në përgjigje të shkresës së mësipërme, nuk mund të bëhet zhvendosja e matësve brenda ambienteve të MB. Gjithashtu kontratat TR2A110031107841 dhe TR2A110031107843 faturohen me lexim të rregullt, duke bërë zbritjen e shënuar nga nën matësi, ndërsa kontrata TR2A110031107841 është konstatuar me “*anomali 51 (matësi jashtë kushtit teknik)*” dhe është faturuar me vlerë referuese për periudhën Nëntor dhe Dhjetor 2022, sipas vendimit të ERE”.

Me shkresën Nr. 10820/3 Prot., datë 23.02.2023 me lëndë “*Në përgjigje të shkresës Tuaj Nr. 833/1 Prot.,13.02.2023*”, i është bërë me dije se nga ana e OSHEE është trajtuar kërkesa për spostim matësi ndërsa kërkitimi kryesor ka qenë verifikimi i matësve nëse furnizojnë me energji subjekte të tjera dhe heqjen e këtyre lidhjeve në se ka, si dhe janë përsëritur pretendimet e ngritura në kërkesat e mëparshme. Gjithashtu është kërkuar që, meqenëse nuk mund të bëhet zhvendosja e matësve brenda godinave të MB, këto matësa të vendosen në një kabinë të vetme pa praninë e asnjë nën matësi apo lidhjeje tjetër.

Me emailin e datës 05.04.20223 të OSHEE-së drejtuar Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, bëhet me dije se në pamundësi të zhvendosjes së matësve brenda godinës së MB, është bërë heqja e të gjithë nën matësve që furnizojnë me energji subjektet e tjera, duke mundësuar furnizimin me energji vetëm të Ministrisë së Brendshme, për të cilën janë mbajtur procesverbalet përkatëse).

Bazuar në tre përllogaritje të OSHEE, (*pasi MB ka 3 tre Kontraktor/matës energjie*), të vëna në dispozicion nga Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore konstatohet kjo situatë sipas kontratave respektive:

- Për kontratën me nr.TR2A110078107840, rezulton e pa paguar fatura e muajit Tetor 2016 për shumën 18,495,540.84 lekë, si dhe detyrimi i ardhur nga pagesa e faturave përtej afatit ligjor institucioni është ngarkuar me kamatë vonesë për shumën 18,946,065.78 lekë, (*për periudhën Tetor 2016 Qershor 2022*), detyrimi total për këtë kontratë është 37,441,606.62 lekë.

-Për kontratën me nr.TR2A110031107841, konstatohen si të pa likuiduara faturat për periudhën nga *Gusht 2015 deri në Dhjetor 2019*, të cilët kapin shumën 18,170,665 lekë, kamat vonesat e aplikuar për likuidim të vonuar, për periudhën *Gusht 2015 deri Qershor 2022* kapin shumën 18,441,248.81 lekë, në total për këtë kontratë detyrimi shkon 36,611,913.81 lekë.

-Për kontratën me nr.TR2A110031107843, detyrimi për faturat e pa likuiduara, për periudhën nga *Janar 2017 deri në Dhjetor 2019* është 30,849,807.20, ndërsa kamat e aplikuar për vonesat

për likuidim të vonuar për periudhën Janar 2017 deri në Qershor 2022 kapin shumën 31,239,528.23 lekë, në total për këtë kontratë detyrimi shkon 62,089,335.43 lekë.

Detyrimi në total i MB ndaj OSHEE i përlllogaritur dhe i pretenduar nga OSHEE në prezencë dhe të grupit të punës të MB ngritur me email datë 07.09.2022, ka shumën, 136,142,855.86 lekë, (principali faturat e pa likuiduara 67,516,013.04 lekë dhe kamat vonesat e aplikuar 68,626,842.82 lekë), sipas tabelës si vijon :

Tabela nr. 3.2

<i>Nr.</i>	<i>Nr. Kontratës</i>	<i>Principal</i>	<i>Kamatë</i>	<i>Total</i>
1	TR2A110078107840	19,331,708.84	18,946,065.78	38,277,774.62
2	TR2A110031107841	18,702,241.00	18,441,248.81	37,143,489.81
3	TR2A110031107843	31,104,956.80	31,239,528.23	62,344,485.03
		69,138,906.64	68,626,842.82	137,765,749.46

Burimi i të dhënave, MB, përpunuar nga GA.

Nga auditimi u konstatua se pagesat e faturave të energjisë elektrike ndaj OSHEE janë kryer me vonesë, përtej afatit ligjor parashikuar nga Ligji nr.48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare”, neni 7, germa ‘c’. Mosrespektimi i afatit ligjor lidhur me pagesat e faturave të konsumit të energjisë elektrike, ka sjellë që Ministria e Brendshme të penalizohet me kamatëvonesa në vlerën **68,626,842.82 lekë, menaxhim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve publike.**

Konkluzion:

Krijimi i detyrimeve të prapambetura ndikon në riskun e realizimit të investimeve të reja, si dhe blerjen e mallrave dhe shërbimeve të planifikuara, për t’u realizuar në periudhat e ardhshme, pasi një pjesë e konsiderueshme e buxhetit vjetor shkon për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të krijuara nga institucioni.

Krijimi i detyrimeve të prapambetura ka ardhur, ndër të tjera, edhe si rrjedhojë e:

- Mos identifikimit të risqeve që pengojnë reduktimin, shlyerjen dhe parandalimin e detyrimeve të prapambetura;
- Mungesës së kontabilizimit të plotë dhe të saktë të të gjitha detyrimeve, që nga koha e krijimit të tyre, si dhe regjistrimit të faturave në kohë në sistemin SIFQ;
- Mungesës së Planeve të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura dhe planifikimit të fondeve të dedikuara për pagesat;
- Mosrespektimit të qasjes FIFO në radhën e shlyerjes së detyrimeve.
- Mos bashkëpunimit ndërmjet drejtorive pjesë e Aparatit të MB, në dërgimin me vonesë të praktikave për shërbimet e marra dhe rrjedhimisht në krijimin e riskut në likuidimin jashtë afatit 30 ditor të përcaktuar në ligj.

Sa më lart në kundërshtim me UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184: Ligji nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare”, neni 7, VKM-së nr. 50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” dhe UMFE nr. 37, datë 06.10.2020 ‘Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.

Nga auditimi i faturave të likuiduara nga ana e Ministrisë së Brendshme, me datën e faturës tatimore, nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua se për vitin 2021/2022/2023, janë kryer likuidime në tejkallim të afatit ligjor 30 ditorë.

Konkretisht, nga kryerja e testeve mbi urdhër shpenzimet, u konstatuan se **60 urdhër**

shpenzime të viteve 2021/2022/2023 janë likuiduar mbi afatin e parashikuar 30 ditor duke shkelur disiplinën buxhetore, *tabela nr. 1/ 2/3*. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 52 ku citohet... : “*specifikohet se Nëpunësi zbatues i njësisve shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatoreve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së, si dhe Ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7.*

-Nga auditimi i urdhër shpenzimeve për pagesat e shpenzimeve gjyqësore, u konstatua se nga ana e MB janë kryer pagesat për vendimet gjyqësore ku përfshihen edhe tarifat përmbartimore me TVSH në vlerën 2,952,523 lekë. Për këto vlera nuk ka fatura tatimore dhe rrjedhimisht nuk është mbajtur tatimi në burim në vlerën 442,878 lekë. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 33.

-Nga auditimi i urdhër shpenzimeve mbi pagesat e energjisë elektrike u konstatua se MB i ka lindur detyrimi prej 136,142,855 lekë, e cila përbëhet nga vlera e faturave të pa likuiduara në shumën 67,516,013 lekë dhe kamatëvonesave në shumën 68,626,842 lekë për të cilat institucioni ka lidhur një aktmarrëveshje për shumën totale propozuar shlyerjen në 60 këste. Çdo muaj është paguar fatura e muajit përkatës dhe një këst. Sa më sipër, nga auditimi u konstatua se Ministria e Brendshme ka likuiduar vetëm një pjesë të faturave të paraqitura nga OSHEE për furnizimin me energji elektrike. Edhe pse nga ana e MB ka pasur përpjekje për zgjidhjen e kësaj situate, mungesa e fondeve dhe mosbashkëpunimi i OSHEE-së ka sjellë që situata të mbetet e paqartë. Ankesat dhe kërkesat e përsëritura nga ana e MB-së nuk kanë marrë përgjigje nga ana e OSHEE, duke lënë Ministrinë në një situatë të vështirë financiare. Nga ana tjetër, edhe pse është lidhur akt marrëveshja midis palëve, u konstatua se ky detyrim nuk është regjistruar si edhe të jetë njohur në kontabilitet në llogarinë nr.486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*”, duke sjellë për pasojë paraqitjen e një situate jo reale të detyrimeve të prapambetura të cilat Institucioni ka ndaj të tretëve në periudha të ndryshme. Sa më sipër, u konstatua se pagesat e faturave të energjisë elektrike ndaj OSHEE janë kryer me vonesë, përtej afatit ligjor parashikuar nga Ligji nr.48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare”, neni 7, germa ‘c’. Mosrespektimi i afatit ligjor lidhur me pagesat e faturave të konsumit të energjisë elektrike, ka sjellë që Ministria e Brendshme të penalizohet me kamatëvonesa në vlerën **68,626,842.82 lekë, menaxhim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve publike.**

2.4 Auditimi i llogarive vjetore.

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Formati 1- Pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2022;
2. Formati 2- Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2022;
3. Formati 3- Pasqyra e flukseve monetare për vitin 2022;
4. Formati 4- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto për vitin 2022;
5. Formati 5- Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për vitin 2022;
6. Formati 6- Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre për vitin 2022;
7. Formati 7- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto për vitin 2022;

8. Formati 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave për vitin 2022.

a. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018.”

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.

Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Për çdo vit të veçantë të periudhës objekt auditimi, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe kërkesave të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, me Udhëzimin e MFE me nr. 5, datë 21.02.2022, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar në afat për miratim në Degën e Thesarit Tiranë.

Rezulton se, veprimet kontabël janë azhornuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga Ministria e Brendshme, situacione këto të rakorduara me degën e Thesarit.

PF është shoqëruar me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore.

Në bazë të të dhënave kontabël përkatëse janë përpiluar Pasqyrat Financiare vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor që janë raportuar.

- Për vitin 2022 janë dorëzuar Pasqyrat Financiare të Aparatit të Ministrisë së Brendshme pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 2039/9 Prot., datë 27.03.2023 “Për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor 2022.”

Nga ana e grupit të auditimit u konstatua se Pasqyrat Financiare të Aparatit të Ministrisë së Brendshme janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 2039/9 Prot., datë 27.03.2023 “Për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor 2022” brenda afatit të përcaktuar. Veprimet e mësipërme janë kryer në përputhje me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

Nga ana tjetër, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit i është raportuar rregullisht Degës së Thesarit.

b. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

▪ **Auditimi i llogarive të performancës financiare**

Nga auditimi i gjendjes së llogarive rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konform rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike dhe ato analitike.

Totali i ardhurave të funksionimit në Pasqyrën e Performancës është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit (formati nr.2). Konkretisht për vitin 2022 paraqiten si vijon:

i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2) = 1,213,297 mijë lekë

ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2) = 1,255,422 mijë lekë

iii. Rezultati i ushtrimit (llog.85)= (42,125 mijë lekë)

Totali ii + iii= 1,213,297 mijë lekë

Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore“ në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (F1) rakordon me vlerën e kësaj llogarie të shënuar në kolonën nr. 132 të Formatit nr. 2 “Pasqyra e Performancës”.

Llogaria 63 “Ndryshimit të gjendjes së inventarit” në Formatin nr. 1 të Pasqyrave Financiare Vjetore, (diferenca midis tepicës më 31.12.2021 me 31.12.2022, përkatësisht 31,182,424 minus 35,540,354) rezulton (4,357,930) lekë, e cila rezulton e barabartë me shumatoren e llogarisë 63 dhe 73 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit” në Pasqyrën nr. 2, “Performanca financiare e institucionit”.

Nga analiza e llogarisë 2 “Gjendje Inventari qarkullues” rezulton të jetë regjistruar llogaria 31 “Materiale” dhe llogaria 32 “Inventar i imët.”

Të ardhurat

‘në lekë

Nr.	Llogaria	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca
1	A	TE ARDHURAT	1,213,297,172	1,085,025,515	128,271,657
34	71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	815,680,430	710,610,491	105,069,939
35	710	I.Nga ndermarrjet dhe pronësia	811,828,060	707,813,757	104,014,303
38	7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronësia	811,828,060	707,813,757	104,014,303
39	711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	3,852,370	2,796,734	1,055,636
40	7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	123,600	145,500	-21,900
43	7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve	3,728,770	2,601,234	1,127,536
45	7115	Gjoha, kamatvonesa, sekuestri dhe zhdemtime		50,000	-50,000
53	72	V.GRANTE KORENTE	397,616,742	374,415,024	23,201,718
54	720	I.Grant korent I Brendshem	397,616,742	374,415,024	23,201,718
55	7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	376,370,472	352,998,568	23,371,904
61	7206	Financim I pritshe nga buxheti	21,246,270	21,416,456	-170,186
73	73	VIL.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE			

Burimi: MB/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Në tabelën e mësipërme, përfshihen të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit 2022, në vlerën 1,213,297,172 lekë, analizuar si më poshtë:

▪ Në llogarinë 710 “Nga ndermarrjet dhe pronësia”, paraqitet në shumën 811,828,060 lekë, shumë e cila përfaqëson të ardhurat nga tarifat koncesionare që realizohen nga pasaportat dhe kartat e identitetit në DPGJC.

- Llogaria 7110 “*Tarifa administrative dhe rregullatore*” në shumën 123,600 lekë përfaqëson të ardhura nga tarifat për vërtetimet që lëshohen nga Drejtoria e Arkivit për shërbime të ofruara nga portali E-albania.
- Llogaria 7113 “*Te ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve*” në shumën 3,728,770 lekë përfaqëson Te ardhura që përfitohen nga Shërbimet që kryhen nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, në varësi të kërkesave për certifikata zjarri, të miratim të projekteve etj.
- Llogaria 720 “*Grant korrent i Brendshëm*” i cili përbëhet nga: llogaria 7200 “*Nga Buxheti për NJQP(Qendrore)*” në shumën 376,370,472 lekë dhe llogaria 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*” në shumën 21,246,270 lekë vlerë e cila rakordon me llogarinë 4342 “*Të tjera operacione me shtetit debitor*”, e cila përfaqëson detyrimet që ka MB ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2022, përkatësisht për pagat, për tatim taksa, për sigurime shoqërore dhe sigurime shëndetësore, si dhe vlera e faturave të shpenzimeve të konstatuara në dhjetor, të cilat paguhen në janar 2023.

Shpenzimet

Në lidhje me raportimin e shpenzimeve të konstatuara gjatë vitit 2022, në vlerën 1,255,422,291 lekë, analizuar si më poshtë:

- Llogaria 600 “*Paga e shpenzimeve personeli*” në shumën prej 215,612,500 lekë, përfaqëson pagat e personelit të përhershëm.
- Llogaria 601 “*Kontribute të Sigurimeve Shoqërore*” në shumën prej 34,597,807 lekë, përfaqëson shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesa e paguar nga punëdhënësi.
- Llogaria 602 “*Blerje mallra e shërbime*” në pasqyrën e performancës financiare paraqitet në shumën prej 116,948,476 lekë, e cila përbëhet nga llogaria 602 “*Mallra dhe shërbime të tjera*” në shumën 11,026,097 lekë, llogaria 6020 “*Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme*” në shumën prej 14,729,797 lekë, llogaria 6021 “*Materiale dhe shërbime speciale*” në shumën 71,560 lekë, llogaria 6022 “*Shërbime nga të tretët*” në shumën prej 51,720,042 lekë, llogaria 6024 “*Shpenzime udhëtimi*” në shumën prej 13,294,231 lekë, llogaria 6025 “*Shpenzime për mirëmbajtje*” në shumën prej 575,124 lekë, llogaria 6026 “*Shpenzime për qiramarrje*” në shumën 145,200 lekë, llogaria 6027 “*Shpenzime për detyrime për kompensime legale*” në shumën prej 21,603,367 lekë dhe llogaria 6029 “*Shpenzime të tjera Operative*” në shumën prej 3,783,058 lekë përfaqëson shpenzime të tjera që nuk janë përfshirë në zërat e sipërpërmendur sipas kriterëve të klasifikimit buxhetor.
- Llogaria 605 “*Transferime korrente me jashtë*” në shumën prej 2,511,385 lekë përfaqëson Transferime Te tjera korrente me jashtë shtetit.
- Llogaria 606 “*Transferime për buxhetet familjare dhe individët*” në shumën prej 4,601,641 lekë përfaqëson shpenzime për pensione dhe shpenzime të tjera familjare.
- Llogaria 681 “*Kuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytëzimit*” në shumën 885,508,412 lekë përfaqëson Amortizimin e Akumuluar për AAGJ-të.

Llogaria 63 “*Ndryshimi i gjendjes së inventarit*” nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Nga veprimet kontabël të bëra nga institucioni dhe të pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare ndryshimi i gjendjes është pasqyruara drejtë në shumën prej 4,146,838 lekë.

Pasqyrat Financiare viti 2022

Paraqitja dhe raportimi i tyre është kryer në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 03.09.2018, Kapitulli V “Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore”, i ndryshuar.

Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale të Ministrisë së Brendshme rezultoi:

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

- » **Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=2,682,164 mijë lekë.**
- Aktivet 735,193 mijë lekë
- Pasivet 81,630 mijë lekë
- Aktivet neto 653,563 mijë lekë

I. Aktivet Afatshkurtra

Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën **95,924,153 lekë** dhe përbëhen nga:
në lekë

Nr.	Llogaria	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021
2		I. Aktivet Afatshkurtra	95,924,153	114,560,940
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	21,623,339	21,623,339
6	520	Disponibiliteti në Thesar	21,623,339	21,623,339
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	35,540,354	31,182,424
12	31	Materiale	25,731,397	21,845,617
13	32	Inventar i imët	9,808,957	9,336,807
21		3.Llogari te Arkëtueshme	32,989,574	54,402,027
23	423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	32,989,574	32,985,568
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	0	21,416,459
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	5,770,886	7,353,150
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	5,770,886	7,353,150

Burimi: MB/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 21,623,339 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 35,540,354 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 32,989,574 lekë dhe “Të tjera aktive Afatshkurtra” në shumën 5,770,886 lekë.

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”, përbëhet nga:

-Gjendja e llogarisë nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas mbylljes së bilancit të vitit në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në shumën prej 21,623,339 lekë, të cilat në rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” paraqiten në vlerën 22,950,156 lekë dhe rubrikën VI “Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në vlerën 21,623,339 lekë. (sipas formatit F3 “Pasqyra e flukseve monetare”),veprime të cilat janë rregulluar në pasqyrat financiare të vitit 2022 të cilat paraqiten në shumën 21,623,339 lekë, e të cilat rakordon me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në vlerën 21,623,339 lekë. (sipas formatit F3 “Pasqyra e flukseve monetare”);

Rakordimi i llogarive me degën e thesarit, llogaria nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, llogaria nr.466 “Mjete në ruajtje” dhe llogaritë e të ardhurave

Llogaria nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, në pasqyrat financiare të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 21,623,339 lekë, e cila përfaqëson gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466.)

Pika 50 e udhëzimit: Tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt rakordimin me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëlidhet llogarisë vjetore. Në akt rakordim tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grandit që trashëgohet). Në llogaritë vjetore të vitit 2022 ka një akt rakordim me thesarin për “Kreditorët për mjete në ruajtje”, llogari e cila në pozicionin financiar të datës 31.12.2022 paraqitet e njëjtë që nga viti 2019. Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë nr.520 “Disponibilitete në Thesar” dhe me ditarin e bankës rezultojnë të jenë të rakorduara.

▪ **Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:**

Në lekë

Nr.	Llogaria	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	35,540,354	31,182,424	4,357,930
12	31	Materiale	25,731,397	21,845,617	3,885,780
13	32	Inventar i imët	9,808,957	9,336,807	472,150

Burimi: MB/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

- Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të MB në 31.12.2022 paraqitet në shumën 35,540,354 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 25,731,397 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” në vlerën 9,808,957 lekë.

Nga auditimi i aktiveve të regjistruara në programin “Financa 5” rezultoi se në llogarinë 32 “Inventar i imët”, rezulton se janë regjistruar padrejtësisht si inventar i imët zëra të aktiveve afatgjata materiale si Ventilator, Elektropompa, Hard disk, makinë grirëse dokumentesh etj., me një vlerë totale prej 1,785,671 lekë.

Sa më sipër veprime në kundërshtim të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Klasa 2 “Aktivet Afatgjata”.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 4,357,930 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 4,357,930 lekë.

Për vitin 2022, është kryer inventarizimi i aktiveve, bazuar në urdhrin e SP me nr. 12500 datë 02.12.2022, “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve për vitin 2022.”

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme”&“Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Në lekë

Nr.	Llogaria	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca
21		3.Llogari te Arkëtueshme	32,989,574	54,402,027	-21,412,453
23	423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	32,989,574	32,985,568	4,006
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	21,246,270	21,416,459	-170,189

36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	5,770,886	7,353,150	-1,582,264
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	5,770,886	7,353,150	-1,582,264

Burimi: MB/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

- Llogaria 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” përbëhet nga llogaria 429 deficite, gjoba të trashëguara para vitit 2005 ne vlerën 32,528,545 lekë, të krijuar para vitit 2004, të cilët janë debitorë pa adresë, disa janë të larguar nga Shqipëria dhe nga llogaria 423 paradhënie për shërbime te pa mbyllura ne fund te vitit ne vlerën 461,029 lekë.

Llogaria 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” në shumën 32,989,574 lekë përfaqëson të drejtat që i kanë lindur institucionit të MB-së për të arkëtuar debitorë, e cila daton që në vitin 2005 dhe përfaqësojnë gjoba ndaj punonjësve. Nga informacioni i vënë në dispozicion, këto të drejta nuk janë arkëtuar dhe kanë kaluar afatin e parashkrimit për arkëtimin e tyre. Nga ana Institucionit për këtë vlerë nuk është proceduar në rrugë gjyqësore për mbledhjen e tij, si rrjedhojë kjo shumë rezulton e pa arkëtueshme, pasi ka humbur fuqinë ligjore, bazuar në Kodin Civil, neni 114.

- Llogaria 4342 “Operacione me shtetin(Te drejta)” në shumën 21,246,270 lekë përfaqëson detyrimet për pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe detyrimet e TAP. Kjo llogari ka si kundër parti llogaritë e pasivit 401,421, 431, 435, 436 dhe 437.

▪ **Situata e Detyrimeve të Prapambetura për Aparatin e Ministrisë së Brendshme:**

- Llogaria nr.486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” në vlerën 5,770,886 lekë e cila përbëhet nga detyrime të krijuara të cilat mbarten në pasqyrat financiare, për të cilët nuk ka asnjë informacion se çfarë masash janë marrë nga ana e Institucionit. Në mënyrë analitike sipas detyrimeve paraqiten si vijon:

- Diferenca e papaguar të Faturave ndaj operatorit ekonomik I*** për Muajin Mars 2020 për shërbimin e kryer, por të pa likuiduar shumen 1,997,574 lekë;
- Detyrime të prapambetura për sigurime shoqërore ne shumen 2,803,534 lekë;
- Detyrime te prapambetura për tatimin nga te ardhurat nga punësimi ne shumen 945,528 leke;
- Detyrime për pritje e përcjellje nga Albcontrol sha në shumën 24,250 lekë.

Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura të njohura në pasqyrat financiare të vitit 2022 u konstatua se:

1. Nga kryqëzimi i detyrimeve me detyrimet e deklaruar sistemin tatimor C@TS për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe detyrime për tatimin nga të ardhurat personale u konstatua se në Pasqyrën e Pozicionit Financiar këto detyrime paraqiten në shumën prej 3,749,062 lekë, ndërsa në sistemin tatimor C@TS paraqiten në shumën prej 17,113,821 lekë, pra me një diferencë prej 13,364,759 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtime me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 61, Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.

2. Nga auditimi u konstatua se MB i ka lindur detyrimi për shpenzime energji elektrike për llogari të OSHEE, për konsumin e energjisë elektrike, si dhe të kamat vonesave të aplikuara për periudhën që nga viti 2015 deri në Qershor 2022, shpenzime të cilët në vlerë totale janë, 136,142,855 lekë. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e sektorit te ankesave, detajohet vlera e këtij detyrimi sipas numrit të tre kontratave respektive, respektivisht për tre matësa. Sipas këtij dokumentacioni vlera e faturave të pa likuiduara është 67,516,013 lekë ndërsa

68,626,842 lekë janë kamatëvonesat e detajuara sipas periudhës, (të detajuara për çdo vit dhe për çdo muaj) dhe sipas tre kontratave respektive.

3. Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore, njohjen e tyre në kontabilitet dhe likuidimin e tyre nëpërmjet bankës rezultoi se në vitin 2022 janë likuiduar në shumën totale vendimet gjyqësore, të cilat kanë marrë formë të prerë në shumën prej 17,407,291 lekë dhe në shumën 16,521,176 lekë për vitin 2021.

Këto vendime gjyqësore nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t'u shlyer.

1. Si pasojë, llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nuk pasqyron vlerën e saktë në pasqyrat financiare të viteve 2021 dhe 2022. Në këtë zë nuk janë reflektuar detyrimet sa i takon shpenzimeve të periudhave të ardhshme për vendimet gjyqësore, të cilat kanë marrë formën e prerë përpara mbylljes së pasqyrave financiare të vitit ushtrimor.

2. Gjithashtu shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos u njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë të Vendimit të Gjykatës, por janë njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.

▪ **Aktivet Afatgjata**

Llogaritë e Klasës 20 “**Aktivet Afatgjata Jo materiale**”, paraqitet në vlerë kontabël neto në shumën 6,158,393 lekë dhe përbëhen nga llog.202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 200,780 lekë, e cila përfaqëson projektin lamp-i viti 2012 dhe nga llog.203 “Koncesione, patenta, licenca të ngjashme” në vlerën 5,957,613 lekë e cila përfaqëson licencën për Intracom në regjistrin kombëtar të gjendjes civile.

Llogaritë e Klasës 21 “**Aktivet Afatgjata Materiale**”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2022, vlera kontabël neto paraqitet në shumën 611,864,559 lekë. Në vitin paraardhës 2021, vlera kontabël neto e AAM-ve paraqitet në shumën 705,613,887 lekë, me një pakësim të AAM-ve në shumën (93,749,328) lekë.

Llogaritë do të analizohen si më poshtë:

-Llogaria 212 “**Ndërtesa dhe Konstruksione**”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 330,834,349 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën prej 348,246,682 lekë. Amortizimi i llogaritur rezulton në vlerën 17,412,334 lekë ose 5% mbi vlerën kontabël neto në çelje të vitit ushtrimor.

Analitiku i llogarisë 212 “**Ndërtesa dhe Konstruksione**” përbëhet nga 12 ndërtesa dhe konstruksione.

Në lekë

Nr.	Përshkrimi	Kosto Historike	Shtesa	Pakësimi	Amortizimi i akumuluar	Viti 2022
1	Godina qend. Nr. 1 M.R.Publik viti 1940	496,356,485			180,442,113	315,914,372
2	Oborri i M.R.Publik	6,571,505			2,395,922	4,175,583
3	Shtylle strehimi M.R.Publik	34,560,630			29,835,109	4,725,521
4	Qendra e Ndërlidhjes Mullet nr. 1	492,364			434,832	57,532
5	Qendra e Ndërlidhjes Mullet nr.	768,623			605,065	163,558

	2				
6	Qendra e Ndërlidhjes Mullet nr. 3	1,105,244		950,493	154,751
7	Qendra e Ndërlidhjes Mullet nr. 4	355,367		253,356	102,011
8	Qendra e Ndërlidhjes Mullet nr. 5	1,179,849		1,179,849	0
9	Shtupi, Vendkomanda Linze	31,318,425		30,299,433	1,018,992
10	Tomorri nr. 1 Linze	3,213,756		1,893,289	1,320,467
11	Tomorri nr. 2 Linze	5,363,619		2,993,840	2,369,779
12	Tomorri nr. 3 Linze	1,986,525		1,154,742	831,783
Totali		583,272,392		252,438,043	330,834,349

Burimi: MB/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi i analitikut të llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione”, rezulton se nuk paraqiten shtesa ose pakësime gjatë vitit ushtrimor 2022.

-Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 88,723,242 lekë dhe përfaqëson rrjetin informativ i Adresarit Regjistri Kombëtar Gjendjes Civile.

Analitiku i llogarisë nr.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” përbëhet nga 4 zërat si vijon:

Në lekë

Nr.	Përshkrimi	Kosto Historike	Shtesa	Pakësime	Amortizimi i akumuluar	Viti 2022
1	Ndërtimi i sistemit te adresave dhe përditësimi i tij	317,430,141			249,949,825	67,480,316
2	Ndërtimi i dhomës ICT te DPGJC Intracom	19,008,000			14,741,642	4,266,359
3	Ndërtimi i ndërfaqes se komunikimit RKGJC dhe RKA	55,636,342			43,109,111	12,527,231
4	Portali ri sistemit regjistrir kombëtar të Gj. Civile	27,600,000			23,150,665	4,449,335
Totali		419,674,483			330,951,242	88,723,241

Burimi: MB/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi i procedurës së inventarizimit dhe analitikut të llogarisë 213 ka rezultuar se Sistemi i adresave, dhoma ICT në DPGJC, ndërtimi i ndërfaqes se komunikimit RKGJC dhe RKA dhe Portali ri sistemit regjistrir kombëtar të Gjendjes Civile nuk është marrë në dorëzim nga AKSHI. Nga auditimi është konstatuar se me urdhrin e SP nr. 8873 datë 30.10.2018 është ngritur grupi i punës i përbërë nga: z. B. D, z. K. F, znj. H. D, znj. E.S dhe znj. D.K për ndjekjen e procedurës së dorëzimit të aktiveve për infrastrukturën e sistemeve IT të MB referuar VKM nr.673 datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”. Nga auditimi ka rezultuar se grupi i ngritur nga kjo procedurë ka identifikuar disa pajisje dhe softëare IT, të cilat aktualisht janë të regjistruara në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” me vlerën 373,205,543 lekë. Nga ana tjetër, sa i takon sistemeve të mësipërme, rezulton se nuk janë përfshirë për kalim në AKSHI. Megjithatë, ka rezultuar se kjo procedurë nuk ka përfunduar, dhe nuk ka akt dorëzimi tek AKSHI. Nga auditimi është konstatuar se këto aktive vazhdojnë të jenë pjesë e pasqyrave financiare të MB. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me VKM. nr.673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së

Informacionit”, i ndryshuar, pika 18 citohet se “*Institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave duhet të dorëzojnë pranë AKSHI-t 1 (një) kopje të dokumentacionit të plotë të çdo sistemi dhe infrastrukture TIK ekzistuese dhe kodin e burimit. Sistemet dhe infrastruktura TIK ekzistuese kalojnë nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse brenda datës 30 shtator 2018.*”

-Llogaria 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*”, paraqitet me vlerën neto 8,619,418 lekë dhe përfaqëson një gjenerator që MB posedon.

Nga auditimi i llogarisë analitike u konstatua se amortizimi është përlllogaritur me normën 5%, duke sjellë një vlerë jo të saktë të zhvlerësimit nga amortizimi, veprim në mospërputhje me Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar pika 36.

-Llogaria 218 “*Inventar ekonomik*” paraqitet me vlerën neto 183,687,550 lekë. Ky zë ka pësuar ndryshime gjatë vitit në vlerën absolute 4,294,938 lekë, ku është shtuar në shumën 4,459,446 lekë nga blerjet me pagesë nga fondet e miratuara për vitin 2022 dhe pakësuar në vlerën 164,508 lekë të cilat përfaqësojnë daljet e jashtme dhëne institucioneve të varësisë sipas dokumenteve përkatës.

Nga auditimi i llogarisë analitike 218 u konstatua se nga ana e Sektorit të Financës në MB, pajisjet kompjuterike janë klasifikuar si në llogarinë 218, dhe jo në llogarinë 214. Gjithashtu, nga analiza e zërave të aktiveve dhe amortizimit të tyre zë për zë u konstatua se artikuj si kondicioner, printer, kompjuter, fotokopje janë amortizuar me normën 20% duke u klasifikuar aktive të tjera AGJ, dhe jo si “Kompjuterë, pajisje të ruajtjes së të dhënave, softë e sisteme informacioni” ku norma e amortizimit llogaritet mbi bazë grupimi me normën 25%. Veprimet e mësipërme janë kryer jo në përputhje me udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar pika 36 dhe VKM-në nr. 25, datë 20.01.2011 “*Për disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 për miratimin e planit kontabël publik*”, duke ndikuar në mos pasqyrimin e saktë të gjendjen neto të aktiveve, si dhe ndikimi i amortizimit vjetor në fondin neto të institucionit.

▪ **Regjistri i aktiveve**

Nga auditimi i regjistrit të aktiveve të regjistruar në kontabilitet u konstatua se një pjesë e këtyre aktiveve pasi i është zbritur amortizimi i akumuluar ndër vite vlera e tyre është papërfillshme ose 0. Këto aktive vazhdojnë të jenë në përdorim dhe gjendje pune. Nga institucioni nuk janë marrë masa për të ngritur grupe e pune me ekspertë të fushave për këto artikuj, për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të këtyre aktiveve, ku pas këtij shqyrtimi të bëhet rivlerësimi i vlerës së tyre. Ndryshimet në jetën e pritshme të dobishme dhe të vlerës së tyre të kontabilizohen duke ndryshuar periudhën e amortizimit apo metodën, sipas rastit, dhe të trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” pika 103, si dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar pika 33.

▪ **Pasivet Afatshkurtra**

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Ministrisë së Brendshme më 31.12.2022, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2022, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2022, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

- Llogaria 42, *“Detyrime ndaj personelit”*, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë MB, paraqitet në vlerën 13,932,679 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të muajit Dhjetor.

- Llogaria 431 *“Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”*, llogaria 435, *“Sigurime shoqërore”* dhe llogaria 436 *“Sigurime shëndetësore”* paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2022 që paguhen në muajin janar 2023 dhe në Pasqyrën e Pozicionit Financiar janë përkatësisht në vlerat 1,654,730 lekë, 4,863,751 lekë dhe 795,109 lekë.

- Llogaria 466 *“Kreditorë për mjete në ruajtje”*, nga pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2022 paraqitet në vlerën kontabël prej 21,623,339 lekë, vlerë kjo e cila është e rakorduar me degën e thesarit, dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, për investime të kryera nga ana e MB sipas kontratës me nr.607/30 datë 16.12.2019, me amendamentin shtesë nr. 607/76 datë 19.10.2020 me objekt "Realizimi i projektit, planimetrisë, skemave të instalimeve të brendshme të godinës së Byrosë Kombëtare të Hetimit(BKH) dhe të Strukturës së Posaçme Antikorrupsionit (SPAK) në vlerën 21,483,366 leke. Sipas pikës 3 të nenit 31 *“Korrigjimi i defekteve”* të kontratës nr.607/30, datë 16.12.2019 dhe amendamentit shtesë të saj nr.607/76 prot. 19.10.2020 të nënshkruar për këtë objekt, Akt-kolaudit të mbajtur me datë 24.02.2021 si dhe certifikatës së marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve, protokolluar në Ministrinë e Brendshme me nr.27/5 datë 04.06.2021, periudha e garancisë së defekteve është 24 muaj nga data e nënshkrimit të Akt-kolaudit. Ndërsa detyrimi 139,973 lekë garanci bankare të trashëguara nga projekti LAMP është i trashëguar ndër vite, të cilat janë fonde që gjenden të ngurtësuar deri në vitin 2014, për të cilat është tejkaluar afati i garancisë dhe nuk është bërë zhblllokimi i tyre sipas kushteve të kontratave respektive. Sektori i Financës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të bërë zhbllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre në buxhetin e vet, veprim në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 *“Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme, Kapitulli II, pikat nr.29, 30, 39 dhe 50;*

UKM nr.3, datë 15.02.2011 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar, Kapitulli II, pika nr.10.6.

Llogaria 17 *“Huatë afatgjata”* paraqiten në shumën zero lekë në pasqyrat e dorëzuara nga MB në Degën e Thesarit.

Nga kryqëzimi i të dhënave midis pasqyrave financiare fizike me pasqyrat e dorëzuara nëpërmjet Sistemit Financiar Qeveritar(SIFQ), u konstatua se: Në pasqyrat e dorëzuara nga MB në Degën e Thesarit llogaria 17 *“Hua Afatgjatë”* paraqitet në shumën zero lekë, ndërsa në pasqyrat financiare në sistemin SIFQ, përkatësisht në pasqyrën e pozicionit financiar, kjo llogari paraqitet në shumën 34,977,500 lekë. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Sektori i Financës u konstatua se kjo shumë përfaqëson një kredi të marrë për projektin e Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës (LAMP) nga IBRD të marrë në vitin 2013 dhe është mbartur në pasqyra financiare që nga viti 2013, por nga Sektori i Financës nuk ka informacion për shlyerjen e saj. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018

“Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

▪ **F4/Pasqyra e ndryshimeve ne aktivet neto/ fondet neto**

Nga auditimi i “*Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto*” dhe rakordimi me pasqyrimin e vlerave në pasqyrën e pozicionit financiar në rubrikën C ka një pasqyrim jo të drejtë të vlerave në pasqyrë.

Aktiviteti neto nuk rakordojnë me fondet neto, dhe për disa zëra nuk ka informacion sesi sektori i financës ka arritur në rezultatet e mësipërme. Llogaria 1013 “*Nga konsumi i AAGJ(-)*” paraqet amortizimin e vitit, pra kemi shtesë në amortizim për vlerën 99,138,161 lekë dhe duke i zbritur amortizimin në pakësim në shumën 7,119 lekë, vlera neto është 99,131,042 lekë. Kjo llogari paraqitet në shumën 99,145,280 dhe ka një diferencë prej 14,238 lekë. Gjithashtu, në pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve neto nuk janë plotësuar të gjithë zërat që përfaqësojnë ndryshimet e ndodhura në nga burimet e brendshme.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimi i MFE nr.5, datë 21.02.2022 “*Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.*

c) Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Nga auditimi u konstatua se Ministria e Brendshme ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, neni 26 ku citohet: “*Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ...*” dhe neni 31, citohet “*...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit në m², numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës... ”.*

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë të aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, ky aspekt është audituar shtrirë për periudhën 2021-2022.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se, për periudhën objekt auditimi, është realizuar procesi i inventarizimit sipas parashikimeve të Paragrafit nr. 74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar që sanksionin se:

“Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”

Regjistrimi i aktiveve është kryer konform Kreut III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, date 27.12.2011 “*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*”.

Hyrja e aktiveve në përgjithësi është dokumentuar me fletë hyrjen përkatëse, të hartuat sipas gjendjes fizike të tyre, sipas pikës 37, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Dalja e aktiveve në përgjithësi është realizuar konform pikës 38, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Më konkretisht:

a) Inventarizimi fizik

Nga auditimi i procesit të inventarizimit u konstatua se:

Procesi i inventarizimit të aktiveve për vitin 2021 është kryer nga komisioni i ngritur sipas urdhrorit të Sekretarit të Përgjithshëm "Për krijimin e komisionit të inventarizimit fizik të aktiveve" me nr. 8021/1, datë 14.12.2021 dhe me përbërje të:

- H. D., Kryetar;
- H. M., anëtar;
- M. G., anëtar;
- L. J., anëtar;
- S. M., anëtar;
- B. Xh., anëtar;
- Sh. Ç., anëtar.

Procesi i inventarizimit të aktiveve për vitin 2022 është kryer nga komisioni i ngritur sipas urdhrorit të Sekretarit të Përgjithshëm "Për krijimin e komisionit të inventarizimit fizik të aktiveve" me nr. 1250, datë 02.12.2022 dhe me përbërje të:

- H. D., Kryetar;
- D. K., anëtar;
- M. G., anëtar;
- M. H., anëtar;
- T. G., anëtar.

Nga grupi i auditimit u konstatua se për vitin 2021 dhe 2022, Kryetari i komisionit të inventarizimit është përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe anëtarë janë specialistët e Sektorit të Financës, veprime në mospërputhje me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011, i ndryshuar pika 82 ku citohet se "Komisioni nuk duhet të jete më pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka ne ngarkim/përdorim aktivin, por ai duhet të jetë i pranishëm kur bëhet inventarizimi ..." si dhe ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin 110/2015, datë 15.10.2015 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 22 "veprimtaria e kontrollit" pika 3. b "ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin". Para fillimit të inventarit, nga komisioni i inventarizimit është mbajtur procesverbal, ku është fiksuar numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, sipas përcaktimit të paragrafit 82 të UMFE nr. 30/2011, i ndryshuar.

Komisioni është bazuar në të dhënat e regjistrit kontabël për kryerjen e inventarizimit të pasurisë. Për sa më sipër është vepruar në bazë të përcaktimeve të paragrafit nr. 26, të Udhëzimit të MFE me nr. 30/2011.

Në dosje janë depozituar kartelat/ fletët e inventarit të çdo punonjësi, të nënshkuara rregullisht nga komisioni i inventarizimit dhe persona materialisht përgjegjës.

Nga komisioni i inventarizimit në fund të procesit ka përgatitur raportin mbi inventarizimin për gjendjen e aktiveve në përdorimi, si dhe për vlerat materiale, (për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike), ku së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit është dorëzuar tek nëpunësi autorizues për veprime të mëtejshme, veprime në përputhje me paragrafin 85/c të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar. Në relacion komisioni është shprehur se nuk ka diferenca midis gjendjes kontabël dhe asaj fizike.

Llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”

Ministria e Brendshme ka në përdorim gjithsej 11 ndërtesa, me vlerë fillestare 583,272,392 lekë, nga të cilat rezulton se në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës janë të regjistruara vetëm 2 ndërtesa, dhe 9 ndërtesa nuk rezultojnë të jenë të regjistruara, përkatësisht :

‘Në lekë

Nr.	Emërtimi i objektit	Vlera fillestare	Administrimi
1	Godina qendrore Nr. 1 M.R.Publik viti 1940	496,356,485	Aparati i MB
2	Oborri I M.R.Publik	6,571,505	Aparati i MB
3	Shtylle strehimi M.R.Publik	34,560,630	Ministria e Financave
4	Qendra e Ndërlidhjes Mullet nr. 1	492,364	Objekte të amortizuara dhe shkatërruara plotësisht
5	Qendra e Ndërlidhjes Mullet nr. 2	768,623	Objekte të amortizuara dhe shkatërruara plotësisht
6	Qendra e Ndërlidhjes Mullet nr. 3	1,105,244	Objekte të amortizuara dhe shkatërruara plotësisht
7	Qendra e Ndërlidhjes Mullet nr. 4	355,367	Objekte të amortizuara dhe shkatërruara plotësisht
8	Qendra e Ndërlidhjes Mullet nr. 5	1,179,849	Objekte të amortizuara dhe shkatërruara plotësisht
9	Shtupi, Vendkomanda Linzë	31,318,425	Aparati i MB
10	Tomorri nr. 1 Linzë	3,213,756	Aparati i MB
11	Tomorri nr. 2 Linzë	5,363,619	Aparati i MB
12	Tomorri nr. 3 Linzë	1,986,525	Aparati i MB
	Shuma	583,272,392	

Burimi: MB/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi mbi regjistrimin e ndërtesave në ASHK, rezultoi se dy ndërtesa me vlerë fillestare 502,927,990 lekë (Godina qendrore dhe Oborri i Ministrisë) janë të regjistruara dhe nëntë ndërtesa me vlerë fillestare 80,344,402 lekë nuk janë të regjistruara. Objektet e paregjistruara, janë kryesisht tunele që i kanë shërbyer MB, të ndërtuara në vitet 1932 – 1935 (objekti “Shtylla” dhe 4 qendrat e ndërlidhjes, vendkomanda Linzë në vitin 1921 dhe 3 tunelet “Tomorri”, të ndërtuara nga viti 1970 – 1974.

Nga komisioni i inventarizimit, për llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”, gjatë procedurës së inventarizimit, është mbajtur një tabelë me të gjitha ndërtesat që MB ka në pronësi, për të cilat është konstatuar se pesë ndërtesa, përkatësisht Qendrat e Ndërlidhjes Mullet me nr. 1, 2, 3, 4 dhe 5 janë objekte të amortizuara dhe shkatërruara plotësisht. Sa më sipër, nga ana e komisionit të inventarizimit të vitit 2021 dhe 2022, në fund të procesit nuk është mbajtur asnjë procesverbal në terren, si dhe nuk është përgatitur një raport mbi inventarizimin e llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” veprime jo në përputhje me paragrafin 85/c të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.

Përpos konstatimeve të Komisionit të inventarizimit mbi dëmtimin apo mungesën e aktiveve, Ministria e Brendshme nuk ka marrë masa për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve.

b) Vlerësimi i aktiveve

Me Urdhrin nr. 12500 datë 02.12.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm është ngritur komisioni “Për krijimin e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit dhe vlerësimit të aktiveve”, për aktivet e identifikuar në relacionin e inventarizimit të vitit 2022.

Me anë të shkresës nr.12500/3 prot., datë 29.12.2022 komisioni i vlerësimit të aktiveve ka mbajtur relacionin mbi përfundimin e procedurës së vlerësimit për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve të Aparatit të Ministrisë së Brendshme, ku kanë evidentuar listën e aktiveve jashtë përdorimi si vijon:

- “Mjete kryesore” me 2265 artikuj në shumën 464,682 mijë lekë, ku u përcaktuan 185 artikuj për vlerësim;

- “Inventar i imët” me 687 artikuj në shumën 9,809 mijë lekë, ku u përcaktuan 231 artikuj për vlerësim;

- “Materiale konsumi” me 464 artikuj në shumën 25,731 mijë lekë, ku u përcaktuan 47 artikuj për vlerësim.

Sa më sipër janë vlerësuar për dalje jashtë përdorimit në llogarinë 327 “Inventar i imët” në shumën 3,341,033 lekë dhe në llogarinë 312 “Materiale konsumi” në shumën 1,489,325 lekë.

Në relacionin e vlerësimit është relatuar procedura e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës, veprime në përputhje me paragrafin 106 të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.

Në fund të procesit të vlerësimit, komisioni i vlerësimit për aktivet e institucionit ka mbajtur procesverbalin e datës 31.12.2022, për secilin aktiv të vlerësuar të dëmtuar dhe jashtë përdorimi, ku janë përcaktuar shkaqet e daljes jashtë përdorimi të këtyre aktiveve, vlera e mbetur e tyre pas amortizimit të akumuluar, si dhe kriterin mbi bazën e të cilit është bërë vlerësimi i aktiveve, veprime në përputhje me paragrafin 102-105 të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.

Sa më sipër, edhe pse nuk janë ngritur as komisione për nxjerrjen jashtë përdorimi/asgjësimi të aktiveve.

Procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të finalizuar pasi nuk janë ndjekur nga proceset e daljes jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit të atyre aktiveve që nuk kanë destinacion tjetër, dhe pse nga komisioni i vlerësimit janë vlerësuar për dalje jashtë përdorimit në shumën 4,830,358 lekë.

Kalimet e kapitalit pa pagesë

Viti 2021

Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se në Ministrinë e Brendshme janë bërë pakësime në llogarinë 218 në shumën 3,839,849 lekë, ku u konstatua se MB ka kryer transferime/pakësime në institucionet e varësisë dhe shtesa në shumën 9,200,533 lekë.

Lëvizja e aktiveve kapitale pa pagesë për vitin 2021, të cilat rezultuan me mungesë dokumentacioni:

▪ **Rritje**

1. Kalim kapitali pa pagesë nga QFMT Mullet në MB të pajisjeve mobilimi në shumën 6,960,000 lekë.

Pajisja është bërë hyrje me FH nr.1, datë 16.02.2021.

Nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga QFMT Mullet deri në momentin e daljes nga pronësia.

2. Kalim kapitali pa pagesë nga Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në MB të të pajisjeve kompjuterike dhe mobilimi në vlerën 2,949,394 lekë.

Pajisjet janë bërë hyrje me FH nr.45, datë 03.11.2021.

Nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga SHÇBA deri në momentin e daljes nga pronësia.

▪ Zvogëlimi

1. Kalim kapitali pa pagesë nga MB në Bashkia Belsh të “Kompjuterëve” në vlerën 410,012 lekë dhe pajisjet janë bërë dalje me FD nr. 14 datë 14.01.2021;

2. Kalim kapitali pa pagesë nga MB në Bashkia Tiranë të “Printerë dhe Tonerë” në vlerën 55,872 lekë dhe pajisjet janë bërë dalje me FD nr. 16 datë 14.01.2021;

3. Kalim kapitali pa pagesë nga MB në Bashkia Cërrik të “Printerë dhe Tonerë” në vlerën 19,176 lekë dhe pajisjet janë bërë dalje me FD nr. 19 datë 19.01.2021;

4. Kalim kapitali pa pagesë nga MB në Bashkia Përrenjas të “Kompjuterë” në vlerën 281,396 lekë dhe pajisjet janë bërë dalje me FD nr. 21 datë 19.01.2021;

5. Kalim kapitali pa pagesë nga MB në Bashkia Tiranë të “Kompjuterë dhe printer” në vlerën 70,428 lekë dhe pajisjet janë bërë dalje me FD nr. 23 datë 20.01.2021;

6. Kalim kapitali pa pagesë nga MB në Bashkia Librazhd të “Kompjuterë dhe printer” në vlerën 99,248 lekë dhe pajisjet janë bërë dalje me FD nr. 24 datë 21.01.2021;

7. Kalim kapitali pa pagesë nga MB në Bashkia Tiranë të “Toner dhe bazë materiale certifikata” në vlerën 148,105 lekë dhe pajisjet janë bërë dalje me FD nr. 25 datë 21.01.2021;

8. Kalim kapitali pa pagesë nga MB në Bashkia Përmet të “Printer” në vlerën 978,021 lekë dhe pajisjet janë bërë dalje me FD nr. 32 datë 22.01.2021;

9. Kalim kapitali pa pagesë nga MB në Bashkia Gramsh të “Printer” në vlerën 108,147 lekë dhe pajisjet janë bërë dalje me FD nr. 18 datë 18.01.2021;

10. Kalim kapitali pa pagesë nga MB në Bashkia Tropojë të “Kompjuter dhe Printer” në vlerën 483,208 lekë dhe pajisjet janë bërë dalje me FD nr. 46 datë 02.02.2021;

11. Kalim kapitali pa pagesë nga MB në Bashkia Berat të “Kompjuter dhe Printer” në vlerën 163,998 lekë dhe pajisjet janë bërë dalje me FD nr. 50 datë 03.02.2021;

12. Kalim kapitali pa pagesë nga MB në Bashkia Dibër të “Kompjuter dhe Printer” në vlerën 126,984 lekë dhe pajisjet janë bërë dalje me FD nr. 57 datë 04.02.2021;

13. Kalim kapitali pa pagesë nga MB në Bashkia Vlorë të “Kompjuter dhe Printer” në vlerën 233,366 lekë dhe pajisjet janë bërë dalje me FD nr. 70 datë 17.02.2021;

14. Kalim kapitali pa pagesë nga MB në Bashkia Maliq të “Kompjuter dhe Printer” në vlerën 279,273 lekë dhe pajisjet janë bërë dalje me FD nr. 30 datë 22.01.2021;

Sa më sipër, nga auditimi u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur asnjë dokumentacion bashkëngjitur, siç janë procesverbali i marrjes në dorëzim, kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga MB deri në momentin e daljes nga pronësia. Gjithashtu mungon Akt konfirmimi i njësisë pritëse të marrjes së aseteve dhe të regjistrimit të tyre si kapital të institucionit. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”.

Viti 2022

Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se në Ministrinë e Brendshme janë bërë

pakësime në llogarinë 218 në shumën 164,508 lekë, ku u konstatua se MB ka kryer transferime/pakësime në institucionet e varësisë.

▪ Zvogëlimi

1. Kalim kapitali pa pagesë nga MB në Bashkia Kurbin të “Kompjuter” në vlerën 22,226 lekë dhe pajisjet janë bërë dalje me FD nr. 128 datë 29.04.2022;

2. Kalim kapitali pa pagesë nga MB në Bashkia Shkodër të “Tonerë” në vlerën 297,889 lekë dhe pajisjet janë bërë dalje me FD nr. 211 datë 26.09.2022;

3. Kalim kapitali pa pagesë nga MB në Prefektura Devoll të “Kompjuter” në vlerën 125,292 lekë dhe pajisjet janë bërë dalje me FD nr. 334 datë 27.12.2022.

Sa më sipër, nga auditimi u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur asnjë dokumentacion bashkëngjitur, siç janë procesverbali i marrjes në dorëzim, kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga MB deri në momentin e daljes nga pronësia. Gjithashtu mungon Akt konfirmimi i njësisë pritëse të marrjes së asetëve dhe të regjistrimit të tyre si kapital të institucionit. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”.

Konkluzion i Përgjithshëm

Nga auditimi i Pasqyrës së Pozicionit Financiar dhe Pasqyrës së Performancës Financiare, të hartuara nga Ministria e Brendshme, për vitin ushtrimor 2022 rezulton se:

-Në lidhje me Klasën e Llogarive të Arkëtueshme, rezulton se llogaria nr.423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba”, në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 32,989,574 lekë, shumë e cila përfaqëson të drejta që Institucioni ka ndaj palëve të treta (ku nga informacioni i vënë në dispozicion janë gjoba ndaj punonjësve që prej vitit 2005). Nga ana e MB, nuk është vepruar me mbledhjen me forcë të këtyre të drejtave, duke sjellë që kjo shumë të jetë e paarkëtueshme pasi ka humbur fuqinë ligjore.

-Në lidhje me situatën e Detyrimeve të Prapambetura të regjistruara në kontabilitet, konkretisht në llogarinë nr.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, kjo llogari në fund të vitit 2022, paraqitet në shumën 5,770,886 lekë, e cila përbëhet nga detyrime ndaj OE “I***” për fatura të muajit mars të vitit 2022, në vlerën 1,997,574 lekë, nga detyrime të prapambetura për sigurime shoqërore në vlerën 2,803,534 lekë si dhe nga detyrime për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi në vlerën 945,528 lekë. Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura dhe të regjistruara në kontabilitet Grupi i Auditimit, kryqëzoi të dhënat duke kryer testet e auditimit, nga ku ka rezultuar se:

1.Nga kryqëzimi i të dhënave me sistemin C@ts, detyrimet e deklaruara për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si edhe detyrimet mbi tatimin mbi të ardhurat personale rezultojnë të jenë në fund të vitit 2022 në shumën 17,113,821 lekë, shumë kjo e cila nuk është kontabilizuar për vlerë të plotë në llogarinë nr.486 “shpenzime të periudhave të ardhshme” ku këto detyrime janë regjistruar vetëm për vlerën 3,749,062 lekë, me një diferencë të pa regjistruar dhe të pa kontabilizuar në shumën 13,364,759 lekë.

2.Nga auditimi kanë rezultuar detyrime të prapambetura për shpenzimet e energjisë elektrike të cilat MB ka kundrejt OSHEE, për periudhën prej vitit 2015 deri në muajin qershor 2022, si edhe kamatëvonesave respektive për 3 matësa, ku shuma në total është prej 136,142,855 lekë e cila përbëhet nga detyrimi në shumën 67,516,013 lekë dhe kamatëvonesat në shumën 68,626,842 lekë. Ky detyrim nuk është regjistruar si edhe të jetë njohur në kontabilitet në llogarinë nr.486 “shpenzime të periudhave të ardhshme”, duke sjellë për pasojë paraqitjen e një situatë jo reale të detyrimeve të prapambetura të cilat Institucioni ka ndaj të tretëve në periudha të ndryshme.

3.Nga informacioni i dhënë nga sektori i ankesave administrative dhe gjyqësore, nga auditimi rezulton se për vendimet gjyqësore për vitin 2022 janë likuiduar vendime të formës së prerë në shumën 17,407,291 lekë, por të cilat nuk kanë qenë të njohura në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos i njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë nga Vendimet e Gjykatave, por janë njohur në momentin e likuidimit. Për sa më sipër, situata e paraqitur për detyrimet e prapambetura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të Institucioni të MB, nuk paraqet gjendjen reale të tyre dhe të detajuar, duke mos regjistruar dhe njohur në kontabilitet shumë detyrime të cilat kanë lindur edhe nga periudhat e mëparshme si edhe diferenca të verifikuara në sistemin tatimor, ku për rrjedhojë shumë totale prej 166,914,905 lekë, përbëjnë detyrime të prapambetura të pa regjistruara në kontabilitet për periudhën ushtrimore 2022, veprime këto jo në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 61, Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.

-Në lidhje me Klasën e Llogarive të Pagueshme, konkretisht llogaria nr.17 “Huatë Afatgjata”, rezulton se paraqitet në shumën prej 34,977,500 lekë, e cila përfaqëson një kredi të marrë për projektin e Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës (LAMP) nga IBRD nga viti 2013. Kjo kredi është e mbartur në Pasqyrat Financiare që nga viti 2013 si dhe nuk ka një informacion mbi shlyerjen e saj dhe planit të amortizimit të kredisë.

-Në lidhje me procedurat e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve u konstatua se procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të finalizuara pasi nuk janë ndjekur nga proceset e daljes jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit të atyre aktiveve që nuk kanë destinacion tjetër, dhe pse nga komisioni i vlerësimit janë vlerësuar për dalje jashtë përdorimit në shumën 4,830,358 lekë.

-Nga grupi i auditimit u konstatua se për vitin 2021 dhe 2022, Kryetari i komisionit të inventarizimit është përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe anëtarë janë specialistët e Sektorit të Financës, veprime në mospërputhje me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011, i ndryshuar pika 82.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

Në lidhje me Projekt raportin e auditimit, nga MB është sjellë observacion në KLSH me shkresën nr 169/7, datë 20.06.2024, marrë në dorëzim nga grupi i auditimit në 24.06.2024. Ky observacion është paraqitur nga DPESHM, Drejtoria e buxhetit dhe menaxhimit financiar, në lidhje me gjetje të caktuara, për të cilat shprehemi si më poshtë vijon:

Pretendimi i subjektit: *Në vlerësim të gjetjes nr.1, ju paraqesim objeksionet si më poshtë:*

Në lidhje me auditimin e projekteve të investimit të planifikuara për vitin 2023 duke krahasuar PBA 2022-2024 dhe PBA 2023-2025 ku nga ana juaj konstatohen ndryshime vlerash në planifikimin buxhetor brenda tavanëve në dy vite të ndryshme të PBA-ve për disa projekte, sqarojmë faktin se ky parashikim pavarësisht ndryshimeve në vlera, është bërë konform Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni nr.25, VKM-së nr. 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, pika 7 dhe Udhëzimi MFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”, paragrafi 7.1. Nga Ministria e Financave janë analizuar çdo vit kërkesat buxhetore sipas Analizës përmbledhëse ku janë paraqitur komente dhe rekomandime lidhur me Planifikimin e Shpenzimeve dhe Investimeve dhe në çdo Analizë është konfirmuar dhe vlerësuar paraqitja e kërkesave buxhetore të Ministrisë së Brendshme sipas formateve dhe në zbatim të Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”.

Për investimet e vitit 2022, të cilat rezultojnë të realizuara gjatë këtij viti janë të përfshira në kërkesat buxhetore të PBA-së 2022-2024 brenda limitit të miratuar si dhe mbi limit, konkretisht: Projektet që kanë të bëjnë me pagesë TVSH-je (rreth 65 milion lekë) për shkak të limitit të kufizuar kanë qenë të parashikuar në kërkesat mbi limit dhe në kuadër të rishikimit të buxhetit me Akt normativ janë çelur si fonde gjatë vitit 2022. Projekti “Rikonstruksion i objekteve të ish Repartit Rdorina për akomodimin e Drejtorisë së Forcës së Posacme Operacionale” (rreth 76 milion lekë), është fond shtesë nga fondet e rindërtimit.

Projekti “Rikonstruksion/ndërtim Parku i Antenave Fushë-Dajt”, është parashikuar në PBA 2022-2024, në shumën 37 milion lekë. Projekti “Rikonstruksion i Sallave operative të NVE në DVP e Komisaritet e Policisë”, është parashikuar në PBA 2022-2024, në shumën 35 milion lekë.

Ndërsa për dy projekte “Blerje pajisjeje për Policinë Kriminale” (në shumën 40 milion lekë) dhe “Blerje pajisje zyre të ndryshme për Shtëpinë e Pushimit Durrës” (në shumën 2 milion lekë), theksojmë se janë shpenzimet e realizuara nga të ardhurat jashtë planit limit (kapitulli 6) dhe për projektin e parë të Policisë së Shtetit janë krijuar nga fondet e përfituara në zbatim të Ligjit nr.10192/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ndërsa për projektin e dytë janë krijuar nga të ardhurat e vetë institucionit (SHPDurrës).

Ndërsa projektet e tjera në vlera të vogla janë të përfshira në PBA në kërkesat mbi limit dhe kanë të bëjnë me studim projekte, supervizime dhe kolaudime të projekteve të parashikuara në PBA por për shkak të kontraktorëve të ndryshëm ndahen më vete për të bërë obligimin e kalimin e kontratës në thesar.

Për investimet e vitit 2023, të cilat rezultojnë të realizuara gjatë këtij viti, parashtrijmë argumentet e mësipërme pra janë të përfshira në kërkesat mbi limit përse i përket projekteve të TVSH-së dhe projekti “Ndërtim/Rikonstruksion i godinës së PKK Qafë-Boti”(kapitulli 2), ndërsa për Projektin “Blerje mjete lundruese për Krijimin dhe kompletimin e njësisë Policore Detare” është bërë shtesë gjatë vitit për shkak të prioritetit që doli nga aksidenti i ndodhur në Himarë gjatë sezonit turistik.

Theksojmë dhe një herë se planifikimi i investimeve në të gjitha fazat e PBA-së janë përgatitur në zbatim të VKM-së nr. 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”.

Në vlerësim të gjetjes nr.2, ju paraqesim objeksionet si më poshtë:

Lidhur me Raportet e Monitorimit, sqarojmë se Raportet e Monitorimi i buxhetit janë hartuar nga 5 programet buxhetore që ka MB. Në asnjë nga pikat e Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 dhe Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, nuk citohet që raportet e monitorimit hartohen edhe nga institucionet e varësisë si dhe Aparati i MB.

Konkretisht në kap.IV, pika 49 dhe kap.V, pika 41, citohet që Raporti i monitorimit përgatitet nga ministritë dhe përveç relacionit shpjegues duhen zbatuar edhe anekset e monitorimit të cilat hartohen mbi bazën e programeve buxhetore, në kuptim të kësaj Aparati i MB është një nga institucionet e varësisë në përbërje të programit “Planifikim Menaxhimi”.

Gjithashtu në zbatim të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, kap. VI, pika 271, nga ana jonë, në përmbushje të konstatimit të KLSH-së, është bërë publikimi i Raporteve të Monitorimit të MB-së për periudhën audituese 2021-2023 në faqen zyrtare të Ministrisë linkun: <https://mb.gov.al/raporte-monitorimi/>

Në vlerësim të gjetjes nr.11, ju paraqesim objeksionet si më poshtë:

Sa i takon regjistrimeve padrejtësisht materialet si Ventilator, Elektropompa, Hard Disk, makinë grirëse dokumentesh, etj në programin “Financa 5” si inventar i imët dhe jo aktive. afatgjata materiale, sqarojmë se regjistrimi i këtyre materialeve është kryer në zbatim të Udhëzimit Nr.30, date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III. Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre, pika 29;

Në vlerësim të gjetjes nr.13, ju paraqesim objeksionet si më poshtë: mosnjohja e detyrimit në PF është e lidhur me zbatimin e udhëzimit nr.5, date 12.06.2023 “Për një shtesë në Udhëzimin nr.24, datë 09.02.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, pika 114 në bazë të të cilit gjohet për deklarimin e vonuar si rezultat i vendimeve të gjykatave të formës së prerë të të larguarve nga puna nuk aplikohen për Institucionet e qeverisjes qendrore apo vendore.

Në vlerësim të gjetjes nr.17, ju paraqesim objeksionet si më poshtë:

Lidhur me llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, nga pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2022 paraqiten me vlerë kontabël prej 21,483,366 lekë që përfaqëson 5% të garancisë së kontratës me nr.607/30, datë 16.12.2019 me amendim shtesë nr.607/76, datë 19.10.2020 me objekt “Realizim i projektit, planimetrisë, skemave të instalimit të brendshëm të godinës së BKH dhe SPAK. Kjo vlerë është rezultat i mospërfundimit të procedurave të marrjes përfundimtare në dorëzim të punimeve për shkak të defekteve brenda periudhës së garancisë së punimeve.

Në vlerësim të gjetjes nr.18, ju paraqesim objeksionet si më poshtë:

Pas diskutimeve të zhvilluara me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në MFE për zgjidhjen e kësaj problematike, pas verifikimeve të kryera nga ana e tyre janë shprehur se Auditi i KLSH për më shumë informacion mund të drejtohet Drejtorisë së Borxhit në MFE, pasi detyrimi për këtë kredi është detyrim i MFE ndaj Bankës Botërore, detyrim i cili vazhdon shlyerjen normale sipas marrëveshjes së palëve për këtë kredi dhe nuk është detyrim i MB.

Në vlerësim të gjetjes nr.22, ju paraqesim objeksionet si më poshtë:

Spektori i financës në vijimësi ka kërkuar dhe ka bërë shkrësat përkatëse për njësitë shpenzuese për Akt Konfirmimet për mallrat e furnizuara.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

-Në lidhje me komentin tuaj mbi **gjetjen nr.1**, sqarojmë se, nga ana e Grupit të Auditimit është evidentuar fakti që ndryshimi i vlerave të konsiderueshme si në raste projektesh edhe në shumën e tyre dhe diferencat të dala si rezultat i kryqëzimit të kryer midis Programeve Buxhetore Afatmesme dhe Planeve Vjetore dhe Realizimit të tyre, tregojnë një planifikim jo të duhur dhe një shpërndarje buxhetore të projekteve jo të saktë, për rrjedhojë observacioni juaj nuk merret në konsideratë. Në lidhje me komentin tuaj mbi çeljet buxhetore, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve, ku për vitet investimet e viteve 2022 dhe 2023 keni dhënë shpjegimet përkatëse për secilin projekt që mund të kenë ardhur ndryshimet nga shtesat nëpërmjet akteve normative, ose prioriteve të mundshme gjatë viti, ose fonde shtesë të tjera, nga ana e Grupit të Auditimit janë kryer kryqëzimet për çdo projekt investimi për vitet buxhetore 2022 dhe 2023 me Programet Buxhetore Afatmesme nga ku kanë rezultuar se për vitin 2022 janë realizuar 23 projekte investimi gjatë vitit të cilat nuk janë planifikuar në PBA 2022-2024 si dhe për vitin 2023 kanë rezultuar 15 projekte investimi të realizuara gjatë vitit të cilat nuk janë planifikuar në PBA 2023-2025, situatë e cila është në kundërshtim me parimet e disiplinës buxhetore ku të gjitha projektet e investimeve të reja duhet të përgatiten përmes propozimit të politikave të reja dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme nga shqyrtimi deri te miratimi i tyre, për rrjedhojë observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

-Në lidhje me komentin tuaj mbi **gjetjen nr.2**, sqarojmë se, nga ana e Grupit të Auditimit është evidentuar fakti se vetë Aparati i MB është njësi shpenzuese dhe ka detyrim ligjor të hartojë raporte monitorimi 4 mujore, duke qenë se programet sipas të cilave Aparati i MB realizon pagesa janë programe ku realizohen pagesa edhe të institucioneve të tjera të varësisë, rrjedhimisht nuk mundësohet identifikimi i buxhetit që administrohet vetëm nga aparati i MB-së, për rrjedhojë komenti juaj nuk merret në konsideratë.

-Në lidhje me komentin tuaj mbi **gjetjen nr.11**, sqarojmë se, bazuar në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", përcakton se kufiri minimal për pragun e vlerësimit të aktiveve afatgjata materiale është 10,000 lekë dhe afat përdorimi mbi një vit. Pra, që aktivet e mësipërme të klasifikohen si inventar i imët, duhet të plotësohen njëkohësisht të dy kushtet e sipërcituara. Për rrjedhojë, observacioni nuk merret në konsideratë.

-Në lidhje me komentin tuaj mbi **gjetjen nr.13**, sqarojmë se, sa i takon njohjes së detyrimeve të prapambetura, bazuar në Udhëzimit e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së

përgjithshme”, i ndryshuar, detyrimet duhet të njihen në pasiv në momentin që kanë lindur, dhe nga ana e Institucionit të MB, siç është trajtuar dhe në PRA, rezulton se llogaria 486 “*Shpenzime te periudhave te ardhshme*” nuk paraqet situatën reale të detyrimeve që MB ka. Për rrjedhojë, observacioni nuk merret në konsideratë.

-Në lidhje me komentin tuaj mbi **gjetjen nr.17**, sqarojmë se, lidhur me llogarinë 466, ky konstatim i takon detyrimi prej 139,973 lekë paraqet garanci bankare te trashëguara nga projekti LAMP dhe është i trashëguar ndër vite. Këto fonde gjenden të ngurtësuara që nga viti 2014, për të cilat rezulton se ka tejkaluar afati i garancisë dhe nuk është bërë zhblllokimi i tyre sipas kushteve të kontratave respektive. Sektori i Financës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të bërë zhbllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre në buxhetin e vet.

-Në lidhje me komentin tuaj mbi **gjetjen nr.18**, sqarojmë se, nga ana juaj si Institucion duhet të merren masat e nevojshme për verifikimin e shumës së huasë prej 34,977,500 lekë, si dhe të bëhen sistemimet përkatëse në pasqyrat financiare me qëllim paraqitjen reale të detyrimeve që ka Ministria e Brendshme.

-Në lidhje me komentin tuaj mbi **gjetjen nr.22**, sqarojmë se, edhe pse nga ana e Sektorit të Financës u është dërguar shkresë të gjitha bashkive për aktin e marrjes në dorëzim si dhe dokumentacionit bashkëlidhur, konstatimi i mungesës së dokumentacionit bashkëlidhur rezulton të jetë në pjesën më të madhe të kalimeve kapitale pa pagesë. Për rrjedhojë, observacioni nuk merret në konsideratë.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me **gjetjen 10** ju dakordësoni me konstatimet tona e rrjedhimisht qëndrimi ynë mbetet i pandryshueshëm.

Në lidhje me **gjetjen 26**, nuk është ngarkuar me përgjegjësi sektori i financës pasi për këtë jemi shprehur edhe në PRA, dhe për këtë arsye rekomandimi i adresohet SP si nëpunësi Autorizues për të koordinuar të gjithë sektorët përkatës sipas detyrave dhe përgjegjësive funksionale në sjelljen e dokumentacionit të plotë për likuidim në sektorin e financës.

2.5 Prokurimet me fonde publike.

2.5.1 Auditimi i procedurave të prokurimit publik me vlerë të vogël

Auditimi i këtij drejtimi u bazua në shqyrtimin e dokumentacionit si më poshtë:

-Dosjet e prokurimit për blerjet e vogla si dhe dosjet e zbatimit për marrëveshjet kuadër, për periudhën 2021-2023.

- Sistemi elektronik i prokurimeve (SPE) në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit publik
- Shkresat dhe Urdhrat e titullarit të AK mbi caktimin e personave përgjegjës për prokurimet;
- Regjistrat e Parashikimit për periudhën objekt auditimi;
- Regjistrat e Realizimit për periudhën objekt auditimi;
- Praktikat e likuidimit të kryera nga Sektori i Financës.

Auditimi i këtij drejtimi u bazua në:

- Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe të gjitha aktet e dala në zbatim të tij (VKM, *udhëzime etj.*)
- Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021” Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.
- VKM nr.285, datë 19.05.2021 neni 68, dhe Udhëzimin Nr.3, datë 18.06.2021.

MB për vitet 2021-2023, në zbatim të detyrimit ligjor përcaktuara në legjislacionin e prokurimit publik ka ngritur Komisionin e prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël si dhe Komisionin e

sistemit dinamik të blerjeve të transportit ajror ndërkombëtar, me urdhrat respektive të titullarit të Autoritetit Kontraktor (AK) bazuar në Ligjin Nr.162/2020 i ndryshuar, VKM nr.285, datë 19.05.2021 neni 68, dhe Udhëzimin Nr.3, datë 18.06.2021.

Sipas viteve objekt auditimi, realizimi i procedurave të prokurimit “*blerje me vlerë të vogël*” dhe “*sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar*” paraqitet në vijim:

Për vitin 2021, janë realizuar 55 procedura prokurimi “*blerje me vlerë të vogël*” dhe “*sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar*” me vlerë totale të kontratave të realizuara **15,330,121** lekë me TVSH dhe fond limit 17,735,274 lekë pa TVSH.

Procedurat sipas llojit dhe realizimit jepen në Tabelën Nr.2.5.1, tek seksioni” Aneksë”.

Për vitin 2021, janë 3 urdhra për krijimin e komisionit të sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar, përkatësisht: Urdhri nr. 496, dt. 28.01.2021, Urdhri nr. 1437, dt. 17.03.2021 dhe Urdhri nr. .2184, të SP. Znj. E. P., datë 29.04.2021, me përbërje:

1. znj. L. M., Kryetar, Përgjegjës në Sektorin e shërbimeve dhe menaxhimit të aseteve, në DMBNJASH

2. znj. D. K., anëtar, me pozicion përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve, në DMBNJSH.

3. z. B. Xh., anëtar me pozicion në sektorin e SHMA, në Drejtorinë e Mirë administrimit të burimeve njerëzore.

1. z. A. K., Kryetar, Drejtor/Drejtorie në DMBNJSHM, në Drejtorinë e Përgjithshme ekonomike dhe shërbimeve mbështetëse.

2. znj. A. H., anëtar, me pozicion përgjegjës në sektorin e Shërbimeve, në DMBNJSH

3. znj. D. K., anëtar, me pozicion përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve, në DMBNJSH.

1. z. A. K., Kryetar, Drejtor/Drejtorie në DMBNJSHM, në Drejtorinë e Përgjithshme ekonomike dhe shërbimeve mbështetëse.

2. znj. D. K. anëtar me pozicion përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve, në DMBNJSH.

3. z. B. Xh., anëtar, specialist në sektorin e shërbimeve, në DMBNJSHM

Për vitin 2021, janë 4 urdhra për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, përkatësisht: Urdhri nr. 494, dt 28.01.2021, Urdhri nr. 494/1, dt. 17.03.2021, Urdhri nr.2183, datë 29.04.2021, të ish-SP. Znj. E. P., me të njëjtën përbërje të komisioneve të ngritura për sistemin dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar.

Me Urdhrin nr. 495, datë 28.01.2021, të SP të MB është caktuar personi përgjegjës për prokurimet e vitit 2021, znj. L. M., me pozicion përgjegjëse në sektorin e shërbimeve dhe menaxhimit të aseteve, në Drejtorinë e Mirë administrimit të burimeve njerëzore, aseteve dhe shërbimeve.

Me urdhër nr. 2185, datë 29.04.2021, i cili ka shfuqizuar urdhrin nr. 290, datë 18.01.2021, është ngritur Komisioni për marrjen në dorëzim të mallrave të prokuruar me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, me përbërje:

1. Z. H. M., Kryetar, me pozicion specialist në sektorin e Kontabilitetit dhe menaxhimit të aktiveve, në DBMF.

2. Znj. S. M., anëtar, me pozicion specialist në sektorin e financës, në DBMF.

3. Znj. M. H., anëtar, me pozicion specialist në sektorin e shërbimeve, në DMBNJASH.

Në lidhje me urdhrat e mësipërm konstatohet se edhe pse ka shumë ndryshime gjatë vitit në përbërjen e komisioneve (si ato të prokurimit me vlerë të vogël ashtu edhe për komisionet e sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar), këto shkresa nuk mbajnë të njëjtin numër protokolli me urdhrin e parë të vitit, në kundërshtim me Normat tekniko-profesionale dhe

metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 19, pika 1, e cila përcakton se:

1. Në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Në të regjistrohen të gjitha dokumentet që krijohen apo që vijnë në organin shtetëror e jo shtetëror, me përjashtim të atyre të përmendura në nenin 6. Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1) një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës. Nuk lejohet evidencimi në një numër i dy ose më shumë praktikave të përafërta që janë të pavarura ndërmjet tyre sipas objektit.

Realizimi i procedurave të prokurimit “blerje me vlerë të vogël” dhe “sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar” paraqitet në vijim:

-Për **vitin 2021**, për zërin 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” dhe zërin 231 të Buxhetit “Shpenzime për Investimet”, janë realizuar 14 procedura prokurimi “blerje me vlerë të vogël” me fond limit në vlerën 4,100,000 lekë dhe realizim 3,624,617 lekë. (tabela 1 bashkëlidhur këtij akti).

-Janë realizuar procedura “sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar” me fond të parashikuar në vlerën 2,000,000 lekë pa Tvsh dhe vlerë të realizuar 1.630.720 lekë pa Tvsh.

Është realizuar procedura, marrëveshje kuadër “Blerje materiale kancelarie për Ministrinë e Brendshme, e cila është kryer nga **Agjencia e Blerjeve të Përqendruara**, që nuk është objekt i auditimit tonë, me fond limit 8,384,948 lekë.

Loti 3 i kësaj procedure me fond limit në vlerën 3,390,895 lekë dhe realizim në vlerën 654,982 lekë, për të cilën është lidhur kontrata nr. 9363/3 prot, datë 16.12.2021. Pra MB është përgjegjëse vetëm për zbatimin e kësaj kontrate sipas detyrimeve kontraktuale.

Në mënyrë të përmbledhur jepen në tabelën në vijim:

Viti	Procedura të realizuara		Procedura të Realizuara të Audituar		Në përqindje
	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	
Janar-dhjetor 2021	14	3,624,617	7	3,182,304	87.79
Janar -dhjetor 2021/bileta	15	1,630,720	10	941,540	57,73
SHUMA		5,255,337	17	4,123,844	78,47

Nga 14 procedurat prokurimi “blerje me vlerë të vogël”, u përzgjedhën për auditim, 7 procedura prokurimi me fond limit 3,400,000 lekë dhe realizim në vlerën 3,182,304 lekë, të pasqyruara në tabelën nr.2.5.2 në seksionin “Aneksë”. Në procedurat e prokurimit “blerje me vlerë të vogël” me të dhënat si më poshtë, të cilat u përzgjedhën mbi bazë risku (vlera më e lartë e kontratës së lidhur), u konstatua në vijim:

1. “Blerje ujë dhe kafe”, fondi i parashikuar është 800,000 Lekë pa Tvsh. Vlera e realizuar është 798.000 Lekë pa Tvsh, për procedurat me objekt:

- “Blerje kafe”, vlera 280,000 lekë pa Tvsh, operatori fitues “K”, sh.p.k; data e zhvillimit të procedurës në sistem 24.03.2021, data e lidhjes së kontratës (nënshkrimit të faturës) 26.03.2021;
- “Blerje ujë”, vlera 85,000 lekë pa Tvsh, operatori fitues “L. I.”, sh. a; data e zhvillimit të procedurës në sistem 04.06.2021, data e lidhjes së kontratës (nënshkrimit të faturës) 09.06.2021;
- “Blerje ujë”, vlera 260,000 lekë pa Tvsh, operatori fitues “L. I.”, sh. a; data e zhvillimit të procedurës në sistem 13.09.2021, data e lidhjes së kontratës (nënshkrimit të faturës) 20.09.2021;
- “Blerje kafe”, vlera 173,000 lekë pa Tvsh, operatori fitues “C. C.”, sh.p. k; data e zhvillimit të procedurës në sistem 03.11.2021, data e lidhjes së kontratës (nënshkrimit të faturës) 11.11.2021.

Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2021. (tab 1.1)

2. “Materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim”, fondi i parashikuar është 800,000 Lekë pa Tvsh; Vlera e realizuar është 706,800 Lekë pa Tvsh, për procedurat me objekt:

Kanë marrë pjesë 5 OE.

- “Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi”, vlera 379,900 lekë pa Tvsh, operatori fitues “M. H.”, person fizik, data e zhvillimit të procedurës në sistem 11.02.2021, data e lidhjes së kontratës (nënshkrimit të faturës), 18.02.2021;
- “Blerje materiale elektrike”, vlera 98.000 lekë pa Tvsh, operatori fitues “A. 2.”, sh.p.k, data e zhvillimit të procedurës në sistem 05.05.2021, data e lidhjes së kontratës (nënshkrimit të faturës), 12.05.2021;
- “Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi”, vlera 228,900 lekë pa Tvsh, operatori fitues “Xh.”, sh.p.k, data e zhvillimit të procedurës në sistem 23.09.2021, data e lidhjes së kontratës (nënshkrimit të faturës), 28.09.2021.

Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2021. (Tab 1.2)

3. “Sigurimi i godinës dhe aseteve të lëvizshme të Ministrisë së Brendshme”:

Fondi i parashikuar është 800,000 Lekë pa Tvsh, vlera e realizuar është 800,000 Lekë pa Tvsh, operatori fitues “I.”, sh. a, data e zhvillimit të procedurës në sistem 19.03.2021, data e lidhjes së kontratës 24.03.2021, data e përfundimit të lidhjes së kontratës 23.03.2022.

Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve, periudha e sigurimit: 24.03.2021 – 23.03.2022.
Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2021. (Tab 1.3)

4. Procedura e prokurimit: “Shpenzime për mirëmbajtjen e sistemit të kondicionimit në Ministrinë e Brendshme”, data e zhvillimit të procedurës në sistem 01.07.2021, data e lidhjes së kontratës (nënshkrimit të faturës) 08.07.2021.

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE si dhe dosjes fizike në lidhje me këtë procedurë, u konstatua se:

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.

Fondi limit i përlogaritur sipas proces verbalit të datës 21.06.2021, është 320,000 Lekë pa Tvsh, vlera e realizuar është 220,000 Lekë pa Tvsh, ose sa 68,75 % e fondit limit. Kanë marrë pjesë 12 OE nga të cilët 8 janë s’ kualifikuar (me argumentimin e tejkalimit të fondit limit) dhe ndër 4 të dalë fitues është zgjedhur oferta më e ulët e Operatorit Ekonomik “K. T. T.”, sh.p.k;

Nga verifikimi i dosjes fizike të operatorit fitues si dhe bazuar në proces verbalin mbi argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit, nr. 3285/5, datë 30.06.2021, në seksionin/Kritere të veçanta të kualifikimit, Komisioni që përfaqëson AK në pikën 1 shprehet se:

1. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës me certifikata specifike, të certifikuar nga një institucion i formimit profesional vendas ose ndërkombëtar.

Komisioni i prokurimit të blerjeve të vogla duhet të jetë specifik dhe me konkret te kriteret e veçanta për kualifikim pasi sipas plotësimit të këtyre kriterëve, operatorët ekonomikë garantojnë zbatimin me sukses të kontratës. Në rastin konkret duheshin specifikuar kategoritë e punonjësve të tipit: Inxhinier elektrik si edhe inxhinier mekanik. Gjithashtu përveç kontratave të punës, AK duhet t'i kërkojë OE fitues që në dosjen fizike të dorëzojë edhe liste pagesat e tij, për një periudhë 3 mujore ku të verifikohen nga KVO, nëse janë të punësuar specialistët dhe teknikët e deklaruar nga Operatori me kontratë pune.

KVO nuk ka kryer verifikimin e plotësimit të këtyre kriterëve të veçanta që vetë i ka vendosur në dokumentet standarde të tenderit, për të garantuar se OE që janë pjesëmarrës në këtë procedurë, janë të specializuar për ofrimin e shërbimit të kërkuar dhe për rëndësinë e punimeve që do të kryejnë në përputhje me standardet teknologjike, veprime në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, ku citohet se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Sipas LPP, operatorët ekonomik janë të detyruar të paraqesin ofertat e tyre në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor. Është Autoriteti Kontraktor ai që përcakton nevojat për shërbime/mallra/punë dhe operatorët ekonomik ata që paraqesin ofertat në përputhje me këto kërkesa ligjore.

Për më tepër, dhe vetë Operatori Ekonomik në deklaratën e ngarkuar në SPE me titull “Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike...” konfirmon se i përmbush specifikimet teknike të përcaktuara në DT dhe e vërtetojnë këtë me dokumentet e certifikata të dorëzuara bashkë me këtë deklaratë.

Për sa më sipër, duke qenë se operatori ofertues nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të saktë për plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim, Autoriteti ose enti Kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave, në bazë të LPP neni 92/ Shqyrtimi I ofertave, pika 1, 3, si dhe **nenit 38 të këtij ligji**.

KVO duhet të kishte kërkuar sqarim nga OE për plotësim të dokumentacionit, për të garantuar zbatimin me sukses të kontratës.

Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2021. (Tab 1.4)

Nga auditimi i respektimit të afatit të pagesës së faturës të sipër cituar, konstatohet së Urdhër shpenzimi për likuidimin e faturës 17/2021, është kryer rreth 49 ditë me vonesë nga afati 30 ditor i përcaktuar në Ligjin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, i ndryshuar, neni 7, germa c/i), e cila përcakton se:

i) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes nga ana e debitorit të faturës ose të një kërkesë pagese të njëvlershme;

5. Për procedurën “Shpenzime për mirëmbajtjen e gjeneratorit në Ministrinë e Brendshme”, fondi i parashikuar është 500,000 Lekë pa Tvsh, vlera e realizuar është 474,200 Lekë pa Tvsh.

- “Shërbim ekspertimi i gjeneratorit në Ministrinë e Brendshme”, vlera 14,700 lekë pa Tvsh, operatori fitues “A. 2.”, sh.p.k; data e zhvillimit të procedurës në sistem 08.11.2021, data e lidhjes së kontratës (nënshkrimit të faturës) 15.11.2021;
- “Shërbim riparimi i gjeneratorit në Ministrinë e Brendshme”, vlera 459,500 lekë pa Tvsh, operatori fitues “A. 2.”, sh.p.k; data e zhvillimit të procedurës në sistem 23.11.2021, data e lidhjes së kontratës (nënshkrimit të faturës) 02.12.2021.

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE si dhe dosjes fizike në lidhje me këtë procedurë, u konstatua se:

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.

Në zbatim të Urdhrit të ish-SP, në Ministrinë e Brendshme, nr. 7865/1, datë 05.11.2021, Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, bëri vlerësimin e procedurës të sipër cituar ku vlerësoi fitues OE A. 2., ShPK, i renditur në vend të tretë (sipas njoftimit dt 23.11.2021), me vlerë 459,500 lekë, pasi OE të renditur në 2 vendet e para (E. & B. C.) janë tërhequr nga gara.

Nga verifikimi i dosjes fizike të operatorit fitues, ku mungojnë disa dokumente, si dhe bazuar në proces verbalin mbi argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit, nr 7865/3 datë 03.11.2021, në seksionin/Kritere të veçanta të kualifikimit, Komisioni që përfaqëson AK në pikën 1 shprehet se:

Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 1 (një) inxhinier elektrik, dhe një specialist elektrik të licencuar, për të cilët duhet të paraqitet diploma dhe kontrata e punës.

Sa më sipër kërkohen për të garantuar se përfaqësuesit e operatorit ekonomik që do paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor, janë të specializuar për ofrimin e shërbimit të kërkuar, për vetë rëndësinë dhe specifikat e punimeve që do të kryhen. Gjithashtu, garantohet organizimi dhe mbikëqyrja e punimeve nga personat përgjegjës, në përputhje me standardet teknologjike.

Komisioni i prokurimit të blerjeve të vogla në verifikimin e dosjes fizike të sjellë nga OE fitues ka qenë sipërfaqësor pasi subjekti ka dorëzuar një kontratë punë të lidhur mes të njëjtit person, i cili është administratori i firmës (A. T. në pozicionin e punëdhënësit dhe punëmarrësit në të njëjtën kohë, kontrata me datë 01.01.2021), çka nuk vërteton dhe nuk plotëson kriterin e vendosur nga KPBV, pasi administratori ka paraqitur formimin e tij profesional, kur ndërkohë ata që kryejnë punën janë të punësuarit në këtë kompani, për të cilët nuk ka as deklaratë dhe konfirmim me të paktën dorëzimin e një listë pagese për muajin nëntor 2021. Pra A. 2. është përzgjedhur fitues pa plotësuar kriteret e vendosura në DST për më tepër që në memon me nr. 4107/1, datë 03.08.2021, drejtuar ish SP të MB, znj. E. P., Komisioni i prokurimit të blerjeve të vogla, thekson faktin e domosdoshmërisë së vënies në funksion të gjeneratorit pasi ai nuk është se ka thjesht defekte por është plotësisht jashtë funksionit. KVO nuk ka kryer verifikimin e plotësimin të këtyre kriterëve të veçanta që vetë i ka vendosur në dokumentet standarde të tenderit, për të garantuar se OE fitues në garë është i specializuar për ofrimin e shërbimit të kërkuar dhe për rëndësinë e punimeve që do të kryejë në përputhje me standardet teknologjike, veprime në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020.

Për sa më sipër, duke qenë se operatori ofertues nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të saktë për plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim, Autoriteti ose enti Kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave, në bazë të LPP neni 92/ Shqyrtimi i ofertave, pika 1, 3, si dhe **nenit 38 të këtij ligji**.

KVO duhet të kishte kërkuar sqarim nga OE për plotësim të dokumentacionit, për të garantuar zbatimin me sukses të kontratës.

Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2021. (Tab 1.5)

6. “Blerje moket për sallën e mbledhjeve”:

Fondi i parashikuar është 100,000 Lekë pa Tvsh, vlera e realizuar është 83,304 Lekë pa Tvsh, operatori fitues “A”, sh.p.k, data e zhvillimit të procedurës 18.08.2021, numri i faturës 26/2021. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2021. (Tab 1.6)

7. Blerje materiale me logo”:

Fondi i parashikuar është 100,000 Lekë pa Tvsh. Vlera e realizuar është 100,000 Lekë pa Tvsh, operatori fitues “O. B.”, person fizik, Nipt: L31307037A; data e zhvillimit të procedurës 16.12.2021, numri i faturës 06/2021.

Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2021. (Tab 1.7)

Për **vitin 2021**, bazuar në të dhënat e regjistrit, janë realizuar disa procedura prokurimi “*sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar*” me fond limit 2,000,000 lekë pa TVSH dhe vlerë totale të kontratave të realizuara 1,620,730 lekë pa TVSH. Autoriteti Kontraktor, në fillim të vitit buxhetor, ka ngritur Komisionin e Sistemit Dinamik (SD) të ndryshuar disa herë, për blerjen e biletave i përbërë prej 3 anëtarë, bazuar në pikën 3 të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 18.06.2021. “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike”. Komisioni, në zbatim të pikës 5-6 të Udhëzimit, ka realizuar procedurën e prokurimit nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik (SPE).

Të dhënat për procedurat e përzgjedhura janë si më poshtë vijon:

1. Objekti i prokurimit: “Blerje bileta avioni Tiranë- Londër-Tiranë dhe Milano-Londër-Tiranë”. Urdhër Prokurimi, nr. 8590/2, datë 22.11.2021 data e tenderit 22.11.2021, fituese oferta " I.T.T.", me vlerë 136,600 lekë pa TVSH, (*lidhur kontrata me OE me ofertën më të ulët*), pjesëmarrës në tender 6 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2021. (Tab 1.8)

2. Objekti i prokurimit: “Blerje bileta avioni Tiranë- Beirut-Tiranë”. Urdhër Prokurimi, nr. 943/1, datë 23.02.2021, data e tenderit 23.02.2021, fituese oferta " K. T. SHPK ", me vlerë 72,924 lekë pa TVSH, (*lidhur kontrata me OE me ofertën më të ulët*), pjesëmarrës në tender 4 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2021. (Tab 1.9)

3. Objekti prokurimit: Blerje bileta avioni Tiranë- Vjenë-Tiranë”. Urdhër Prokurimi, Nr. 5418/3, datë 17.09.2021 data e tenderit 17.09.2021, fituese oferta " D. Ka. ", me vlerë 22,880 lekë pa TVSH, (*lidhur kontrata me OE me ofertën më të ulët*), pjesëmarrës në tender 4 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2021. (Tab 1.10).

4. Objekti prokurimit: Blerje bileta avioni Tiranë- Bukuresht- Vjenë-Tiranë”. Urdhër Prokurimi, nr. 1774/1, datë 06.04.2021 data e tenderit 06.04.2021, fituese oferta " A.T.T.", me vlerë 179,900

lekë pa TVSH, (*lidhur kontrata me OE i renditur i dyti ne klasifikimin e gjeneruar nga sistemi*), pasi OE "A.L." i renditur në vend të parë (*oferta 171,120 lekë*) është tërhequr nga lidhja e kontratës me pretendimin "për shkak të ndryshimit të gjendjes së vendeve", pjesëmarrës në tender 3 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2021. (Tab 1.11).

5. Objekti prokurimit: "Blerje bileta avioni Tiranë- Sofie-Tiranë".

Urdhër Prokurimi, nr. 6853/4, datë 11.10.2021 data e tenderit 12.10.2021, fituese oferta " A.T.T.", , me vlerë 118,900 lekë pa TVSH, (*lidhur kontrata me OE me ofertën më të ulët*), pjesëmarrës në tender 6 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2021. (Tab 1.12).

6. Objekti prokurimit: "Blerje bileta avioni Vjenë - Tiranë".

Urdhër Prokurimi, Nr. 296/1, datë 18.01.2021 data e tenderit 18.01.2021, fituese oferta "K.T. SHPK ", me vlerë 55,000 lekë pa Tvsh, (*lidhur kontrata me OE, i dyti me ofertë më të lartë*), pasi OE "L. I." i kualifikuar në vend të parë (*oferta 43,750 lekë*) është tërhequr nga lidhja e kontratës me pretendimin "për shkak të mungesës së disponibilitetit", pjesëmarrës në tender 6 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2021. (Tab 1.13).

7. Objekti prokurimit: "Blerje bileta avioni Tiranë- Stamboll – Ankara -Tiranë". Urdhër Prokurimi, Nr. 4586/1, datë 09.08.2021 data e tenderit 09.08.2021, fituese oferta " A. T. T. ", me vlerë 89,000 lekë pa TVSH, (*lidhur kontrata me OE me ofertë më të ulët*), pjesëmarrës në tender 1 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2021. (Tab 1.14).

8. Objekti prokurimit: "Blerje bileta avioni Tiranë- Kopenhagen-Tiranë". Urdhër Prokurimi, Nr. 7299/3, datë 25.10.2021 data e tenderit 25.10.2021, fituese oferta "K.T. shpk ", me vlerë 131,638 lekë pa TVSH, (*lidhur kontrata me OE I dyti me ofertë më të lartë*), pasi OE "D. K." i kualifikuar në vend të parë (*oferta 108,200 lekë*) është tërhequr nga lidhja e kontratës me pretendimin "për shkak të ndryshimit të vlerës së biletës", pjesëmarrës në tender 3 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2021. (Tab 1.15).

9. Objekti prokurimit: "Blerje bileta avioni Tiranë- Lubjanë-Tiranë". Urdhër Prokurimi, Nr. 8759/2, datë 26.11.2021 data e tenderit 26.11.2021, fituese oferta "I.T.T. ", me vlerë 103,688.40 lekë pa TVSH, (*lidhur kontrata me OE me ofertë më të ulët*), pjesëmarrës në tender 3 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2021. (Tab 1.16).

10. Objekti prokurimit: "Blerje bileta avioni Tiranë – Vjenë - Tiranë". Urdhër Prokurimi, Nr. 6906/2, datë 15.10.2021 data e tenderit 15.10.2021, fituese oferta " K.T. shpk ", me vlerë 30,990 lekë pa TVSH, (*lidhur kontrata me OE me ofertë më të ulët*), pjesëmarrës në tender 7 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2021. (Tab 1.17).

Nga auditimi i blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar rezultoi se:

Blerja e biletave është realizuar në kufijtë e datës së nisjes megjithëse ftesa për pjesëmarrje nga organizatorët e takimit/ aktivitetit është dërguar disa javë para kryerjes së procedurave të prokurimit dhe blerjes së biletave. Kjo ka ardhur si pasojë e miratimit me vonesë të

autorizimeve, mbi pjesëmarrjen e përfaqësuesve të MB në këto aktivitete. Një fenomen i tillë sjell si pasojë riskun e blerjes së biletave me çmim më të lartë, kur prokurohet pak ditë para datës së nisjes, krahasuar me çmimet e tregut.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me nenin 8, pika 1, nenin 9, pika 1 dhe nenin 12, pika 3, germa a, të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm”, i ndryshuar.

Në disa prej urdhër-shpenzimeve të blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar të përzgjedhura për t’u audituar nga ana e Grupit të Auditimit, si dhe në disa urdhër-pagesa të shërbimeve-dieta jashtë vendit të punonjësve, të likuiduara nëpërmjet arkës, u konstatua mungesa e ftesës së vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve. Me anë të këtij dokumentacioni, vërtetohet qëllimi dhe objekti i shërbimit si dhe pjesa e shpenzimeve që do të mbulojë organizatori dhe pjesa që do të mbulojë buxheti i shtetit, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr.22 të MFE datë 10.07.2013 “ Mbi zbatimin e VKM nr. 870, date 14.12.2011“Për trajtimin financiar te punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, pika 4 dhe me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenin 4, pika 26 të ku citohet se “Dokument financiar është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative”, nenin 2, pika 16 “Gjurma e auditimit, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre...”, si dhe pikën 35, germa b “Dokumente vërtetues”, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik.”

-Në lidhje me procedurën, marrëveshje kuadër “Blerje materiale kancelarie për Ministrinë e Brendshme, e cila është kryer nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, që nuk është objekt i auditimit tonë, me fond limit 8,384,948 lekë.

Loti 3 i kësaj procedure me fond limit në vlerën **3,390,895 lekë** dhe realizim në vlerën **654,982 lekë**, për të cilën është lidhur Kontrata nr. 9363/3 prot, datë 16.12.2021, me datë fillimi 16.12.2021 dhe datë përfundimi 26.12.2021. Malli është marrë në dorëzim sipas faturës nr. 2309/2021, datë 29.12.2021 dhe fletëhyrjes në magazinë nr. 56, datë 29.12.2021. Janë respektuar afatet e njoftimit mbi kontratën e nënshkruar pranë ASHPP dhe APP, zbatimi i të cilës jepet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Paguar: Urdhër shpenzimi			Faturuar: Fatura			Marrë në dorëzim
	nr.	datë	vlerë	nr.	datë	vlerë	
1	494	30.12.2021	785,979	2309/2021	29.12.2021	785,979	Aparati MB
SHUMA			785,979	SHUMA			785,979

Sa më sipër arrihet në konkluzion:

☛ Nga auditimi me përzgjedhje mbi bazë risku (referuar kontratës së lidhur me vlerë më të lartë) i procedurave të prokurimit “blerje me vlerë të vogël” u konstatua se:

a. Dosjet nuk ishin të arkivuara, në përputhje me Ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar.

b. Komisioni i prokurimit të blerjeve të vogla nuk ka kryer me korrektësi verifikimin dhe plotësimin nga OE të kriterëve të veçanta të kualifikimit të vendosura në DST duke mos garantuar zbatimin me sukses të kontratave, veprime në kundërshtim me nenin 82/ Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave të VKM nr. 285, pika 2, ku citohet se:

Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

☒ Nga auditimi me përzgjedhje mbi bazë risku (referuar kontratës së lidhur me vlerë më të lartë) i procedurave të prokurimit “**sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar**” si gjetje e përbashkët u konstatua:

-Në të gjitha rastet e audituara trajtuar në këtë akt konstatim, procedurat e prokurimit realizohen kryesisht 1-2 ditë para datës së udhëtimit. Për vitin 2022, praktika e miratimit për pjesëmarrje në evente bëhet me vonesë nga Drejtoria e Kabinetit, jo menjëherë nga momenti i njoftimit nga organizatorët. Vonesa në fillimin e procedurave të prokurimit, sjell si pasojë blerjen e biletave të transportit ajror me kosto të lartë.

☒ Në disa nga rastet e audituara trajtuar në këtë akt konstatim (blerje të vogël dhe sistem dinamik blerje), vihet re tërheqja e operatorëve ekonomik fitues në fazën e lidhjes së kontratës, me pretendimin se “*ka ndryshuar çmimi*” me të cilin kanë ofertuar ose me pretendimin se “*është përlllogaritur gabim fondi limit*” me të cilin kanë ofertuar duke sjellë si pasojë që, kontrata të lidhet me OE të renditur më pas, me një vlerë më të lartë. AK, nuk ka raportuar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik për rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik nga procedura, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 30: *Rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik, sipas pikës 6, të këtij neni, raportohen nga autoriteti/enti Kontraktor pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, me qëllim veprimin nga kjo e fundit, sipas parashikimeve të nenit 78, të LPP-së.*

Për sa sipër, veprimet referuar sa më lart janë kompetencë e ish Sekretarit të Përgjithshëm, Drejtorit të Kabinetit dhe Komisionit të Sistemit Dinamik, sipas praktikave dhe vitit respektiv trajtuar në këtë akt konstatim:

∞ **-Për vitin 2022**, janë 2 urdhra për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, përkatësisht: Urdhri nr. 500, dt 18.01.2022 dhe Urdhri nr. 4101, dt 20.04.2022, për një ndryshim në Urdhrin e parë, me të njëjtën përbërje si më sipër.

Me Urdhrin nr. 501, datë 18.01.2022, të SP të MB është caktuar personi përgjegjës për prokurimet e vitit 2021, znj. A. H., me pozicion përgjegjëse në sektorin e shërbimeve dhe menaxhimit të aseteve, në Drejtorinë e Mirë administrimit të burimeve njerëzore, aseteve dhe shërbimeve.

Me urdhër nr. 502, datë 18.01.2022, është krijuar Komisioni për marrjen në dorëzim të mallrave të prokuruar me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, me përbërje:

4. Z. H. M., Kryetar, me pozicion specialist në sektorin e Kontabilitetit dhe menaxhimit të aktiveve, në DBMF.
5. Znj. S. M., anëtar, me pozicion specialist në sektorin e financës, në DBMF.
6. Znj. M. H., anëtar, me pozicion specialist në sektorin e shërbimeve, në DMBNJASH.

- Me urdhër nr. 502/1, datë 07.03.2022, është kryer ndryshim në Komisionin për marrjen në dorëzim të mallrave të prokuruar me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, në lidhje me anëtarin Znj. M. H. dhe zëvendësimin e saj me znj. K. V. , me pozicion: specialist në sektorin e shërbimeve, në DMBNJASH.

-Me urdhër nr. 4099, datë 20.04.2022, është ri ngritur Komisioni për marrjen në dorëzim të mallrave të prokuruar me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, me përbërje:

1. Z. H. M., Kryetar, me pozicion specialist në sektorin e Kontabilitetit dhe menaxhimit të aktiveve, në DBMF.

2. Znj. S. M., anëtar, me pozicion specialist në sektorin e financës, në DBMF.

3. z. B. Xh., anëtar, specialist në sektorin e shërbimeve, në DMBNJASH.

-Me urdhër nr. 4099/1, datë 20.04.2022, ka përsëri ndryshim në Komisionin për marrjen në dorëzim të mallrave të prokuruar me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, me përbërje:

1. z. B. Xh., Kryetar, specialist në sektorin e shërbimeve, në DMBNJASH.

2. z. L. J., anëtar, specialist në sektorin e financës, në DBMF.

3. Znj. S. M., anëtar, me pozicion specialist në sektorin e financës, në DBMF.

Në lidhje me urdhrat e mësipërm konstatohet se edhe pse ka shumë ndryshime gjatë vitit në përbërjen e komisioneve (si ato të prokurimit me vlerë të vogël ashtu edhe për komisionet e sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar), këto shkresa nuk mbajnë të njëjtin numër protokolli me urdhrin e parë të vitit, në kundërshtim me Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 19, pika 1, e cila përcakton se:

1. Në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Në të regjistrohën të gjitha dokumentet që krijohen apo që vijnë në organin shtetëror e jo shtetëror, me përjashtim të atyre të përmendura në nenin 6. Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1) një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës. Nuk lejohet evidencimi në një numër i dy ose më shumë praktikave të përafërta që janë të pavarura ndërmjet tyre sipas objektit.

Për vitin 2022, realizimi i procedurave të prokurimit “blerje me vlerë të vogël” dhe “sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar” paraqitet në vijim:

-Për zërin 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” dhe zërin 231 të Buxhetit “Shpenzime për Investimet”, janë realizuar 12 procedura prokurimi “blerje me vlerë të vogël” me fond limit në vlerën 4,600,000 lekë dhe realizim 3,880,251 lekë.

-Janë realizuar procedura “sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar” me fond limit në vlerën 4,000,000 lekë pa Tvsh dhe vlerë të realizuar 3,918,361 lekë.

Janë realizuar 4 procedura marrëveshje kuadër me objekt:

1. “Blerje materiale kancelarie për Ministrinë e Brendshme,
2. “Blerje pajisje elektronike
3. “Blerje tonerë për MB”
4. “Blerje letër për DPGJC”,

për të cilat janë lidhur minikontratat me MB, për zbatimin e tyre, me fond limit 13,344,000 lekë dhe vlerë të realizuar 10,994,408 lekë. (Këto procedura janë kryer nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, dhe më pas MB si autoritet ka lidhur minikontratat, të cilat janë objekt auditimi).

Në mënyrë të përmbledhur tabela:

Tabela 1 Përmbledhëse e procedurave të realizuara dhe atyre të audituara (blerje të vogla dhe sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar)

Viti	Procedura realizuara		Procedura të Realizuara të Audituar		Në përqindje
	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	
Janar-dhjetor 2022	12	3,880,251	6	3,510,026	90,45
Janar -dhjetor 2022/bileta		3,918,361	10	1,514,660	38,65
SHUMA		7,798,612	16	5,024,686	64,43

Nga 12 procedurat prokurimi “*blerje me vlerë të vogël*”, u përzgjedhën për auditim, 6 procedura prokurimi mbi bazë risku (*vlera më e lartë e kontratës së lidhur*), me fond limit 4,000,000 lekë dhe realizim në vlerën 3,510,026 lekë, të pasqyruara në tabelën e paraqitur në pikën 2.5 për vitin 2022, tek seksioni ‘Aneksë’.

1. Objekti i prokurimit: “Sigurimi i godinës dhe aseteve të lëvizshme të Ministrisë së Brendshme”.

Fondi i parashikuar është 1,000,000 Lekë pa Tvsh, vlera e realizuar është 997,700 Lekë pa Tvsh, operatori fitues “A”, sh.a, data e zhvillimit të procedurës në sistem 27.04.2022, data e lidhjes së kontratës 28.04.2022, data e përfundimit të lidhjes së kontratës 27.04.2023, operatorë ekonomikë pjesëmarrës 1. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Aneksë për vitin 2022. (Tab 1.1).

2. Objekti i prokurimit: “Materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim”, fondi i parashikuar është 1.000.000 Lekë pa Tvsh; Vlera e realizuar është 936.090 Lekë pa Tvsh, për procedurat me objekt:

- ∞ Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi”, vlera 417,650 lekë pa Tvsh, operatori fitues “Xh.”, sh.p.k, data e zhvillimit të procedurës në sistem 22.04.2022, data e lidhjes së kontratës (nënshkrimi të faturës), 29.04.2022; operatorë ekonomikë pjesëmarrës 29.
- ∞ Blerje materiale pastrimi”, vlera 189,940 lekë pa Tvsh, operatori fitues “M. V.”, person fizik, data e zhvillimit të procedurës në sistem 30.09.2022, data e lidhjes së kontratës (nënshkrimi të faturës), 05.10.2022; operatorë ekonomikë pjesëmarrës 24.
- ∞ “Blerje materiale elektrike”, vlera 328.500 lekë pa Tvsh, operatori fitues “A. 2.”, sh.p.k, data e zhvillimit të procedurës në sistem 19.12.2022, data e lidhjes së kontratës (nënshkrimi të faturës), 28.12.2022; operatorë ekonomikë pjesëmarrës 30.

Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Aneksë për vitin 2022. (Tab 1.2).

3. Objekti i prokurimit: Blerje ujë dhe kafe”, fondi i parashikuar është 800,000 Lekë pa Tvsh. Vlera e realizuar është 770,666 Lekë pa Tvsh, për procedurat me objekt:

- Blerje kafe”, vlera 270,833 lekë pa Tvsh, operatori fitues “C. C.”, sh.p.k; data e zhvillimit të procedurës në sistem 27.03.2022, data e lidhjes së kontratës (nënshkrimi të faturës) 30.03.2022; operatorë ekonomikë pjesëmarrës 10.

- “Blerje ujë”, vlera 229,167 lekë pa Tvsh, operatori fitues “L. I.”, sh.a; data e zhvillimit të procedurës në sistem 17.03.2022, data e lidhjes së kontratës (nënshkrimit të faturës) 23.03.2022; operatorë ekonomikë pjesëmarrës 7.
- “Blerje ujë”, vlera 126,666 lekë pa Tvsh, operatori fitues “Q”, sh.p;k data e zhvillimit të procedurës në sistem 28.07.2022, data e lidhjes së kontratës 01.08.2022; data e përfundimit të lidhjes së kontratës 31.12.2022, operatorë ekonomikë pjesëmarrës 5.
- “Blerje kafe”, vlera 144,000 lekë pa Tvsh, operatori fitues “K. C.”, sh.p.k; data e zhvillimit të procedurës në sistem 08.08.2022, data e lidhjes së kontratës (nënshkrimit të faturës) 12.08.2022, operatorë ekonomikë pjesëmarrës 7.

Kontrata e lidhur Nr. 7920/5 Prot, datë 01.08.2022. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2022. (Tab 1.3).

4. Objekti i prokurimit: Shpenzime për mirëmbajtjen e sistemit të kondicionimit në Ministrinë e Brendshme”, fondi i parashikuar është 1,000,000 Lekë pa Tvsh, vlera e realizuar është 606,870 Lekë pa Tvsh, ose sa 60,6 % e fondit limit, për procedurat me objekt:

- Shërbim ekspertimi i sistemit të kondicionimit në Ministrinë e Brendshme”, vlera 29,870 lekë pa Tvsh, operatori fitues “S. K.”, sh.p.k; data e zhvillimit të procedurës në sistem 24.05.2022, data e lidhjes së kontratës (nënshkrimit të faturës) 30.05.2022; operatorë ekonomikë pjesëmarrës 6.
- “Shërbim riparimi dhe mirëmbajtje e sistemit të kondicionimit në Ministrinë e Brendshme”, vlera 577,000 lekë pa Tvsh, operatori fitues “C.”, sh.p. k; data e zhvillimit të procedurës në sistem 20.06.2022, data e lidhjes së kontratës 20.06.2022, data e përfundimit të lidhjes së kontratës 20.06.2023, operatorë ekonomikë pjesëmarrës 9.

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE në lidhje me këtë procedurë sipas Urdhrit të prokurimit me nr 6273/1, datë 13.06.2022 të ish Titullarit të AK, znj. E. P., u konstatua se:

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.

Është kualifikuar fitues nga KVO, Operatori Ekonomik “C.” SHPK, me ofertë ekonomike më të ulët 577,000 lekë pa tvsh nga 8 operatorë të kualifikuar fitues si dhe është s kualifikuar një OE S. R. pasi nuk kishte si fushë të veprimtarisë së tij, objektin e prokurimit (mirëmbajtje të sistemit të kondicionimit).

Nga verifikimi i dosjes fizike të operatorit fitues si dhe bazuar në proces verbalin nr. 6273/2, datë 13.06.2022, në seksionin 1/Kritere të veçanta të kualifikimit, Komisioni që përfaqëson AK në pikën 4 kërkon nga OE shprehimisht:

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 1(një) inxhinier elektrik dhe një specialist elektrik të licencuar, të certifikuar nga një institucion i formimit profesional, për të cilët duhet të paraqitet diploma dhe kontrata e punës.

Për sa më sipër, OE C., ka paraqitur respektivisht diplomën dhe kontratën e punës të lidhur me një inxhinier elektrik (B. Z.) si dhe diplomën dhe kontratën e punës me një inxhinier mekanik dhe njëkohësisht elektrikist (A. K.), të cilët nuk figurojnë të deklaruar në listë pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të sjellë nga vetë subjekti në deklarin on - line, për muajin maj 2022. Pra OE lidh kontrata punësimi dhe nuk bën deklarin e këtyre punonjësve në shkelje të detyrimeve kontraktuale si dhe në kundërshtim me Ligjin 9920 dt. 19.05.2008, i ndryshuar “Për procedurat tatimore në RSH”.

KVO nuk ka kryer verifikimin e plotësisht të këtyre kriterëve të veçanta të cilat janë për të garantuar se OE që do të paraqiten pranë AK, janë të specializuar për ofrimin e shërbimit të kërkuar dhe për rëndësinë e punimeve që do të kryejnë në përputhje me standardet teknologjike, veprime në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, ku citohet se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Sipas LPP, operatorët ekonomik janë të detyruar të paraqesin ofertat e tyre në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Sipas LPP, operatorët ekonomik janë të detyruar të paraqesin ofertat e tyre në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor. Është Autoriteti Kontraktor ai që përcakton nevojat për shërbime/mallra/punë dhe operatorët ekonomik ata që paraqesin ofertat në përputhje me këto kërkesa ligjore.

Për më tepër, dhe vetë Operatori Ekonomik në deklaratën e ngarkuar në SPE me titull “Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike...” konfirmon se i përmbush specifikimet teknike të përcaktuara në DT dhe e vërtetojnë këtë me dokumentet e certifikata të dorëzuara bashkë me këtë deklaratë.

Për sa më sipër, duke qenë se operatori ofertues nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të saktë për plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim, Autoriteti ose enti Kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave, në bazë të LPP neni 92/ Shqyrtimi I ofertave, pika 1, 3, si dhe **nenit 38 të këtij ligji**.

KVO duhet të kishte kërkuar sqarim nga OE për plotësim të dokumentacionit, për të garantuar zbatimin me sukses të kontratës.

Kontrata e lidhur nr. 6273/4, datë 20.06.2022.

Nr.	Paguuar: Urdhër shpenzimi			Faturuar: Fatura			Marrë në dorëzim
	nr.	datë	vlerë	nr.	datë	vlerë	
1	185	15.06.2022	35,844	97/2022	30.05.2022	35,844	Aparati MB
2	433	27.12.2022	13,515	239/2022	30.11.2022	13,515	Aparati MB
3	334	20.10.2022	Anuluar	-	-	-	Aparati MB
4	450	30.12.2022	43,525	265/2022	28.12.2022	43,525	Aparati MB
5	439	29.12.2022	368,160	110/2022	30.07.2022	368,160	Aparati MB
6	385	22.11.2022	30,025	198/2022	02.11.2022	30,025	Aparati MB
7	335	20.10.2022	31,515	120/2022	02.08.2022	31,515	Aparati MB
8	336	20.10.2022	30,025	148/2022	29.08.2022	30,025	Aparati MB
9	337	20.10.2022	22,515	169/2022	29.09.2022	22,515	Aparati MB
10	48	21.02.2023	13,515	10/2023	31.01.2023	13,515	Aparati MB
11	92	06.04.2023	30,025	38/2023	28.02.2023	30,025	Aparati MB
12	124	03.05.2023	22,515	61/2023	31.03.2023	22,515	Aparati MB
13	188	27.06.2023	30,025	21/2023	11.05.2023	30,025	Aparati MB
14	189	27.06.2023	13,515	56/2023	31.05.2023	13,515	Aparati MB
15	227	26.07.2023	43,525	83/2023	30.06.2023	43,525	Aparati MB

SHUMA	728,244	SHUMA	728,244	629400
-------	---------	-------	---------	--------

Nga auditimi i respektimit të afatit të pagesës së faturës të sipër cituar, konstatohet së Urdhër shpenzimet për likuidimin e faturës: 120/2022 dhe 110/2022, është kryer përkatësisht 42 ditë me vonesë nga afati 30 ditor dhe 120 ditë me vonesë, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, i ndryshuar, neni 7, germa c/i), e cila përcakton se:

i) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes nga ana e debitorit të faturës ose të një kërkesë pagese të njëvlershme;

5. Objekti i prokurimit: “Blerje material me logo”, fondi i parashikuar është 100,000 Lekë pa Tvsh. Vlera e realizuar është 100,000 Lekë pa Tvsh, për procedurat me objekt:

- “Blerje baze materiale për Protokollin e Ministrit” vlera 100,000 Lekë pa Tvsh, operatori fitues “G. L.” shpk, data e zhvillimit të procedurës 04.11.2022, numri i faturës 154/2022; operatorë ekonomike pjesëmarrës 3. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2022. (Tab 1.4).

- **6.** Objekti prokurimit: Shërbim mirëmbajtje e kolaudim fikëse zjarri, operatorë ekonomike pjesëmarrës 3. Likuidimi sipas urdhër shpenzimit nr. 423. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2022. (Tab 1.5).

II. Në procedurat e prokurimit “*sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar*” të cilat u përzgjedhën mbi bazë risku (vlera më e lartë e kontratës së lidhur), Për vitin 2022, bazuar në të dhënat e regjistrimit, janë realizuar disa procedura prokurimi “*sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar*” me vlerë të fondit limit 4,000,000 lekë pa TVSH dhe vlerë të kontratave të realizuara 3,918,361 lekë pa TVSH Të dhënat për procedurat e përzgjedhura janë si më poshtë vijon:

- **1.** Objekti i prokurimit: “Blerje e bileta avioni Tiranë- Bruksel (Belgjikë)-Tiranë”. Urdhër Prokurimi, Nr. 8317/10, datë 23.11.2022 data e tenderit 23.11.2022, fituese oferta " A.T.T. ", me vlerë 75,000 lekë pa TVSH, (lidhur kontrata me OE me ofertën më të ulët), pjesëmarrës në tender 2 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2022. (Tab 1.6).

- **2.** Objekti i prokurimit: “Blerje e bileta avioni Tiranë- Vjenë (Austri)-Tiranë”. Urdhër Prokurimi, Nr. 4198/5, datë 28.04.2022 data e tenderit 28.04.2022, fituese oferta “D. K.”, me vlerë 67,000 lekë pa TVSH, (lidhur kontrata me OE me ofertën më të ulët), pjesëmarrës në tender 6 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2022. (Tab 1.7).

- **3.** Objekti i prokurimit: “Blerje e bileta avioni Tiranë- Bruksel (Belgjikë)-Tiranë”. Urdhër Prokurimi, nr. 9311/3, datë 20.09.2022 data e tenderit 20.09.2022, fituese oferta " O.T.T. ", me vlerë 637,200 lekë pa TVSH, (lidhur kontrata me OE me ofertën më të ulët), pjesëmarrës në tender 3 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2022. (Tab 1.8).

- **4.** Objekti i prokurimit: “Blerje e bileta avioni Tiranë- Berlin (Gjermani)- Tiranë”. Urdhër Prokurimi, Nr. 10418/5, datë 13.10.2022 data e tenderit 13.10.2022, fituese oferta " E.T.T ", me vlerë 79,655 lekë pa TVSH, (lidhur kontrata me OE i renditur i treti ne klasifikimin e gjeneruar

nga sistemi), pasi OE "A.B.T.O" i renditur në vend të parë (oferta 57,160 lekë) është tërhequr nga lidhja e kontratës me pretendimin "për shkak të ndryshimit të gjendjes së vendeve" dhe OE "K. T." OE i renditur në vend të dytë (oferta 68,676 lekë) është tërhequr nga lidhja e kontratës me pretendimin "për shkak të ndryshimit të çmimit në sistem", pjesëmarrës në tender 4 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2022. (Tab 1.9).

5. Objekti i prokurimit: "Blerje e bileta avioni Tiranë- Bruksel- Tiranë". Urdhër Prokurimi, nr. 12462/3, datë 02.12.2022 data e tenderit 02.12.2022, fituese oferta " A.T.T ", me vlerë 301,200 lekë pa TVSH, (lidhur kontrata me OE renditur i katërti ne klasifikimin e gjeneruar nga sistemi), pasi OE "A. C." i renditur në vend të parë (oferta 134,491 lekë) është tërhequr nga lidhja e kontratës me pretendimin "për shkak të problemeve në sistemin e biletave", OE "D. K." i renditur në vend të dytë (oferta 188,800 lekë) është tërhequr nga lidhja e kontratës me pretendimin "për shkak të ndryshimit të çmimit në sistem" dhe OE "K. T. SHPK" i renditur në vend të tretë (oferta 211,220 lekë) është tërhequr nga lidhja e kontratës me pretendimin "nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në Ftesën për Ofertë", pjesëmarrës në tender 4 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës.

Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2022. (Tab 1.10).

6. Objekti i prokurimit: "Blerje e bileta avioni Tiranë- Vjenë - Tiranë". Urdhër Prokurimi, Nr. 9155/6, datë 06.10.2022 data e tenderit 06.10.2022, fituese oferta "E.T.T ", me vlerë 34,860 lekë pa TVSH, (lidhur kontrata me OE klasifikuar i dyti me ofertë më të lartë), pasi OE "A.C" i kualifikuar në vend të parë (oferta 34,500 lekë) është tërhequr nga lidhja e kontratës me pretendimin "për shkak të ndryshimit të çmimit në sistem", pjesëmarrës në tender 5 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2022. (Tab 1.11).

7. Objekti i prokurimit: "Blerje e bileta avioni Tiranë- Athinë - Tiranë". Urdhër Prokurimi, Nr. 3034/2, datë 25.03.2022 data e tenderit 25.03.2022, fituese oferta "S.T.T ", me vlerë 135,850 lekë pa TVSH, (lidhur kontrata me OE me ofertë më të ulët), pjesëmarrës në tender 5 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2022. (Tab 1.12).

8. Objekti i prokurimit: "Blerje e bileta avioni Tiranë- Vjenë-Tiranë". Urdhër Prokurimi, nr. 9503/3, datë 29.09.2022 data e tenderit 29.09.2022, fituese oferta " K.TSHPK ", me vlerë 27,495 lekë pa TVSH, (lidhur kontrata me OE me ofertë më të ulët), pjesëmarrës në tender 5 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2022. (Tab 1.13).

9. Objekti i prokurimit: "Blerje e bileta avioni Tiranë- Bukuresht". Urdhër Prokurimi, nr. 11779/2, datë 14.11.2022 data e tenderit 14.11.2022, fituese oferta "A.T.T" me vlerë 71,400 lekë pa TVSH, (lidhur kontrata me OE me ofertë më të ulët), pjesëmarrës në tender 1 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2022. (Tab 1.14).

10. Objekti i prokurimit: "Blerje e bileta avioni Tiranë - Strasburg - Tiranë". Urdhër Prokurimi, nr. 10870/3, datë 21.10.2022 data e tenderit 21.10.2022, fituese oferta " A.T.T", me vlerë 85,000

lekë pa TVSH, (lidhur kontrata me OE i dyti me ofertë më të lartë), pasi OE “E.T.T” i kualifikuar në vend të parë (oferta 75,580 lekë) është tërhequr nga lidhja e kontratës me pretendimin “për shkak të ndryshimit të çmimit”, pjesëmarrës në tender 5 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2022. (Tab 1.15).

Nga procedurat e sipër cituara u arrit në konkluzionin se:

☒ Vonesë në realizimin e procedurës së prokurimit, nga dalja e akteve administrative të sipërme për miratimin e pjesëmarrësve në event deri në daljen e urdhër prokurimit. Kjo sjell si pasojë blerje të biletave me kosto më të lartë e cila është përgjegjshmëri menaxheriale e dobët sipas Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 4, pika 9, ku citohet se “përgjegjshmëria menaxheriale është detyrimi i menaxherëve të njësisive, që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë. Përgjegjshmëria përfshin çështjet që lidhen me ndarjen e detyrave, zhvillimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, të gjitha transaksionet financiare, bashkërendimin me shërbimet qendrore të harmonizimit, si dhe me vlerësimin dhe raportimin për sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Përgjegjshmëria menaxheriale përfshin, gjithashtu, përgjegjësinë për veprimet e kryera”, kompetencë e ish Sekretarit të përgjithshëm, E. H.

☒ Tërheqja e operatorëve ekonomik fitues në fazën e lidhjes së kontratës, me pretendimin se “ka ndryshuar çmimi” me të cilin ka ofertuar. Kjo ka sjellë si pasojë që, kontrata të lidhet me OE të renditur më pas, me një vlerë më të lartë.

III. U verifikuan zbatimi i kontratave për 3 procedura marrëveshje kuadër me objekt:

1. “Blerje materiale kancelarie për Ministrinë e Brendshme, me fond limit 3,500, 000 lekë dhe vlerë të realizuar të kontratës 4,167,298 lekë
2. “Blerje tonerë për MB” me fond limit 4,000, 000 lekë dhe vlerë të realizuar të kontratës 2,050,960 lekë, pa tvsh.
3. “Blerje letër për DPGJC”, me fond limit 1,844, 000 lekë dhe vlerë të realizuar të kontratës 1,844,000 lekë, pa tvsh.

për të cilat janë lidhur minikontratat me MB, për zbatimin e tyre, me fond limit 13,344,000 lekë dhe vlerë të realizuar 10,994,408 lekë. (Këto procedura janë kryer nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, dhe më pas MB si autoritet ka lidhur minikontratat, të cilat janë objekt auditimi për saktësinë e zbatimit të tyre.

1/1. Për procedurën “Blerje materiale kancelarie” për Ministrinë e Brendshme, është lidhur Kontrata me nr. 458/4 prot, datë 11.05.2022, me datë fillimi 11.05.2022 dhe datë përfundimi 21.05.2022, bashkëlidhur formulari i sigurimit të kontratës Nr. 070110110033631 datë 11.05.2022. Malli është marrë në dorëzim nga komisioni i ngarkuar me urdhër të titullarit të institucionit, në datë 19.05.2022, brenda afatit të përcaktuar të kontratës. Marrja në dorëzim është bërë sipas faturës nr. 158/2022, datë 19.05.2022 dhe fletëhyrjes në magazinë nr. 12, date 19.05.2022. Janë respektuar afatet e njoftimit mbi kontratën e nënshkruar pranë ASHPP dhe APP.

1/2. Për procedurën “Blerje letër”, për Ministrinë e Brendshme, është lidhur Kontrata nr. 10126/3 prot, datë 02.12.2022, me datë fillimi 02.12.2022 dhe datë përfundimi 12.12.2022, bashkëlidhur formulari i sigurimit të kontratës nr. 220705492 datë 23.11.2022. Malli është marrë

në dorëzim sipas faturës nr. 17041/2022, date 09.12.2022 dhe fletëhyrjes në magazinë nr. 44, datë 09.12.2022. Janë respektuar afatet e njoftimit mbi kontratën e nënshkruar pranë ASHPP dhe APP.

1/3. Për procedurën “Blerje materiale kancelarie me baze letre” është lidhur kontrata me nr. 10124/3 prot, datë 02.12.2022, me datë fillimi 02.12.2022 dhe datë përfundimi 22.12.2022, bashkëlidhur formulari i sigurimit të kontratës nr. 220705490 datë 23.11.2022. Malli është marrë në dorëzim sipas faturës nr. 17614/2022, date 20.12.2022 dhe fletëhyrjes në magazinë nr. 45, datë 20.12.2022. Janë respektuar afatet e njoftimit mbi kontratën e nënshkruar pranë ASHPP dhe APP.

Nr.	Paguar: Urdhër shpenzimi			Faturuar: Fatura			Marrë në dorëzim
	nr.	datë	vlerë	nr.	datë	vlerë	
1	198	07.07.2022	1,199,608	158	19.05.2022	1,199,608	Aparati MB
2	472	30.12.2022	2,414,490	17614	20.12.2022	2,414,490	
3	470	30.12.2022	553,200	17041	09.12.2022	553,200	
SHUMA			4,167,298	SHUMA		4,167,298	

2. Për procedurën “Blerje tonerë” për Ministrinë e Brendshme, është lidhur kontrata nr. 3863/7 prot, datë 12.07.2022, me datë fillimi 12.07.2022 dhe datë përfundimi 09.09.2022, bashkëlidhur formulari i sigurimit të kontratës Nr. 220702273 datë 05.07.2022. Malli është marrë në dorëzim sipas faturës nr. 11552/2022, date 02.09.2022 dhe fletëhyrjes në magazinë nr. 29, date 02.09.2022. Janë respektuar afatet e njoftimit mbi kontratën e nënshkruar pranë ASHPP dhe APP.

Nr.	Paguar: Urdhër shpenzimi			Faturuar: Fatura			Marrë në dorëzim
	nr.	datë	vlerë	nr.	datë	vlerë	
1	349	31.10.2022	2,461,152	11552	02.09.2022	2,461,152	Aparati MB
SHUMA			2,461,152	SHUMA		2,461,152	

3. Për procedurën “Blerje letër për DPGJC” për Ministrinë e Brendshme, është lidhur Kontrata me nr. 12894/1 prot, datë 15.12.2022, me date fillimi 15.12.2022 dhe datë përfundimi 28.12.2022. Malli është marrë në dorëzim nga komisioni i ngarkuar me urdhër të titullarit të institucionit, në datë 21.12.2022, brenda afatit të përcaktuar të kontratës. Marrja në dorëzim është bërë sipas faturës nr. 17711/2022, date 21.12.2022 dhe fletëhyrjes në magazinë nr. 46, datë 21.12.2022. Janë respektuar afatet e njoftimit mbi kontratën e nënshkruar pranë ASHPP dhe APP.

Nr.	Paguar: Urdhër shpenzimi			Faturuar: Fatura			Marrë në dorëzim
	nr.	datë	vlerë	nr.	datë	vlerë	
1	471	30.12.2022	2,218,800	17711	21.12.2022	2,218,800	Aparati MB
SHUMA			2,218,800	SHUMA		2,218,800	

Sa më sipër arrihet në konkluzion:

Nga auditimi me përzgjedhje mbi bazë risku (referuar kontratës së lidhur me vlerë më të lartë) i procedurave të prokurimit “blerje me vlerë të vogël” u konstatua se:

☒ Komisioni i prokurimit të blerjeve të vogla nuk ka kryer me korrektësi verifikimin dhe plotësimin nga OE të kriterëve të veçanta të kualifikimit të vendosura në DST duke mos garantuar zbatimin me sukses të kontratave, veprime në kundërshtim me nenin 82/ Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave të VKM nr. 285, pika 2, ku citohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

☒ Në shumicën e rasteve të audituara “*blerje me vlerë të vogël*” dhe “*sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar*” për blerjen e biletave të transportit ajror për vitin 2022, vihet re tërheqja e operatorëve ekonomik fitues në fazën e lidhjes së kontratës, me pretendimin se “*është përlllogaritur gabim fondi limit*” ose “*ka ndryshuar çmimi*” me të cilin kanë ofertuar, kjo ka sjellë si pasojë që, kontrata të lidhet me OE të renditur më pas me vlerë më të lartë. AK, nuk ka raportuar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik për rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik nga procedura, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 30: *Rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik, sipas pikës 6, të këtij neni, raportohen nga autoriteti/enti Kontraktor pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, me qëllim veprimin nga kjo e fundit, sipas parashikimeve të nenit 78, të LPP-së.*

☒ Nga auditimi me përzgjedhje mbi bazë risku (*referuar kontratës së lidhur me vlerë më të lartë*) i procedurave të prokurimit “*sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar*” si gjetje e përbashkët u konstatua:

☒ Në të gjitha rastet e audituara trajtuar në këtë akt konstatim, procedurat e prokurimit realizohen kryesisht 1-2 ditë para datës së udhëtimit. Për vitin 2022, praktika e miratimit për pjesëmarrje në evente bëhet me vonesë nga Drejtoria e Kabinetit, jo menjëherë nga momenti i njoftimit nga organizatorët. Vonesa në fillimin e procedurave të prokurimit, sjell si pasojë blerjen e biletave të transportit ajror me kosto të lartë.

- ∞ **MB për vitin 2023**, në zbatim të detyrimit ligjor përcaktuar në legjislacionin e prokurimit publik ka ngritur Komisionin e prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël si dhe Komisionin e sistemit dinamik të blerjeve të transportit ajror ndërkombëtar, me urdhrat respektivë të titullarit të Autoritetit Kontraktor (AK) bazuar në Ligjin nr.162/2020 i ndryshuar, VKM nr.285, datë 19.05.2021 neni 68, dhe Udhëzimin nr.3, datë 18.06.2021, konkretisht:

Për vitin 2023, janë 4 urdhra për krijimin e komisionit të sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar, përkatësisht: Urdhri nr. 186 datë 10.01.2023, Urdhri nr. 4381, dt. 20.04.2023, Urdhri nr. 4381/1, dt. 13.07.2023 dhe Urdhri 4381/2, datë 02.10.2023, me përbërje:

1. z. F. T., Kryetar, me pozicion Drejtor i DSHM;
2. znj. D. K., anëtar, me pozicion specialist në Sektorin e Shërbimeve të përgjithshme, në DPESHM
3. znj. M. H., anëtare, me pozicion specialiste në sektorin e shërbimeve të përgjithshme.

-Për vitin 2023, janë 5 urdhra për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, përkatësisht: Urdhri nr. 185, dt. 10.01.2023 dhe Urdhri nr. 187, dt. 10.01.2023, Urdhri nr. 4382,

datë 20.04.2023, Urdhri 4382/1, datë 13.07.2023, dhe Urdhri nr 4382/2, datë 02.10.2023 me përbërje:

- 1- z. F. T., Kryetar, me pozicion Drejtor I DSHM
- 2- znj. D. K., anëtare, me pozicion specialiste në sektorin e shërbimeve të përgjithshme,
- 3- znj. M. H., anëtare, me pozicion specialiste në sektorin e shërbimeve të përgjithshme.

Kemi disa ndryshime në përcaktimin e personit përgjegjës për prokurimet për vitin 2023, ku starton me Urdhrin nr. 107 datë 06.01.2023, të SP të MB është caktuar personi përgjegjës për prokurimet e vitit 2023, znj. A. H., përgjegjëse në sektorin e SHP;

Me urdhrin nr. 4380, datë 20.04.2023, ku personi përgjegjës është caktuar z. F. T., me pozicion Drejtor i Drejtorisë së shërbimeve mbështetëse.

Me urdhrin nr. 4380/2, datë 13.07.2023, ku personi përgjegjës është caktuar znj. B. K. me pozicion Drejtor i Drejtorisë MBNJ në DPESHM.

Me urdhrin nr. 4380/5, datë 03.10.2023, ku personi përgjegjës është ricaktuar z. F. T, me pozicion Drejtor i Drejtorisë së shërbimeve mbështetëse.

Me urdhër nr. 185 datë 10.01.2023 është krijuar Komisioni për marrjen në dorëzim të mallrave të prokuruarra me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, me përbërje:

7. Z. B. Xh., Kryetar, me pozicion specialist në sektorin e shërbimeve të përgjithshme në DSHM.
8. Znj. S. M., anëtar, me pozicion specialist në sektorin e financës, në DBMF.
9. Znj. D. K., anëtar, me pozicion specialist në sektorin e kontabilitetit dhe menaxhimit të aktiveve, në DMBNJASH.

Për vitin 2023, realizimi i procedurave të prokurimit “blerje me vlerë të vogël” dhe “sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar” paraqitet në vijim:

-Për zërin 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” dhe zërin 231 të Buxhetit “Shpenzime për Investimet”, janë realizuar 17 procedura prokurimi “blerje me vlerë të vogël” me fond limit në vlerën 6,900,000 lekë dhe realizim 4,126,573 lekë. (sipas tabelës bashkëlidhur këtij PRA, në pikën 2.5, Aneksë).

-Janë realizuar procedura “sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar” me fond limit në vlerën 5,000,000 lekë pa Tvsh dhe vlerë të realizuar 2,313,530 lekë.

Tabela 1 Përmbledhëse e procedurave të realizuara dhe atyre të audituara (blerje të vogla dhe sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar)

Viti	Procedura realizuara		Procedura të Realizuara të Audituarra		Në përqindje
	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	
Janar-dhjetor 2023	17	4,126,573	9	3,465,019	83,96
Janar -dhjetor 2023/bileta		2,313,530	10	833,830	36
SHUMA		6,440,103	19	4,298,849	66,75

Janë realizuar 5 procedura marrëveshje kuadër (*nga APB*) dhe janë lidhur minikontratrat me MB, për zbatimin e tyre, me vlerë të fondit limit 25,125,324 lekë dhe realizim kontrate në vlerën 20,714,027 lekë, nga të cilat janë përzgjedhur për auditim të zbatimit të kontratës vetëm 4 procedura të trajtuara në seksionin III të këtij akt konstatimi.

I. Nga 17 procedurat e prokurimit “blerje me vlerë të vogël”, u përzgjedhën për auditim, 9 procedura prokurimi me fond limit 5,200,000 lekë dhe realizim në vlerën 3,465,019 lekë, të pasqyruara në tabelën e paraqitur në pikën 2.5.3, seksioni “Anekse”, për vitin 2023.

Në procedurat e prokurimit “blerje me vlerë të vogël”, të cilat u përzgjedhën mbi bazë risku (vlera më e lartë e kontratës së lidhur), u konstatua si më poshtë:

1. Objekti i prokurimit: “Blerje ujë dhe kafe”, fondi i parashikuar është 800,000 Lekë pa Tvsh. Vlera e realizuar është 744,583 Lekë pa Tvsh, për procedurat me objekt:

- “Blerje kafe”, vlera 195,833 lekë pa Tvsh, operatori fitues “C. C.”, sh.p.k; data e zhvillimit të procedurës në sistem 25.01.2023, data e lidhjes së kontratës (nënshkrimit të faturës) 30.01.2023;
- “Blerje ujë”, vlera 229,166 lekë pa Tvsh, operatori fitues “L. I.”, sh. a; data e zhvillimit të procedurës në sistem 25.01.2023, data e lidhjes së kontratës (nënshkrimit të faturës) 30.01.2023;
- “Blerje ujë”, vlera 143,334 lekë pa Tvsh, operatori fitues “L. I.”, sh. a; data e zhvillimit të procedurës në sistem 22.08.2023, data e lidhjes së kontratës 28.08.2023, data e përfundimit të lidhjes së kontratës 31.12.2023;
- “Blerje kafe”, vlera 176,250 lekë pa Tvsh, operatori fitues “C. C.”, sh.p.k; data e zhvillimit të procedurës në sistem 09.10.2023, data e lidhjes së kontratës (nënshkrimit të faturës) 16.10.2023;

Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2023. (Tab 1.1).

2. Objekti i prokurimit: “Materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim”, fondi i parashikuar është 1,000,000 Lekë pa Tvsh; Vlera e realizuar është 764,700 Lekë pa Tvsh, për procedurat me objekt:

- “Blerje materiale pastrimi”, vlera 498,700 lekë pa Tvsh, operatori fitues “Xh.”, sh.p. k, data e zhvillimit të procedurës në sistem 13.03.2023, data e lidhjes së kontratës (nënshkrimit të faturës), 20.03.2023;

“Blerje materiale pastrimi”, vlera 266,000 lekë pa Tvsh, operatori fitues “M. V.”, p.f, data e zhvillimit të procedurës në sistem 18.12.2023, data e lidhjes së kontratës (nënshkrimit të faturës), 22.12.2023. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2023. (Tab 1.2).

3. Objekti i prokurimit: “Sigurimi i godinës së Ministrisë së Brendshme”, fondi i parashikuar është 1,000,000 Lekë pa Tvsh. Vlera e realizuar është 995,500 Lekë pa Tvsh, për procedurat me objekt:

“Sigurimi i godinës së Ministrisë së Brendshme”, operatori fitues “I. V. I. G.”, sh. a, data e zhvillimit të procedurës në sistem 27.04.2023, data e lidhjes së kontratës 01.05.2023, data e përfundimit të lidhjes së kontratës 02.05.2023.

Kontrata e lidhur (polica e sigurimit) nr. 0065575, periudha e sigurimit: 02.05.2023 – 01.05.2024. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2023. (Tab 1.3).

4. Objekti i prokurimit: “Shpenzime për mirëmbajtjen e sistemit të kondicionimit në Ministrinë e Brendshme”. Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE në lidhje me këtë procedurë sipas Urdhrit të prokurimit me nr. 8882/1, datë 22.08.2023 të ish Titullarit të AK, z. E. H., u konstatua se:

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.

Fondi limit i përlogaritur nga Komisioni i prokurimit me vlera të vogla me përbërje (B. K., D. K. dhe M. H.), është 970, 000 lekë pa tvsh.

Është kualifikuar fitues nga KVO, Operatori Ekonomik "S.-K." SHPK, me ofertë ekonomike më të ulët 565,500 lekë pa tvsh nga 2 operatorë të kualifikuar fitues si dhe është s kualifikuar një OE "E. G. C." për tejkalim të fondit limit.

Nga verifikimi i dosjes fizike të operatorit fitues si dhe bazuar në proces verbalin nr. 8882/2, datë 22.08.2023, në seksionin 1/Kritere të veçanta të kualifikimit, Komisioni që përfaqëson AK në pikën 3 kërkon nga OE shprehimisht:

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 1(një) inxhinier elektrik dhe një specialist elektrik të licencuar, të certifikuar nga një institucion i formimit profesional, për të cilët duhet të paraqitet diploma dhe kontrata e punës.

Për sa më sipër, OE "S.-K." SHPK, ka paraqitur respektivisht diplomën dhe kontratën e punës të lidhur me një inxhinier elektrik (F. Y.) si dhe kontratën e punës (01.04.2023) me një elektriciçist (J. A.), i cili nuk figuron i deklaruar në listë pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore vetë subjekti në deklarinimin on -line, për muajin gusht 2023. Pra OE lidh kontrata punësimi dhe nuk bën deklarinimin e këtyre punonjësve në shkelje të detyrimeve kontraktuale si dhe në kundërshtim me Ligjin 9920 dt. 19.05.2008, i ndryshuar "Për procedurat tatimore në RSH".

KVO nuk ka kryer verifikimin e plotësimin të këtyre kritereve të veçanta të cilat janë për të garantuar se OE që do të paraqiten pranë AK, janë të specializuar për ofrimin e shërbimit të kërkuar dhe për rëndësinë e punimeve që do të kryejnë në përputhje me standardet teknologjike, veprime në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, ku citohet se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Sipas LPP, operatorët ekonomik janë të detyruar të paraqesin ofertat e tyre në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor. Është Autoriteti Kontraktor ai që përcakton nevojat për shërbime/mallra/punë dhe operatorët ekonomik ata që paraqesin ofertat në përputhje me këto kërkesa ligjore.

Për më tepër, dhe vetë Operatori Ekonomik në deklaratën e ngarkuar në SPE me titull "Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike..." konfirmon se i përmbush specifikimet teknike të përcaktuara në DT dhe e vërtetojnë këtë me dokumentet e certifikata të dorëzuara bashkë me këtë deklaratë.

Për sa më sipër, duke qenë se operatori ofertues nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të saktë për plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim, Autoriteti ose enti Kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave, në bazë të LPP neni 92/ Shqyrtimi I ofertave, pika 1, 3, si dhe nenit 38 të këtij ligji.

KVO duhet të kishte kërkuar sqarim nga OE për plotësim të dokumentacionit, për të garantuar zbatimin me sukses të kontratës.

Zbatimi i pjesshëm i Kontratës së lidhur nr. 8882/5 Prot, datë 28.08.2023, (data e përfundimit të lidhjes së kontratës 27.08.2024) deri në 31.03.2024.

Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2023. (Tab 1.4).

5. Objekti i prokurimit: “Shërbim riparimi fotokopjesh” vlera 99,984 lekë pa Tvsh, operatori fitues I. Gj. K.” ShPK, data e zhvillimit të procedurës 02.11.2023, numri i faturës 4271/2023; Numri i OE pjesëmarrës 3. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2023. (Tab 1.5).

6. Objekti i prokurimit: “Blerje materiale me logon e Ministrisë së Brendshme” vlera 99,800 Lekë pa Tvsh, operatori fitues “V. K./ Q.” shpk, data e zhvillimit të procedurës 15.02.2023, numri i faturës 04/2023; Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2023. (Tab 1.6).

7. Objekti i prokurimit: “Blerje grila për Ministrinë e Brendshme”, fondi i parashikuar për këtë procedurë është 100,000 Lekë pa Tvsh. Vlera e realizuar është 96,992 Lekë pa Tvsh, për procedurat me objekt:

“Blerje grila për zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm”, vlera 96,992 Lekë pa Tvsh, operatori fitues “A.”, sh.p. k, data e zhvillimit të procedurës 27.02.2023, numri i faturës 441/2023; Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2023. (Tab 1.7).

8. Objekti i prokurimit: “Blerje vegla pune, aksesorë etj.”, fondi i parashikuar është 100,000 Lekë pa Tvsh. Vlera e realizuar është 97,960 Lekë pa Tvsh, për procedurat me objekt: “Blerje vegla pune, aksesorë etj”, vlera 97.960 lekë pa Tvsh, pranë operatorit fitues “Sh.”, ShPK; data e zhvillimit të procedurës 10.02.2023, numri i faturës 05/2023; Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2023. (Tab 1.8).

9. Objekti i prokurimit: “Shërbime lyerje për godinën e Ministrisë së Brendshme”, fondi i parashikuar është 100,000 Lekë pa Tvsh. Vlera e realizuar është 63,771 Lekë pa Tvsh, për procedurat me objekt: “Shërbim lyerje zyrash”, vlera 63.771 lekë pa Tvsh, operatori fitues “A. B.”, person fizik; data e zhvillimit të procedurës në sistem 14.06.2023, data e lidhjes së kontratës 19.06.2023, data e përfundimit të lidhjes së kontratës 26.06.2023; Kontrata e lidhur nr. 6328/6 prot, datë 19.06.2023. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2023. (Tab 1.9).

II. Për vitin 2023, bazuar në të dhënat e regjistrit, janë realizuar disa procedura prokurimi “sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar” me fond limit 5,000,000 lekë pa TVSH dhe vlerë totale të kontratave të realizuara 2,313,530 lekë pa TVSH dhe. Të dhënat për procedurat e përzgjedhura për auditim, janë si më poshtë vijon:

1. Objekti i prokurimit: “Blerje e bileta avioni Tiranë- Bruksel (Belgjikë)-Tiranë”. Urdhër Prokurimi, Nr. 888/3, datë 30.01.2023 data e tenderit 30.01.2023, fituese oferta "D. K.", me vlerë 113,980 lekë pa TVSH, (lidhur kontrata me OE me ofertën më të ulët), pjesëmarrës në tender 4 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2023. (Tab 1.10).

2. Objekti i prokurimit: “Blerje e bileta avioni Tiranë- Gjenevë (Zvicër)-Tiranë”. Urdhër Prokurimi, nr. 11660/5, datë 12.12.2023 data e tenderit 12.12.2023, fituese oferta "A.T.T ", me vlerë 82,000 lekë pa TVSH, (lidhur kontrata me OE me ofertë më të ulët), pjesëmarrës në tender

2 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2023. (Tab 1.11).

3. Objekti i prokurimit: “Blerje e bileta avioni Tiranë- Verona (Itali) dhe Romë (Itali)-Tiranë”. Urdhër Prokurimi, Nr. 109/2, datë 10.01.2023 data e tenderit 10.01.2023, fituese oferta " O.T.T.", me vlerë 132,000 lekë pa TVSH, (*lidhur kontrata me OE i renditur i dyti ne klasifikimin e gjeneruar nga sistemi*), pasi OE “E.T.T” i renditur në vend të parë (*oferta 121,800 lekë*) është tërhequr nga lidhja e kontratës me pretendimin “për shkak të ndryshimit të çmimit”, pjesëmarrës në tender 4 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2023. (Tab 1.12).

4. Objekti i prokurimit: “Blerje e bileta avioni Tiranë- Vjenë (Austri)-Tiranë”. Urdhër Prokurimi, nr.10031/2, datë 04.10.2023 data e tenderit 04.10.2023, fituese oferta "K.T SHPK", me vlerë 56,500 lekë pa TVSH, (*lidhur kontrata me OE i renditur i treti në klasifikimin e gjeneruar nga sistemi*), pasi OE “A.T.T” i renditur në vend të parë (*oferta 51,840 lekë*) është tërhequr nga lidhja e kontratës me pretendimin “nuk i përmbahet dot specifikimeve sipas Ftesës për Ofertë” dhe OE “A. “D.” – V.T.O” i renditur në vend të dytë (*oferta 53,840 lekë*) është tërhequr nga lidhja e kontratës me pretendimin “për shkak të ndryshimit të çmimit të ofertuar”, pjesëmarrës në tender 4 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2023. (Tab 1.13).

5. Objekti i prokurimit “Blerje e bileta avioni Tiranë- Palermo (Itali)- Romë (Itali)-Tiranë”. Urdhër Prokurimi, nr.9495/2, datë 12.09.2023 data e tenderit 12.09.2023, fituese oferta "K.T SHPK", me vlerë 140,300 lekë pa TVSH, (*lidhur kontrata me OE i renditur i treti ne klasifikimin e gjeneruar nga sistemi*), pasi OE “I.T.T” i kualifikuar në vend të parë (*oferta 82,090 lekë*) është tërhequr nga lidhja e kontratës me pretendimin “për shkak të ndryshimit të çmimit të ofertuar” dhe OE “E.T.T” I kualifikuar në vend të dytë (*oferta 95,400 lekë*) është tërhequr nga lidhja e kontratës me pretendimin “për shkak të ndryshimit të çmimit të ofertuar”, pjesëmarrës në tender 4 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2023. (Tab 1.14).

6. Objekti i prokurimit: Blerje e bileta avioni Tiranë - Bukuresht - Tiranë”. Urdhër Prokurimi, nr. 4394/3, datë 12.06.2023 data e tenderit 13.06.2023, fituese oferta " ITT ", me vlerë 69,900 lekë pa TVSH, (*lidhur kontrata me OE me ofertë më të ulët*), pjesëmarrës në tender 7 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2023. (Tab 1.15).

7. Objekti i prokurimit “Blerje e bileta avioni Tiranë – Stokholm - Tiranë”. Urdhër Prokurimi, Nr. 2789/3, datë 16.03.2023 data e tenderit 16.03.2023, fituese oferta “E.T.T”, me vlerë 50,600 lekë pa TVSH, (*lidhur kontrata me OE me ofertë më të ulët*), pjesëmarrës në tender 3 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2023. (Tab 1.16).

8. Objekti i prokurimit “Blerje e bileta avioni Tiranë- Gjenevë-Tiranë”. Urdhër Prokurimi, nr. 5844/5, datë 21.08.2023 data e tenderit 21.08.2023, fituese oferta " A.T.T ", me vlerë 69,200 lekë pa TVSH, (*lidhur kontrata me OE me ofertë më të ulët*), pjesëmarrës në tender 5 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2023. (Tab 1.17).

9. Objekti i prokurimit “Blerje e bileta avioni Tiranë- Bruksel -Tiranë”. Urdhër Prokurimi, nr.10086/2, datë 28.09.2023 data e tenderit 28.09.2023, fituese oferta "A.B.T.O", me vlerë 80,250 lekë pa TVSH, (lidhur kontrata me OE me ofertë më të ulët), pjesëmarrës në tender 3 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2023. (Tab 1.18).

10. Objekti i prokurimit “Blerje e bileta avioni Tiranë- Bruksel - Tiranë”. Urdhër Prokurimi, Nr. 9062/5, datë 25.09.2023 data e tenderit 25.09.2023, fituese oferta “O.T.T. ", me vlerë 39,100 lekë pa TVSH, (lidhur kontrata me OE klasifikuar i dyti me ofertë më të lartë), pasi OE “V. T& T” i kualifikuar në vend të parë (oferta 29,540 lekë) është tërhequr nga lidhja e kontratës me pretendimin “për shkak të ndryshimit të çmimit të ofertuar”, pjesëmarrës në tender 3 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Zbatimi i kontratës sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në pikën 2.5, në seksionin Anekse për vitin 2023. (Tab 1.19).

☞ Vonesë në realizimin e procedurës së prokurimit, nga dalja e akteve administrative të sipërme për miratimin e pjesëmarrësve në event deri në daljen e urdhër prokurimit. Kjo sjell si pasojë blerje të biletave me kosto më të lartë e cila është përgjegjshmërisë menaxheriale e dobët sipas Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 4, pika 9, ku citohet se “përgjegjshmëria menaxheriale është detyrimi i menaxherëve të njëjstive, që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë. Përgjegjshmëria përfshin çështjet që lidhen me ndarjen e detyrave, zhvillimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, të gjitha transaksionet financiare, bashkërendimin me shërbimet qendrore të harmonizimit, si dhe me vlerësimin dhe raportimin për sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Përgjegjshmëria menaxheriale përfshin, gjithashtu, përgjegjësinë për veprimet e kryera”, kompetencë e ish Sekretarit të përgjithshëm Oltjon Muzaka.

☞ Tërheqja e operatorëve ekonomik fitues në fazën e lidhjes së kontratës, me pretendimin se “ka ndryshuar çmimi” me të cilin ka ofertuar. Kjo ka sjellë si pasojë që, kontrata të lidhet me OE të renditur më pas, me një vlerë më të lartë.

☞ Gjithashtu u konstatuan se urdhër shpenzimet me nr. 428, datë 28.12.2023 si dhe 223, datë 14.07.2023, janë kryer me vonesë nga 60 ditë për urdhrin e parë dhe rreth 90 ditë për urdhrin e dytë, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, i ndryshuar, neni 7, germa c/i).

III. Për sa i përket zbatimit të kontratave në lidhje me procedurat e prokurimit “Marrëveshje kuadër”, u verifikuan likuidimi i urdhër-shpenzimeve dhe minikontratat e lidhura për secilën procedurë, trajtuar në tabelën 3:

Tabela 3: Procedurat e prokurimit të llojit “Marrëveshje kuadër:

	Emërtimi i procedurës	Marrëveshje kuadër	Fondi limit	Vlera kontratës	viti	Autoriteti Kontraktor
1	Blerje orendish dhe pajisjesh për	Marrëveshje kuadër	1,000,000	999,100	2023	ABP

	mobilitim zyrash					
2	Blerje tonerë për Ministrinë e Brendshme	Marrëveshje kuadër	2,500,000	1,300,893	2023	ABP
3	Blerje tonerë për DPGJC në Ministrinë e Brendshme	Marrëveshje kuadër	8,550,583	8,550,583	2023	ABP
4	Blerje materiale kancelarie	Marrëveshje kuadër	4,000,000	3,073,251	2023	ABP
	Totali		16,050,583	13,923,827		

1. Në lidhje me procedurën “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilitim zyrash”, me fond limit 1,000,000 lekë dhe vlerë të realizuar të kontratës 999,100 lekë pa tvsh, zbatimi sipas urdhër shpenzimeve, është lidhur kontrata me MB me nr. 53/4 prot, datë 27.02.2023, me datë fillimi 27.02.2023 dhe date përfundimi 10.04.2023, bashkëlidhur formulari i sigurimit të kontratës Nr. 230701218, paraqitet në vijim:

Nr.	Paguar: Urdhër shpenzimi			Faturuar: Fatura			Marrë në dorëzim
	nr.	datë	vlerë	nr.	datë	vlerë	
1	156	11.04.2023	1,198,920	31/2023	07.03.2023	1,198,920	Aparati MB
	SHUMA		1,198,920	SHUMA		1,198,920	

2. Në lidhje me procedurën Blerje tonerë për Ministrinë e Brendshme, me fond limit 2,500,000 lekë dhe vlerë të realizuar të kontratës 1,300,893 lekë pa tvsh, pas përfundimit të procedurës së prokurimit, është lidhur kontrata me MB me nr. 11296/4 prot, datë 01.11.2023, zbatimi sipas urdhër shpenzimeve, paraqitet në vijim:

Nr.	Paguar: Urdhër shpenzimi			Faturuar: Fatura			Marrë në dorëzim
	nr.	datë	vlerë	nr.	datë	vlerë	
1	420	20.12.2023	1,561,072	17550/2023	11.12.2023	1,561,072	Aparati MB
	SHUMA		1,561,072	SHUMA		1,561,072	

3. Në lidhje me procedurën Blerje tonerë për DPGJC në Ministrinë e Brendshme, me fond limit 8,550,583 lekë dhe vlerë të realizuar të kontratës 8,550,583lekë pa tvsh, pas përfundimit të procedurës së prokurimit, është lidhur kontrata me MB me nr. 3256/3 prot, datë 29.08.2023, me datë fillimi 29.08.2023 dhe datë përfundimi 09.09.2023, bashkëlidhur formulari i sigurimit të kontratës Nr. 070014450068119 datë 14.07.2023, zbatimi sipas urdhër shpenzimeve, paraqitet në vijim:

Nr.	Paguar: Urdhër shpenzimi			Faturuar: Fatura			Marrë në dorëzim
	nr.	datë	vlerë	nr.	datë	vlerë	
1	285	26.09.2023	10,260,700	12530/2023	08.09.2023	10,260,700	Aparati MB
	SHUMA		10,260,700	SHUMA		10,260,700	

4. Në lidhje me procedurën **Blerje materiale kancelarie**, me fond limit 4,000,000 lekë dhe vlerë të realizuar të kontratës **3,073,251** lekë pa tvsh, pas përfundimit të procedurës së prokurimit, është lidhur kontrata me MB me nr. 5903/4 prot, datë 20.06.2023 zbatimi sipas urdhër shpenzimeve, paraqitet në vijim:

Nr.	Paguar: Urdhër shpenzimi			Faturuar: Fatura			Marrë në dorëzim
	nr.	datë	vlerë	nr.	datë	vlerë	
1	245	04.08.2023	1,364,461	9537/2023	07.07.2023	1,364,461	Aparati MB
2	246	04.08.2023	2,323,440	9071/2023	29.06.2023	2,323,440	
SHUMA			3,687,901	SHUMA			3,687,901

Sa më sipër arrihet në konkluzion:

☒ Nga auditimi me përzgjedhje mbi bazë risku (referuar kontratës së lidhur me vlerë më të lartë) i procedurave të prokurimit “blerje me vlerë të vogël”, për vitin 2023, u konstatua se:

a. Komisioni i prokurimit të blerjeve të vogla nuk ka kryer me korrektësi verifikimin dhe plotësimin nga OE të kriterëve të veçanta të kualifikimit të vendosura në DST duke mos garantuar zbatimin me sukses të kontratave, veprime në kundërshtim me nenin 82/ Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave të VKM nr. 285, pika 2, ku citohet se: *Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim.*

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së

☒ Nga auditimi me përzgjedhje mbi bazë risku (referuar kontratës së lidhur me vlerë më të lartë) i procedurave të prokurimit “sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar” si gjetje e përbashkët u konstatua:

Blerja e biletave është realizuar në kufijtë e datës së nisjes megjithëse ftesa për pjesëmarrje nga organizatorët e takimit/ aktivitetit është dërguar disa javë para kryerjes së procedurave të prokurimit dhe blerjes së biletave. Kjo ka ardhur si pasojë e miratimit me vonesë të autorizimeve, mbi pjesëmarrjen e përfaqësuesve të MB në këto aktivitete. Një fenomen i tillë sjell si pasojë riskun e blerjes së biletave me çmim më të lartë, kur prokurohet pak ditë para datës së nisjes, krahasuar me çmimet e tregut.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me nenin 8, pika 1, nenin 9, pika 1 dhe nenin 12, pika 3, germa a, të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm”, i ndryshuar.

-Në disa nga rastet e audituara trajtuar në këtë akt konstatim, vihet re tërheqja e operatorëve ekonomik fitues në fazën e lidhjes së kontratës, me pretendimin se “ka ndryshuar çmimi” me të cilin kanë ofertuar, duke sjellë si pasojë që, kontrata të lidhet me OE të renditur më pas, me një vlerë më të lartë. AK, nuk ka raportuar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik për rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik nga procedura, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 30: *Rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik, sipas pikës 6, të këtij neni, raportohen nga autoriteti/enti Kontraktor pranë*

Agjencisë së Prokurimit Publik, me qëllim veprimin nga kjo e fundit, sipas parashikimeve të nenit 78, të LPP-së.

2.6 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm.

Në zbatim të pikës 6 të programit të auditimit “**Nr. 169/1, datë 31.01.2024**” Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm:

Veprimtaria e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme ushtron veprimtarinë audituese referuar ligjit nr.114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016; Kartën e Auditimit të Brendshëm të miratuar nga Ministri i MB me urdhrin nr. 129 datë 01.03.2018; Kodin e Etikës të miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.86 datë 10.12.2015, “Për miratimin e Kodit të etikës së audituesve të brendshëm në sektorin publik”.

Struktura dhe organika e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm (DAB) në Ministrinë e Brendshme sipas urdhrin të Kryeministrit nr.45, datë 09.03.2018 “Për miratimin e strukturës e organikës së Ministrisë së Brendshme”, ka në organikë 8 punonjës nga të cilët: Drejtori dhe 7 specialistë (auditues).

Profili profesional i audituesve është financiar për 4 auditues, administrim biznesi për 2 auditues dhe agrobiznes për një auditues.

Të gjithë specialistët e DAB janë të certifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik. Trajnuesit kanë zhvilluar trajnimin e vazhdueshëm vjetor, të certifikuar nga MF (listuar në faqen zyrtare të MF) sipas kuadrit ligjor e rregullator (Ligjit nr.114, datë 22.10.2015 Neni 20 Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm) .

Organizimi i punës audituese

Ministria e Brendshme ka rreth 58 njësi shpenzuese të cilat janë audituar nga dy njësi audituese.

-Programi buxhetor “Policia e Shtetit” *me 39 njësi shpenzuese auditohet nga 5 auditues në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit* .

-Ndërsa *21 subjekte të tjera* pjesë e pesë programeve buxhetore auditohen nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme me 8 auditues.

Konkretisht DAB auditon:

- ✓ 12 Institucionet e Prefekturave në 12 qarqe,
- ✓ Garda e Republikës,
- ✓ Shtëpia e Pushimit Durrës,
- ✓ Qendra Kombëtare e Pritjes për Azilkërkuesit,
- ✓ Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, Qendra e Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit dhe Aparati i Ministrisë së Brendshme e organizuar me 11 Drejtori ku është i përfshirë dhe programi buxhetor “Shërbimi i Gjendjes Civile”,
- ✓ Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve,
- ✓ Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive dhe Aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara,
- ✓ Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Fondet buxhetore që menaxhohen nga programi buxhetor “Policia e Shtetit” dhe që auditohen nga Sektori i AB në Policinë e Shtetit, zënë rreth 80 % në totalin e fondeve buxhetore që menaxhon MB, ndërkohe që të dhënat për rezultatet e auditimit të këtyre fondeve, si dhe monitorimi e vlerësimi mbi menaxhimin e këtyre fondeve, raportohen dhe ndiqen vetëm nga Drejtuesi i Programit “Policia e Shtetit”.

Për vitin 2021, me urdhrin e Ministrit nr. 336 datë 19.10.2020 (Nr.7492/2 Prot.) “Për auditimin e njësisve shpenzuese të programit buxhetor, “Policia e Shtetit” janë përcaktuar 6 misione auditimi të cilat do të auditoheshin nga audituesit e DAB në MB, edhe pse kjo drejtori ka strukturën e saj të auditimit.

Për vitin 2022, me urdhrin e Ministrit nr.327 datë 19.10.2021 (Nr.5691/6 Prot.) Për auditimin e njësisve shpenzuese “Policia e Shtetit”, janë përzgjedhur 4 misione auditimi të cilat do të auditoheshin nga audituesit e DAB në MB.

Për vitin 2023, me urdhrin e Ministrit nr. 200 datë 17.10.2022 (Nr.9307/1 Prot.) Për auditimin e njësisve shpenzuese “Policia e Shtetit” janë përzgjedhur 8 misione auditimi të cilat do të auditoheshin nga audituesit e DAB në MB.

Lidhur me sa më sipër konstatuam parregullsitë e mëposhtme:

-Referuar VKM Nr. 353 datë 11.05.2016 Pika 4, auditimet në institucionet e varësisë kryhen vetëm në raste të veçanta, por miratimi i një plani vjetor auditimi për tre vite të njëpasnjëshme nuk përbën një rast të veçantë.

-DAB e Ministrisë së Brendshme, për vitet 2021, 2022 dhe 2023 ka planifikuar dhe realizuar auditime për institucionet e varësisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit të cilat janë objekt i auditimit nga një strukturë tjetër audituese (DAB në DPPSH).

-Në Ministrinë e Brendshme mungon për vitet 2021-2023, Komiteti i Auditimit të Brendshëm. Duke qenë se MB është një institucion me shumë institucione varësie, si dhe me dy njësi auditimi të brendshme (NjAB e MB dhe NjAB e DPPSH).

Komiteti i Auditimit të Brendshëm është kërkesë ligjore dhe mungesa e tij nuk është në përputhje me nenin 12 të Ligjit Nr.114 datë 22.20.2015. **Me urdhrin e Ministrit nr. 58 datë 12.03.2024 është ngitur Komiteti i Auditimit të Brendshëm.**

Nga verifikimi dhe krahasimi i planeve strategjike (3 vjeçare) dhe planeve vjetore u konstatua se subjektet e planifikuara për tu audituar sipas viteve të përcaktuar në planet strategjik, për vitin 2022 ndryshonin duke bërë kështu që plani strategjik dhe vjetor mos të ketë një rrjedhë të natyrshme por të ketë shmangie nga plani **në mospërputhje me Manualin e AB, pika 3.4**, ku përcaktohet se:

Lidhjet midis planit strategjik dhe planit vjetor të auditimit të brendshëm duhet të rrjedhin natyrshëm nga planifikimi strategjik i auditimit të brendshëm – ndërsa ky i fundit, rrjedh nga objektivat strategjike të njësisë publike.

Për vitin 2021, në planin strategjik kanë qenë të planifikuara 21 auditime të cilat sipas planit vjetor të auditimeve janë ezauruar të gjitha konform planit strategjik, por kanë ngelur për tu evaduar në 2022 tre auditime, përkatësisht raporti i auditimit në Drejtorinë e Përgjithshme Regullatore të Përputhshmërisë, Drejtoria për Rendin dhe Sigurinë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Në planin vjetor dhe strategjik të drejtorisë së auditimit të brendshëm për periudhën 2021-2023, për vitin 2022 ishte planifikuar auditimi i 22 subjekteve prej të cilave nuk janë audituar në ndryshim nga plani strategjik, përkatësisht: Prefekti i Qarkut Shkodër, Prefekti i Qarkut Korçë, Prefekti i Qarkut Gjirokastër, Shtëpia e Pushimit Durrës, QSHAMT, Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve Bashkëpunëtorë të Drejtësisë, Shërbimi Zjarrëfikës. Pra afërsisht

36% e planit strategjik të auditimeve nuk është përmbushur për vitin 2022. Por me Urdhër Nr.327 datë 19.10.2021 (Nr.5691/6 Prot.), për auditimin e njësive shpenzuese “Policia e Shtetit” janë shtuar 4 misione auditimi. Për vitin 2022 sipas planit strategjik, ishin planifikuar 23 (22 auditime faktike por subjekti Garda e republikës është shënuar dy herë në planin strategjik) auditime por në planin vjetor me tej kanë qenë të planifikuara 21 auditime.

Në planin vjetor të miratuar nga Ministri për vitin 2022 është parashikuar dhe auditimi i Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqëndruara. Pasi është dërguar njoftimi në subjekt për auditim me shkresën Nr.12347/1 Prot. datë 25.11.2022, ASHPP i është drejtuar DA me shkresën nr. 1845/1 datë 02.12.2022 duke kërkuar shtyrjen e auditimit. Ish- Ministri, Z.B. Ç., me Urdhrin Nr. 241 datë 20.12.2022 ka urdhëruar ndryshimin e planit të punës së DA për vitin 2022, duke hequr nga auditimi i përputhshmërisë ASHPP.

Për vitin 2023 nga plani strategjik në planin vjetor ka pasur ndryshime në shtimin e disa auditimeve dhe heqjen nga plani të disa auditimeve të planifikuara, posaçërisht Qendrën

Pika 5 Rishikimi i planeve strategjike dhe vjetor të auditimit të brendshëm

Standardi 2000 – Administrimi i aktivitetit të Auditimit të Brendshëm

Drejtuuesi i auditimit duhet të drejtojë me efektivitet aktivitetin e auditimit të brendshëm, për të siguruar se i shton vlerë organizatës. Për arsye të ndryshme lind nevoja që të rishikohen e të bëhen ndryshime në planet e auditimit të brendshëm të një njësie në rastet kur bëhen auditime në raste të veçanta me urdhër të titullarit. Veprimtaria e auditimit të brendshëm ka si synim të jetë shërbim i dobishëm për menaxhimin e njësisë dhe si rrjedhojë është e rëndësishme që planet e auditimit të brendshëm të ndryshojnë me qëllim që t’u përgjigjen ndryshimeve në njësi. Në kohën që planifikimi është në fazën e diskutimeve me nëpunësit e njësisë, mund të jenë bërë zhvillime të cilat nuk ishin të njohura në kohën që u përgatitën planet.

Kombëtare për Azilkërkuesit dhe Agjencia për Mbështetjen e Qeverisjes Vendore.

Vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm

Në vijim të Urdhrit Nr.502 datë 22.10.2018 (Nr.8438/2 Prot) për miratimin e programit të sigurimit të brendshëm të cilësisë së veprimtarisë audituese, sigurimi i cilësisë së DAB është kryer nga Drejtori i Auditimit duke monitoruar veprimtarinë audituese që në hartimin e programit të punës deri në Raportin Final të Auditimit. Gjithashtu sigurimi i cilësisë në zbatim të Manualit të Auditimit të Brendshëm, arrihet nëpërmjet programit të sigurimit të cilësisë të hartuar e zbatuar nga audituesit e NJAB në MB.

Ndjekja e rekomandimeve

Drejtorja e Auditimit në vitet 2021, 2022 dhe 2023 ka planifikuar auditim për zbatimin e rekomandimeve në secilën nga planet vjetore, duke zbatuar rekomandimin e KLSH të lënë në raportin pararendës të auditimit.

Plani Vjetor dhe Plani Strategjik

Raporti mbi hartimin e Planit Vjetor dhe plani Strategjik së bashku me pasqyrat mbështetëse, për vitin 2021, 2022 dhe 2023 është përcjellë brenda afatit të Ministri dhe Drejtorja e Harmonizimit sipas Manualit të Auditimit të Brendshëm i miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave Nr.100 datë 25.10.2016, Kap. III. “Planifikimi i veprimtarive të auditimit të brendshëm” pika 3.3:

“Afati i përgatitjes dhe miratimit të planit strategjik dhe planit vjetor”, afati i fundit i dërgimit të Planit vjetor dhe Planit strategjik pranë NJQHAB është brenda datës 20.10.2017.

- Për vitin 2021, me urdhrin Nr.7492 datë 19.10.2020, “Për miratimin e planit vjetor të veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2021”, dërguar ne MFE-së me shkresën Nr.7492/4 Prot. datë 19.10.2017 **brenda afatit të përcaktuar në manualin e AB.**

- Për vitin 2022 me urdhrin Nr.5691, datë 19.10.2021, “Për miratimin e planit vjetor të veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2022”, është dërguar ne MFE-së me shkresën Nr. 5691/7 Prot. datë 19.10.2021 **brenda afatit të përcaktuar në manualin e AB.**

- Për vitin 2023, me urdhrin Nr.199, datë 17.10.2022, “Për miratimin e planit vjetor të veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023”, është dërguar në MFE-së me shkresën Nr.9658/4 Prot. datë 17.10.2022 **brenda afatit të përcaktuar në manualin e AB.**

-Për vitin 2024, me urdhrin Nr.9897/2 Prot, datë 19.10.2023, “Për miratimin e planit vjetor të veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2021”, është dërguar në MFE me shkresën Nr. 9897/5 Prot. datë 19.10.2023.

Raportimi i veprimtarisë audituese të Drejtorisë së Auditimit

Raportimi i veprimtarisë vjetore pranë strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit është kryer referuar ligjit nr.114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 14 gërma “ç”, Manuali i Auditimit të Brendshëm i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr.100 datë 25.10.2016, Kap.IV “Kryerja e auditimit të brendshëm, ndjekja e procedurave dhe raportimi e komunikimi i auditimiti” dhe shkresat përkatëse vjetore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Së bashku me paketën raportuese është dërguar edhe pyetësori i vetëvlerësimit të AB.

Raportimi i veprimtarisë audituese për vitin 2021, 2022 dhe 2023 është kryer brenda afatit ligjor, elektronikisht dhe në mënyrë shkresore:

-Për veprimtarinë e vitit 2021, me shkresën nr.291/1 datë 15.2.2022,

-për veprimtarinë e vitit 2022, me shkresën nr.875/1 datë 14.2.2023,

-për veprimtarinë e vitit 2023, me shkresën nr.1657/1 datë 12.02.2024.

Veprimtaria audituese

Për vitin 2021, sipas planit vjetor të azhurnuar dhe të miratuar nga Ministri, janë planifikuar gjithsej 19 auditime nga të cilat 15 auditime të kombinuara; dy auditime përputhshmërie dhe dy auditime performance, nga këto (13 auditime në njësitë e varësisë së MB dhe 6 auditime në programin buxhetor “Policia e Shtetit”) dhe 1 (një) *auditim*, për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lënë në auditimet e mëparshme të realizuara nga DA. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021 është realizuar plani vjetor i vitit 2021, janë evaduar përfundimisht 16 auditime dhe janë në proces tre auditime të cilat kanë filluar së audituari në muajin Dhjetor 2021 por përfundimi dhe evadimi i tyre është përfunduar në 2022.

Gjithashtu për këtë periudhë janë raportuar edhe 2 misione auditimi të planit vjetor të vitit të mëparshëm (2020), të nisura si angazhime në muajin Dhjetor 2020 por të evaduara në fillim të vitit 2021. Në total raportohen nepërmjet evidencave bashkëlidhur raportit, gjithsej 18 subjekte të evaduara gjatë periudhës objekt raportimi.

Nga raportet e auditimit të evaduara për vitin 2021 kanë rezultuar gjithsej 209 gjetje nga të cilat 12 shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik në vlerën 9,367.000 lekë. Gjetjet konsistojnë në; *sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, sistemin e administrimit të pronave, pasurisë e kontabilitet, sistemin e kreditime subvencione, sistemin e*

prokurimeve, sistemin e administrimit të buxhetit dhe likuiditeteve, sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore, paga shpërblime, sigurime etj.

Në përfundim të auditimeve, nga Drejtoria e Auditimit në MB janë dhënë rekomandime në varësi të gjetjeve, gjithsej 209 rekomandime me prioritet kryesisht të lartë e të mesëm nga të cilat **137 me prioritet të lartë**, 69 me prioritet të mesëm dhe 3 rekomandime me prioritet të ulët.

Për vitin 2022 kanë qënë të planifikuara për t'u audituar gjithsej 21 auditime si më poshtë: *shtatë auditime* në njësitë e programit buxhetor “Planifikim Menaxhimi” në MB; *shtatë auditime* në njësitë e programit buxhetor “Prefekturat dhe Funkcionet e Deleguara”; *katër auditime* në njësitë e programit buxhetor “Policia e Shtetit”; *dy auditime* në programet buxhetor “Gjendja Civile”, “Garda e Republikës” dhe *një auditim*, për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lënë në auditimet e mëparshme të realizuara nga DA .

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 është realizuar plani vjetor i vitit 2022, i ndryshuar. Janë evaduar përfundimisht *17 auditime* dhe janë në proces *tre auditime* të cilat kanë filluar si misionë auditimi në muajin Dhjetor 2022, evadimi i tyre ishte në proces dhe du raportuan në raportin e radhës për vitin 2023 (*IKMT, Garda e Republikës, Gjendja Civile*).

Gjithashtu për këtë periudhë raportohen edhe *3 auditime* të planit vjetor të vitit të mëparshëm (2021), të nisura si angazhime në muajin Dhjetor 2021 por të evaduara në fillim të vitit 2022. Në total raportohen nepërmjet evidencave bashkëlidhur raportit, gjithsej *20 auditime* të evaduara gjatë periudhës objekt raportimi.

Nga raportet e auditimit të evaduara për për vitin 2022 kanë rezultuar gjithsej 157 gjetje nga të cilat 7 gjetje shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik në vlerën 9.636 lekë. Gjetjet më kryesore gjatë këtyre auditimeve janë evidentuar në :

- *Sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, kontroll i brendshëm jo eficientë, mungesë të sistemit të kontrollit të brendshëm në sisteme dhe fusha me risk të lartë, janë identifikuar nevojat për përmirësimin e procedurave të shkruara dhe akteve normative.*
- *Sistemin e administrimit të pronave, inventarizimin dhe rregjistrimin e tyre në hipotekë.*
- *Administrimin dhe dokumentimin e shpenzimeve të likujdura për energjinë elektrike dhe transportin, mangësi në plotësimin e dokumentacionit të plotë justifikues dhe kryerjen në kohë të këtyre pagesave .*
- *Mbajtjen e kontabilitetit, mbylljen e llogarive vjetore dhe hartimin e pasqyrave financiare.*
- *Shlyerjen e detyrimeve të prapambetura .*
- *Sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore, paga shpërblime, sigurime etj.*
- *Mosndjekjen, zbatimin dhe raportimin periodikisht nga ana e njërive të audituara të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme .*

Në përfundim të auditimeve, nga Drejtoria e Auditimit në MB janë dhënë rekomandime në varësi të gjetjeve, gjithsej **160 rekomandime** nga të cilat **96 rekomandime me prioritet të lartë**; 62 rekomandime me prioritet të mesëm dhe 2 rekomandime me prioritet të ulët.

Për vitin 2023, sipas planit të auditimit miratuar me urdhrat e Ministrit : nr.199, datë 17.10.2022 “Për auditimin e brendshëm në strukturat e Ministrisë së Brendshme për vitin 2023”; nr.200, datë 17.10.2022 “Për auditimin e njërive shpenzuese të programit buxhetor, “Policia e Shtetit” për vitin 2023”, vlerësuar sipas nivelit të riskut, kanë qënë të planifikuara për t'u realizuar gjithsej 20 auditime (17 auditime të kombinuara (financiar-përputhshmërie) dhe tre auditime përputhshmërie) si në vijim : **5** auditime në njësitë e programit buxhetor “Planifikim Menaxhimi” në MB; 1 auditim në Gardën e Republikës, vlerësuar me risk të lartë për shkak të kompleksitetin; 1 auditim në Shoqërinë Shtetërore e Policisë “Ilirian Guard” vlerësuar me risk të

lartë; **3** Auditime në njësitë e programit buxhetor “Prefekturat dhe Funkcionet e Deleguara”- *Prefekturën Shkodër, Prefekturën Korçë, Prefekturën Gjirokastrë*; **1** auditim në Drejtorinë e Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, rekomanduar edhe nga KLSH; **8** auditime (me urdhër të veçantë të Ministrit), në programin buxhetor “Policia e Shtetit” dhe *një auditim*, për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lënë në auditimet e mëparshme të realizuara nga DA.

Përgjatë vitit 2023, nuk ka pasur ndryshime në planin vjetor të miratuar dhe gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 është realizuar plani vjetor. Janë evaduar përfundimisht *17 auditime* dhe janë në proces *tre auditime* të cilat kanë filluar si misione auditimi në muajin Dhjetor 2023, përfundimi dhe evadimi i tyre është në proces dhe do raportohen të përfunduara në raportin e radhës për vitin 2024 (*Garda e Republikës; Aparati Drejtorial e Përgjithshme e Policisë; Aparati Ministria e Brendshme*). Gjithashtu në 2023 janë raportuar edhe *3 auditime* të planit vjetor të vitit të mëparshëm (2022), të nisura si angazhime në muajin Dhjetor 2022 por të evaduar në fillim të vitit 2023. Në total raportohen nëpërmjet evidencave bashkëlidhur raportit, gjithsej *20 auditime* të evaduara gjatë vitit 2023.

Nga raportet e auditimit të evaduara për vitin 2023 kanë rezultuar gjithsej 183 gjetje nga të cilat 5 gjetje shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik në vlerën 13.197 mijë lekë.

Gjetjet më kryesore gjatë këtyre auditimeve janë evidentuar në :

- *Sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, kontrolli i brendshëm jo eficientë, mungesë të sistemit të kontrollit të brendshëm në sisteme dhe fusha me risk të lartë, janë identifikuar nevojat për përmirësimin e procedurave të shkruara dhe akteve normative;*

-*Mos-zbatimin sa e si duhet të bazës ligjore në fushën e prokurimeve; ndjekja dhe zbatimi i kushteve të kontratës;*

- *Sistemin e administrimit të pronave, inventarizimin dhe regjistrimin e tyre në hipotekë;*

-*Administrimin dhe dokumentimin e shpenzimeve të likuiduara për energjinë elektrike dhe transportin, mangësi në plotësimin e dokumentacionit të plotë justifikues dhe kryerjen në kohë të këtyre pagesave;*

-*Mungesë të të ardhurave, lidhur me mos- arkëtimin e gjobave të policisë rrugore, gjobave të IKMT-së etj;*

-*Mbajtjen e kontabilitetit, mbylljen e llogarive vjetore dhe hartimin e pasqyrave financiare.*

-*Shlyerjen e detyrimeve të prapambetura;*

- *Sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore, paga shpërblime, sigurime etj.*

-*Mos ndjekjen, zbatimin dhe raportimit periodikisht nga ana e njërive të audituara të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme .*

Në përfundim të auditimeve, nga Drejtoria e Auditimit në MB janë dhënë rekomandime në varësi të gjetjeve, gjithsej 183 rekomandime nga të cilat **121 rekomandime me prioritet të lartë**; 59 rekomandime me prioritet të mesëm dhe 3 rekomandime me prioritet të ulët.

Auditimi me zgjedhje i 8 dosjeve të auditimit:

Nga auditimi i grupit të KLSH për vitin 2021,2022 dhe 2023 janë audituar 8 dosje të realizuara auditimi subjekte te DA në MB. Përkatësisht:

1. Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara (Periudha 01.04.2021-30.03.2023)
2. Illyrian Guard (Periudha Prill 2019-30.04.2021)
3. Drejtoria e Përgjithshme e Politikave për Rendin dhe Sigurinë Publike Nësia IPA (Për vitin 2021)

4. Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Brendshme (Për vitin 2022)
5. Qendra e Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit Tiranë (Për vitin 2021)
6. Aparati i Policisë së Përgjithshme të Shtetit (Periudha 01.07.2021-01.07.2022)
7. IKMT (Periudha 01.12.2022-31.10.2023)
8. IKMT (Periudha 10.10.2021-30.11.2022)

Rezulton se dosjet nga ana dokumentimit administrativ janë korrekte, pra nuk ka pasur mangësi në plotësimin e kërkesave që janë të parashikuara në Manualin e Auditimit të brendshëm të miratuar nga Ministri i financave dhe Udhëzimi Nr. 12, datë 05.06. 2012 “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve për çdo subjekt, gjatë auditimit të dosjeve u konstatua si në tabelën më poshtë vijon:

Tabela 1

Subjekti i Auditit të Brendshëm	Rekomandime total	Të zbatuara	Në proces	Pjesërisht të zbatuara	Të pazbatuara
Drejtoria e Përgjithshme e Politikave për Rendin dhe Sigurinë Publike Njësia IPA (Për vitin 2021)	3	2	1	0	0
Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse (Për vitin 2022)	33	14	5	0	14
Qendra e Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit Tiranë (Për vitin 2021)	22	6	16	0	0
Aparati i Policisë së Përgjithshme të Shtetit (Periudha 01.07.2021-01.07.2022)					
1.Sektori i Prokurimeve	17	12	1	0	4
2.Drejtimi i Menaxhimit dhe Kontrollit Financiar	19	7	4	2	6
3.Investimet e Huaja dhe Financimet	11	2	1	1	7
IKMT (Periudha 10.10.2021-30.11.2022)	19	5	11	0	3
IKMT (Periudha 01.12.2022-31.10.2023)	6	1	4	0	1
Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara Periudha (01.04.2021-30.03.2023)					
Illyrian Guard Periudha (Prill 2019-30.04.2021)					
Realizimi i zbatimit të rekomandimeve	Total 130	~38 %	~33 %	~2 %	~27 %

Konkluzion:

Siç paraqitet në tabelën 1, nga 130 rekomandime të lëna për 6 subjekte, ~38 % e tyre rezultojnë të zbatuara, ~33 % janë në proces, ~2 % pjesërisht të zbatuara dhe ~27 % të pazbatuara. *Pra duke analizuar shifrat sa më sipër, rezulton se numri i rekomandimeve të lëna nga AB por të pazbatuara dhe pjesërisht të zbatuara është rreth 29 % dhe i atyre në proces 33%.*

Nga verifikimi dhe krahasimi i planeve strategjike (3 vjeçare) dhe planeve vjetore u konstatua se subjektet e planifikuara për tu audituar sipas viteve të përcaktuara në planet strategjike, ndryshonin nga një vit në tjetrin duke bërë që plani strategjik dhe vjetor mos të ketë një rrjedhë të natyrshme por ndryshim të tij në mospërputhje me Manualin e AB, pika 3.4. Në planin vjetor dhe strategjik të drejtorisë së auditimit të brendshëm për periudhën 2021-2023, për vitin 2022 ishte planifikuar auditimi i 22 subjekteve të cilat nuk janë audituar konform këtij plani strategjik, pasi me Urdhër Nr.327 datë 19.10.2021 (Nr.5691/6 Prot.), janë shtuar 4 misione auditimi për njësitë shpenzuese “Policia e Shtetit”.

Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

1. Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit

Referuar legjislacionit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, Ligjit Nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, “Mjedisi i kontrollit” është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit. Vlerësimi i Mjedisit të kontrollit bazohet në komponentët si më poshtë:

Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike;

Titullari i njësisë publike dhe të gjithë anëtarët e stafit duhet të udhëhiqen nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe në kryerjen e detyrave të tyre. Sipas përcaktimeve të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave Nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar, në Kapitullin III, pika 3.1 përcaktohet se:

‘Kudri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësisë publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje’.

Gjithashtu, edhe në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, intsitucionet duhet të hartojnë kod etike. Për sa më sipër, rezulton se Ministria e Brendshme nuk ka një Kod Etike por rregullat e etikës i ka përfshirë shkurtimisht në rregulloren e saj të brendshme, konkretisht në kreun VII. Punonjësit duhet ti referohen edhe ligjit “Për Rregullat e Etikës” që në momentin e punësimit dhe në zbatim të këtij ligji ka dalë dhe Urdhri i Ministrit nr. 5, datë 15.01.2014 “Per komunikimin elektronik dhe etiken e punonjësve të Ministrisë së Brendshme dhe institucioneve të varësisë” si dhe Urdhri i Ministrit nr. 344, datë 24.11.2014 “Per miratimin e rregullores për parandalimin e konfliktit të interesave”, i ndryshuar.

Rezulton se shkeljet trajtohen sipas procedurave të parashikuara në Kreun X të Ligjit 152/2013, i ndryshuar, Vendimin Nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", si dhe Udhëzimin nr.1, datë 02.04.2014 "Për elementët kryesore proceduriale dhe materiale të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore", të Departamentit të Administratës Publike.

2. Politikat menaxheriale dhe stilin e punës;

Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit reflektojnë pikëpamjet kryesore të drejtuesit rreth mënyrës se si duhen organizuar punonjësit dhe aktivitetet e një njësie. Çdo drejtues ka një filozofi dhe një stil pune të veçantë, nëpërmjet të cilit menaxhon punonjësit, demonstroi dhe nxiti kompetencën dhe sjelljen etike. Qasja ndaj punës dhe ngritja e sistemeve, zakonisht paraqiten në një strategji institucionale. Në Kreun 2 Përgjegjshmëria menaxheriale, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, Neni 8 Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit, përcakton detyrimet ligjore të titullarit të institucionit ku në kuadër të drejtimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, këto të fundit konsistojnë në :

Neni 8. *Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të planveprimeve për arritjen e objektivave; b) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, në përputhje me **kërkesat e nenit 27 të këtij ligji**; c) miratimin e sistemeve të menaxhimit të informacionit; ç) miratimin e sistemit të rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministri i Financave; d) propozimin e një strukture të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësive të tyre, përveç rasteve kur legjislacioni i posaçëm parashikon ndryshe etj*

Neni 27 *Takime periodike ndërmjet menaxherëve të njësisë publike ‘Grupi për menaxhimin strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendëstitullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë. Kreu i auditimit të brendshëm merr pjesë në mbledhjet e grupit për menaxhimin strategjik pa të drejtë vendimmarrjeje. Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë publike. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë i parashirohen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave’.*

Neni i mësipërm referon në nenin 27 të po të njëjtit ligj i cili shprehet se:

Me 11.04.2018 me Urdhër të Ministrit të Brendshëm nr.224 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik aktual, i cili duke qenë se në formulimin e tij ka të listuara funksionet përkatëse të anëtarëve të GMS,dhe jo funksionarët (emrat përkatës) nuk ka ndryshuar në vitet objekt auditimi. Në Udhëzimin Nr.16, datë 20.07.2016 ‘Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike’, lidhur me rolin e GMS në sistemin e MFK, përcaktohet se ‘GMS duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike’. Për sa më sipër, për periudhën 2021, 2022 dhe 2023 në baze të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti rezultoi se nuk ka asnjë mbledhje të GMS të dokumentuar konform procedurave administrative të kërkuara, pra as njoftim për thirrje të mbledhjes dhe as procesverbal (minutat përkatëse të mbledhjes, veprime në kundërshtim me dispozitat ligjore të ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010.

Referuar ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, pika 4, germa “a” Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore:

- a) *propozimin te nëpunësi autorizues i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe*

monitorimin e zbatimit të tyre në njësi; dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. IV “Zbatimi i MFK”, pika, 4.2.10 “Roli i nëpunësit autorizues të njësisë”, germa a, Ministria e Brendshme ka hartuar dhe propozuar një plan strategjik i cili përmban objektivat afatmesëm dhe vjetore prioritetare të institucionit si dhe ka përgatitur planet e masave dhe veprimet në mënyrë që të monitorojë zbatimin e tyre.

Lidhur me nëpunësin zbatues rezulton se në vitet objekt auditimi ka qenë z. V. H. i cili mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar. Sipas ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, citohet se:

Nëpunësi zbatues i njësisë publike është përgjegjës dhe i raporton nëpunësit autorizues të njësisë publike për garantimin e cilësisë së: a) dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe bashkëredimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të njësisë publike, në rolin e sekretarit të grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike; b) raportimit periodik për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, si dhe të pasqyrave financiare vjetore të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e miratuara nga Ministri i Financave.

Sikurse e kemi trajtuar edhe në pikën 2, të programit të auditimit por lënë edhe në konstatimet e mëparshme të auditimit të KLSH-së, rekomandim i pa zbatuar, është rikonstatuar se, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar nuk ka varësi direkte nga Nëpunësi Autorizues, por ka varësi nën Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse duke cenuar varësinë e marrëdhënies të Nëpunësit Zbatues ndaj Nëpunësit Autorizues të njësisë publike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 12, pika 1, Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 44, Ligjin Nr. 90/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore”, neni 16. Në këto kushte, NZ, duhet të kontrollojë, monitorojë dhe raportojë mbi punën e tij, tek Z. A. M./ DP i DEFM, kur në fakt duhet të raportojë tek NA, SP i Ministrisë.

Punonjësit e Ministrisë së Brendshme, marrëdhëniet e punës me punëdhënësin i rregullojnë në bazë të ligjit mbi nëpunësin civil. Titullari i institucionit, në rast të shkeljes së normave ligjore apo, të rregullave ka të drejtë të ndërmarrë hapat e duhura, duke propozuar masa disiplinore dhe administrative për punonjësit, deri në largim nga puna.

Sa i përket delegimit të kompetencave, në Ministri të Brendshme delegimi i kompetencave apo detyrave bëhet sipas përcaktimeve në rregulloren e brendshme, në përputhje me rregullat dhe procedurën e përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative.

3. Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;

Gjatë vitete 2021-2023 Ministria e Brendshme është ristrukturuar 2 herë por ka funksionuar me rregulloren e vitit 2019, duke mos përditësuar rregulloren sipas çdo ndryshimi të strukturës. Deri në fillim të vitit 2021 Ministria e Brendshme ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit me nr. 16, dt. 28.07.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Brendshme”, me 172 punonjës.⁶

Gjithashtu nga miratimi i strukturës aktuale me urdhrin e Kryeministrit me Nr. 16, dt. 28.07.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Brendshme”, rregullorja është nxjerrë dhe miratuar 9 muaj me vonë nga miratimi i strukturës dhe organikës së Ministrisë Urdhri Nr. 3778/1 Prot., datë 05.04.2023, me Nr. 42, dt. 05.04.2023 “Për miratimin e rregullores

⁶ Trajtuar ndryshimi i strukturës dhe drejtorive përkatëse në drejtimin 2, të këtij RPA.

së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Brendshme”, e cila është në funksion edhe sot.

Me 2 ristrukturimet e periudhës 2021-2023 numri i përgjithshëm i punonjësve është shtuar vetëm me 1(një) por përveç ristrukturimeve në nivel drejtorish së përgjithshme, specialistësh dhe përgjegjës sektorësh struktura aktuale ka ndryshime dhe në emërtimin e disa drejtorive të përgjithshme apo sektorëve në krahasim me strukturën e vitit 2021. Ndryshim tjetër i rëndësishëm është krijimi i një drejtorie të re 1 Drejtori e Përgjithshme, (Drejtoria e Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve) e përbërë nga 2 sektorë, 1 Drejtori, Qendra e ekselencës dhe një sërë pozicionesh pune të reja të shtuara sipas saj.

Në institucion janë përcaktuar nëpunësi autorizues (NA) në përputhje me kërkesat e Nenit 12/1, “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues” të ligjit nr.10296, datë 08. 07. 2010, të ndryshuar. Sipas shkresës Nr. 17873/1 Prot. 06.10.2020 në pozicionin e Nënpunësit Autorizues është emëruar zj. E. P. dhe në 28.09.2022 me shkresën Nr.17159/1 Prot. është ndryshuar NA dhe është vendosur Z. E. H. Me shkresën Nr. 20911/1 Prot. datë 24.11.2023 është ndryshuar Nënpunësi Autorizues i Ministrisë së Brendshme duke u vendosur z. B. B.

Rolin e Nënpunësit Zbatues e mban që prej mbi 10 vjetësh Z. V. H. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe me shkresën e MB drejtuar Ministrisë së Fianacave dhe Ekonomisë, Shkresa me Nr.7372/5 Prot datë 16.12.2019 është konfirmuar Z. V.H si NZ.

Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;

Politikat e burimeve njerëzore dhe praktikat e ngjashme lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, avancimin në detyrë dhe veprimet disiplinore. Ato përbëjnë një pjesë të rëndësishme të kontrollit të brendshëm.

Në rregulloren e brendshme të institucionit, ky institucion ka përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, shkeljet disiplinore, hyrjen dhe qëndrimin në mjediset e punës etj. Për pozicionet vakante, pjese të shërbimit civil, aplikohen kriteret dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin për shërbimin civil, ndërsa për vendet vakante jo të shërbimit civil shapllja behet në faqen zyrtare të Ministrise dhe të Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Gjithashtu për periudhën objekt auditimi vitet 2021/2022/2023 u verifikua nëse është kryer vlerësimi periodik i rezultateve individuale në punë dhe a janë të bashkëlidhura në dosjet e nëpunësive. Vlerësimi i fundit periodik është ai i periudhës qershor - dhjetor të vitit 2023.

Bëhen trajnime të vazhdueshme për ngritjen e nivelit profesional nga Shkolla e Administratës Publike si dhe trajnime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit por kontatohet se për vitet objekt auditimi nuk ka patur një program strategjik dhe vjetor të trajnimeve të shpallur nga institucioni.

Për periudhën 2021- 2023 është proceduar duke iu përcjellë nëpunësve civilë programet e trajnimeve të formimit të vazhdueshëm me modulet përkatëse që janë dërguar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike. Nevojat e stafit janë konsideruar përmes plotësimit të pyetësorëve elektronik mbi vlerësimin e nevojave për trajnim të dërguara nga ASPA.

4. Menaxhimi i riskut.

Menaxhimi i riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut. Pas planifikimit të fondeve buxhetore institucionit analizon dhe bën kontrollin e risqeve hap pas hapi të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore dhe ka hartuar regjistrin e risqeve por, në kundërshtim me nenin 8, pika 8/a të ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, ku përcaktohet se ‘*Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të*

planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arriten e objektivave’, dhe nenit 21, pika 2: “Menaxhimi i riskut”: ku percaktohet : “Për t’i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike (ose duke deleguar këtë detyrë), miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet, ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, rezulton se Ministria e Brendshme nuk ka hartuar një strategji për menaxhimin e riskut deri në 21.01.2022.

Me Urdhër Nr.12 datë 21.01.2022 është miratuar plani i integritetit dhe plani i veprimit 2022-2024 në të cilin përfshihet dhe strategjia për menaxhimin e riskut si kapitull më vete. Referuar periudhës 2021-2023, MB ka hartuar regjistrat e riskut, ka plotësuar pyetësin mbi MFK sipas komponentëve, gjithashtu për secilin vit është hartuar dhe plani i masave për çdo fushë të identifikuar me mangësi, por ajo që konstatohet është që për çdo element të evidentuar dhe masën përkatëse, kjo e fundit çdo vit rezulton në proces dhe jo e përfunduar. Pra masat të cilat janë marrë në kuadër të planit të masave për fushat e evidentuara me mangësi, nuk janë të përfunduara, por në proces.

5. Aktivitetet e kontrollit.

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synin arritjen e objektivave dhe të misionit të saj, që është hartimi, zbatimi dhe zbrëthimi i strategjive dhe politikave të punëve të brendshme, në përputhje me programin politik të Qeverisë duke i shërbyer interesit publik me paanësi, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, duke kryer shërbimet publike dhe duke hartuar e zbatuar politikat e përgjithshme shtetërore në fushën e punëve të brendshme. Në vendosjen e aktiviteteve të kontrollit, titullarët e njësisë duhet të marrin parasysh përfitimi që pritët prej tyre si dhe kostot për futjen dhe zbatimin e tyre. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen në proceset dhe sitemet mbi të cilat funksionon institucioni, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Proceset kryesore të punës dhe funksionet administrative e nënpunësit civil janë të shkruara në rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit dhe në strukturën organike dhe dinamika e tyre duhet të shoqërohet edhe me dinamikën e mekanizmave të kontrollit.

Nëpunësi autorizues në bazë të ligjit për buxhetin merr përsipër angazhimet për realizimin e programit buxhetor. Në funksion të kontroleve parandaluese është kryer ndarja e detyrave, në lidhje me kryerjen e transaksioneve financiare, është përdorur sistemi me dy firma.

Në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 16, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III “Procesi i implementimit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.2 “Cikli i MFK-se”, Hapi 5 “Gjurmët e auditimit”, njësia ka hartuar gjurmët e auditimit që ka si qëllim, të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet, etj.

Për regjistrimin dhe sigurimin e të dhënave kontabël, njësia megjithëse ka instaluar programin “Financa 5”, nga Sektori i Financës për përpunimin e të dhënave përdoret programi “Exel” ndërsa “Financa 5” përdoret vetëm për magazinën.

6. Informimi dhe komunikimi

Shkëmbimi i informacionit ndërmjet punonjësve të institucionit si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht kryhet sipas rregullores së Ministrisë, por në këtë rregullore të brendshme parashikohen kanalet dhe mënyra periodike e raportimit për Sekretarin e Përgjithshëm dhe Drejtorët e Përgjithshëm.

Informacioni dhe komunikimi lidhen gjithashtu edhe me teknologjinë e informacionit dhe zbatimin e rregullave të tyre për gjenerimin, përpunimin, përdorimin dhe ruajtjen e informacionit

dhe në Ministrinë e Brendshme ato bëhen sipas standardeve dhe rregulloreve të AKSHI-t. Komunikimi elektronik bëhet sipas Urdhri i Ministrit nr. 5, datë 15.01.2014 “Per komunikimin elektronik dhe etiken e punonjësve të Ministrisë së Brendshme dhe institucioneve të varësisë” por nuk ka asnjë rregullore të përditësuar në kuadër të strategjisë ndërsektoriale për “Agjendën Digjitale të Shqipërisë” miratuar me vendim nr. 370, datë 1.6.2022, kjo edhe në ambientin e riskuar nga sulmet kibernetike. Në MB funksionon Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit si dhe përdorimi i email-t është një rrugë e mundshme për të kërkuar apo shkëmbyer informacion me të gjitha institucionet e varësisë.

Nga kërkimi i ndërveprimit të tij me qytetarët, konstatohet se në faqen ëeb pasqyrohet programi i transparencës, në përmbushje të ligjit nr. 119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’ ku në nenin 4 përcaktohet se:

Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni.

Gjithashtu është i pasqyruar koordinatori për të drejtën e informimit.

Në ëeb, pasqyrohet regjistri me kërkesat dhe përgjigjet e qytetarëve, në përmbushje me këtë ligj ku në nenin 8 përcaktohet se ‘*Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuësve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër*’.

7. Monitorimi

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur. Titullarët e njësisve publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë.

Me qëllim monitorimin e institucioneve të varësisë, në nenin 9 pika 3 e ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se ‘*Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisve të varësisë janë përgjegjës dhe raportojnë sipas shkallës hierarkike, deri te nëpunësi autorizues i njësisë publike, për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose risqe, të cilat nuk janë adresuar nga njësia, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë që drejtojnë*’. Për të realizuar këtë detyrim, nëpunësi autorizues i njësisë publike ka zbatuar një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga të gjitha njësitë e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas ligjit.

Monitorimi kryhet nëpërmjet monitorimit dhe performancës financiare të shpenzimeve të buxhetit, analizave të zbatimit të buxhetit nga Drejtuesit e Programeve, Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar çdo muaj, katërmujor dhe vjetor apo sa herë të lind nevoja, që titullari kërkon nga menaxherët e drejtorive, njësitë e varësisë të MB-së. Monitorimi i buxhetit faktik është raportuar çdo katër muaj dhe në fund të vitit në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financës. Nga auditimi konstatohet se në vijim të përcaktimit në pikën 23/1 të nenit 4 të Ligjit Nr. 10 296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin: “Nëpunës autorizues i nivelit të dytë” dhe /ose të niveleve të tjera, janë nëpunës të administratës publike në secilën nga njësitë e vartëse, me buxhet më vite

të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të tyre, që përgjigjet përpara nëpunësit autorizues...”, për periudhën objekt auditimi janë hartuar raportet e monitorimit 4-8-12 mujore të konsoliduara të buxhetit të Ministrisë së Brendshme, por institucionet e varësisë, dhe Ministria e Brendshme si institucion buxhetor më vete, nuk kanë hartuar raportet 4 mujore të monitorimit të buxhetit, veprime në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III të 41.2 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”.

Monitorimi i sistemit të MFK nga titullari realizohet nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm, sikurse paqaritet në Shtojcën 2 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Duke ju përgjigjur pyetjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit, institucioni bën vlerësimin e zhvillimit të komponentëve të veçantë të kontrollit të brendshëm, ku çdo përgjigje me jo tregon se ka mangësi dhe duhen marrë masat për përmirësime. Për periudhën nën auditim, nga shqyrtimi i plotësimit të pyetësorëve të vetëvlerësimit rezulton se është plotësuar në zbatim të formatit të miratuar pjesë e Manualit për MFK, aneksi 6 kërkesat e kapitullit V siç cilësohet në Kapitullin III, Hapi III, kreu “Procesi i Implementimit të MFK” dhe kreun V, të Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Titullarit të Financave Nr. 54, datë 15.7.2010, i ndryshuar.

Në nenin 18 pika 1 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se *‘Nëpunësi autorizues i njësisë publike, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual’*. Për sa më sipër, Ministria e Brendshme, në bazë të ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me ndryshime, ka hartuar deklaratën dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2021,2022 dhe 2023, dhe një kopje i është dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresat Nr. 10026/12 Prot., datë 28.02.2022 “Dërgohet pyetsori i vetvlerësimit, deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë dhe funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2021 për Ministrinë e Brendshme” dhe Nr. 13034/10 Prot., datë 28.02.2023 “Dërgohet pyetsori i vetvlerësimit, deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë dhe funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2022 për Ministrinë e Brendshme”, dhe Nr. 18070/9 Prot., datë 29.02.2024 “Dërgohet pyetsori i vetvlerësimit, deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë dhe funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2023 për Ministrinë e Brendshme”. Për të tre vitet këto dokumenta janë dërguar brenda afatit të caktuar në ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i cili është jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual. Për të realizuar këtë detyrim, nëpunësi autorizues i njësisë publike ka zbatuar një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga të gjitha njësitë e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas ligjit.

Raportet janë hartuar në bazë të formatit të përkthyer në Shtojcën 2 të Udhëzimit të Titullarit të Financave nr. 28, datë 15.12.2011.

Përveç monitorimit të vazhdueshëm titullari i MB-së dhe nëpunësi autorizues përdor edhe auditin e brendshëm të njësisë. Ligji për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, garanton objektivitetin dhe pavarësinë e Sektorit të Auditimit të Brendshëm në MB. Në bazë të ligjit dhe Urdhrave të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së MB”, Drejtoria e Auditit varet dhe raporton direkt tek titullari i njësisë.

Konkluzion:

Nga auditimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se: Për periudhën në auditim nuk është thirrur dhe kryer asnjë mbledhje e Grupit të menaxhimit Strategjik, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 ‘Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike’, lidhur me rolin e GMS në sistemin e MFK.

Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimeve për punonjësit e Institucionit për ngritjen e nivelit profesional, ku të përcaktohen përparësitë si dhe nevojat më të mëdha në llojin e temave të përzgjedhura për trajnim.

Për periudhën objekt auditimi janë hartuar raportet e monitorimit 4-8-12 mujore të konsoliduara të buxhetit të Ministrisë së Brendshme, por institucionet e varësisë, dhe Ministria e Brendshme si institucion buxhetor më vete, nuk i kanë hartuar këto raporte, veprime në kundërshtim Udhëzimi nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”, pika 42 kapitulli III dhe 41.2 kapitulli III.

Shkëmbimi i informacionit ndërmjet punonjësve të institucionit si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht kryhet sipas rregullores së Ministrisë, por në këtë rregullore të brendshme parashikohen kanalet dhe menyra periodike e raportimit vetëm për Sekretarin e Përgjithshëm dhe Drejtorët e Përgjithshëm duke sjellë mungesë të harmonizimit të punës dhe bashkëpunimit midis njësisve të ndryshme në institucion.

MB nuk ka asnjë rregullore të përditësuar në kuadër të strategjisë ndërsektoriale për “Agjendën Digjitale të Shqipërisë” miratuar me vendim Nr. 370, datë 1.6.2022, kjo në ambientin e riskuar nga sulmet kibernetike ku aktualisht prej dy vitesh Qeveria e Shqipërisë ndodhet.

2.7 Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.

Në zbatim të pikës 7 të programit të auditimit “Nr. *169/1, datë 31.01.2024*”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-VKM nr. 528, datë 25.07.2019 ‘Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të pronës me emërtimin “Qendra e Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit”.

-VKM nr. 529, datë 25.07.2019 “Për kalimin në përgjegjësi dhe administrim nga ndërmarrja industriale nr.1, Tiranë, te Ministria e Brendshme, të pasurive nr. 3/771, 3/772, 3/773, 3/774, zona kadastrale 8240, me sipërfaqe totale 4122.56 m², Rruga ‘Hamdi Pepa”.

-Auditimi i mëparshëm i kryer nga KLSH, përfundimet e të cilit janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 171, datë 19.10.2021.

-Korrespondenca shkresore në lidhje me kalimin e pasurive të QSHAMT në pronësi të MFE, buxhetet e alokuara për periudhën 2020-2023, dhe çdo shkresë që trajton këtë problematikë.

- Ligji nr. 97/2019 ‘Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”. (VKM, udhëzime etj.)

- VKM nr. 980, datë 02.12.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e projektimit, zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të Qendrës së Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit”.

Nga ri verifikimi i procesit të transferimit të pronës në të cilën ushtronte aktivitetin QSHAMT nga Ministria e Brendshme në pronësi të MFE-së, rekomandimet e lëna nga auditimi i fundit përfundimet e të cilit janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 171, datë 19.10.2021,

grupi i auditimit kërkoi informacion nëpërmjet emailit datë 15.02.2024, drejtuar z. A. M., Drejtor i Përgjithshëm i DPESHM si dhe Drejtorit të DBMF, në lidhje me funksionimin e QSHAMT-së në vijim pas datës **23.04.2021**, si dhe menaxhimin e fondeve të buxhetit të shtetit lidhur me investimet e kryera për këtë institucion, i cili prej datës 12.04.2021 është strukturë në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Në rend kronologjik, u konstatua si më poshtë vijon:

Qendra e Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit (QSHAMT), prona e të cilës i kaloi në përgjegjësi dhe administrim MFE-së me VKM-në nr. 528, datë 25.07.2019⁷ ka qenë strukturë në varësi të Ministrisë së Brendshme⁸, deri në prill 2021 dhe aktualisht është strukturë në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Misioni i Qendrës së Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit është: *Të sigurojë shërbime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit në inventar si dhe administrimin e tyre, sipas dispozitave ligjore dhe akteve normative të Ministrisë së Brendshme.*

Prona në të cilën zhvillonte veprimtarinë QSHAMT kishte një sipërfaqe 28,452 m² si dhe e pozicionuar në zonën pranë parkut të automjeteve.

Procedura e zhvendosjes së vendndodhjes së QSHAMT është iniciuar nga një letër-ankesë e datës **04.07.2019** dërguar nga shoqata “P.-I.” për mbrojtjen dhe zhvillimin mjedisor, e cila kërkonte adresimin e çështjes së zhurmës që vinte nga parku i automjeteve të Ministrisë së Brendshme, çka sillte shqetësim për banorët.

Ish – Sekretari i Përgjithshëm i MB, z. P. N., (i emëruar në këtë detyrë në datë **19.07.2019**) nëpërmjet shkresës **nr. 5713/1 prot. datë 24.07.2019**, i ka kërkuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë caktimin e një prone brenda territorit të Tiranës që plotëson kushtet për t’u përdorur si park automjetesh si dhe të mos cenoje procesin e punës në këtë strukturë.

Menjëherë pas dërgimit të shkresës nga MB-MFE, **në harkun kohor prej 24 orësh**, Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë znj. Anila Denaj nëpërmjet vendimit **nr. 528, datë 25.07.2019**, kaloi në përgjegjësi administrimi të MFE-së pronën me emërtimin QSHAMT me sipërfaqe totale 28,452 m² dhe në të njëjtën ditë me vendimin **nr. 529, datë 25.07.2019**, kaloi në përgjegjësi administrimi të MB-së, pasuritë me nr. 3/771, 3/772, 3/773, 3/774, zona kadastrale 8240, *me sipërfaqe totale 4,122 m² (7 herë më e vogël se sipërfaqja në të cilën ushtronte aktivitetin QSHAMT) me vendndodhje në Rrugën Hamdi Pepa, me qëllim që në këtë pronë të zhvendoset QSHAMT.*

Me shkresën **nr. 12966/8 prot. datë 05.08.2019**, të MFE-së si dhe shkresën **nr. 325 prot. datë 06.08.2019** nga Ndërmarrja Industriale Tiranë⁹ “*Mbi zbatimin e VKM-së nr.529 datë 25.07.2019*”

i kërkohet Ministrisë së Brendshme të merren masa për lirim të pronës dhe dorëzimin e aseteve **brenda datës 20.08.2019.**

Këto veprime nga ish -SP i Ministrisë së Brendshme, si dhe VKM-të, nr 528 dhe 529, datë 27.07.2019 “*Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të pronës me emërtimin “Qendra e Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit” me*

⁷ VKM nr. 528, datë 25.07.2019 ‘Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të pronës me emërtimin “Qendra e Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit”

⁸ Urdhri nr. 196, datë 12.04.2021 i Ministrisë së MB “Për kalimin e Qendrës së Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit (QSHAMT) në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit”.

⁹ Urdhri nr. 309, datë 14.08.2019 të Ministrisë së Financave, asetet e kaluara në përgjegjësi administrimi të MFE nëpërmjet VKM nr 528, i kalojnë në administrim Ndërmarrjes Industriale Nr.1 Tiranë.

një interval kohe 2-ditor, pa kryer paraprakisht një studim dhe vlerësim të pretendimeve të ngritura në ankesë në raport me interesat e Ministrisë së Brendshme, si dhe për funksionin e rëndësishëm që ka QSHAMT në administrimin dhe riparimin e mjeteve të MB dhe DPPSH, janë në kundërshtim me **nenin 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.02.200** “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, ku lidhur me ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pronave shtetërore, citohet se:

Këshilli i Ministrave ndryshon përgjegjësinë e administrimit nga një organ shtetëror ose ent publik te një tjetër në rastet kur:

a) Organi përgjegjës nuk administron pronën në përputhje me nenin 13 të këtij ligji;

b) Ndryshojnë karakteristikat e pronës;

c) Përdorimi më i dobishëm i pronës mund të realizohet nën administrimin e një organi tjetër shtetëror publik.

Në këtë rast, ndryshimi i përgjegjësisë së administrimit të pronës së QSHAMT-së nga Ministria e Brendshme te Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nuk është bërë për asnjë nga qëllimet e përmendura në nenin 15, të sipërcituar.

Në lidhje me VKM nr. 529 datë 27.07.2019 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të pronës me emërtimin “Qendra e Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit”, **në të njëjtën datë të daljes së vendimit nga MFE/Drejtoria e përgjithshme e Pronës Publike është dërguar Këshillit të Ministrave shkresa me nr. 12966/3, datë 25.07.2019**, me lëndë: Dërgim për shqyrtim dhe miratim një projekt vendim. Në relacionin bashkëngjitur këtij projekt vendimi, ndër të tjera në pikën të tij citohet se:

Ky projekt vendim nuk ka ndikim financiar në buxhetin e shtetit...

*çka nuk është e vërtetë pasi ky vendim ka ndikim në buxhetin e shtetit sepse pas këtij vendimi jo më larg se shkurt 2020¹⁰, është vendosur të përdoret fondi i rindërtimit në masën **275,000,000 lekë për financimin e projektit të QSHAMT** ku është caktuar Agjencia e Blerjeve të Përqendruara si njësi zbatuese e këtij projekti.*

Procedura e propozimit dhe miratimit të një projekt akti kalon në disa etapa të cilat kërkojnë kohën e përcaktuar për t’u trajtuar dhe shqyrtuar, në zbatim të Ligjit nr.9000, date 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” si dhe VKM nr. 584, datë 28.8.2003 (I përditësuar), “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave” Kreu III, përkatësisht:

Neni 24 Bashkërendimi 1. *Propozuesit e projekt akteve jua dërgojnë për mendim ministrive dhe institucioneve të tjera të interesuara projekt aktin dhe një relacion shpjegues për objektin, qëllimin dhe përmbajtjen e tij. 2. Në çdo rast projekt aktet, përveç atyre me karakter individual, i dërgohen për mendim Ministrisë së Drejtësisë, i cili shprehet për ligjshmërinë e formës dhe të përmbajtjes së tyre.*

Neni 25 Përmbajtja e projekt akteve 1. *Propozimet e projekt akteve, që paraqiten për shqyrtim e miratim në Këshillin e Ministrave, duhet të përmbajnë projekt aktin, relacionin, mendimet ose vërejtjet e ministrive ose të institucioneve të interesuara, dokumentacionin që shoqëron projekt aktin, në varësi të kërkesave të ligjit ose të përmbajtjes së tij, ...2. Relacionet duhet të përmbajnë:*

a) objektivat që synohen të arrihen, lidhjen ose jo me programin politik të Këshillit të Ministrave; b) argumentin që objektivat e projekt aktit nuk mund të arrihen me instrumentet ekzistuese ligjore; c) përmbledhjen e përmbajtjes së projekt aktit; ç) përputhshmërinë me

¹⁰ Sipas VKM. Nr. 980, datë 02.12.2020 ‘Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e projektimit, zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të Qendrës së Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit’, është vendosur të përdoret fondi i rindërtimit në masën **275,000,000 lekë për financimin e projektit të QSHAMT**

Kushtetutën dhe harmonizimin me legjislacionin në fuqi.3. Për projekt aktet me karakter financiar-ekonomik, relacioni duhet të përmbajë edhe efektet e pritshme financiare, që rrjedhin nga zbatimi i tyre.

VKM nr. 584, datë 28.8.2003 (I përditësuar) “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, Kreu III, ku citohet se:

13. Mbështetur në vlerësimin paraprak të projekt aktit, ministri cakton me urdhër të veçantë çështjet që duhen rregulluar, format e pjesëmarrjes dhe hapat kryesore të realizimit dhe bashkërendimit të procesit legjislativ, afatet përkatëse për realizimin e tyre, strukturat përgjegjëse, si dhe burimet njerëzore dhe materiale që ngarkohen të bashkëpunojnë me strukturën juridike për hartimin e çdo projekt akti.

16. Në bashkërendim me strukturën juridike, strukturat përgjegjëse përpilojnë raportin e vlerësimit të ndikimit të projekt aktit, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij vendimi, relacionin shpjegues të projekt aktit, raportin e vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, si dhe mbi burimet financiare, si dhe plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm shoqëruar përpara se t'i dërgohen për shqyrtim ministrit.

17. Në përfundim të konsultimeve dhe shqyrtimit të projekt aktit, raportit të vlerësimit të ndikimit të tij, relacionit shpjegues, raportit të vlerësimit ekonomik dhe dokumentacionit shoqëruar, ministri pasi vlerëson nismën, vendos dërgimin e tyre për mendim në ministritë dhe institucionet e interesuara ose urdhëron rishikimin e tyre brenda një afati të caktuar prej tij.

18. Projekt akti i dërguar për mendim duhet të shoqërohet me **raportin e vlerësimit të ndikimit të plotësuar, relacionin shpjegues me të gjitha elementet e tij**, si dhe çdo dokument tjetër, sipas përcaktimeve të kësaj VKM-je.

44. Projekt akti, raporti i vlerësimit të ndikimit, relacioni shpjegues, dokumentet e përcaktuara në

pikën 45 të kësaj rregulloreje, në dy kopje origjinale, së bashku me shkresën përcjellëse i dërgohen

Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, të paktën **10 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e Këshillit të Ministrave.**”

Pra kjo procedurë është kryer jashtë çdo afati kohor të parashikuar në dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndonëse nuk ka pasur asnjë emergjencë për inicimin e këtij projekt akti.

Gjithashtu në zbatim të VKM Nr.584, datë 28.8.2003 (i përditësuar)¹¹, projekt-akti shoqërohet nga raporti i vlerësimit të ndikimit i plotësuar, dokument i cili duhet të ishte përgatitur nga Ministria e Brendshme për të përcaktuar riskun e zhvendosjes së QSHAMT-së, ndikimin që do të kishte transferimi si dhe përcaktimin e kriterëve dhe nevojave të pronës ku do të transferohet QSHAMT në kuadër të mirëfunksionimit të këtij institucioni.

Këto veprime të ish-SP, z. P. N. dhe ish Ministrit të MB, z. S. Ll., në zhvendosjen e pastudiuar të pronave të QSHAMT, pa caktuar nëpërmjet dokumentacionit të sipërpërmendur kriteret dhe kushtet për vendndodhjen e re, janë shoqëruar me kosto financiare e buxhetore për Ministrinë e Brendshme në vazhdimësi, problematika të ngritura post-factum nga ish-Drejtori i QSHAMT, z. E. J. dhe stafi përgjegjës i MB, të paraqitura në vijim:

1. Memo e datës 08.10.2019, nr.6327/1 prot. drejtuar ish Ministrit, z. Ll, e përgatitur nga znj. L. M., përgjegjëse e sektorit të shërbimit dhe menaxhimit të aseteve në MB. Në memon me objekt zbatimin e VKM nr. 528, datë 25.07.2019 dhe VKM nr. 529, datë 25.07.2019, znj. M. shprehet

¹¹ VKM. nr.584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave” (Ndryshuar me VKM nr.201, datë 29.03.2006; nr.4, datë 7.01.2009; nr.233, datë 18.03.2015; nr.653, datë 14.09.2016)

se:” Nga një vizitë e thjeshtë në këtë pronë, (pasuritë me nr. 3/771, 3/772, 3/773, 3/774, zona kadastrale 8240, **me sipërfaqe totale 4,122 m²**), rezulton se ambientet e saj nuk janë të përshtatshme për veprimtarinë e QSHAMT-së, qoftë sa i përket hapësirave, gjithashtu dhe për sa i përket gjendjes së godinës ekzistuese (fotot bashkëlidhur memos)”.

2. Shkresa e datës 22.10.2019, nr. 395 prot, nga Drejtuesi i Ndërmarrjes Industriale Nr.1, ku rikërkohej marrja e masave për dorëzimin e aseteve të QSHAMT në zbatim të Urdhrit të Ministrit nr. 309. datë 14.08.2019.

3. Në vijim të zbatimit kësaj shkrese, në datë **01.11.2019**, znj. M. i dërgon një **memo të dytë** (pa nr. Prot) veprime në kundërshtim me Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, z. Ll. me objekt ngritjen e grupit të punës në zbatim të VKM nr. 528, datë 25.07.2019 dhe VKM nr. 529, datë 25.07.2019, ku ri sjell në vëmendje shqetësimin për zbatueshmërinë e VKM-ve, duke parashtruar nevojën për ngritjen dhe miratimin nga ana e Ministrit, të një grupi pune me specialistë të fushës për të vlerësuar hapësirën e domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë së QSHAMT-së. (veprime këto që duhet të ishin kryer nga Titullari i MB dhe strukturat mbështetëse para hartimit të propozimeve dhe vendimeve të transferimit të pronës nga KM).

4. Nëpërmjet shkresës **nr. 1135 prot, datë 01.11.2019**, QSHAMT, ka përgatitur një relacion mbi hapësirat e nevojshme minimale për funksionimin e QSHAMT, drejtuar znj. A. Sh., Drejtore e Përgjithshme Ekonomike e Shërbimeve Mbështetëse në MB. Në këtë relacion grupi i ekspertëve të QSHAMT ka llogaritur dhe përcaktuar se hapësira e nevojshme për ofiçinat e parkimet, zyrat e administratës dhe magazinat, duhet të jetë të paktën një sipërfaqe prej **14,855 m²**. Prona e re që i është caktuar QSHAMT-së, ka sipërfaqe totale 4,122 m² dhe nuk plotëson as kushtin e hapësirës së nevojshme për vendosjen e makinerive dhe serviseve.

Pavarësisht sa më sipër, Ministri i Brendshëm z. S. Ll., nëpërmjet urdhërit **nr. 575, datë 12.11.2019** “Për marrjen në dorëzim të pronës me nr. pasurie 3/771, 3/772, 3/773, 3/774, zona kadastrale 8240, me sipërfaqe totale 4122.56 m², Rruga ‘Hamdi Pepa’, nga Ndërmarrja Industriale nr.1 Tiranë, tek Ministria e Brendshme”, urdhëroi ngritjen e grupit të punës për ndjekjen e procedurave për marrjen në dorëzim të kësaj prone.

5. Në datë **21.11.2019**, ish Ministri S. Ll. nxjerr **Urdhrit nr. 385** për dorëzimin e pronës me emërtimin QSHAMT nga Ministria e Brendshme tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Pas nxjerrjes së këtyre urdhrave ish- Drejtori i QSHAMT, z. E. J., ka një korrespondencë shkresore të vazhdueshme me ish-Ministrin, z. S. Ll., përkatësisht shkresa **nr.1166/7 prot. datë 11.12.2019**; shkresa me nr **1166/8 datë 11.12.2019**, ku bën me dije mbi problematikat që do të sjellë disponimi i pronës nga Ndërmarrja Industriale nr.1, si titullarë legjitime e pronës ku ende në atë datë ushtronte veprimtarinë QSHAMT, në mundësinë e ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike dhe ujë. Gjithashtu ka ri sjellë në vëmendje nevojën e ngritjes së grupit të punës për të facilituar zhvendosjen e QSHAMT-së sipas urdhrave të Ministrit, duke konsideruar së ky institucion ka disa makineri të rënda të cilat përdoren në funksion të mirëmbajtjes së automjeteve të Ministrisë së Brendshme.

Me shkresën **nr. 1166/9 datë 11.12.2019**, z. J. ka informuar Ministrin mbi listën e dokumentacionit të nevojshëm që i ka kërkuar Ndërmarrjes Industriale Nr.1 lidhur me pasurinë nr.3/771, 3/772, 3/773, 3/774, zona kadastrale 8240, rruga “Hamdi Pepa” dhe ka sqaruar se pas verifikimit në vend nga ana e komisionit të ngritur, ky i fundit ka konstatuar se prona është e parrethuar dhe e pasiguruar, jo funksionale dhe brenda territorit të saj ndodhen dy subjekte të tjera.

Pra veprimet e ish-Ministrit në dorëzimin e pronës ku ushtronte aktivitetin QSHAMT, kanë vazhduar duke mos marrë në konsideratë memot e njëpasnjëshme të stafit të tij, të cilat i bëjnë me dije problematikën lidhur me pasurinë nr.3/771, 3/772, 3/773, 3/774 zona kadastrale 8240, rruga “Hamdi Pepa” dhe kushtet e përcaktuara në relacionin e përcjellë me shkresën nr. 1135 prot, datë 01.11.2019, në shkelje të ligjit organik mbi misionin e Ministrisë së Brendshme ku pika e parë është rendi dhe siguria publike; e cila bëhet e pamundur nëse automjetet e Ministrisë së Brendshme nuk mirëmbahen dhe administrohen konform kushteve të përcaktuara.

Prona e QSHAMT iu dorëzua ndërmarrjes Industriale Nr.1, nëpërmjet akt dorëzimit **nr. 6743/3 prot, datë 22.11.2019**, me vlerë kontabël të mbetur në fund të vitit 2019- **1,081,893,747 lekë**, nga të cilat **873,562,984 lekë vlera e tokës**.

Prona nr.3/771, 3/772, 3/773, 3/774 zona kadastrale 8240, rruga “Hamdi Pepa” është marrë në dorëzim nëpërmjet Akt dorëzimit **nr. 6746/4 prot, datë 12.12.2019**, me vlerë kontabël 35,865,369 lekë dhe grupi i marrjes në dorëzim u shpreh se brenda territorit të pronës që u mor në dorëzim janë edhe dy subjekte të tjera: një objekt kulti me sipërfaqe rreth 300 m2 dhe një banesë private me sipërfaqe rreth 300 m2, dhe nga fotot bashkëlidhur godina duket totalisht e amortizuar.

Me **memon e datës 27.12.2019**¹², drejtuar z. Ll., znj. M. G. me detyrë specialist për menaxhimin e aseteve, ka risjellë në vëmendje të ish Ministrit problematikën e sjellë me shkresën 1166/8 datë 11.12.2019.

Sekretari i Përgjithshëm, z. P. N. nëpërmjet shkresës **nr. 5713/2 prot, datë 24.01.2020**, i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ndërmarrjes Ekonomike nr.1 Tiranë ku kërkon bashkëpunimin për zgjidhjen e këtyre problematikave, duke vijuar më pas me shkresën **6746/8, datë 30.01.2020**, ku kërkon shtyrjen e afatit të qëndrimit të QSHAMT në ambientet ekzistuese pasi prona e re e vendosur në dispozicion nuk i plotëson kushtet, si dhe mos ndërprerjen e energjisë elektrike dhe furnizimit me ujë për këtë institucion.

Me shkresën nr. 745/2, datë 06.03.2020, MB dërgon për mendim MFE mendime më lidhje me projekt vendimin “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të MFE-së dhe për një ndryshim në VKM nr. 250, datë 24.04.2023, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik” ku ndër të tjera shprehet se:

Pasuria e cila propozohet t’i kalohet në përgjegjësi administrimi MFE, është në përdorim nga strukturat e Policisë së Shtetit, Reparti i sigurisë së brendshme Ceremonialit në objektin godinë 3-katë (zyra, magazinë) të Parkut.

Për sa më sipër bazuar në nenin 15/Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajshme të shtetit”, nuk mund të ndryshohet përgjegjësia e administrimit, për sa kohë nuk jemi në kushtet e përcaktuara në geramat a, b dhe c të këtij neni.

*Ndërkohë këto veprime të cilat duhet të kryheshin para daljes së VKM janë të gjitha post factum pasi **VKM ka nr. 67, datë 22.01.2020**¹³, ndërsa korrespondencat shkresore janë kryer pas kësaj date dhe konkretisht 28.01.2020 e në vijim.*

Me shkresë nr. 5265, datë 30.03.2020, MFE i dërgon MB dhe Ministrisë së Drejtësisë përgjigje për mendimet e dhëna nga MB me shkresën nr. 745/2, datë 06.03.2020, ku thekson se me VKM nr. 528, dt. 27.07.2019, prona me emërtimin QSHAMT ka kaluar në përgjegjësi administrimi të

¹² Asnjë nga memot e dërguara për informacion tek Ministri z. Ll. nuk është sigluar nga ish Sekretari i Përgjithshëm z. N., ky i fundit, duke shkelur procedurat administrative të institucionit.

¹³ VKM nr. 67, datë 22.01.2020 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të MFE të disa pasurive dhe për një ndryshim në VKM nr 250, datë 24.04.2003 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, i ndryshuar.

MFE dhe me Urdhrin nr. 309, datë 14.08.2019, i ka kaluar Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë sipas inventarit të QSHAMT-së. Sipas akt dorëzimit nr. 437 dhe nr. .6746/3, datë 21.10.2019 dhe raportit të ekspertit vlerësues, sipërfaqja totale e truallit është **28,439.8 m²** dhe sipërfaqja nën ndërtim është 9649,67 m².

ASHK nuk procedoi me regjistrimin e kësaj pronësie pasi kishte mospërputhje të sipërfaqes sipas VKM nr. 528, dt. 25.07.2019 me sipërfaqen faktike të marrë në dorëzim nga Ndërmarrja Industriale nr. 1, Tiranë. Pas takimit të përbashkët të kryer midis ASHK dhe MFE u konkludua në inicimin e një VKM për kalimin në përgjegjësi administrimi të MFE, të diferencës së sipërfaqes që rezultonte ndërmjet sipërfaqes së marrë në dorëzim me sipërfaqen e përcaktuar në VKM nr. 528, datë 25.07.2019. E gjithë situata u konkretizua me VKM nr. 67 datë 22.01.2020 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të MFE të disa pasurive dhe për një ndryshim në VKM nr 250, datë 24.04.2003 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, i ndryshuar.

Për sa më sipër prona me emërtimin QSHAMT me sipërfaqe totale tashmë **28,439.8 m²** dhe vlerë totale **1,081,839,747 lekë** ka kaluar në administrimin e Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë, e cila ka kryer aplikimin për regjistrimin e saj pranë ASHK, duke u pajisur me dokumentin e pronësisë. Pra MFE nuk merr parasysh shkresën e MB, duke qenë se është rreth një muaj e gjysmë me vonesë pas zbardhjes së VKM nr. 67, datë 22.01.2020.

Të njëjtën përmbytje ka dhe shkresa e MFE nr. 5265/1, datë 11.05.2020 drejtuar MB ku ri qartëson se mendimet e dhëna ose thënë ndryshe kontestimet, post factum nëpërmjet shkresës (dt. 06.03.2020) të MB nuk merren parasysh pasi prona e sipërcituar është kaluar në administrim të MFE kohë më parë sipas VKM nr 528, datë 25.07.2019, dhe VKM nr. 67 datë 22.01.2020 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të MFE të disa pasurive dhe për një ndryshim në VKM nr 250, datë 24.04.2003 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, i ndryshuar, ka dalë në 20 janar 2020.

Nëpërmjet shkresës **nr. 144/3 prot, datë 24.03.2021**, Drejtori i Përgjithshëm i QSHAMT z. E. J., ka njoftuar Sekretaren e Përgjithshme të MB, znj. E. P. se pronarët e pronës së QSHAMT i kanë lënë afat të panegociueshëm që të ushtrojë veprimtarinë në ambientet ekzistuese deri me datë **20.08.2021**.

Veprime të ish Sekretarit të Përgjithshëm, jo eficient, *post factum*, të cilat treguan në kohë se problematika e zhvendosjes së QSHAMT-së vijon dhe **sot (viti 2024)** duke qenë se ky institucion nuk e ushtron veprimtarinë e tij në pronën e transferuar sipas **VKM nr. 529, datë 25.07.2019**, por në një pronë tjetër me nr. rendor 180 me emërtimin “Policia Ushtarake (Reparti Ushtarak nr. 6620)” me vendndodhje në Sauk, Tiranë”, ku QSHAMT-ja ka zhvilluar dhe vazhdon aktivitetin e saj pranë Akademisë së Sigurisë, sipas **Urdhrit nr.158 datë 23.08.2022** të ish Ministrit të Brendshëm.¹⁴

Grupi i auditimit verifikoi në vend ambientin ku QSHAMT kryen veprimtarinë e saj aktualisht, paraqitur në fotot e mëposhtme:

¹⁴ Prona me nr. Pasurie 3/771, 3/772,3/773,3/774, në zonën kadastrale 8240, me sipërfaqe 4122.56 m² sipas Urdhrit nr 166, datë 12.01.2024 të DPPSH, z. M. Rrumbullaku kalon në administrim dhe përdorim nga Ish-QSHAMT sot DMMT tek Instituti i Policisë Shkencore.



Ndërtimi i objektit të ri të QSHAMT-së

Projekti “Ndërtim/Rikonstruksioni i objekteve të QSHAMT-së”, financohet nga fondet e rindërtimit dhe synon krijimin e infrastrukturës së nevojshme për sigurimin e gatishmërisë teknike të mjeteve lëvizëse të strukturave të Policisë së Shtetit.

Projekti përfshin:

- ✓ *Projekt Idenë Përfundimtare* 998,082 lekë
- ✓ *Projekti i detajuar* 11,800,000 lekë
- ✓ *Punime Ndërtimi* 243,700,000 lekë
- ✓ *Mbikëqyrje* 3,200,000 lekë

Nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 980, datë 02.12.2020 ‘Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e projektimit, zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të Qendrës së Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit’, është vendosur të përdoret fondi i rindërtimit në masën 275,000,000 lekë për financimin e projektit të QSHAMT dhe është caktuar Agjencia e Blerjeve të Përqendruara si njësi zbatuese e këtij projekti. **Përdorimi i fondit të rindërtimit për financimin e objekteve shtetërore të amortizuara ku dëmtimi nuk ka ardhur si pasojë e tërmetit të ndodhur me datë 26 nëntor 2019, është në kundërshtim me ligjin nr. 97/2019 ‘Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.** Në nenin 5 të këtij akti normativ, lidhur me subjektet përfituese, përcaktohet se “Subjekte përfituese janë individët dhe familjet, që kanë humbur një ose më shumë anëtarë të familjes dhe/ose kanë pësuar dëme në banesat e tyre dhe kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe institucionet publike që kanë pësuar dëme në ndërtesat apo infrastrukturën publike në pronësi apo në administrim të tyre, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore. Gjendja e fatkeqësisë natyrore është shpallur me datë 27 nëntor 2019, nëpërmjet vendimit nr. 750 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, si pasojë e tërmetit të datës 26 nëntor 2019.

Ish-Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme, (znj. E. P.) me shkresën nr. 2614/4, datë 07.07.2021 “Kthim përgjigje”, ka konfirmuar miratimin e Ministrit të Brendshëm për përdorimin e një pjese të pronës në administrim të Qendrës së Furnizimit Materialo Teknik (QFMT), për dislokimin e strukturës së Qendrës së Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit,

njëkohësisht përdorimin e pronës me sipërfaqe totale 4,122.5 m², me vendndodhje në rrugën “Hamdi Pepa”, Tiranë, ZK 8240, për ndërtimin e godinës së re të Policisë Shkencore.

Me shkresën nr. 2660, date 26.4.2022 “Mbi zbatimin e projektit për ndërtimin e QSHAMT-së”, drejtuar Ministrit të Brendshëm dhe për dijeni Ministrit për Rindërtimin, është informuar mbi pronën ku do të zbatohet projekti, vlerën totale të projektit dhe statusin e procedurave të prokurimit.

Me urdhër nr. 158, datë 23.8.2022 “Për ngritjen e Grupit të Punës për dhënien në përdorim të përkohshëm pa shpërblim Drejtorisë së Menaxhimit të Mjeteve të Transportit në DPPSH të një pjese të pronës me numër rendor 180, me emërtimin “Policia Ushtarake”, (Reparti Ushtarak nr.6620)” me vend ndodhje në Sauk Tiranë”, janë përcaktuar ambientet ku është akomoduar dhe zhvillon aktivitetin aktualisht Drejtoria e Menaxhimit të Mjeteve të Transportit -DMMT (ish-QSHAMT) deri në përfundimin e realizimit të projektit të ri. Për përgatitjen e dokumentacionit dhe kryerjen e procedurave të nevojshme për realizimin e projektit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit janë marre këto masa:

- Me urdhrin nr.14, datë 02.7.2021 është ngritur grupi i punës për hartimin e detyrës së projektimit. Detyra e Projektimit nr.2651/8, date 28.7.2021 është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë;
- Me urdhrin e prokurimit nr. 53, date 25.8.2021 është ngritur komisioni për procedurën “Përgatitja e projekt Idesë Përfundimtare të objektit “Ndërtim/Rikonstruksion i objekteve të QSHAMT-së në Mullet Tirane”;
- Është lidhur kontrata nr.53/7, date 25.8.2021 me objekt “Përgatitja e projekt Idesë Përfundimtare të objektit “Ndërtim/Rikonstruksion i objekteve të QSHAMT-se në Mullet Tiranë” me operatorin Ekonomik “A***”, me vlerë 998,082 leke dhe afat 30 dite nga lidhja e kontratës. Projekt Ideja përfundimtare është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
- Me urdhrin e prokurimit nr. 53, date 25.8.2021 është ngritur komisioni për procedurën “Përgatitja e projekt Idesë Përfundimtare të objektit “Ndërtim/Rikonstruksion i objekteve të QSHAMT-së në Mullet Tirane”.
- Kontrata nr.61/26, datë 27.5.2021 “Ndërtim/Rikonstruksioni objekteve të QSHAMT-së, me afat 680 dite, nga të cilat: projekti i detajuar 120 dite, zbatimi punimeve 560 ditë. Dhe vlera e kontratës 255,500 mijë lekë;
- Kontrata e Mbikëqyrjes nr. 71/23, date 04.04.2023 me bashkimin e operatorëve ekonomike “G.&L. C.” shpk & “N.G.” shpk, në vlerën 3,200,000 lekë;
- Me shkresën nr. 1827/1, date 31.5.2022 të Drejtorit të Departamentit për Shërbimet Mbështetëse kontrata i është dërguar për zbatim DMMT-se;
- Me urdhrin nr. 61, date 14.6.2022 “Për ngritjen e Ekipit të menaxhimit të Kontratës nr.61/26, date 27.5.2021 “Ndërtim/Rikonstruksioni i objekteve të QSHAMT-se”, drejtori i QMMT ka ngritur Ekipin për Menaxhimin e Kontratës nr.61/26, date 27.5.2021;
- Me vendim të KKT nr.12, date 14.12.2022 është miratuar Leja e Ndërtimit, njoftimi nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit me shkresën nr.1815 date 12.5.2023;

➤ *Data e fillimit të punimeve: 06.06.2023, dorëzimi Sheshit të Ndërtimit;*

➤ *Periudha e implementimit të punimeve: 560 ditë.*

• **Ecuria e projektit:**

Janë kryer punimet e prishjes së objekteve ekzistuese, punimet e gërmimit, hedhjes së shtresës së varfër, punime hekur betoni, hedhjen e pllakës së themeleve, kanë përfunduar kolonat dhe tarraca

e katit përdhe dhe kolonat e katit te pare te objektit 2-katesh te ofiçinës. Ka përfunduar struktura e parkimit te mbuluar si dhe muret mbajtës te presioneve te dheut.

Aktualisht po punohet në muret ndarëse të katit përdhe të ofiçinës, në punimet e shtresave të parkimit të mbuluar dhe përgatitjen e mbulesës për objektin e ofiçinës.

Janë hartuar 3 situacione punimesh në vlerën 47,846,626 lekë.

Realizimi fizik i punimeve: 30% e volumit të punimeve të kontratës.

- **Statusi financiar:**

Lidhur me transaksionet financiare të kryera në funksion të ndërtimit të godinës së QSHAMT-së sipas periudhave përkatëse janë si më poshtë vijon:

Në zbatim të **VKM nr. 980, datë 02.12.2020**, me shkresën nr. **24243/1, datë 30.12.2020** të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është çelur fondi në shumën 55,000,000 leke. Vlera e kontratës për projektin është 255 500 000 lekë.

Në zbatim te VKM nr. 239, datë 14.04.2021 (e cila bëri ndryshimin për transferimin e fondeve nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara në programin Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit”), me shkresën nr. **6899/2 datë 07.05.2021** të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është transferuar fondi për në njësinë shpenzuese Aparati i Drejtorisë se Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në shumën 55.000.000 leke.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është kërkuar çelja e fondeve nga Fondet e Rindërtimit për këtë projekt në Qendrën e Mirëmbajtjes së Mjeteve të Transportit-QMMT, si njësi përfituese e drejtpërdrejtë, për arsye se caktimi i Aparatit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë si njësi zbatuese për këtë projekt ka krijuar problematika në ndjekjen e realizimit të fondeve.

Në vijim të vitit 2023 me shkresën nr. **22312/1, datë 12.12.2023** të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të VKM nr.675 datë 06.12.2023 është çelur fondi në shumën 16.000.000 lekë. Fondi i çelur është realizuar dhe dokumentacioni gjendet në QMMT (ish – QSHAMT).

Realizimi shpenzimeve sipas komponentëve të projektit dhe kontratave:

<i>Nr.</i>	<i>Aktiviteti</i>	<i>Kontraktuar</i>	<i>Realizuar</i>	<i>Diferenca</i>
1	Projekt Idea Përfundimtare	998,082	998,082	-
2	Projekti i detajuar	11,800,000	11,800,000	-
3	Punime Ndërtimi	243,700,000	47,846,626	195,853,374
4	Mbikëqyrje	3,200,000	-	3,200,000
	Totali	259,698,082	60,644,708	199,053,374

Burimi i të dhënave: DPPSH

Gjate vitit 2022 është likuiduar vlera e kontratës nr.53/7, date 25.8.2021 “Përgatitja e projekt Idesë Përfundimtare të objektit “Ndërtim/Rikonstruksion i objekteve te QSHAMT-se në Mullet Tiranë” në shumën 998,082 lekë.

Për vitin 2023 për këtë projekt u planifikuan 50,000,000 lekë në Kapitullin 6 dhe 16,000,000 lekë në Kap 1.

U realizuan shpenzime në vlerën 59,646,626 lekë nga të cilat për pagesën e projektit të detajuar 11,800,000 lekë dhe pagesën e punimeve të ndërtimit sipas tre situacioneve pjesore në vlerën 47,846,626.00 leke.

Nga Aparati i DPPSH u likuiduan 44,766,616 leke, nga fondet e trashëguara ne kapitullin 6. Në QMMT janë çelur në vitin 2023. Në kapitullin 1 shuma 16,000,000 lekë të cilat janë realizuar.

Në njësinë shpenzuese Aparati DPPSH, kanë mbetur gjendje 9,256,987 lekë, fonde të trashëguara për këtë projekt.

Punime ndërtimi të realizuara:

Nr.	Situacioni		Urdhër Shpenzimi		
	Nr.	Vlera e Situacionit	Nr.	Datë	Vlera
1	Situacioni nr.1	15,869,168	548	25.9.2023	15,869,168
2	Situacioni nr.2	16,777,458	729	14.12.2023	16,777,458
3	Situacioni nr.3	15,200,000			15,200,000
	Totali	47,846,626			47,846,626

Burimi i të dhënave: DPPSH

Sa i takon vitit 2024, nga grupi i auditimit konstatohet se nuk ka çelje fondi për investime në QMMT. Nga ana e OE është në përgatitje situacioni punimeve të kryera për vitin 2024.

Nga vlera totale e kontratës së punimeve të ndërtimit 243,700 mijë leke janë likuiduar 47,847 mijë lekë.

Deri në përfundim të projektit kërkohet financim në shumën **189,762,736 leke**, nga të cilat:

- Për kontratën e punimeve të ndërtimit: 186,562,736 leke
- Për kontratën e mbikëqyrjes: 3,200,000 leke.

Grupi i auditimit verifikoi në vend objektin e ri ku po ndërtohet me qëllim kryerjen e veprimtarisë së QMMT-së në Mullet, paraqitur në fotot e mëposhtme:



Konkluzion:

1. Menaxhimi, dhe në këtë kuadër:

-Transferimi i pronave/ asetëve të Ministrisë së Brendshme(ish-QSHAMT) është një proces që nuk është bazuar në prioritete të shpallura dhe mbi një strategji sektoriale. Auditimi ka evidentuar se ka munguar standardizimi, dhe se vendimet mbi transferimin e pronës së QASHMT janë marrë në mënyrë të menjëhershme, ad hoc; në mungesë të një kuadri strategjik në lidhje me menaxhimin e asetëve, të rregulloreve specifike me procedura standarde (*ligjore dhe administrative*) për kategorizimin, gjurmën dhe rastet e transferimit dhe tjetërsimit të pronave publike, (për të garantuar kontroll të pavarur dhe korrekt të procedurave për menaxhimin e këtyre pronave); mungojnë mekanizmat që shpjegojnë e argumentojnë efektshmërinë dhe efikasitetin e procedurave, domosdoshmërinë dhe logjikën që qëndron pas vendimeve të marra për menaxhimin e këtyre pronave si dhe transparencën publike. Nga auditimi u konstatua se prona me sipërfaqe 28,452 m² ku ushtronte aktivitetin ish-QSHAMT, institucion në varësi të MB, **në harkun kohor prej 24 orësh**, pa u kryer paraprakisht një studim dhe vlerësim i ankesës së ardhur nga qytetarët¹⁵, në raport me interesat e Ministrisë së Brendshme, si dhe për funksionin e rëndësishëm që QSHAMT ka në administrimin dhe riparimin e mjeteve të MB dhe DPPSH, nëpërmjet vendimit **nr. 528, datë 25.07.2019**, të Këshillit të Ministrave kaloi në përgjegjësi administrimi të MFE-së dhe në të njëjtën datë me vendimin **nr. 529, datë 25.07.2019**, kaluan në përgjegjësi administrimi të MB-së, pasuritë me nr. 3/771, 3/772, 3/773, 3/774, zona kadastrale 8240, me sipërfaqe totale 4,122 m² (**7 herë më e vogël** se sipërfaqja në të cilën ushtronte aktivitetin QSHAMT) me vendndodhje në Rrugën Hamdi Pepa, me qëllim që në këtë pronë të zhvendosej QSHAMT, veprime të ish SP të Përgjithshëm të MB dhe ish-Ministrit të Brendshëm, z. S. Ll., në kundërshtim me **nenin 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001** “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar. Konstatohet që veprimet e mësipërme janë të pastudiuara dhe të nxituara, duke sjellë pasoja për Ministrinë e Brendshme, pasi asetet në pronësi të QSHAMT nuk mund të përshtaten në një *sipërfaqe 7 herë më të vogël se ajo që MB dispononte dhe aktualisht Drejtoria e Menaxhimit të Mjeteve të Transportit -DMMT (ish-QSHAMT), sot ende nuk ushtron aktivitetin e saj as në pronën e dhënë*¹⁶ me nr. 3/771, 3/772, 3/773, 3/774, zona kadastrale 8240, me sipërfaqe totale 4,122 m². Si rrjedhojë, procedura e zbatuar për transferimin e pronës së QASHMT nuk ka plotësuar kërkesat që Ministria e Brendshme i ka përcjellë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me anë të shkresës nr. 3713/1 datë 24.7.2019 ku kërkohej përcaktimi i një prone që plotëson kushtet si park automjeteve dhe që nuk cenon procesin e punës së kësaj strukture.

2. Procedura e tjetërsimit të pronës është kryer jashtë çdo afati kohor të parashikuar në dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndonëse nuk ka pasur asnjë emergjencë për iniciimin e këtij projekt akti, ku për miratimin e VKM-ve do të duheshin minimalisht **10 ditë kalendarike** nga propozimi tek miratimi i projekt-aktit, veprime që nuk janë në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.9000, date 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave".

¹⁵ Procedura e zhvendosjes së vendndodhjes së QSHAMT është iniciuar nga një letër-ankesë e datës **04.07.2019** dërguar nga shoqata “PSEDA-ILIRIA” për mbrojtjen dhe zhvillimin mjedisor, e cila kërkonte adresimin e çështjes së zhurmës që vinte nga parku i automjeteve të Ministrisë së Brendshme, çka sillte shqetësim për banorët.

¹⁶ Vendimi nr. 529, datë 25.07.2019, i MFE.

Relacionet e drejtuara ish Ministrin të Brendshëm, nga punonjësit e MB dhe ish Drejtuesi i QSHAMT kanë qenë të vazhdueshme (*post factum*) gjatë periudhës tetor 2019 - dhjetor 2019, në lidhje me pamundësinë e zhvendosjes së asetëve të ish-QSHAMT në një sipërfaqe 7 herë më të vogël e cila për më tepër kishte dhe dy objekte në këtë sipërfaqe. Ish Ministri nuk ka marrë parasysh se mos funksionimi i QSHAMT, cenimi apo vështirësimi i veprimtarisë së saj është në shkelje të Ligjit Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” Seksioni III, Neni 32, pasi *Strukturat operacionale të mbrojtjes civile që angazhohen në përballimin e fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera, janë: a) Forcat e Armatosura; b) Policia e Shtetit; c) Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit; etj.* Gjithashtu veprime të ish Sekretarit të Përgjithshëm, jo eficient, *post factum*, të cilat treguan në kohë se problematika e zhvendosjes së QSHAMT-së vijon dhe sot (viti 2024) duke qenë se ky institucion nuk e ushtron veprimtarinë e tij në pronën e transferuar MB-së, sipas **VKM nr. 529, datë 25.07.2019**, por në një pronë tjetër me nr. rendor 180 me emërtimin “Policia Ushtarake (Reparti Ushtarak nr. 6620)” me vendndodhje në Sauk, Tiranë”, pranë Akademisë së Sigurisë.¹⁷

3. Procesi i pastudiuar i tjetërsimit të pronave ka sjellë implikime financiare për buxhetin e shtetit, përdorim të fondeve buxhetore jashtë destinacionit të miratuar nga ligjvënësi dhe për pasojë është shoqëruar me vonesa të procesit të rindërtimit dhe korigjimin në kohë të efekteve të fatkeqësisë natyrore për qytetarët e dëmtuar. Në lidhje me transaksionet financiare dhe investimin e kryer për ndërtimin e godinës së re që do të ushtrojë aktivitetin Drejtoria e Menaxhimit të Mjeteve të Transportit -DMMT (ish-QSHAMT), iu kërkua informacion DPPSH si institucion varësie nga ku rezultoi se shpenzime të realizuara deri tani janë 60,645 mijë lekë ose e thënë ndryshe 23.35% e totalit të fondeve të kontraktuara në vlerën 259,699 mijë lekë, sipas VKM nr. 980, datë 02.12.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e projektimit, zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të Qendrës së Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit”, veprime **në kundërshtim me ligjin nr. 97/2019** ‘Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” ku subjektet përfituese, përcaktohet se janë individët dhe familjet, që kanë humbur një ose më shumë anëtarë të familjes dhe/ose kanë pësuar dëme në banesat e tyre dhe kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe institucionet publike që kanë pësuar dëme në ndërtesat apo infrastrukturën publike në pronësi apo në administrim të tyre, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore. Ndryshimi i destinacionit të fondeve të rindërtimit në vlerën prej 259,699 mijë lekë dhe përdorimi i tyre për qëllime të tjera që nuk kanë lidhje me dëmtimet e tërmetit, është tërësisht menaxhim joefektiv, jo eficient dhe jo ekonomik i fondeve të buxhetit të shtetit. Pra ndërtimi i godinës së re të QSHAMT nuk është pjesë e asnjë fatkeqësie natyrore.

4. Transferimi dhe kalimi në përgjegjësi administrimi të MFE/Ndërmarrja Industriale Nr.1 të pronës prej 28,452 m² nga MB/QASHMT është kryer me datën 21.11.2019 sipas vendimit **nr. 528, datë 25.07.2019**, për sipërfaqen totale 28,452 m², por nuk ka gjetur zbatim vendimi **nr. 529, datë 25.07.2019 i KM**, për kalimin në përgjegjësi administrimi të MB-së, pasuritë me nr. 3/771, 3/772, 3/773, 3/774, zona kadastrale 8240, me sipërfaqe totale 4,122 m² dhe se *kjo pronë nuk është në funksion të DMMT pasi për kryerjen e funksioneve ky institucion nuk e ushtron veprimtarinë e tij në pronën e transferuar sipas VKM nr. 529, datë 25.07.2019, por në një pronë tjetër me nr. rendor 180 me emërtimin “Policia Ushtarake (Reparti Ushtarak nr. 6620)” me*

¹⁷ sipas Urdhrit nr.158 datë 23.08.2022 të ish Ministrin të Brendshëm.

vendndodhje në Sauk, Tiranë”, ku QSHAMT-ja ka zhvilluar dhe vazhdon aktivitetin e saj pranë Akademisë së Sigurisë, sipas **Urdhrit nr.158 datë 23.08.2022** të ish Ministrit të Brendshëm.

5. Referuar dokumentacionit të administruar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e cila ka hartuar projektvendimet e Këshillit të Ministrave, rezulton se pasuria e kaluar në përgjegjësi administrimi të MFE/Ndërmarrja Industriale Nr.1 të pronës prej 28,439.8 m² nga MB/QASHMT, me datën 21.11.2019 sipas vendimit **nr. 528, datë 25.07.2019, është privatizuar, sipas kontratës datë 30.06.2020 të lidhur ndërmjet:**

Pala shitëse: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike i përfaqësuar me autorizimin Nr. 17612, date 02.10.2019, nga Zoti N. S., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shitjes, dhe Ndërmarrja Industriale Nr. 1 e përfaqësuar nga Znj. E. P., me detyrë Drejtor i Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë, dhe

Pala blerëse:

1. Trashëgimtarët e subjektit të M. Ll.,
2. Trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar H. B. dhe Z. A. ,
3. Trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar Z. A.,
4. Trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar M. B.,
5. Trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar B. Xh.,
6. V. D., shtetase shqiptare, banuese ne Rrugën e Kavajës Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
7. K. D., shtetas shqiptar banues në Tiranë, i identifikuar madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Gjithashtu shtetasve V. D. dhe K. D., u shitet edhe sipërfaqja nën objekt dhe funksionale prej **3765.85 m²** e objektit në proces privatizimi, e cila në bazë të kufirit të pronës të përcaktuar në Relacionin tekniko hartografik në të cilën është pasqyruar prona e ish- pronarëve të truallit si dhe objektit në proces privatizimi, **ndodhet jashtë kufirit të pronës së ish- pronarëve te sipërpërmendur.**

Në objektin e kontratës citohet se: *Sipërfaqja gjithsej e objekteve të "Qendrës së Shërbimit dhe Administrimit të Transportit" të ndodhura në Tiranë është **28,095 .6 m²** dhe sipërfaqe nën objekt 10,862.58 m². Trualli me Nr. Pasurie 6/145 me sipërfaqe 463 m² i cili rezulton i regjistruar në pronësi të shoqërisë "P. C. A. shpk dhe ndodhet brenda sipërfaqes së përgjithshme prej 28 095.6 m² nuk përfshihet në privatizim.*

Çmimi i shitjes së objektit bashkë me sipërfaqen e truallit prej 3765.85 m², në total është **348,103,114 lekë.** nga e cila 232,178,953 lekë vlera e mjeteve kryesore dhe 115,924,161 lekë për truallin me sipërfaqe 3765.85 m². Kjo vlerë është paguar pjesërisht nga pala blerëse, për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Tiranë, sipas kushteve të vendosura në Autorizim për kryerjen e pagesave të objekteve të “Qendrës së Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit” të ndodhura në Tiranë, Nr: 11382 Prot. datë 17.06.2020,

duke ndryshuar të drejtën e pronësisë shtetërore në pronë private.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme ka përgjegjësi:

1. Z. P. N.me detyrë, ish Sekretar i Përgjithshëm i MB.

Për sa më sipër nuk është paraqitur observacion në fazën e RPA.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. **Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi përgatitjen e Programit Buxhetor

Afatmesëm dhe kryqëzimit dhe krahasimit të të dhënave midis PBA 2022-2024 dhe PBA 2023-2025, u konstatuan se 14 projekte investimi, si projekte të reja në vlerë më të ulët, duke ruajtur tavanet buxhetore të miratuara, e më pas në PBA 2023-2025 rriten me një vlerë të konsiderueshme. Konkretisht, në PBA 2022-2024 janë parashikuar me një vlerë totale prej 458,408 mijë lekë, ndërsa në PBA 2023-2025 janë parashikuar në vlerën totale prej 981,369 mijë lekë, ose 522,961 mijë lekë më shumë.

Nga auditimi i planifikimit për vitin 2023, u konstatua se 21 projekte investimi nuk reflektohen në PBA 2023-2025, ose reflektohen me vlera të konsiderueshme më të ulëta, me qëllim ruajtjen e taveve të miratuara dhe alokimin e fondeve për projekte të reja. Për vitin 2022, rezultoi se, për 23 projekte me vlerë 343,148 mijë lekë, të realizuara nuk kanë qenë të planifikuara në PBA 2022-2024 dhe për vitin 2023, u konstatua se për 15 projekte investimi me vlerë 204,347 mijë lekë të realizuara nuk kanë qenë të planifikuara në PBA 2023-2025. Gjithashtu për vitin 2023 në 21 projekte investimi, në PBA 2022-2024 parashikoheshin në shumën 578,719 mijë lekë, ndërsa në PBA 2023-2025 parashikohen në shumën 284,222 mijë lekë, me një diferencë prej 294,497 mijë lekë. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, pika 7 dhe Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” paragrafi 7.1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 17-33, të Raportit të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Ministria e Brendshme të marrë masa për krahasimin e kërkesave buxhetore në vitin aktual me kërkesat buxhetore të PBA-ve të viteve të kaluara duke rakorduar ecurinë e investimeve kapitale me qëllim vlerësimin dhe prioritizimin e projekteve të reja të investimeve, respektimin e pragjeve minimale e maksimale financiare për çdo kategori të projekteve të investimeve publike, mirëmenaxhimin e tyre për të evituar krijimin e detyrimeve të prapambetura, ndryshimet në prioritetet e projekteve, si dhe cenimin apo favorizimin e projekteve specifike.

Në vijimësi

1.2 Rekomandimi: Titullari i Institucionit në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit Strategjik, të marrin masat e nevojshme në mënyrë që në periudhat në vijim të eliminohen praktikat e çeljes së projekteve të reja pa kaluar në procedurat e ciklit të menaxhimit të investimeve publike, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga ana institucioneve të varësisë së Ministrisë së Brendshme, si dhe nga vetë aparati i Ministrisë së Brendshme, si njësi shpenzuese, nuk janë hartuar raportet e monitorimit si dhe relacionet shpjeguese 4-8-12 mujore për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit të secilës njësi shpenzuese më vete, për të garantuar përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, ndjekjen dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara, sipas deklaratës së politikës së programit, si dhe krahasimin e treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik. Raportet e monitorimit janë hartuar në bazë të programeve buxhetore nga Ekipi i Menaxhimit të Programeve, ku monitorimi është kryer për të gjithë programet e MB pa hartuar raporte 4 mujore monitorimi sipas Udhëzimit nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të Buxhetit në NJQQ” dhe Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar të nenit 65. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 17-33, të Raportit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Brendshme të marrë masat, për hartimin e raporteve

të monitorimit të buxhetit 4-8-12 mujore për aparatën e MB-së dhe njësitë e varësisë si njësi shpenzuese për produktet e buxhetit të administruara, me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i situatës së detyrimeve të prapambetura për vitin 2022, rezulton se përgjatë periudhës ushtrimore ka pasur një rritje në shumën 246,608,212 lekë, krahasuar me gjendjen e detyrimeve të prapambetura të raportuara në vitin 2021. Shtesa e detyrimeve për vitin 2022 ka ardhur kryesisht si pasojë e mos likuidimit në afat të kontratave me palë të treta si dhe nga Institucioni i IKMT-së në shumën 120,700,596 lekë, për shkak të mos ndjekjes së procedurave ligjore nga ana e IKMT-së në lidhje me shembjen e objekteve duke krijuar detyrime me impakt në riskun e likuidimit të kamatëvonesave dhe krijimin e vështirësive financiare. Nga auditimi i situatës së detyrimeve të prapambetura për vitin 2023, rezulton se përgjatë periudhës ushtrimore ka pasur pakësim në shumën 324,344,696 lekë. Gjithashtu nga auditimi i raportimeve periodike mbi ecurinë e detyrimeve të prapambetura për të cilat MB ka dërguar në MFE, rezulton se vlera e raportuar mbi gjendjen e detyrimeve të prapambetura për vitin 2022 në MFE është në shumën 833,5 milionë lekë, *shumë e cila nuk rakordon dhe nuk pasqyrohet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të Konsoliduar të Institucionit ku është regjistruar gjendja e detyrimeve të prapambetura për vitin 2022, konkretisht në llogarinë nr.486 “shpenzime të periudhave të ardhshme”* në shumën 819,641,150 lekë, për rrjedhojë *me një diferencë të pa regjistruar dhe të pa kontabilizuar* në krahasim me të dhënat e raportuara në MFE, në shumën 13,9 milionë lekë. Nga auditimi i raportimeve periodike mbi ecurinë e detyrimeve të prapambetura për të cilat MB ka dërguar në MFE, rezulton se vlera e raportuar mbi gjendjen e detyrimeve të prapambetura për vitin 2023 në MFE është në shumën 572,7 milion lekë, *shumë e cila nuk rakordon dhe nuk pasqyrohet gjendjen e detyrimeve të prapambetura të Institucionit ku konkretisht janë në shumën 565,389,912 lekë, për rrjedhojë me një diferencë të pa regjistruar dhe të pa kontabilizuar* në krahasim me të dhënat e raportuara në MFE, në shumën 7,3 milionë lekë.

Sa më sipër, nga ana e Institucionit të MB, nuk është hartuar dhe përcaktuar një strategji konkrete në lidhje me njohjen e saktë dhe reale të detyrimeve si edhe shlyerjen e tyre.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 61, Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42, Udhëzimi nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pikat nga 60 – 68. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 17-33, të Raportit të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për evidentimin dhe pasqyrimin real të detyrimeve të prapambetura në Pasqyrat Financiare, duke rakorduar me të dhënat e detyrimeve të paraqitura në MFE.

Në vijimësi

3.2 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të merren masa për hartimin e një strategjie konkrete dhe efektive për njohjen e saktë dhe reale të detyrimeve si edhe të krijohet një plan shlyerje në lidhje me situatën e detyrimeve të prapambetura dhe të pa regjistruara në kontabilitet.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në strukturat e Ministrisë së Brendshme të miratuara në periudhën objekt auditimi është konstatuar se, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar nuk ka varësi

direkt nga Nëpunësi Autorizues, (NA) por është nën Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse duke cenuar varësisë e marrëdhënies ndërmjet Nëpunësit Zbatues (NZ) dhe Nëpunësit Autorizues të njësisë publike. Pozicionimi i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar me përbërje sektorin e Financës në varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse pra jo si një strukturë administrative më vete që i raporton direkt Nëpunësit të Autorizuar nuk mundëson linjën direkt të raportimit të Nëpunësit Zbatues tek Nëpunësi i Autorizuar, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 12, pika 1, Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 44, si dhe neni 16, pika 2, Ligji Nr. 90/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 33-58, të Raportit të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi: Titullari i MB në lidhje me pozicionin e Nëpunësit Zbatues të vlerësojë dhe të rishikojë modelin e organizimit të institucionit dhe të marrë masa për ndryshimin e varësisë funksionale të DBMF duke ri-kërkuar përshtatjen e strukturës organike aktuale, miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.116, datë 28.07.2022, në mënyrë të tillë që të respektohen kriteret ligjore, për të eliminuar mospërputhjen që cenon përmbushjen e objektivave të njësisë publike.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave mbi strukturën organike aktuale të miratuar të Ministrisë së Brendshme, rezulton një numër i konsiderueshëm vendesh vakante, 25 të tillë, si dhe qarkullime të shpeshta të stafit në pozicione të përkohshme fenomen i cili konstatohet për të gjithë vitet objekt auditimi duke sjellë mangësi në organizimin e disa drejtorive, si dhe rrishton e dobëson performancën e institucionit në mos kryerjen me eficiencë të funksioneve të tyre. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 33-58, të Raportit të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Titullari i MB, në bashkëpunim me DAP të marrë masa, që vendet vakante të plotësohen nga punonjës që përmbushin kriteret sipas pozicionit, duke shpallur dhe rishpallur nevojën për plotësimin e këtyre vendeve me qëllim plotësimin e strukturës dhe arritjen e objektivave të institucionit. Gjithashtu të analizohen shkaqet e qarkullimit të shpeshtë të stafit dhe të adresohen ato.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Me gjithë rekomandimet e lëna nga KLSH ajo që konstatohet është se institucioni derisa ka dalë rregullorja e re (në vitin 2022) ka funksionuar me rregulloren e vjetër të vitit 2019 e cila nuk është përputhur me strukturën e re. Nuk ka një ndryshim, përditësim në rregulloren me të cilën Ministria e Brendshme ka operuar gjatë vitit 2022, ku mungon përshtatja e punës për sektorët si pjesë e Drejtorive të MB-me, në kundërshtim me VKM nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshtatjen dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura. Në vijim edhe rregullorja aktuale e miratuar me Urdhrin Nr. 3778/1 prot., datë. 05.04.2023 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Brendshme”, është 9 muaj me vonë nga miratimi i strukturës së re organike, veprime në kundërshtim me Ligjin 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 33-58, të Raportit të Auditimit).*

6.1 Rekomandimi: Sekretari i Përgjithshëm i MB së bashku me strukturat përkatëse të marrë masa që në vijim me ndryshimet strukturore të kryejë dhe të përditësojë në kohë reale aktet e reja normative në përputhje me funksionet e reja të krijuara.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit konstatohet se, në të gjitha rastet dosjet janë të inventarizuara por në disa prej tyre mungon dokumentacioni i plotë si: diplomat ose diplomat e nivelit të dytë të pa noterizuara, në 4 raste mungonte certifikata e aftësisë shëndetësore, në 5 raste mungonte dëshmia e penaltetit, në 7 raste mungonte lista e notave. Gjithashtu në dosjet e audituara asnjë nga dosjet nuk e ka të inventarizuar raportin mjeko- ligjor të azhurnuar në zbatim të VKM nr. 124, datë 17.02.2016 (i ndryshuar me VKM nr. 747, datë 19.12.2018) “Për pezullimin dhe lirim nga Shërbimi Civil” kreu III, pika 23, paragrafi 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 33-58, të Raportit të Auditimit).*

7.1 Rekomandimi: Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të marrë masa të plotësojë dosjet e personelit me gjitha të dhënat e karakterit teknik, profesional, për administrimin e saktë dhe të nevojshëm të dokumentacionit në mirë funksionimin e kontrollit të brendshëm duke mos neglizhuar dhe respektuar kriteret ligjore.

Në vijimësi

8.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se prona me sipërfaqe 28,452 m² ku ushtronte aktivitetin ish-QSHAMT, institucion në varësi të MB, në harkun kohor prej 24 orësh, pa u kryer paraprakisht një studim dhe vlerësim i ankesës së ardhur nga qytetarët¹⁸, në raport me interesat e Ministrisë së Brendshme dhe për funksionin e rëndësishëm që QSHAMT ka në administrimin dhe riparimin e mjeteve të MB dhe DPPSH, nëpërmjet vendimeve nr. 528, datë 25.07.2019 dhe nr. 529, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave, propozuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, kaluan përkatësisht në pronësi të MFE-së dhe pasuritë me nr. 3/771, 3/772, 3/773, 3/774, zona kadastrale 8240, me sipërfaqe totale 4,122 m² (7 herë më e vogël se sipërfaqja në të cilën ushtronte aktivitetin QSHAMT) me vendndodhje në Rrugën Hamdi Pepa, në përgjegjësi administrimi të MB-së, me qëllim që në këtë pronë të zhvendosej QSHAMT, veprime në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar. Konstatohet që veprimet e mësipërme janë të pastudiuara dhe të nxituara, duke sjellë pasoja për Ministrinë e Brendshme, pasi asetet në pronësi të QSHAMT nuk mund të përshtaten në një sipërfaqe sa 1/7 e sipërfaqes që MB dispononte dhe aktualisht Drejtoria e Menaxhimit të Mjeteve të Transportit -DMMT (ish-QSHAMT), sot ende nuk ushtron aktivitetin e saj as në pronën e dhënë¹⁹ me nr. 3/771, 3/772, 3/773, 3/774, me sipërfaqe totale 4,122 m². Procedura e tjetërsimit të pronës është kryer jashtë çdo afati kohor të parashikuar në dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndonëse nuk ka pasur asnjë emergjencë për inicimin e këtij projekt akti, ku për miratimin e VKM-ve do të duheshin minimalisht 10 ditë kalendarike nga propozimi tek miratimi i projekt-aktit, veprime që nuk janë në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", përgjegjësi kjo e MFE dhe MB. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqet 134-152, të Raportit të Auditimit).*

8.2 Gjetje nga auditimi: Procesi i pastudiuar i tjetërsimit të pronave ka sjellë implikime financiare për buxhetin e shtetit, përdorim të fondeve buxhetore sipas VKM nr. 980, datë 02.12.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e projektimit, zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të Qendrës së Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve

¹⁸ Procedura e zhvendosjes së vendndodhjes së QSHAMT është iniciuar nga një letër-ankesë e datës **04.07.2019** dërguar nga shoqata “PSEDA-ILIRIA” për mbrojtjen dhe zhvillimin mjedisor, e cila kërkonte adresimin e çështjes së zhurmës që vinte nga parku i automjeteve të Ministrisë së Brendshme, çka sillte shqetësim për banorët.

¹⁹ Vendimi nr. 529, datë 25.07.2019, i MFE.

të Transportit”, në vlerën 259,699 mijë lekë, *jashtë destinacionit të miratuar nga ligjvënësi dhe për pasojë është shoqëruar me vonesa të procesit të rindërtimit dhe korrigjimin në kohë të efekteve të fatkeqësisë natyrore për qytetarët e dëmtuar, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 97/2019 ‘Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”* ku subjektet përfituese, përcaktohet se janë individët dhe familjet, që kanë humbur një ose më shumë anëtarë të familjes dhe/ose kanë pësuar dëme në banesat e tyre dhe kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe institucionet publike që kanë pësuar dëme në ndërtesat apo infrastrukturën publike në pronësi apo në administrim të tyre, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, *në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë.* Ndryshimi i destinacionit të fondeve të rindërtimit nga MFE, në vlerën prej 259,699 mijë lekë dhe përdorimi i tyre për qëllime të tjera që nuk kanë lidhje me korrigjimin e pasojave të tërmetit, është përdorim pa ekonomikitet i fondeve të buxhetit të shtetit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqet 134-152, të Raportit të Auditimit).*

8.3 Gjetje nga auditimi: Referuar dokumentacionit të administruar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e cila ka hartuar projektvendimet e Këshillit të Ministrave, rezulton se pasuria e kaluar në përgjegjësi administrimi të MFE/Ndërmarrja Industriale Nr.1 të pronës prej 28,439.8 m² nga MB/QASHMT, me datën 21.11.2019 sipas vendimit nr. 528, datë 25.07.2019, *është privatizuar, sipas kontratës datë 30.06.2020 të lidhur ndërmjet: Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike dhe Ndërmarrjes Industriale Nr. 1 dhe palës blerëse ku janë trashëgimtarët e pronës ku çmimi i shitjes së objektit bashkë me sipërfaqen e truallit prej 3765.85 m², në total është 348,103,114 lekë. nga e cila 232,178,953 lekë vlera e mjeteve kryesore dhe 115,924,161 lekë për truallin me sipërfaqe 3765.85 m², duke ndryshuar të drejtën e pronësisë nga shtetërore në pronë private.* *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqet 134-152, të Raportit të Auditimit).*

8.1 Rekomandimi: Nga ana e MB, të merren masa për të nventarizuar, regjistruar e saktësuar pronësitë e aktiveve që ajo disponon, duke vendosur një korrespondencë me ASHK dhe të rifreskohen kartelat/hartat treguese të saj, të specifikohen qartazi kufijtë e pasurive të paluajtshme që janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë apo posedimit rast pas rasti. Ministria e Brendshme të marrë masa që në të gjitha çështjet që përfshijnë tjetërsimin e pronës shtetërore, iniciativat ligjore të ndjekin përcaktimet e kuadrit ligjor në fuqi dhe pas kryerjes së një analize dhe studimi nga specialistët e fushës mbi nevojën apo domosdoshmërinë e transferimit të pronës, pasojat dhe kostot financiare që mund të sjellë tjetërsimi i pronës shtetërore, duke garantuar një proces vendim marrje transparent dhe ligjor, bazuar në analizën kosto përfitim si dhe vlerësimin nëse mund të ushtrohet plotësisht e në formë të pa cenuar aktiviteti i Institucionit që i transferohet pronësia që disponon.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i urdhër shpenzimeve të likuiduara nga ana e Ministrisë së Brendshme, me datën e faturës tatimore, u konstatua se për periudhën 2021-2023, janë kryer likuidime në tejkalim të afatit ligjor 30 ditor, gjithsej 60 urdhër shpenzime me një vlerë totale 100,417 mijë lekë, përgjegjësi kjo jo vetëm e DBMF por kryesisht e Drejtorive përbërëse të aparatit të MB të cilat kanë marrë shërbimet përkatëse dhe kanë sjellë me vonesë praktikën e pagesave. Mos pagesa në kohë e faturave, shkakton premisë në aplikimin e sanksioneve dhe kamatëvonesave, moslikuidimi i të cilave në afat në dëm të interesave të shtetit, janë veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në

RSH”, i ndryshuar, neni 52 si dhe Ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 58-66, të Raportit të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues në bashkëpunim me drejtorinë e varësisë, pjesë e strukturës së MB, të marrin masa për të paraqitur në afat në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, kërkesat për shpenzime si dhe dokumentacionin justifikues mbështetës, brenda afatit 15 ditor nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik, me qëllim shmangien e detyrimeve dhe kamatëvonesave që mund të gjenerohen me kosto në buxhetin e shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Shuma e përlloritur e efekteve financiare që burojnë nga vendimet gjyqësore që kanë marrë formë të prerë për ekzekutim, nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t’u shlyer sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, por janë njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42. Kjo ka sjellë mos pasqyrim të drejtë të llogarive në pasqyrën e “Pozicionit financiar”. Për periudhën në auditim 2021-2023 numri i të rikthyerve në punë është 8 punonjës ndërsa është pushuar ekzekutimi i titullit ekzekutiv për 3 persona të cilët nuk janë rikthyer në punë edhe pas gjetjes dhe ofrimit të pozicionit përkatës. Janë të pa sistemuar për rikthimin në punë, ende 8 persona me vendim gjyqësor të formës së prerë, të cilët vazhdojnë të paguhen nga buxheti i shtetit si dhe t’u mbahen kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore çdo muaj.

Konstatohet se efekti negativ financiar në buxhetin e shtetit nga MB, për 2021-2023, për pagesën ndaj gjyqësive, është 66,838,356 lekë, kur ndërkohë vende bosh në strukturë janë 25. Shpenzimet përmbartimore janë në vlerën e 2,261,079 lekë duke sjellë kosto shtesë në buxhetin e shtetit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Drejtësisë, Nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit” pika 5. Në respekt të këtij detyrimi ligjor MB rezultoi se nuk ka publikuar on line në faqen zyrtare të saj, grafikun e shlyerjes së detyrimeve sipas përcaktimit të bërë në këtë udhëzim, e cila fillon me likuidimin e detyrimeve duke njoftuar menjëherë gjyqësuesin.

Kjo ka sjellë rritje të shpenzimeve të kryera për shërbimin përmbartimor për vitin 2023, rreth 4 herë më shumë krahasuar me vitin 2022, çka tregon për një risk të vazhdueshëm në ndikimin financiar negativ që kanë të larguarit nga puna pa të drejtë në Ministrinë e Brendshme. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 33-58, të Raportit të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, të marrë masa në vijimësi për ndjekjen me përparësi të proceseve gjyqësore dhe përcjelljen në kohë të informacionit të plotë dhe të saktë të vendimeve të gjykatës të formës së prerë, në njësinë përkatëse, përgjegjëse për financë/kontabilitetin.

- Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi, që menjëherë pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë të bëjë regjistrimin në kontabilitet të detyrimit të plotë të titullit ekzekutiv, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i aktiveve të regjistruara në programin “Financa 5” rezultoi se në llogarinë 32 “Inventar i imët”, rezulton se janë regjistruar padrejtësisht si inventar i

imët zëra të aktiveve afatgjata materiale si Ventilator, elektro pompa, Hard disk, makinë grirëse dokumentesh etj., me një vlerë totale prej 1,785,671 lekë.

Sa më sipër veprime në kundërshtim të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Klasa 2 “Aktivet Afatgjata”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 66-89, të Raportit të Auditimit*).

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa të menjëhershme, për verifikimin e diferencave të konstatuara nga rakordimi i të dhënave të sistemit “Financa 5” dhe atyre të pasqyruara në pasqyrat financiare dhe më pas të bëjnë korrigjimet dhe sistemimet e nevojshme, duke bërë që në llogarinë e aktiveve afatgjata materiale të paraqitet vlera e drejtë dhe e rakorduar sipas kërkesave të teknikave kontabël.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zërave të “Llogarive të arkëtueshme” u konstatua se llogaria 423-429 “*Personeli, paradhënie, deficite, gjoba*” në shumën 32,989,574 lekë përfaqëson të drejtat që i kanë lindur institucionit të MB-së për të arkëtuar debitorë, e cila daton që në vitin 2005 dhe përfaqësojnë gjoba ndaj punonjësve. Nga informacioni i vënë në dispozicion, këto të drejta nuk janë arkëtuar dhe kanë kaluar afatin e parashkrimit për arkëtimin e tyre. Nga ana Institucionit për këtë vlerë nuk është proceduar në rrugë gjyqësore për mbledhjen e tij, si rrjedhojë kjo shumë rezulton e paarkëtueshme, pasi ka humbur fuqinë ligjore, bazuar në Kodin Civil, neni 114. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 66-89, të Raportit të Auditimit*).

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat për kryerjen e analizave të nevojshme për sistemimin e këtyre vlerave, të cilat janë të parashkruara dhe evidentohen si të pa arkëtueshme, me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të Institucionit.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura dhe njohjes së tyre në pasqyrat financiare të aparatit të Ministrisë së Brendshme u konstatua se:

1. detyrimet e prapambetura të regjistruara mbi sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si edhe tatimit nga të ardhurat personale paraqiten në shumën 3,749,062 lekë, ku nga krahasimi i kryer me të dhënat e raportuara nga sistemi C@ts rezulton se Aparati i MB, ka gjendjen e detyrimeve në shumën 17,113,821 lekë. Sa më sipër, diferenca prej 13,364,759 lekë nuk është njohur dhe regjistruar në pasqyrat financiare të institucionit;

2. nuk janë paraqitur detyrimet e krijuara nga viti 2015 deri në muajin Qershor të vitit 2022, të cilat janë shpenzime për energji elektrike për llogari të OSHEE, mbi konsumin e energjisë elektrike si edhe kamatëvonesave të aplikuar për periudhën e mos shlyerjes së detyrimit, edhe pse nga institucioni i MB dhe OSHEE është lidhur një marrëveshje për shlyerjen e këtij detyrimi me këste. Për rrjedhojë shpenzimet për këto vite kanë qenë në shumën 136,142,855 lekë, e cila përbëhet nga vlera e faturave të pa likuiduara në shumën 67,516,013 lekë/detyrime dhe kamatëvonesave në shumën 68,626,842 lekë., vlerë kjo më e madhe se detyrimet. Ky detyrim nuk është regjistruar si edhe të jetë njohur në kontabilitet në llogarinë nr.486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*”, duke sjellë për pasojë paraqitjen e një situatë jo reale të detyrimeve të prapambetura të cilat Institucioni ka ndaj të tretëve në periudha të ndryshme.

Sa më sipër, të dhënat e paraqitura dhe të raportuara nga ana e Institucionit MB, nuk paraqesin gjendjen reale si dhe detyrimet nuk janë të regjistruara në kontabilitet me vlerë të plotë.

3. Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore, njohjen e tyre në kontabilitet dhe likuidimin e tyre nëpërmjet bankës rezultoi se në vitin 2022 janë likuiduar në shumën totale

vendimet gjyqësore, të cilat kanë marrë formë të prerë në shumën prej 17,407,291 lekë dhe në shumën 16,521,176 lekë për vitin 2021.

Këto vendime gjyqësore nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t'u shlyer.

- Si pasojë, llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nuk pasqyron vlerën e saktë në pasqyrat financiare të viteve 2021 dhe 2022. Në këtë zë nuk janë reflektuar detyrimet sa i takon shpenzimeve të periudhave të ardhshme për vendimet gjyqësore, të cilat kanë marrë formën e prerë përpara mbylljes së pasqyrave financiare të vitit ushtrimor.

- Gjithashtu shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos u njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë të Vendimit të Gjykatës, por janë njohur në momentin e likuidimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtime me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 61, Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 66-89, të Raportit të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi, që menjëherë pas lindjes së detyrimit të bëjë regjistrimin në kontabilitet të detyrimit të plotë, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Në vijimësi

13.2 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi për të rakorduar me Sektorin e Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, sa i takon informacionit të plotë të vendimeve të gjykatës të formës së prerë, të cilat duhet të njihen në vlerën e tyre të plotë, si detyrime për tu shlyer në periudhat e ardhshme dhe për të cilat duhet të provigjionohen shumat përkatëse. Njëkohësisht vlera e tyre duhet njohur edhe si shpenzim periudhe në pasqyrat financiare të institucionit.

Në vijimësi

13.3 Rekomandimi: Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, të marrë masa për ndjekjen me kujdes të proceseve gjyqësore dhe përcjelljen në kohë të informacionit të plotë dhe të saktë në njësinë përkatëse, përgjegjëse për financë/kontabilitetin, në mënyrë që kjo e fundit të njohë dhe kontabilizojë në kohë vlerat që lidhen me këto shpenzime/detyrime, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së inventarizimit dhe elementeve analitikë përbërës të llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” ka rezultuar se Sistemi i adresave, dhoma ICT në DPGJC, ndërtimi i ndërfaqes së komunikimit RKGJC dhe RKA dhe Portali ri sistemit regjistrit kombëtar të Gjendjes Civile nuk është marrë në dorëzim nga AKSHI. Nga Ministria e Brendshme është ngritur grupi i punës për ndjekjen e procedurës së dorëzimit të aktiveve për infrastrukturën e sistemeve IT, i cili ka identifikuar disa pajisje dhe softëare IT, të cilat aktualisht janë të regjistruara në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” me vlerën 373,205,543 lekë. Nga ana tjetër, sa i takon sistemeve të mësipërme, rezulton se nuk janë përfshirë për kalim në institucionin e AKSHI-t. Rezulton se kjo procedurë nuk ka përfunduar, dhe nuk ka akt dorëzimi tek AKSHI. Nga auditimi është konstatuar se këto aktive vazhdojnë të jenë pjesë e pasqyrave financiare të MB. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me VKM. nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar, pika 18. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 66-89, të Raportit të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Nga Ministria e Brendshme në bashkëpunim me AKSHI-n të merren masa

të menjëhershme për kalimin e Sistemeve dhe infrastrukturës TIK ekzistuese nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive analitike 214 “*Instalime teknike, makineri e pajisje*” dhe 218 “*Inventar ekonomik*” u konstatua se:

-për llogarinë 214, amortizimi është përlllogaritur me normën 5%, duke sjellë një vlerë jo të saktë të zhvlerësimit nga amortizimi;

- pajisjet kompjuterike janë klasifikuar si në llogarinë 218, dhe jo në llogarinë 214. Gjithashtu, nga analiza e zërave të aktiveve dhe amortizimin e tyre zë për zë u konstatua se artikuj si kondicioner, printer, kompjuter, fotokopje janë amortizuar me normën 20% duke u klasifikuar aktive të tjera AGJ, dhe jo si “*Kompjuterë, pajisje të ruajtjes së të dhënave, softë e sisteme informacioni*” ku norma e amortizimit llogaritet mbi bazë grupimi me normën 25%.

Veprimet e mësipërme janë kryer jo në përputhje me udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar pika 36, duke ndikuar në mos pasqyrimin e saktë të gjendjen neto të aktiveve, si dhe ndikimi i amortizimit vjetor në fondin neto të institucionit. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 66-89, të Raportit të Auditimit*).

15.1 Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa për ri klasifikimin e pajisjeve kompjuterike në llogaritë kontabël 214 “*Instalime teknike, makineri e pajisje*”, si dhe në ri llogaritjen e amortizimit të akumuluar me normat përkatëse për këto artikuj, me qëllim përcaktimin e vlerës reale neto të gjendjes së aktiveve që institucioni disponon.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i regjistrimit të aktiveve, u konstatua se një pjesë e këtyre aktiveve pasi i është zbritur amortizimi i akumuluar ndër vite vlera e tyre është papërfillshme ose zero. Këto aktive vazhdojnë të jenë në përdorim dhe gjendje pune. Nga institucioni nuk janë marrë masa për të ngritur grupe e pune me ekspertë të fushave për këto artikuj, për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të këtyre aktiveve, ku pas këtij shqyrtimi të bëhet rivlerësimi i vlerës së tyre. Ndryshimet në jetën e pritshme të dobishme dhe të vlerës së tyre të kontabilizohen duke ndryshuar periudhën e amortizimit apo metodën, sipas rastit, dhe të trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 103, si dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar pika 33. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 66-89, të Raportit të Auditimit*).

16.1 Rekomandimi: Nga ana e titullarit të institucionit të MB të merren masat e nevojshme për ngritjen një komisioni me ekspertë të fushave, për artikujt, për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të këtyre aktiveve, ku të bëhet përcaktimi i sakte i vlerës së këtyre aktiveve në përdorim dhe më pas, mbi bazën e aktit të rivlerësimit, institucioni të realizojë regjistrimet e vlerës së tyre në kontabilitet.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*” u konstatua se detyrimi prej 139,973 lekë paraqet garanci bankare të trashëguara nga projekti LAMP ndër vite. Këto fonde gjenden të ngurtësuar që nga viti 2014, për të cilat rezulton se

është tejkaluar afati i garancisë dhe nuk është bërë zhblokimi i tyre sipas kushteve të kontratave respektive. Sektori i Financës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të bërë ç'ngurtësimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre në buxhetin e OE, në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme, Kapitulli II, pikat nr.29, 30, 39 dhe 50; UKM nr.3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kapitulli II, pika nr.10.6. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 66-89, të Raportit të Auditimit).

17.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të merren masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, duke rakorduar në mënyrë periodike vlerat e llogarisë, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detyrimeve afatgjata u konstatua se llogaria 17 “Huatë afatgjata” paraqitet në shumën zero lekë në pasqyrat e dorëzuara nga MB në Degën e Thesarit. Nga kryqëzimi i të dhënave midis pasqyrave financiare fizike me pasqyrat e dorëzuara nëpërmjet Sistemit Informatik Qeveritar(SIFQ), u konstatua se: Në pasqyrat e dorëzuara nga MB në Degën e Thesarit llogaria 17 “Hua Afatgjatë” paraqitet në shumën zero lekë, ndërsa në pasqyrat financiare në sistemin SIFQ, përkatësisht në pasqyrën e pozicionit financiar, kjo llogari paraqitet në shumën 34,977,500 lekë. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Sektori i Financës u konstatua se kjo shumë përfaqëson një kredi të marrë për projektin e Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës (LAMP) nga IBRD të marrë në vitin 2013 dhe është mbartur në pasqyra financiare që nga viti 2013, por nga Sektori i Financës nuk ka informacion për shlyerjen e saj. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar klasa 4 “Detyrime afatgjata”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 66-89, të Raportit të Auditimit).

18.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim verifikimin e shumës së huasë prej 34,977,500 lekë, si dhe nga ana e Sektorit të Financës të bëhen sistemimet përkatëse në pasqyrat financiare me qëllim paraqitjen reale të detyrimeve që ka Ministria e Brendshme.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i “Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto” dhe rakordimi me pasqyrimin e vlerave në pasqyrën e pozicionit financiar në rubrikën C ka një pasqyrim jo të drejtë të vlerave në pasqyrë. Aktivet neto nuk rakordojnë me fondet neto, dhe për disa zëra nuk ka informacion sesi sektori i financës ka arritur në rezultatet e mësipërme. Llogaria 1013 “Nga konsumi i AAGJ(-)” paraqet amortizimin e vitit, pra kemi shtesë në amortizim për vlerën 99,138,161 lekë dhe duke i zbritur amortizimin në pakësim në shumën 7,119 lekë, vlera neto është 99,131,042 lekë. Kjo llogari paraqitet në shumën 99,145,280 lekë dhe ka një diferencë prej 14,238 lekë. Gjithashtu, në pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve neto nuk janë plotësuar të gjithë zërat që përfaqësojnë ndryshimet e ndodhura në nga burimet e brendshme. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimi i MFE nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.” (Më

hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 66-89, të Raportit të Auditimit).

19.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim më të drejtë të fondit neto, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së inventarizimit, rezultoi se për vitet 2021 dhe 2022 janë ngritur komisionet përkatëse të inventarizimit, nga ku grupi i auditimit konstatoi se Kryetari i komisionit të inventarizimit është përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe anëtarë janë specialistët e Sektorit të Financës, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011, i ndryshuar pika 82 si dhe ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 22 “veprimtaria e kontrollit” pika 3.b “ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin”.

- Nga auditimi i dosjes së inventarizimit u konstatua se titullari i institucionit, pas evidentimit nga komisioni i inventarizimit të aktiveve të dëmtuara, ka ngritur komisionin për vlerësimin e aktiveve, ku janë vlerësuar për dalje jashtë përdorimit në llogarinë 327 “*Inventar i imët*” në shumën 3,341,033 lekë dhe në llogarinë 312 “*Materiale konsumi*” në shumën 1,489,325 lekë. Sa më sipër, rezulton se procedurat e inventarizimit nuk janë të finalizuara pasi nuk janë ndjekur nga proceset e daljes jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit të atyre aktiveve që nuk kanë destinacion tjetër, dhe pse nga komisioni i vlerësimit janë vlerësuar për dalje jashtë përdorimit në shumën 4,830,358 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 96.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 66-89, të Raportit të Auditimit).

20.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit në cilësinë e NA të marrë masa në vazhdimësi për shmangien e përfshirjes së punonjësve në proceset e punës, të cilat mund ta vendosin atë në konflikt interesi, me qëllim funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm sa më të qëndrueshëm dhe më efektiv.

Në vijimësi

20.2 Rekomandimi: Titullari i Institucionit në cilësinë e NA të marrë masa në vazhdimësi për ndjekjen e procedurave për aktivet e dala jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit të atyre aktiveve që nuk kanë destinacion tjetër, me qëllim finalizimin e procesit të inventarizimit.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi regjistrimin e ndërtesave në ASHK, rezultoi se 2 (dy) ndërtesa me vlerë fillestare 502,927,990 lekë (Godina qendrore dhe Oborri i Ministrisë) janë të regjistruara dhe 9 (nëntë) ndërtesa (pjesë e kontabilitetit të MB) me vlerë fillestare 80,344,402 lekë nuk janë të regjistruara dhe nuk disponohen në kartelat e tyre të pronësisë. Objektet e paregjistruara, janë kryesisht tunele që i kanë shërbyer MB, të ndërtuara në vitet 1932 – 1935 (objekti “Shtylla” dhe 4 qendrat e ndërlidhjes, vendkomanda Linzë në vitin 1921 dhe 3 tunelet “Tomori”, të ndërtuara nga viti 1970 – 1974.

Nga komisioni i inventarizimit, për llogarinë 212 “*Ndërtesa dhe Konstruksiione*”, gjatë procedurës së inventarizimit, është mbajtur një tabelë me të dhënat përkatëse për të gjitha ndërtesat që MB ka në pronësi, për të cilat është konstatuar se 5 (pesë) ndërtesa, përkatësisht Qendrat e Ndërlidhjes Mullet me nr. 1, 2, 3, 4 dhe 5 janë objekte të amortizuara dhe shkatërruara

plotësisht. Sa më sipër, nga ana e komisionit të inventarizimit për vitet 2021 dhe 2022, në fund të procesit nuk është mbajtur asnjë procesverbal në terren, si dhe nuk është përgatitur një raport mbi inventarizimin e llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” veprime jo në përputhje me paragrafin 85/c të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.

Përpos konstatimeve të Komisionit të inventarizimit mbi dëmtimin apo mungesën e aktiveve, Ministria e Brendshme nuk ka marrë masa për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve si dhe analizimit të situatës së këtyre objekteve për ti kthyer ato në eficient dhe funksionalë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 66-89, të Raportit të Auditimit).

21.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat, për verifikimin e gjendjes reale dhe statusin e pronave si dhe të kryhet vlerësimi i këtyre aktiveve, regjistrimi i tyre në ASHK, duke përgatitur të gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të kalimit të aktiveve, nga një subjekt në tjetrin mbështetur në Urdhrat për “Kalim kapitali pa pagesë” u konstatua mungesë dokumentacioni për rastet: procesverbali i marrjes në dorëzim, kartela shoqëruese e llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga MB deri në momentin e daljes nga pronësia. Gjithashtu mungon Akt konfirmimi i njësisë pritëse të marrjes së asetëve dhe të regjistrimit të tyre si kapital i institucionit. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, në kapitullin III të udhëzimit “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”. Mungesa e dokumentacioneve shoqëruese le të hapur ciklin e transferimit të kapitalit nga një institucion në tjetrin. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 66-89, të Raportit të Auditimit).

22.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat, që përpara se të bëjë reflektimin e pakësimit ose të shtesës së aktiveve në kontabilitet nga lëvizjet kapitale pa pagesë brenda apo jashtë sistemit, të disponojë të gjithë dokumentacionin përkatës të kalimit kapital të aktiveve hyrëse ose dalëse, me qëllim mbylljen e ciklit të transferimit si dhe verifikimin e reflektimit në kontabilitet të tyre.

Në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje mbi bazë risku i procedurave të prokurimit “sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar” (gjithsej 35 procedura) për periudhën në auditim 2021-2023, si gjetje e përbashkët u konstatua:

-Në të gjitha rastet e audituara, procedurat e prokurimit realizohen kryesisht 1-2 ditë para datës së udhëtimit. Praktika e miratimit për pjesëmarrje në evente bëhet me vonesë nga Drejtoria e Kabinetit, jo menjëherë nga momenti i njoftimit nga organizatorët. Vonesa në fillimin e procedurave të prokurimit, sjell si pasojë blerjen e biletave të transportit ajror me kosto të lartë. Në disa nga urdhër shpenzimet e përzgjedhura për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar, si dhe në disa urdhër-pagesa të shërbimeve-dieta jashtë vendit të punonjësve, të likuiduara nëpërmjet arkës, u konstatua mungesa e ftesës së vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve. Me anë të këtyre dokumente, vërtetohet qëllimi dhe objekti i shërbimit si dhe pjesa e shpenzimeve që do të mbulojë organizatori dhe pjesa që do të mbulojë buxheti i shtetit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 89-117, të Raportit të Auditimit).

23.1 Rekomandimi: Sekretari i përgjithshëm i institucionit të marrë masa që menjëherë pas dërgimit të ftesës për pjesëmarrje në takime/evente jashtë vendit, të përgatitet dokumentacioni ligjor në kohë optimale duke respektuar afatet për qarkullimin e shkresave administrative, në

mënyrë që blerja e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me sistem dinamik blerje të kryhet jo në datë të përafërt (apo brenda ditës) me datën e nisjes.

- Sektori i Financës të marrë masa që në të gjitha praktikatat për udhëtime dieta për jashtë shtetit, dokumentit të pagesave t'i bashkëngjitet ftesa e vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Në disa nga rastet e audituara (blerje të vogël dhe sistem dinamik blerje), vihet re tërheqja e operatorëve ekonomik fitues në fazën e lidhjes së kontratës, me pretendimin se “*ka ndryshuar çmimi*” me të cilin kanë ofertuar ose me pretendimin se “*është përlllogaritur gabim fondi limiti*” me të cilin kanë ofertuar duke sjellë si pasojë që, kontrata të lidhet me OE të renditur më pas, me një vlerë më të lartë. AK, nuk ka raportuar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik për rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik nga procedura, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 30, pika 6. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 89-117, të Raportit të Auditimit*).

24.1 Rekomandimi: Komisioni i vlerësimit të ofertave të marrë masa që në të gjitha rastet e tërheqjes së OE pjesëmarrës në procedura prokurimi të raportojë në kohë reale pranë Agjencisë së Prokurimit Publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 4 (katër) procedurave të prokurimit “Blerje e vogël” me objekt “Punë dhe shërbime”, në Ministrinë e Brendshme dhe konkretisht për procedurat:

-Procedura e hapur me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtjen e sistemit të kondicionimit në Ministrinë e Brendshme”, korrik 2021,

- Procedura e hapur me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtjen e gjeneratorit në Ministrinë e Brendshme”, nëntor 2021.

- Procedura e hapur me objekt: Shpenzime për mirëmbajtjen e sistemit të kondicionimit në Ministrinë e Brendshme”, maj 2022

- Procedura e hapur me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtjen e sistemit të kondicionimit në Ministrinë e Brendshme”, gusht 2023

U konstatua se KVO për blerjet e vogla nuk ka kryer verifikimin me korrektësi të plotësisimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, të vendosura nga vetë ky komision të cilat janë për të garantuar se OE që do të paraqiten pranë AK, janë të specializuar për ofrimin e shërbimit të kërkuar dhe për rëndësinë e punimeve që do të kryejnë në përputhje me standardet teknologjike, veprime në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020. Konkretisht kriteri bazë i vendosur për procedurat e sipërcituara ka qenë *punësimi nga OE, i të paktën 1(një) inxhinieri elektrik dhe një specialisti elektrik të licencuar, të certifikuar nga një institucion i formimit profesional* për të cilin në dosjen fizike nuk ka pasur dokumente që vërtetojnë praninë në skemën e sigurimeve shoqërore për të paktën një muaj. Grupi i auditimit ka verifikuar dhe ka konstatuar se OE lidhin kontrata punësimi dhe nuk bëjnë deklarin e këtyre punonjësve në listë pagesën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore në shkelje të detyrimeve kontraktuale si dhe në kundërshtim me Ligjin 9920 dt. 19.05.2008, i ndryshuar “Për procedurat tatimore në RSH”. Në lidhje me mangësitë në plotësimin e kriterëve nga OE pjesëmarrës në garë dhe shpallur fitues, nga KVO-ja nuk rezulton të jetë kërkuar asnjë sqarim nga ofertuesi për të motivuar apo argumentuar vendimin e tyre në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 89-117, të Raportit të Auditimit*).

25.1 Rekomandimi: AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja,

përpara së të kryejë një s' kualifikim apo kualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Rast pas rasti

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave në procedurat e prokurimit të përzgjedhura për t'u audituar dhe verifikimit të likuidimit të urdhër shpenzimeve brenda afatit 30 ditor nga data e lëshimit të faturës, për periudhën në auditim u konstatuan se

-Për vitin 2021, konstatohet së Urdhër shpenzimi për likuidimin e faturës 17/2021, është kryer rreth 49 ditë me vonesë nga afati 30 ditor i përcaktuar në Ligjin nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", i ndryshuar, neni 7, germa c/i),

-Për vitin 2022, konstatohet së Urdhër shpenzimet për likuidimin e faturës: 120/2022 dhe 110/2022, është kryer përkatësisht 42 ditë me vonesë nga afati 30 ditor dhe 120 ditë me vonesë, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", i ndryshuar, neni 7, germa c/i), e cila përcakton se:

-Për vitin 2023, urdhër shpenzimet me nr. 428, datë 28.12.2023 si dhe 223, datë 14.07.2023, janë kryer me vonesë nga 60 ditë për urdhrin e parë dhe rreth 90 ditë për urdhrin e dytë, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", i ndryshuar, neni 7, germa c/i. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 89-117, të Raportit të Auditimit).*

26.1 Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues të marrë masat të paraqesë në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se: Për periudhën në auditim nuk është mbajtur asnjë mbledhje e Grupit të menaxhimit Strategjik, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", lidhur me rolin e GMS në sistemin e MFK.

Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimeve për punonjësit e Institucionit për ngritjen e nivelit profesional, ku të përcaktohen përparësitë si dhe nevojat më të mëdha në llojin e temave të përzgjedhura për trajnim.

Për periudhën objekt auditimi janë hartuar raportet e monitorimit 4-8-12 mujore të konsoliduara të buxhetit të Ministrisë së Brendshme, por institucionet e varësisë, dhe Ministria e Brendshme si institucion buxhetor më vete, nuk i kanë hartuar këto raporte, veprime në kundërshtim Udhëzimi nr. 22, datë 17.11.2016, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore", pika 42 kapitulli III dhe 41.2 kapitulli III.

Shkëmbimi i informacionit ndërmjet punonjësve të institucionit si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht kryhet sipas rregullores së Ministrisë, por në këtë rregullore të brendshme parashikohen kanalet dhe mënyra periodike e raportimit vetëm për Sekretarin e Përgjithshëm dhe Drejtorët e Përgjithshëm duke sjellë mungesë të harmonizimit të punës dhe bashkëpunimit midis njërive të ndryshme në institucion.

MB nuk ka asnjë rregullore të përditësuar në kuadër të strategjisë ndër sektoriale për "Agjendën Digjitale të Shqipërisë" miratuar me vendim Nr. 370, datë 1.6.2022, kjo në ambientin e riskuar nga sulmet kibernetike ku aktualisht prej dy vitesh Qeveria e Shqipërisë ndodhet. *(Më hollësisht*

trajtuar në pikën 6, faqe 117-134, të Raportit të Auditimit).

27.1 Rekomandimi: Titullari i MB në lidhje me pozicionin e Nëpunësit Zbatues të konsiderojë dhe njëherë modelin e organizimit të institucionit dhe të marrë masa që të ri-kërkohej përshtatja e strukturës organike aktuale, miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.116, datë 28.07.2022, në mënyrë të tillë që të respektohen kriteret ligjore, duke eliminuar mospërputhjen që cenon përmbushjen e objektivave të njësisë publike.

Menjëherë

27.2 Rekomandimi: Për të rritur njohuritë e stafit mbi çështjet e MFK të merren masa që të përfshihen në planin vjetor të trajnimeve tema në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin, për të gjithë stafin e Ministrisë së Brendshme.

Institucioni të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar strategjinë e riskut, e cila duhet të përditësohet rregullisht, të paktën 1 herë në 3 vjet, si dhe sa herë kur mjedisi i riskut pëson ndryshime të rëndësishme, duke bërë kështu vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që venë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë.

Në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi dhe krahasimi i planeve strategjike (3 vjeçare) dhe planeve vjetore u konstatua se subjektet e planifikuara për tu audituar sipas viteve të përcaktuara në planet strategjik, ndryshonin nga një vit në tjetrin duke bërë që plani strategjik dhe vjetor mos të ketë një rrjedhë të natyrshme por ndryshim të tij në mospërputhje me Manualin e AB, pika 3.4. Në planin vjetor dhe strategjik të drejtorisë së auditimit të brendshëm për periudhën 2021-2023, për vitin 2022 ishte planifikuar auditimi i 22 subjekteve të cilat nuk janë audituar konform këtij plani strategjik, pasi me Urdhër Nr.327 datë 19.10.2021 (Nr.5691/6 Prot.), janë shtuar 4 misione auditimi për njësitë shpenzuese “Policia e Shtetit “. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 117-134, të Raportit të Auditimit).*

28.1 Rekomandimi: Të merren masa nga ana e Drejtorisë së Auditimit të brendshëm të Ministrisë së Brendshme, mbi zbatimin me korrektesë dhe dokumentimit të ndryshimeve dhe rishikimeve të planit vjetor e strategjik, duke argumentuar arsyet e korrigjimit të planit si dhe dërgimit të këtyre ndryshimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MF.

Në vijimësi

28.2 Rekomandimi: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në vazhdimësi pas miratimit të Komitetit të Auditimit të Brendshëm, me urdhrin e Ministrit nr. 58 datë 12.03.2024 të zbatojë kuadrin ligjor dhe rregullator lidhur me shpërndarjen dhe menaxhimin e punës sipas prioritarizimit të vendosur në bashkëpunim me KAB.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i urdhër shpenzimeve për pagesat e shpenzimeve gjyqësore, u konstatua se nga ana e MB janë kryer pagesat për vendimet gjyqësore ku përfshihen edhe tarifat përmbartimore me TVSH në vlerën 2,952,523 lekë. Për këto vlera nuk ka fatura tatimore dhe rrjedhimisht nuk është mbajtur tatimi në burim në vlerën 442,878 lekë. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 33. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 58-66, të Raportit të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Nga Institucioni të merren masat për llogaritjen dhe mbajtjen e tatimit në burim për pagesat e tarifave e subjekteve përmbarimore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të cilat nuk dorëzojnë faturën TVSH-së.

Në vijimësi

1.2 Rekomandimi: Nga ana e Sektorit të Financës të merren masat për kontabilizimin dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës 442,878 lekë nga subjektet përmbarimore përfituar padrejtësisht si rezultat i mos mbajtjes të tatimit në burim mbi të ardhurat nga shërbimi përmbarimor.

Në vijimësi

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i urdhër shpenzimeve mbi pagesat e energjisë elektrike u konstatua se MB i ka lindur detyrimi prej 136,142,855 lekë, e cila përbëhet nga vlera e faturave të pa likuiduara në shumën 67,516,013 lekë dhe kamatëvonesave në shumën 68,626,842 lekë për të cilat institucioni ka lidhur një aktmarrëveshje për shumën totale propozuar shlyerjen në 60 këste. Çdo muaj është paguar fatura e muajit përkatës dhe një këst. Sa më sipër, nga auditimi u konstatua se Ministria e Brendshme ka likuiduar vetëm një pjesë të faturave të paraqitura nga OSHEE për furnizimin me energji elektrike. Edhe pse nga ana e MB ka pasur përpjekje për zgjidhjen e kësaj situate, mungesa e fondeve dhe mosbashkëpunimi i OSHEE-së ka sjellë që situata të mbetet e paqartë. Ankesat dhe kërkesat e përsëritura nga ana e MB-së nuk kanë marrë përgjigje nga ana e OSHEE, duke lënë Ministrinë në një situatë të vështirë financiare. Nga ana tjetër, edhe pse është lidhur akt marrëveshja midis palëve, u konstatua se ky detyrim nuk është regjistruar si edhe të jetë njohur në kontabilitet në llogarinë nr.486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*”, duke sjellë për pasojë paraqitjen e një situate jo reale të detyrimeve të prapambetura të cilat Institucioni ka ndaj të tretëve në periudha të ndryshme. Sa më sipër, u konstatua se pagesat e faturave të energjisë elektrike ndaj OSHEE janë kryer me vonesë, përtej afatit ligjor parashikuar nga Ligji nr.48/2014, “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare*”, neni 7, germa ‘c’. Mosrespektimi i afatit ligjor lidhur me pagesat e faturave të konsumit të energjisë elektrike, ka sjellë që Ministria e Brendshme të penalizohet me kamatëvonesa në vlerën 68,626,842.82 lekë, menaxhim pa efektivitet, eficiencë dhe economicitet i fondeve publike. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, 4, në faqet 58-66,66-89, të Raportit të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit në bashkëpunim me Strukturat Drejtuese, të marrin masat e nevojshme për shlyerjen e detyrimit pa vonesa të institucionit të MB-së kundrejt OSHEE, me qëllim shmangien e përdorimit të fondeve publike pa economicitet, eficiencë dhe efektivitet si pasojë e llogaritjes së kamatëvonesave në shumën 68,626,842.82 lekë.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se përveç efektit negativ financiar që mbartin shlyerja e vendimeve gjyqësore për të larguarit pa të drejtë nga puna dhe mos sistemimit të tyre në organikën aktuale të MB një pasojë tjetër me kosto në buxhetin e shtetit është detyrimi që ka gjeneruar dhe rivlerësimi i listë pagesave mujore me këta gjyqë fitues në vite si rezultat i tej zgjatjes së proceseve gjyqësore. Nga verifikimi i detyrimeve të prapambetura të deklaruara në

pasqyrat financiare me ato në sistemin tatimor C@TS konstatohet se Ministria e Brendshme ka detyrime në Kontributet e Sigurimeve shoqërore e shëndetësore detyrimet (deri më datë 06.03.2024), në vlerën 17,399,158 lekë ku të ndarë sipas llojeve të tatimit vërehet se peshën më të madhe e kanë Kontributet e Sigurimeve shoqërore e shëndetësore në vlerën 15,488,419 lekë dhe Tatim mbi të ardhurat personale në vlerën 1,910,739 lekë ose e thënë ndryshe 96,5 % e detyrimeve totale të pushlyera dhe të mbartura relativisht në një kohë të gjatë, janë gjoba dhe kamatëvonesa në Kontributet e Sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Nisur nga sa më sipër, grupi i auditimit verifikoi “moshën” e borxhit në këtë lloj tatimi si dhe arsyen e këtyre vlerave të larta ku vetëm gjobat dhe interesat janë 10,828,310 lekë. Në analizën e kryer u konstatua se këto gjoba dhe interesa vijnë si rezultat i likuidimit të vendimeve gjyqësore për të larguarit nga puna, për një kohë relativisht të gjatë, si nga tej zgjatja e proceseve gjyqësore ashtu edhe në mos kthimin në vendin e punës të gjyqe fituesve, ku përveç pagave që paguhen nga buxheti i shtetit për këta ish punonjës, duhet të krijohet edhe një tjetër dëm dhe kjo për ndërhyrje në kohë në listë pagesat e viteve të mëparshme. Për periudhën në auditim 2021-2023, MB ka gjeneruar detyrime në kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në vlerën 1,585,626 lekë, të përfshira këto në vlerën totale të cituar më sipër. (17,399,158 lekë).

Kjo ndërhyrje në sistemin tatimor C@TS ka gjeneruar këto gjoba dhe interesa në vlera të konsiderueshme dhe ajo që përbën risk potencial është se përveç mungesës së koordinimit midis vetë institucioneve qendrore MB dhe MFE (DPT) nuk ka asnjë nismë për ecurinë e mëtejshme dhe zgjidhjen e këtij problemi me një kosto në dëm të buxhetit të shtetit në vlerën 17,399,158 lekë, për të cilat mban përgjegjësi MB, MF dhe DPT. Drejtoria e buxhetit dhe menaxhimit financiar në MB nuk kishte ndjekur ecurinë e tyre periodikisht si dhe nuk i kanë pasqyruar në detyrimet e prapambetura në pasqyrat financiare të MB duke mos i “njohur” ato si të tilla, çka ka sjellë mos pasqyrim të drejtë të llogarive në pasqyrën e “Pozicionit financiar”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 61, Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.

Sa më sipër, vlera prej 84,238 mijë lekë e përbërë nga:

- 64,577 mijë lekë, paga (përfshirë këtu edhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore +TAP);
- 2,261, mijë lekë -shpenzime përmbartimore
- 17,399 mijë lekë - gjoba + kamatëvonesa në sigurime shoqërore dhe TAP, konsiderohet si shpenzim pa efektivitet për buxhetin e shtetit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 33-58, të Raportit të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave (Drejtoria e përgjithshme e tatimeve) të bashkëpunojnë dhe të marrin masa të menjëhershme në vlerësimin e detyrimit prej 17,399,158 lekë, të cilat janë gjoba dhe kamatëvonesa në kontribute të sigurimeve shoqërore dhe Tatim mbi të ardhurat personale të gjeneruara prej vitit 2008 e në vijim, të pa pasqyruara në pasqyrat financiare të Ministrisë së Brendshme si detyrim i prapambetur e për rrjedhim i padeklaruar as në pasqyrat financiare të konsoliduara të MB në MFE.

- Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave të marrin masa për shlyerjen/sistemimin e këtij detyrimi i cili është evident në sistemin C@TS dhe “njihet” si i tillë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHITIT